



# SAMI FRASHERI



SAMI FRASHERI



# V E P R O A O

PUBLIKASIA & KUMTESAT

# VEPRA SÄMILI

VEPRA 00

BIBLIOGRAFIA  
&  
KUMTESAT



V

E

R

Biblioteka:  
BOTIME TË VEÇANTA

SAMI FRASHËRI - VEPRA  
00

Redaktor i përgjithshëm:  
ROF. DR. XHEVAT  
K. LOSHI

AVO





# LEPRA SÄHÄRI SAM

VEPRA 00

BIBLIOGRAFIA  
&  
KUMTESAT





## **PARATHËNIE**

---

Me rastin e njëqindvjetorit nga dita kur mbylli sytë enciklopedisti i madh dhe Rilindësi Sami Frashëri, u mbajt në Shkup më 19-20 nëntor 2004 Konferenca Shkencore “Sami Frashëri 100 vjet pas, 1904-2004”. Konferenca u organizua nga Shtëpia Botuese Logos-A, në bashkëpunim me Administratën Ndërkombëtare Turke të Bashkëpunimit dhe Zhvillimit “TIKA” dhe SHKH “Merhamet” Shkup. Merrnin pjesë studiues nga Maqedonia, Shqipëria, Kosova, Turqia, Italia, Japonia, përfaqësues të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Republikës së Maqedonisë. Ishin të ftuar edhe intelektualë, pedagogë të universiteteve, shkrimtarë, politikanë, botues, si dhe ambasadori i R. së Shqipërisë dhe ambasadori i R. së Turqisë në R. e Maqedonisë. Duke qenë Shemsedin Sami Frashëri një figurë që i bashkon popujt e Ballkanit në trashëgiminë e tyre shkencore e kulturore, Konferenca Shkencore ishte ndërkombëtare dhe tuboi njëkohësisht studiues nga trojet ku jetojnë shqiptarët bashkë me shkencëtarë të vendeve të tjera. Merrte pjesë edhe stërmbesa e Sami Frashërit nga Turqia, zonja Samie Oz. Organizimin e Konferencës Shkencore e drejtoi një komision, i përbërë nga kryetari Mr. Adnan Ismaili, Drejtor i SHB Logos-A, me anëtarë Prof. dr. Xhevat Lloshi, Akad. Ali Aliu, Akad. Luan Starova, Prof. dr. Ismail Ahmedi dhe Prof. dr. Mehdi Polisi.

Konferenca u mbajt në mjediset e ASHARM dhe i zhvilloi punimet në katër sesione. Tubimin shkencor e



përshëndetën Ministri i arsimit dhe shkencës i Maqedonisë, dr. Aziz Pollozhani, kryetari i ASHARM, akademiku Cvetan Grozdanov dhe personalitete shkencore, politike e fetare të pranishme. Pastaj u lexuan 18 kumtesa, rreth të cilave u bënë edhe diskutime. Punimet e konferencës sollën një varg ndihmesash të reja për jetën dhe veprën e ideologut të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, dijetarin enciklopedist, shkrimtarin e publicistin me personalitet poli-edrik si veprimtar në kulturën shqiptare dhe në kulturën e re turke. Për herë të parë studiuesit nga një varg vendesh hapën një dritare komunikimi shkencor rreth veprimtarisë së shumanshme të këtij personaliteti të shquar, i cili ka botuar vepra në disa gjuhë, në një kohë që në asnjërën prej këtyre gjuhëve nuk gjendet e botuar tërësisht vepra e tij, për shkak të mungesës së përkthimeve të dyanshme. Tashmë dalin në dukje si qëndrimet e Samiut lidhur me fatin e atdheut të vet dhe të Rilindjes Shqiptare, ashtu edhe idetë e tij reformatore në lëvizjen turkiste, duke e parë të ardhmen e popujve me të njëjtin këndvështrim të përparimit kombëtar. Në veprat e tij enciklopedike bashkohen kulturat dhe qytetërimet Lindore e Perëndimore, duke pasur vend qendror dijet historike-geografike dhe figurat e shquara të popullit shqiptar dhe të popullit turk. Me të njëjtat metoda bashkëkohore Shemsedin Samiu ka përshkruar gjuhën shqipe dhe gjuhën turke e arabe, duke përçuar po ato ide për ruajtjen e natyrës kombëtare të gjuhëve, për pastërtinë dhe pasurinë e tyre, e me këtë ka ndihmuar kodifikimin e gjuhëve të reja. Fjalori i tij shpjegues i turqishtes mbetet një bazë e përhershme në përpunimin e turqishtes së sotme, ndërsa ai ka punuar edhe për një fjalor shpjegues të shqipes. Fjalorët dygjuhësh të turqishtes me frëngjishten, bashkë me përkthimet ndihmuan breza të tërë për t'u njohur me kulturën e përparuar europiane dhe letërsinë, duke nxitur edhe zhvillimin e gjinive të

reja letrare. Jo rastësisht ai ishte autori i të parit roman turqisht në stilin modern. Edhe veprat e tij dramatike, që patën sukses në skenën turke, sollën ndër të tjera dhe një tematikë shqiptare. Për herë të parë u shprehën në një tubim shkencor mendimet lidhur me ndihmesat e tij në fushën e islamistikës. Hap pas hapi po njihet gjithashtu më thellë veprimtaria e gjerë publicistike e Samiut si në gjuhën turke, ashtu edhe në gjuhën shqipe, duke e shfaqur njëkohësisht atë si dijetar, enciklopedist dhe veprimtar politik, të përfshirë me një zë të fuqishëm në trajtimin e çështjeve të mpërhta të ditës, shpesh me mjeshteri të veçantë polemike.

Konferenca shkencore kushtuar Shemsedin Sami Frashërit jo vetëm paraqiti kontribute të frytshme shkencore, por edhe çeli shtigje të reja studimesh për të ardhmen me bashkëpunimin ndërkombëtar, në veçanti shqiptaro-turk, ndërmjet institucioneve dhe studiuesve. Për ta mbështetur këtë drejtim kërkimor, SHB Logos-A po i boton punimet e Konferencës në këtë vëllim, si vijim të botimit prej njëzet vëllimesh të Veprës së Sami Frashërit.

Për herë të parë një përmbledhje e veprave të Sami Frashërit shqip u ndërmor nga NGB "Rilindja" e Prishtinës e cila botoi vëllimet 1-4 më 1978, vëllimin 5 më 1979 dhe vëllimet 6-8 më 1984. Në vitin 1994 SHB Logos-A mori përsipër vijimin, duke botuar vëllimin 9. Vëllimi 10 doli më 1999 dhe vëllimi i fundit 11 më 2001. Ndërkaq Akademia e Shkencave e Shqipërisë botoi më 1988 një përmbledhje të Veprës së Sami Frashërit në dy vëllime. Shtëpia Botuese Logos-A është interesuar në vazhdimësi për plotësimin e botimeve nga Sami Frashëri dhe sidomos për të vënë në qarkullim përkthime të reja për herë të parë në gjuhën shqipe. Më 1994 SHB Logos-A botoi dy përkthime, në vitin 2002 nxori katër libra të tjerë, në vitin 2003 dy vëllime dhe në vitin 2004 një libër tjetër. Në këtë mënyrë u krijuan mundësitë që të ndërmerrej botimi i një Bi-

biblioteke të Veprave të Sami Frashërit në 20 vëllime, që doli nga shtypi më 2004 nën redaktimin e përgjithshëm të prof. dr. Xhevat Lloshit dhe përkujdesjen e përkthyesit të përkushtuar, prof.dr. Mehdi Polisi. Ky është jo vetëm botimi më i gjerë i derisotëm, jo vetëm përmban përkthime të reja për herë të parë, por sidomos është ushtruar gjithë kujdesi, që lexuesit shqiptar t'u jepej vepra e personalitetit të shquar e pacenuar dhe me përkthimin sa më besnik origjinalit.

Paraqitja e *Veprave të Sami Frashërit në 20 vëllime* u bë më 19 nëntor 2004. Fjalën e hapjes e mbajti Mr. Adnan Ismaili, Drejtor i SHB Logos-A. Me këtë rast për veprën e botuar 20-vëllimëshe të kësaj figure me peshë ndërkombëtare folën edhe prof. dr. Remzi Nesimi, Fahri Kaja dhe dr. Milazim Krasniqi. Materialet e kësaj paraqitjeje gjithashtu botohen në këtë vëllim. Me këtë rast u hap një ekspozitë me mjaft fotografi, disa edhe të panjohura, nga jeta e Sami Frashërit dhe me faksimile prej veprave të tij, e përgatitur me bashkëpunimin e arkivave të Shqipërisë e të Kosovës.

Ky vëllim, si vazhdim i *Veprave të S. Frashërit në 20 vëllime*, është pasuruar me dy bibliografi, për të cilat është bërë përpjekja që të jenë sa më të plota, duke përfshirë edhe botimet më të fundit. Bibliografia *Veprat e Shemsedin Sami Frashërit* përmbledh të gjitha botimet e bëra nga viti 1872 deri në vitin 2006 si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën turke dhe përkthimet në gjuhë të tjera, duke shënuar gjithashtu çfarëdo ribotimi të plotë ose të pjesshëm. Po këtu është dhënë një listë e dorëshkrimeve të njohura ose të përmendura, një listë tjetër e letërkëmbimit të Samiut dhe veçan është paraqitur bashkëpunimi i tij në gazeta e në periodikë. Gjithashtu jepen të dhëna për gjendjen e materialeve nëpër arkiva, duke përfshirë Arkivin familjar të pasardhësve të Sami Frashërit në Turqi, Arkivin e Institutit të Historisë dhe Arkivin Qendror të Shtetit në



Tiranë. Botimi *VEPRA* në 20 vëllime është paraqitur me përmbajtjen e plotë të secilit vëllim, si dhe me njoftime bibliografike plotësuese. *Bibliografia e shkrimeve për Shemsetin Sami Frashërin* përfshin të gjitha shkrimet e punimet kushtuar posaçërisht Sami Frashërit nga viti 1880 deri në vitin 2006 në gjuhën shqipe, turqisht dhe në gjuhë të tjera. Për herë të parë kështu jepet një tablo e gjerë dhe e gjithanshme, e cila dëshmon se vepra e Sami Frashërit mbetet e pavdekshme dhe jep ndihmesën e vet edhe në kulturën bashkëkohore. Bibliografitë janë përgatitur nga prof. dr. Xhevat Lloshi.

Po ashtu duke i qëndruar besnik serisë 20-vëllimëshe të veprave tashmë të botuara të Sami Frashërit nga Logos-A, këtë vëllim po e botojmë nën numrin 00 që të jetë fillim i serisë që fillon me 01, si dhe nga arsyeja se ky libër praktikisht është vepër mbi Samiun e jo nga Samiu.

*Botuesi*



PJESA E PARË  
Bibliografi e veprës së Sami bej Frashërit





## **VEPRAT E SHEMSEDIN SAMI FRASHËRIT**

---

*Pas botimit të parë jepen vitet e ribotimeve (R) dhe të përkthimeve (P).  
Ribotimet dhe përkthimet jepen të plota në vitin përkatës.  
Kur ka vepra në gjubë të ndryshme, të parat jepen botimet shqip.*

### **I. BOTIME**

#### **1872**

*Taaşşuk-ı Tal'at ve Fitnat*. [“Dashuria e Talatit me Fitneten”, roman]. Elcevaib, Stamboll. 179 f.

R. 1964; 1979; 1990; 1997.

P. 1984 shqip; 1994; 2002; *Vepra* 9, 2004.

*Tarih-i Mücmel-i Fransa* [“Histori e shkurtër e Francës” deri në shek. XIV, nga Madame du Saint Ouen; përkthyer nga frëngjishtja me parathënie të S. Frashërit]. Camli Handa Matbaa, Stamboll. 164 f.

#### **1873**

*Galatée* [“Galateja”, roman në vargje i Jeanne Pierre Claris de Florian (1755-1794), botuar frëngjisht më 1783, përkthyer në prozë]. D. Hünkâr Beğendi, Stamboll. 40 f.

*Ihtiyar onbaşı. Beş fasıldan ibaret facia* [“Rreshteri plak”. Pjesë teatrale në pesë akte nga Dumonoir-Donnery; përkthyer nga frëngjishtja, me ilustrime]. D. Hünkâr Beğendi, Stamboll. 62 f.

#### **1874**

*Tarablus-i Garp Tarihi* [“Historia e Tripolit”. Nënftetë e gazetës *Vilayet*]. Tripoli.

## 1875

*Besa Yahud Ahde Vefa. Altı fasıldan ibaret facia* [“Besa ose mbajtja e fjalës së dhënë”. Pjesë teatrale në gjashtë akte]. Me *Parathënie* nga autori. Matbuat-i Ceyyide, 1. Po atë vit nga: Tasvir-i Efkar Matbaası, Stamboll. 176 f.

P. 1901 shqip; 1902 bullgarisht; 1908 italisht; 1913 ribotim shqip; 1918 e përmbledhur frëngjisht; 1937 shqip; 1945 anglisht; 1970 ribotim shqip; 1988 shqip; 2002 shqip; 2004 shqip *Vepra* 8.

*Seydi Yahya. Beş fasıldan ibaret facia* [“Zotëri Jahjai”. Pjesë teatrale në pesë akte]. Matbuat-i Ceyyide, 2. Tasvir-i Efkar Matbaası, Stamboll. 192 f.

P. 2004 shqip.

## 1876

*Gâve. Beş Fasıldan Ibaret Facia*. [“Gave”. Pjesë teatrale në pesë akte]. Matbuat-i Ceyyide, 3. Tasvir-i Efkar Matbaası, Stamboll. 190 f.

P. 2006 shqip.

## 1879

*Dbeshkronjë*, në: “Alfabetare e gjuhësë shqip”, Konstan-  
dinupojë. f. 71-84.

R. 1988.

*Gjuba shqip*, në: “Alfabetare e gjuhësë shqip”, Konstan-  
dinupojë. f. 24-33.

R. 1988.

*Medeniyet-i Islâmiyye* [“Qytetërimi islam”]. Cep Kütüphanesi, nr. 1. Mihran Matbaası,

Stamboll. 126 f.

R. 1885; 1996.

P. 1999 shqip *Vepra* 10; 2002; 2004 *Vepra* 13.

*Esâtir* [“Mitologjitë”]. Cep Kütüphanesi, nr. 2. Mihran Matbaası, Stamboll. 108 f.

R. 1893.

P. 2004 shqip *Vepra* 20.

*Kadınlar* ["Gratë"]. Cep Kütüphanesi, nr. 3. Mihran Matbaası, Stamboll. 96 f.

R. 1894.

P. 1973 shqip; 2004 shqip *Vepra* 15.

*Gök* ["Qielli"]. Cep Kütüphanesi, nr. 4. Mihran Matbaası, Stamboll. 112 f.

P. 2004 shqip *Vepra* 16.

*Yer* ["Toka"]. Cep Kütüphanesi, nr. 5. Mihran Matbaası, Stamboll. 119 f.

P. 2004 shqip *Vepra* 17.

*İnsân* ["Njeriu"]. Cep Kütüphanesi, nr. 10. Mihran Matbaası, Stamboll. 115 f.

P. 2004 shqip *Vepra* 18.

*Emsâl* ["Fjalë të urta". Përmbledhur nga botimet në gazetën "Sabah" gjatë viteve 1876-1877]. Cep Kütüphanesi, nr. 11-14. Mihran Matbaası, Stamboll. 511 f.

P. 1970 shqip; 2002; 2004 shqip *Vepra* 10.

*Şeytanın Yadigârları* ["Bëmat e djallit", roman nga Frédéric Soulié (1800-1847), përkthyer nga frëngjishtja]. Mihran, Stamboll. 595 f.

## 1880

*Sefiller*. Birinci, ikinci ve üçüncü kitap [*Les misérables* – "Të mjerët" nga Victor Hugo. Libri i parë, i dytë dhe i tretë. Përkthim nga frëngjishtja fjalë për fjalë. Vijimi i përkthimit u bë nga H. Bedrettin]. Mihran Matbaası, Stamboll. 645 f.

R. 1934.

## 1882

*Kamûsi Fransevi. Fransızcadan Türkçeye Lügat – Dictionnaire Français-Turc.* [Fjalor frëngjisht-turqisht]. 2 vëll. Editeur Imprimeur Mihran Matbaası, Constantinople, 1630 f.

R. 1898; 1901; 1905.

## 1883

*Küçük Elifba* [“Abetare e vogël” për shkollat fillore Hamidiye]. Stamboll. 39 f.

R. 1887; 1894.

*Letaif* [“Anekdota”]. Cep Kütüphanesi, nr. 17-18. Mihran Matbaası, Stamboll. 224 f.

P. 2003 shqip; 2004 shqip *Veptra* 11.

## 1884

*Dituria*, në: “Drita”, nr. 1, f. 1.

R. 1972; 1988

*Qytetëria*, në: “Drita”, nr. 2, f. 17.

R. 1972; 1988

*Qytetëri e grekeret*, në: “Drita”, nr. 3, f. 40.

R. 1972; 1988

*Himmat-ul-Himâm fi Neşri'l-Islâm* [“Përpyjekjet e heronjve për përhapjen e islamizmit”, arabisht]. Mihran Matbaası, Konstantiniye. 29 f.

P. 1887 turqisht; 1989 shqip; 2003 shqip; 2004 shqip *Veptra* 12.

## 1885

*Qytetëri e arabëvet*, në: “Dituria”, nr. 6, f. 89.

R. 1972; 1988.

*Qytetëri e evropjanëvet*, në: “Dituria”, nr. 8, f. 113.

R. 1972; 1988.



*Hurdeçin* ["Thërrmija", 29 tekste persiane përkthyer turqisht]. Mihran Matbaası, Stamboll, 56 f.

*Kamûs-i Fransevi, Türkçeden Fransızcaya Lügat. – Dictionnaire Turc-Français.* ["Fjalor turqisht-frëngjisht"]. Editeur imprimeur Mihran, Constantinople. 1208 f.

R. 1928.

*Medeniyyet-i Islâmiyye* ["Qytetërimi islam"]. Cep Kütüphanesi, nr. 1. İkinci tab'i. Mihran Matbaası, Stamboll. 123 f.

*Robinson* ["Robinson" nga Daniel Defoe; përkthim sipas përshtatjes frëngjisht të Ambroise Rendue (1778-1860). Parathënia nga S. Frashëri]. Mihran basımevi, Stamboll. 136 f.

*Yine İnsân* ["Përsëri njeriu"]. Cep Kütüphanesi, nr. 26. Mihran Matbaası, Stamboll. 144 f.

P. 2004 shqip *Veptra* 19.

## 1886

*Abetare e gjuhësë shqip.* Drita, Bukuresht, 78 f.

R. 1888; 1900; 1909; 1988; 2004 *Veptra* 4.

Shkronjëto e gjuhësë shqip. Drita, Bukuresht, 138 f.

R. 1979; 1988; 2004 *Veptra* 5.

*Küçük Kamus-i Fransevi. Fransızcadan Türkçeye Lügat* ["Fjalor i vogël frëngjisht-turqisht"]. Mihran Matbaası, Stamboll. 605 f.

*Lisân* ["Gjuha"]. Cild I. Cep Kütüphanesi, nr. 27. Mihran Matbaası, Stamboll. 128 f.

R. 1997 me alfabetin e sotëm të turqishtes.

P. 1983 shqip fragment; 2001 shqip; 2002; 2004 shqip *Veptra* 7.

*Taşrifat-i Arabiyye* ["Eptimet e arabishtes"]. A. Mavyan Matbaası, Stamboll. 71 f.

*Usûl-i Tenkît ve Tertîp* ["Rregullat e pikësimit dhe të rradhitjes"]. Cep Kütüphanesi, nr. 32. Mihran Matbaası, Stamboll. 130 f.

## 1887

*Himmat-ul-Himâm fi Neşri'l-Islâm* ["Përpjekjet e heronjve për përhapjen e islamizmit"]. Përkthyer turqisht nga Girdli Mustafa Nuriu, Hania. Konstantiniye.

*Kavâid-i Sarfiyye-i Arabiyye* ["Rregullat e gramatikës së arabishtes"]. Stamboll.

*Kavâid-i Nabviyye-i Arabiyye* ["Rregullat e sintaksës së arabishtes"]. Stamboll.

*Küçük Elifba* ["Abetare e vogël" për shkollat fillore Hamidiye]. Stamboll. 39 f.

## 1888

*Abetare e gjuhësë shqip*. Dituri, Bukuresht. 78 f.

*Dheshkeronjë*. Dituri, Bukuresht, 158 f.

R. 1988; 2004 *Vepra* 6.

## 1889

*Kamus al-A'lâm – Dictionnaire Universel d'Histoire e de Géographie par Ch. Samy-Bey Frascbery*. ["Fjalor universal i historisë dhe i gjeografisë"]. Editeur Mihran. 6 vëllime. Constantinople 1889-1898: vëll. I f. 14. Fjala e botuesit Mihran, parathënia e Sami Frashërit dhe shënime të tjera 1-800 f.; vëll. II. 1889 f. 801-1600; vëll. III 1891 f. 1601-2400; vëll. IV 1894 f. 2401-3200; vëll. V 1896 f. 3201-4000; vëll. VI 1898 f. 4001-4830.

R. 1996.

P. shqip - zëra për trevat shqiptare dhe figurat; 1988; 1992; 1994; 2004 *Vepra* 2 dhe 3.

## 1891

*Yeni Usul Sarf-i Türki* ["Gramatikë e turqishtes sipas metodës së re"]. Stamboll. 120 f.

*Yeni Usul Elifba-yi Türki* ["Abetare e turqishtes sipas metodës së re"]. A. Asdoryan Matbaası, Stamboll. 96 f.

### 1893

*Esâtir* ["Mitologjitë"]. Cep Kütüphanesi, nr. 2. İkinci tabı. Mihran Matbaası, Stamboll. 108 f.

### 1894

*Kadınlar* ["Gratë"]. Cep Kütüphanesi, nr. 3. İkinci tabı. Mihran Matbaası, Stamboll. 96 f.

*Küçük Elifba* ["Abetare e vogël", botimi i katërt]. Stamboll. 39 f.

### 1896

*Autobiografi*. Shkruar nga Sami Frashëri, bashkë me një letër të S. Frashërit për Ahmet Ihsanin, botuar në "Serveti Fünun" nga ky autor dhe ribotuar lidhur me shkrimin *Ziya-i Elim, Merhum Şemsettin Sami Bey* [Humbje e dhimbshme, i ndjeri Shemsedin Sami Beu], në: "Servet-i Fünun", nr. 687, Stamboll, 10 (23) qershor 1904, f. 162-164.

### 1897

*Gjuha dhe letërsia jonë*, në: "Kopja e vetme e jashtëzakonshme, ndihmë në të holla për nevojtarët e Kretës, mbledhur nga revistat *Tercumani Hakikat* dhe *Servet-i Fünun*", f. 89-91 [sipas A. S. Levend].

### 1898

*Kamus-i Arabi. Arapçadan Türkçeye Lügat*. ["Fjalor arabisht-turqisht". Deri te shkronja e pestë]. Mahmud Bey basımevi, Stamboll. 504 f.

*Kamûs-i Fransevi. Fransızçadan Türkçeye Lügat – Dictionnaire Français-Turc*. [Fjalor frëngjisht-turqisht, me parathënie të re nga S. Frashëri]. Seconde édition corrigée et augmentée. Editeur Imprimeur Mihran Matbaası, Constantinople, 1920 f.

## 1899

*Baki-nin Eş'ar-i Müntehabasi* ["Vjersha të përzgjedhura prej Bakiut" poet i shek. XVI]. Kütüphanesi-i Muntahabat, 1. Mahmud Bey basımevi. Stamboll. 112 f.

*Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë?* Mendime për shpëtimt të mëmëdheut nga reziket që e kanë rethuarë. Bukuresht, 96 f.

R. 1907; 1919; 1923; 1950 fragmente; 1955-1958 fragmente; 1962; 1978; 1980; 1988; 1999; 2001; 2002; 2004 *Vepra* 1.

P. 1904, 1904-1906 dhe 1907 turqisht; 1907 greqisht; 1913 gjermanisht; 1923 italisht; ? frëngjisht.

## 1900

*Abetare e gjuhësë shqip.* Dituria, Bukuresht. 79 f.

*Kamûs-i Türki* ["Fjalor i turqishtes" me parathënie]. 2 vëllime. Ahmet Cevdet, Dersaadet, Stamboll 1900-1901. 1574 f.

R. 1979; 1998.

*Tatbikat-i Arabiyye* ["Ushtrime për arabishten"]. Stamboll. 79 f.

## 1901

*Besa.* Dramë me gjashtë pamje prej Sami Bej Frashërit. Shqipëruar nga turqishtja prej Ab. A. Ypi Kolonja. Mbrothësia, Sofje, 108 f.

*Ali Bin Abu Talib-in Eş'ar-i Müntahabalari ve Şerb ve Tercemesi* ["Vjersha të përzgjedhura të Ali b. Abu Talibit", në shek. VII; arabisht, të përkthyer turqisht e me shpjegime]. Kütüphanesi-i Muntahabat, aded 2. Nasrullah, Stamboll. 125 f.

*Resimli Kamûs-i Fransevi.* *Fransiçadan Türkçeye Lügat Kitabı - Dictionnaire Français-Turc.* [Fjalor frëngjisht-turqisht i ilustruar. Me 3000 gravura]. 3-ème édition entièrement refon-



due. Editeur Imprimeur Mihran Matbaası, Constantinople, 2240 f.

### 1902

*Besa – Çestna Duma. Drama v shest deistvija.* Iz albanski zivot. [“Besa – Fjala e nderit. Dramë me gjashtë akte. Nga jeta shqiptare”]. E përktheu nga shqipja L. J. Siljanov. L.V. Mançov, Plovdiv. 95 f.

### 1904

*Arnautluk Ne Idi, Ne Dir Ve Ne Olacak* [Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhetë?]. Përkthyer nga Sh. Kolonja në “Drita”, Sofje. 19 nëntor – 9 gusht 1906.

### 1905

*Resimli Kamûs-i Fransevi. Fransızcadan Türkçeye Lügat – Dictionnaire français-turc illustré de 3000 gravures.* 3-ème édition entièrement refondue par Ch. Sami-Bey Frascheri [Fjalor frëngjisht-turqisht i ilustruar me 3000 gravura]. Editeur Imprimeur Mihran Matbaası, Constantinople, 2240 f.

### 1907

*Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhetë?* Mendime për shpëtimt të mëmëdheut nga reziket që e kanë rethuarë. Mbrothësia, Sofje, 96 f.

*Arnautluk Ne Idi, Ne Dir Ve Ne Olacak.* [Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhetë?]. Përkthyer nga Sh. Kolonja, Mbrothësia, Sofje. 165 f.

*I Alvania ti ito, ti eine, kai ti prepei na eine.* Skeepseis pros apeleutherosin tes patridos apo tus perikykluntas auten kindynus. [Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhetë? Mendime për shpëtimt të mëmëdheut nga reziket që e



kanë rethuarë]. Përkthim i Nemërçkës, Mbrothësia, Sofje. 126 f.

### 1908

*Besa o la fede albanese. Drama in 6 atti.* [Besa ose betimi shqiptar. Dramë me gjashtë akte]. E përktheu dr. A. Ribecco. Tip. Tuscolano, Frascati. 112 f.

### 1909

*Abetare e gjuhësë shqip.* [Me disa ndryshime]. Rufeja, Konstantinopojë. 66 f.

### 1910

*Bedaiy-I Edebiye* [“Bukuri të letërsisë”, përfshihen 5 artikuj të S. Frashërit për gjuhën dhe letërsinë turke]. Muntehibi: Bulgurzade Riza, Stamboll. 384 f.

### 1913

*Besa. Dramë me gjashtë pamje prej Sami Bej Frashërit.* Shqipëruar nga turqishtja prej Ab. A. Ypi Kolonja. SHB K. Luarasi, 138 f.

*Was war Albanien, was ist es, was wird es werden?* Gedanken und Betrachtungen über die unser geheiligtes Vaterland Albanien bedrohenden Gefahren und deren Abwendung. [Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhetë? Mendime për shpëtimt të mëmëdheut nga reziket që e kanë rethuarë]. Aus dem Türkischen übersetzt von A. Traxler. Alfred Holder, Wien und Leipzig, 69 f.

### 1918

*Sommaire de Bessa (Serment de fidélité)* [Përmbledhje e Besës – Betimi për mbajtjen e fjalës]. “Korça”, Korçë 15 f.

## 1919

*Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë?* Mendime për shpëtimt të mëmëdheut nga reziket që e kanë rethuarë. Worcester Mass.

## 1923

*L'Albania, suo passato, presente ed avvenire.* Bukuresht 1899. Traduzione dal'albanese per Luigi Lorecchio; në: "Albania", nr. 8, Roma. f. 1-91.

*Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe ç'do të bëhetë.* Përshtypje e tretë. [Në kopertinë: 1924]. Sh. "Mbrothësia" K.P. Luarasi. 142 f.

## 1928

*Kamûs-i Fransevi, Türkçeden Fransızcaya Lügat. – Dictionnaire Turc-Français.* ["Fjalor turqisht-frëngjisht i ilustruar"]. Editeur Diran Kelekiyan. Imprimerie Kanaat, Constantinople. 1373 f.

## 1934

*Sefiller.* [*Les misérables* – "Të mjerët" nga Victor Hugo. Përkthim nga frëngjishtja në dy vëllime. Vëllimi i parë prej S. Frashërit.]. Cihan Kütüphanesi, Stamboll. 2670 f. me ilustrime.

## 1937

*Besa.* Dramë me gjashtë pamje prej Sami Bej Frashërit. Shqipëruar nga turqishtja prej Ab. A. Ypi Kolonja. SHB K. Luarasi, 138 f.

## 1945

*Et-Tubfetü'z-Zekiyye fil Lügatit Türkiyye* ["Dhuratë e mençur për fjalorin e gjuhës turke", fjalor turqisht i shek. XV, përkthyer nga arabishtja dhe një shtojcë "Dituria e

gjuhës” me të dhëna gramatikore]. Dorëshkrim, 212 f. Botuar nga Instituti i Gjuhësisë Turke, Stamboll, me parathënie nga Besim Atalay.

*Pledge of honor.* An Albanian tragedy by Sami Bey Frashëri. Translated and edited by Nelo Drizari. S.F. Vanni, New York, 118 f.

### 1950

*Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe ç'do të bëhetë*, fragmente në: “Zëri i popullit”, 13 qershor.

### 1955

*Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe ç'do të bëhetë*, fragmente në: Dh. S. Shuteriqi, “Antologji e letërsisë shqipe për shkollat e mesme”, bot. II 1958, f. 176-182.

### 1957

*Dheu është flori.* Përmbledhur e redaktuar nga B. Dedja, V. Bala, N. Jorgaçi. NSHB Tiranë, 35 f.  
R. 1967; 1973; 1997; 2000.

### 1962

*Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe ç'do të bëhetë.* SHB Naim Frashëri, Tiranë. 110 f.

### 1964

*Taaşuk-ı Tal'at ve Fitnat, İkinci Baskı.* [“Dashuria e Talatit me Fitneten”, përg. për botim dr. Sedit Yüksel]. Üniversite Basımevi, Ankara Üniversitesi. 130 f.

### 1965

*Tregime dhe përralla për të vegjëlit.* [K. Kristoforidhi, N. Frashëri, S. Frashëri]. Tiranë. 24 f.

## 1967

*Dheu është flori.* Përmbledhur e redaktuar nga B. Dedja, V. Bala, N. Jorgaqi. SHB Naim Frashëri. 35 f.

*Skënderbeu* simbas Kamus al-A'lamit të Sami Frashërit. Përkthyer nga T. Dizdari, në: "Ylli", nr. 3.

## 1970

*Besa. Dramë në gjashtë pamje.* Shqipëroi nga turqishtja A. Kolonja. Prishtinë, 126 f.

*Fjalë të urta të zgjedhura.* Përkthyer nga Zyber Bakiu, në: "Nëntori", nr. 6, f. 133-173.

## 1972

*Dituria.* Ribotuar në: A. Kondo, "Drita" – "Dituria". SHB e Librit Politik, Tiranë. f. 76-82.

*Qytetëria.* Ribotuar në: A. Kondo, "Drita" – "Dituria". SHB e Librit Politik, Tiranë. f. 83-91.

*Qytetëri e grekëve.* Ribotuar në: A. Kondo, "Drita" – "Dituria". SHB e Librit Politik, Tiranë. f. 92-99.

*Qytetëri e arabëve.* Ribotuar në: A. Kondo, "Drita" – "Dituria". SHB e Librit Politik, Tiranë. f. 100-106.

*Qytetëri e evropjanëve.* Ribotuar në: A. Kondo, "Drita" – "Dituria". SHB e Librit Politik, Tiranë. f. 107-114.

## 1973

*Dheu është flori.* Rilindja, Prishtinë, 69 f.

*Gratë.* E përktheu H. Bushati. Shkodër.

R. 2004.

Shkrime të zgjedhura për fëmijë. SHB Naim Frashëri, 28 f.

R. 1975

## 1974

*Mendimet aforistike të Sami Frashërit,* në: "Jeta e re", nr. 2, f. 256-259.

## 1975

*Shkrime të zgjedhura për fëmijë.* SHB Naim Frashëri, Tiranë. 28 f.

## 1978

*Vepra.* Rilindja, Prishtinë (1978-1984):

Vëll. 1: *Besa, me Parathënie* nga V. Shita, 160 f.

Vëll. 2: *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet?* E. Reso, Parathënie; Sh. Demiraj, Disa shënime të përmbledhura rreth gjuhës së veprës. Fjalorth i veprës (f. 117-121). 123 f.

Vëll. 3: *Fjalë të urta, me parathënie "Fjalë të urta" të Sami Frashërit* nga S. Çarçani, 149 f.

[Vëll. 4: Zija Xholi, *Sami Frashëri* (Monografi) 153 f.]

*Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?* Mendime për shpëtim të mëmëdheut nga reziket që e kanë rethuarë. Dituria. Prishtinë.

## 1979

*Vepra.* Rilindja, Prishtinë:

Vëll. 5: *Shkronjëtove e gjuhësë shqip* (Rishtypje dhe transliterim). (Përgatiti për shtyp R. Ismajli, me parathënie f. 7-13). 294 f.

*Kamûs-i Türki.* [Fjalor i turqishtes], 2 vëllime. Stamboll, 1574 f.

*Şiir ve Edebiyattaki Teceddüd-i Ahirimiz,* në: "Yeni Türk Edebiyatı Antolojisi", III. Përgatitën M. Kapllan etj. Stamboll.

*Taaşuk-u Tal'at ve Fitnat. İkinci Baskı* [me alfabetin e sotëm turqisht]. Ankara. 180 f.



## 1980

*Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë?* Mendime për shpëtim të mëmëdheut nga reziket që e kanë rethuarë. SHB e Librit Shkollor. 130 f.

## 1983

*Formimi i fjalëve dhe përcaktimi i emrave* (Nga "Lisan"). Përktheu F. Mehdiu, në: "Dituria", Prishtinë, nr. 1, f. 116-119.

## 1984

*Vepra*. Rilindja, Prishtinë:

Vëll. 6 : *Dashuria e Talatit me Fitneten*. Përkthim nga M. Polisi e R. Lata. 153 f.

Vëll. 7: *Kâmus Al-Alâm. Pjesë të zgjedhura*. Zgjodhi dhe përktheu F. Mehdiu. 186 f.

[Vëll. 8: Z. Bakiu, Bibliografi e zgjeruar e veprave të Sami Frashërit. 289 f.]

## 1988

*Vepra*. Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë:

Vëll. 1: *Besa* (Përkthyer nga V. Buharaja). Zëdhënësi i Lindjes (Përkthyer nga K. Prifti, V. Buharaja). Alfabetare e gjuhësë shqip. Drita dhe Dituria. Abetare e gjuhësë shqip. Dheshkronjë. 439 f.

Vëll. 2: *Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë? Shkronjëto e gjuhësë shqip*. Fjalor i përgjithshëm i historisë dhe i gjeografisë (Përkthyer 96 zëra lidhur me trevat shqiptare dhe figurat shqiptare nga S. Pulaha). Nga letërkëmbimi. 391 f.

## 1989

*Përhapja e Islamizmit* [Himmat-ul-Himâm fi Neshri'l-Islâm], përkthyer nga M. Ajdini, Prizren.

## 1990

*Taaşşuk-ı Tal'at ve Fitnat*. [“Dashuria e Talatit me Fitneten”], Enderun Kitabevi, Stamboll.

## 1992

*Personalitetet shqiptare në Kamus al-A'lâm*. në Dituria islame, nr. 22-23 /shkurt-mars, 1991 deri në nr. 43/ nëntor, 1992, Prishtinë. Përkthyer nga M. Polisi.

## 1994

*Vepra*. Logos-A, Shkup:

Vëll. 9: *Personalitetet shqiptare në Kamus al-A'lâm të Sami Frashërit*, me parathënie të M. Polisit, Sami Frashëri dhe Kamus al-A'lâm; Fjalor terminologjik (f. 137-170). 173 f.

R. 2002.

*Dashuria e Talatit me Fitnetin*. Roman. E përkthyen nga origjinali turqisht M. Polisi e R. Lata. Elena Gjika, Tiranë, 132 f.

*Personalitetet shqiptare në Kamus al-A'lâm të Sami Frashërit*. Përktheu M. Polisi. SHB Logos-A, Shkup. 169 f.

*Përhapja e Islamit*. Përktheu M. Ajdini. Bot. 3, SHB Logos-A, Shkup. 46 f.

## 1996

*Kamus al-Alâm – Dictionnaire Universel d'Histoire e de Géographie* par Ch. Samy-Bey Fraschery. [“Fjalor universal i historisë dhe i gjeografisë”].Vëll. I-VI, Kaşgar Neşriyat, Ankara.

*Medeniyet-i Islâmiyye* [“Qytetërimi islam”], ribotuar nga: E. Çalık në: *Şemseddin Sami ve Medeniyet-i Islamiyye*. [Shemseddin Samiu dhe Qytetërimi islam]. İnsan Yayınları, Stamboll.

[Shkrime të zgjedhura nga veprat e Sami Frashërit] botuar nga E. Çalık në: *Şemseddin Sami ve Medeniyet-i Islamiyye*.

[Shemsedin Samiu dhe Qytetërimi islam]. Insan Yayınları, Stamboll.

### 1997

*Dheu është flori*. Rilindja, Prishtinë. 31 f.

*Lisân* ["Gjuha"]. Cep Kütüphanesi, nr. 27. Ribotuar me alfabetin e sotëm të turqishtes nga Ismail Doğan. Ankara 119 f.

*Përmbledhja e Shabnamesë. Parathënie*. E përktheu K. Nuro, në: "Perla", nr. 4, f. 81-84.

*Taaşşuk-ı Tal'at ve Fitnat*. ["Dashuria e Talatit me Fitneten", roman], ribotuar në: Yerguz, I. *Şemsettin Sami, Yaşamı, Sanatı, Yapıtları*. [Shemsedin Samiu. Jeta, arti, vepra]. Engin Yayıncılık Stamboll.

### 1998

*Kamus-i Türki* [Fjalor i turqishtes]. Alfa, Stamboll.

### 1999

Vepra.

Vëll. 10: *Qytetërimi islam*. Përktheu M. Polisi. Prishtinë. 137 f.

*Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet?* Mësonjëtorja e parë, Tiranë. 122 f.

[Shkrime të zgjedhura të Sami Frashërit] në: Ş. Tural, *Şemsettin Sami*. Şule Yayınları, Stamboll. f. 66-151.

### 2000

*Dheu është flori*. Argeta, Tiranë. 21 f.

*Kush e prish paqen në Ballkan. Publicistikë e Sami Frashërit turqisht*. 81 shkrime. Përktheu nga turqishtja dr. A. Hamiti. Dukagjini, Pejë. 361 f.

*Shqipëria dhe shqiptarët*. Nxjerrë dhe renditur nga vepra “Diksioneri historik e gjeografik”. Përktheu Z. Bakiu. Dajti, Tiranë. 318 f.

R. 2002.

## 2001

Vepra.

Vëll. 11: *Gjuba*. Përktheu M. Polisi. Parathënie nga M. Polisi. Prishtinë. 120 f.

*Hasan Tahsini*, në: Z. Osmani – I. Karanfili, “Libër leximi për klasën VI”, SHB Logos-A, Shkup. f. 60-62.

*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë?* Libri Shkollor, Prishtinë. 115 f.

## 2002

*Besa e shqiptarit*. Drier.

*Dashuria e Talatit me Fitnetin*. E përktheu M. Polisi. SHB Logos-A, Shkup.

*Dashuria e Talatit me Fitnetin*, fragment në: R. Bekteshi – T. Hodo, “Libër leximi për klasën VII”, SHB Logos-A, Shkup. f. 152-155.

*Fjalë të urta dhe tregime zëbatëse nga Sami Frashëri*. Mbledhur dhe shqipëruar nga Z. Bakiu. Tiranë. 348 f.

*Gjuba*. Përktheu M. Polisi. SHB Logos-A, Shkup. 99 f.

*Personalitetet shqiptare. Marrë nga Kamus al-A’lâm*. Zgjodhi, përktheu e shpjegoi M. Polisi. Logos-A, Shkup. 216 f.

*Qytetërimi islam*. Përktheu M. Polisi. SHB Logos-A, Shkup. 104 f.

*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë?* SHB Naim Frashëri. 119 f.

*Shqipëria dhe shqiptarët*. Nxjerrë dhe renditur nga vepra “Diksioneri historik e gjeografik”. Përktheu Z. Bakiu. Dajti, Tiranë. 318 f.



## 2003

*Anekdotat*. Përktheu M. Polisi. Logos-A, Shkup. 155 f.

*Besa*, fragment në: T. Hodo – R. Bekteshi, “Libër leximi për klasën VIII”, SHB Logos-A, Shkup. f. 72-76.

*Përpjekja e heronjve në përhapjen e Islamit*. Përkth. nga arabishtja Ismail Ahmedi. SHB Logos-A Shkup. 43 f.

## 2004

*Gratë*. Përkthyer nga H. Bushati. Logos-A, Shkup.

*Sejdi Jahja. Dramë në 5 akte*. Përktheu nga turqishtja Raif Morina. Transkriptoi Irfan Morina. Prizren. 211 f.

Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë, fragment “Përmbledhje”, në: S. Hamiti, Letërsia romantike shqiptare, për klasën XI, Albas, Prishtinë, f. 142-146.

*Vepra*. Logos-A, Shkup

Redaktor i përgjithshëm: Xh. Lloshi

Vëll. 1: *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë?* A. Ismaili, Dy fjalë për serinë e veprave të Sami Frashërit (f. 7-12). Parathënie nga Z. Xholi (f. 13-16). 134 f.

Vëll. 2: *Personalitetet shqiptare në Kamûs al-Alâm*. I përktheu M. Polisi. *Sami Frashëri dhe Kamûs al-Alâm* nga M. Polisi (f. 7-24). “Fjalor i termave (f. -207-238). 243 f.

Vëll. 3: *Viset shqiptare në Kamûs al-Alâm*. I përktheu Z. Bakiu. 297 f.

Vëll. 4: *Abetare e gjuhës shqip*. 96 f.

Vëll. 5: *Shkronjëtove e gjuhës shqip*. 175 f.

Vëll. 6: *Dheshkronjë*. 143 f.

Vëll. 7: *Gjuha*. E përktheu M. Polisi. 109 f.

Vëll. 8: *Besa*. E përktheu Abdyl Ypi. 179 f.

Vëll. 9: *Dasburia e Talatit me Fitnetin*. E përktheu M. Polisi. 139 f.

Vëll. 10: *Fjalë të urta*. I përktheu Z. Bakiu. Parathënie nga Z. Bakiu (f. 15-18). 209 f.

Vëll. 11: *Anekdotat*. I përktheu M. Polisi. 178 f.



Vëll. 12: *Përpyjekjet e heronjve në përhapjen e Islamit*. E përktheu I. Ahmedi. *Parathënie* nga I. Ahmedi (f. 7-15). 49 f.

Vëll. 13: *Qytetërimi islam*. E përktheu M. Polisi. *Sami Frashëri në fushën e islamistikës* nga M. Polisi (f. 7-17). 113 f.

Vëll. 14: *Zëdhënësi i Lindjes* [Artikuj nga “Terxhumani Shark”]. I përkthyer: K. Prifti, V. Buharaja. 179 f.

Vëll. 15: *Gratë*. E përktheu H. Bushati. 64 f.

Vëll. 16: *Qielli*. E përktheu M. Polisi. *Parathënie* nga M. Polisi (f. 7-12). 97 f.

Vëll. 17: *Toka*. E përktheu M. Polisi. *Parathënie* nga M. Polisi (f. 7-10). 97 f.

Vëll. 18: *Njeriu*. E përktheu M. Polisi, *Parathënie* nga M. Polisi (f. 7-9). 89 f.

Vëll. 19: *Përsëri njeriu*. E përktheu M. Polisi. *Parathënie* nga M. Polisi (f. 7-11). 123 f.

Vëll. 20: *Mitologjitë*. E përktheu M. Polisi. *Parathënie* nga M. Polisi (f. 7-8). 87 f.

## 2006

*Gave* [“Farkëtari Gjave”]. Përkthyer shqip nga Raif Morina.

## II. DORËSHKRIME

1871. - *Küçük Tarih-i Umumi* [Histori e përgjithshme e shkurtër].

1873. - *Iskati Cenin-Yabut-Ikisi-Ölmüş, Ikisi-Çıldırniş* [“Pjella e dështuar ose të dy të vdekur, të dy të çmendur”, roman].

1873. - *Rekabet* [“Rivaliteti”, roman].

1880. - *Muntahabat-i Arabiye* [“Pjesë të zgjedhura arabe”, proverba, tregime, tekste arabisht].

1882. - Mbledhje këngëve shqip të vjetëra e të ra. Ndë Konstandinopojë më 4 të qershorit [AQSH].

1891. - *Nev Usul Nabr-i Türki* ["Sintaksë e turqishtes sipas metodës së re". "Islam Ansiklopedisi", Cuz 115, f. 416.]. 120 f.

1901. - *Zübde-i Şahname* ["Ajka e Shahnemesë". AQSH]. 409 f.

P. 1997 shqip vetëm "Parathënia".

1902. - *El-Mual'lakatu's-Sab'a* ["Shtatë poezi të ndërldhura" arabisht me përkthimin turqisht],

1902. - *Kutadgu-Bilig* ["Njohuri që të bëjnë të lumtur". Përkthim turqisht i veprës së vitit 1069 prej 12850 vargësh të Jusuf Balasagunit, Has Haxhip; traktat për qeverisjen e drejtë. Parathënie e S. Frashërit 1900. Përkthyer në turqishten e kohës nga botimi i turkologut hungarez Hermann Wambery]. Konstantiniyye.

1903. - *Et-Tuhfetü'z-Zekiyye fil Lügati't Türkiyye* ["Dhuratë e mençur për fjalorin e gjuhës turke", fjalor turqisht i shek. XV, përkthyer nga arabishtja dhe një shtojcë "Dituria e gjuhës" me të dhëna gramatikore]. 212 f. Botuar më 1945.

1903. - *Orhun Abideleri* ["Përmendoret e Orhunit" mbi shkrime mbi gurë të shek. VIII me alfabetin runik, zbuluar në Siberi më 1850, botuar nga danezi V. Thomson më 1896. Transkriptuar me shkronja arabe dhe përkthyer turqisht e komentuar nga S. Frashëri. Parathënia e Samiut është riprodhuar më 1934 nga H. Dağlioğlu (Turhan) në: *Şemsettin Sami. Hayati ve Eserleri*. {"Shemsedin Samiu. Jeta dhe veprat"} . Resimli Ay Matbaası, Stamboll, 72 f.]. 104 f.

1904: - *Lehçe-i Türkiyye-i Mamalik-i Misir* ["E folmja turke në viset e Egjiptit" për turqishten kipçake]. 171 f.

### **Pa datë:**

*Kavaid-i Nabviyye ve Sarfiyye* ["Rregulla të sintaksës dhe të gramatikës së turqishtes"].

*Kiraet-i Türkiyye* ["Libër leximi i turqishtes", sipas "Islam Ansiklopedisi", Cuz 115, f. 416.].

*Küçük Kamus-i Türki* ["Fjalor i vogël i turqishtes", i përfunduar].

*Subrab Yahud Ferzendkuş* ["Suhrabi ose Përsiatësi", dramë me temë nga Shahnameja. Përmendur nga S. Frashëri në: "Serveti Fünun", 19 qershor 1896, f. 227].

*Vicdan* ["Ndërgjegjja", dramë në 3 akte. Sipas A. S. Levend, 1969].

### **Mungojnë dorëshkrimet:**

*Cadı* ["Shtriga", dramë, njofton se po e shkruante më 1876].

*Çocuklar* ["Fëmijët", dramë, njofton se po e shkruante më 1876].

Fjalor i gjuhës shqipe.

*Intibah* ["Gatimi", 1876, roman?].

*Kuran Çevirisi* ["Përkthim i Kuranit" - dorëshkrimi është asgjësuar me kërkesë të Komisionit të kontrollit të Sheriatit].

*Mezalimi Endelus* ["Mizoritë në Andaluzi", dramë në pesë akte. Përmendur në kopertinën e *Himmat-ul-Himam fi Neşri'l-Islam*, 1885].

*Mufassal Kavaidi Arabiye* ["Gramatikë e hollësishme e arabishtes". Përmendet te 'Parathënia' e "Eptimet e arabishtes" 1886].

*Yine Besa* ["Përsëri Besa", dramë, njofton se po e shkruante më 1876].

*Sarf ve Nahr-i Arabi* ["Gramatika e arabishtes"].

### **III. LETRA**

Tahsin Frashërit në Kajro, 5 shkurt 1876.

Tahsin Frashërit në Kajro, 11 shkurt 1876.

Jeronim De Radës në Itali, Stamboll, 20 shkurt [4 mars] 1881; botuar në: "Buletin i shkencave shoqërore", 1954,

nr. 2, f. 114-116. R. në: Dh. S. Shuteriqi, *Antologji e letërsisë për shkollat e mesme*, Bot. I 1955, bot. II 1958, f. 176-179; *Veptra*, 2, 1988, f. 373-377.

Degës së Shoqërisë për shkronja shqip në Bukuresht, 23 korrik 1882 (bashkë me 7 rilindës të tjerë). Botuar nga Dh. Shuteriqi, në: "Buletin i Institutit të Shkencave", nr. 1-2, 1950, f. 34-35; ribotuar në: Naim Frashëri, *Veptra të zgjedhura*, vëll. II, 1980; Sami Frashëri, *Veptra*, vëll. 2, 1988, f. 378-79; Xh. Lloshi, *Kristoforidhi përmes dokumentimit*, 2005, f. 350-351.

Jani Vretos në Rumani, Tri letra bashkë me Naim Frashërin, e para 10 maj 1886, në: V. Dodani, *Memoriet e mia*, Konstancë 1930, f. 32-34.

Visarion Dodanit në Rumani. Bashkë me Naim Frashërin, 10 shkurt 1887, në: V. Dodani, *Memoriet e mia*, Konstancë 1930, f. 43. R. në: Naim Frashëri, *Veptra të zgjedhura*, vëll. II, 1980; 1988, vëll. 2, f. 38-82.

Visarion Dodanit në Rumani. Bashkë me Naim Frashërin, 11 prill 1887, në: V. Dodani, *Memoriet e mia*, Konstancë 1930, f. 43. R. në: Naim Frashëri, *Veptra të zgjedhura*, vëll. II, 1980; 1988, vëll. 2, f. 383.

Visarion Dodanit në Rumani. Bashkë me Naim Frashërin e Jani Vreton, 1 maj 1887, në: V. Dodani, *Memoriet e mia*, Konstancë 1930, f. 45. R. në: Naim Frashëri, *Veptra të zgjedhura*, vëll. II, 1980; 1988, vëll. 2, f. 384.

Visarion Dodanit në Rumani. Bashkë me Naim Frashërin, 16 maj 1887, në: V. Dodani, *Memoriet e mia*, Konstancë 1930, f. 46. R. në: Naim Frashëri, *Veptra të zgjedhura*, vëll. II, 1980; 1988, vëll. 2, f. 385.

Mehmet Emin Jurdakullit, 18 qershor (1 korrik) 1897, sipas: A. S. Levend, *Sami Frashëri*, Dituria, Tiranë, 2004.

Murad Toptanit nga Stambolli. Bashkë me Naim Frashërin, 27 dhjetor (8 janar) 1899; në: "Drita", 1 qershor 1975. R. në: Naim Frashëri, *Veptra të zgjedhura*, vëll. II,



1980; 1988, vëll. 2, f. 386-390; Faik Konica, *Vepra 5*, 2001, f. 72-79.

#### IV. BASHKËPUNIMI NË GAZETA E PERIODIKË

**1873.** *Sirac* ["Feneri"]: revistë e botuar nga Ebuzija Tevfiku; numri i parë 15 mars.

*Hadika* ["Kopshti"]: gazetë e përjavshme; numri i parë më 17 shkurt 1870; nga 9 nëntori 1872 gazetë e përditshme. E drejtoi S. Frashëri nga 21 maj (3 qershor) 1873; u mbyll me nr. 72, më 16 korrik.

*Askerlik*, 15 korrik.

**1874.** *Trablusigarb* ["Tripoli"] ose *Vilâyet* [Vilajeti]: gazetë e përjavshme në Libi nga viti 1864. S. Frashëri e mori drejtimin e saj nga nr. 256, 18 qershor; u largua më 4 mars 1875.

**1876.** *Sabah* ["Mëngjesi"]: e para gazetë e përditshme turke e themeluar nga S. Frashëri më 25 shkurt (9 mars). Drejtor Mihrani, të cilit më 3 janar 1877 ia lëshoi për arsye financiare dhe vijoi si kryeredaktor i saj. Kryeartikulli i numrit të parë ng S. Frashëri. Mbajti edhe rubrikën *Andejkëndej* [Şurada-burada]. Nga artikujt e botuar:

*Orientalistët dhe gjuhët orientale*, 1 gusht 1898.

*Gjuha dhe letërsia jonë*, 8 gusht 1898. Ribotuar në: *Bedaiy-i Edebiye*, 1910.

*Përsëri mbi gjuhën dhe letërsinë tonë, rruga e reformimit*, 15 gusht 1898.

*Për zgjedhja e gjuhës sonë letrare*, 22 gusht 1898.

*Drejtshkrimi ynë*, 29 gusht 1898.

*Dy fjalë*, 5 shtator 1898.

*Reformimi i drejtshkrimit tonë*, 12 shtator 1892.

*Gjuhët semitike dhe gjuha arabe*, 19 shtator 1898.

*Dëshmi e provuar*, 26 shtator 1898.



- Kufizimet e gjubës sonë*, 3 tetor 1898.
- Përsëri mbi gjubën dhe drejtshtkrimin*, 17 tetor 1898.
- Zgjidhja e çështjes*, 7 nëntor 1898.
- Përgjithësimi i gjubës sonë*, 21 nëntor 1898.
- Risitë e fundit në poezinë dhe letërsinë tonë*, 28 nëntor (8 dhjetor) 1898.
- Biblioteka*, 5 dhjetor 1898.
- Librat për fëmijë*, 12 dhjetor 1898.
- Poezia dhe letërsia jonë e re*, 21 dhjetor 1898 (8 janar 1899).
- Shtypshkrimi dhe bukurshkrimi*, 26 dhjetor.
- Refuzimi i kundërshtimit*, 23 janar 1899.
- Gjubët, dija dhe shkenca*, 30 janar 1899.
- Çfarë është letërsia*, 6 shkurt 1899.
- Llojet e turqishtes*, 20 shkurt 1899.
- Fjala dhe kuptimi*, 27 shkurt 1899.
- E ardhmja e letërsisë*, 13 mars 1899.
- Mubarrir* ["Shkrimtari"]: revistë turqisht. S. Frashëri ka nxjerrë 4 numra në emër të Ebuzija Tevfikut të internuar, i cili e vijoi pas kthimit vetëm 4 numra të tjerë.
- 1878.** *Tercumani Şark* ["Zëdhënësi i Lindjes"] numri i parë doli më 10 prill; drejtor Mihrani. S. Frashëri nga numri 75 nis si redaktor më 10 (23) qershor. U mbyll nga nr. 180, më 5 nëntor 1878.
- Artikuj përkthyer shqip e botuar në *Veptra*, vëll. 1, 1988, f. 107-233, ribotuar në *Veptra*, vëll. 14, më 2004.
- Kryeartikuj nga S. Frashëri: Socializmi. Aksionerët. Kongresi i çështjes lindore. Sistemi politik. Intrigat e sllavëve dhe të grekëve në Rumeli.
- 1880.** *Aile* ["Familja"]: revistë për familjen; pronar Mihrani. Themeluar e drejtuar nga S. Frashëri; 3 numra: 26 maj – 10 qershor 1880.
- Zaman* ["Koha"]: 2 prill S. Frashëri, *Përgjigje* për shënimin e datës 30 mars lidhur me përkthimin e "Të mjerëve".

**1881.** *Hafta* ["Java"]: revistë letrare, shkencore dhe e mjeshtrëve; pronar Mihrani.

Themeluar e drejtuar nga S. Frashëri. Numri i parë më 24 mars; 20 numra: deri më 12 janar 1882. Artikuj nga S. Frashëri:

*Kryeartikulli*, nr. 1, 24 mars.

*Şiir-in Nahiyet ve Hakikati*, nr. 2, f. 28.

*Şarkta Şiir ve Şuara*, nr. 4-7.

*Hoxha Tabsin*, 21 shtator, nr. 6, f. 92.

*Lisân-i Türki-Osmâni* [Gjuha turke-osmane], 4 nëntor, nr. 12.

*Poezia në Lindje dhe poetët e saj*.

**1884.** *Drita-Dituria*: Revistë e përmuajshme kulturore, letrare e arsimore, e drejtuar nga P. Sotiri. Numri i parë doli në Stamboll më 10 gusht, e ndërroi titullin nga nr. 4, u botuan 12 numra deri më 11 korrik 1885. S. Frashëri ka botuar:

*Dituria*, nr. 1, f. 1; *Qytetëria*, nr. 2, f. 17; *Qytetëri e grekvet*, nr. 3, f. 40; *Qytetëri e arabëvet*, nr. 6, f. 89; *Qytetëri e evropjanëvet*, nr. 8, f. 113.

*Tercumani Hakikat* ["Zëdhënësi i së vërtetës", gazetë]: redaktor. Botuar nga S. Frashëri:

*Zotit autor*, 24 dhjetor 1878.

*Shpresat e Shqipërisë*, 3 janar 1879.

*Shqipëria*, 13 janar dhe 14 janar 1879.

*Letër* 5 dhjetor.

*Shkëlqesisë së tij*, zotit gazetar, 11 dhjetor 1885.

*Lisan ve Edebiyatımız* [Gjuha dhe letërsia jonë].

*Yol* ["Rruga", gazetë]: Artikuj nga S. Frashëri:

*Thjeshtëzimi i gjuhës sonë*, 7 qershor 1899.

*Reformimi dhe përgjithësimi i gjuhës sonë*, 16 qershor 1899.

*Serveti Fünun* ["Thesari i dijeve"]: S. Frashëri, *Fjalori i turqishtes dhe Fjalori arabisht-turqisht*, vëll. 18, nr. 462, 18 janar 1900, f. 306.

*Ikdam* ["Përpyjekja", gazetë]: Artikuj nga S. Frashëri: *Fjalori i turqishtes*, dy artikuj: 15 dhjetor 1901, 16 janar 1902.

Thjeshtëzimi i gjuhës sonë, 27 janar 1902.

*Gjeografët arabë*, 22 shkurt 1902.

*Hayal* ["Ëndërrime"]: botues Theodor Kasapi. Bashkëpunoi edhe S. Frashëri

*Istikbal* ["E ardhmja"]: bashkëpunoi edhe S. Frashëri

## ARKIVAT

### **Arkivi familjar i pasardhësve të Sami Frashërit, Turqi:**

### **Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë:**

Fotokopje dhe mikrofilma dhuruar nga Emin Erer prej Arkivit familjar:

Korrespondenca e Sami Frashërit me të vëllezërit; fotokopje.

Letër Tahsin Frashërit, 5 shkurt 1876.

Letër Tahsin Frashërit, 11 shkurt 1876.

Përkthime për përdorim të brendshëm:

Artikuj të gazetës "Terxhumani-Shark" 29 mars-23 tetor 1878, nga V. Buharaja, 68 f.

*Besa*, nga J. Tafilaj, 91 f.

*Emsal*, nga J. Tafilaj, 191 f.

*Kamûs al-Alâm*, pjesë nga H. Sharofi, 151 f.; nga H. Bushati, 125 f.; Xh. Belegu; "Frashëri" nga M. Janina.

## Arkivi Qendror i Shtetit: F. 51

*Kutadgu-Bilig* [Njohuri që të bëjnë të lumtur]. Konstantinyye. 1902.

*Lebçe-i Türkiyye-i Mamalik-i Misir* [E folmja e turqishtes në viset e Egjiptit]. 171 f.

Letra për J. De Radën, 20 shkurt 1881; dorëshkrimi origjinal.

*Lisan ve Edebiyatimiz* [Gjuha dhe letërsia jonë], në: "Servet-i Fünun".

Mbledhje këngëve shqip të vjetëra e të re [AQSH, Fondi Sami Frashëri, Dosja nr. 1, 38 f.]. 1882.

Morfologjia e persishtes.

*Orhun Abideleri* [Përmendoret e Orhunit]. 1903. 104 f.

*Pjesë të zgjedhura nga letërsia arabe*, 1881, një fletore.

Tharja e liqenit të Zvirinës.

*Vicdan* ["Ndërgjegjja", dramë në 3 akte].

*Zübde-i Şahname* ["Ajka e Shahnamesë". AQSH]. 1901. 409 f.

## SAMI FRASHËRI: VEPRA NË 20

### VËLLIME

---

Redaktor i përgjithshëm: prof. dr. Xh. Lloshi

Shtëpia botuese Logos-A, Shkup, 2004

**Vëll. 1:** *Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe ç'do të bëhet?* Mëndime për shpëtimt të mëmëdheut nga reziket që e kanë rethuarë. 134 f.

A. Ismaili, *Dy fjalë për serinë e veprave të Sami Frashërit* (f. 7-12). Parathënie nga Z. Xholi (f. 13-16).

Manifesti politik i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në fund të shek. XIX. Enciklopedisti dhe ideologu rilindës Sami Frashëri, me diapazonin e gjerë të njohjes së historisë, kulturës, etnopsikologjisë dhe gjuhës së shqiptarëve, por veçanërisht të problemeve të kohës, jep për të ardhmen e atdheut një vizion, i cili edhe pas njëqind vjetësh duket se është po aq i nevojshëm për Shqipërinë.

Vepra u botua me alfabetin e Stambollit në Bukuresht më 1899. Është ribotuar më 1907; 1923; 1950 fragmente; 1955-1958 fragmente; 1962; 1978; 1980; 1988; 1999; 2001; 2002.

Është përkthyer turqisht më 1904 dhe ribotuar më 1907; greqisht më 1907; gjermanisht më 1913 dhe italisht më 1923.

Ky është ribotimi më i përpiktë i bërë deri më sot.

**Vëll. 2:** *Personalitetet shqiptare në Kamûs al-Alâm*. 243 f.

E përktheu M. Polisi. Paraqitja *Sami Frashëri dhe Kamûs al-A'lâm* nga M. Polisi (f. 7-24).



Vepër e përgatitur me zërat e marrë prej enciklopedisë *Kamus al-A'lam*. Janë zgjedhur figurat më të shquara me prejardhje shqiptare, që kanë punuar në Perandorinë Osmane, e në veçanti personalitetet e historisë sonë kombëtare. Për secilin Samiu jep jetëshkrimin, veprimtarinë me anët më të rëndësishme të saj, me çka e kanë merituar të zënë vend në një enciklopedi.

Vepra e plotë e S. Frashërit u botua në gjuhën turke-osmane me titullin *Kamus al-A'lâm* dhe nëntitullin *Dictionnaire Universel d'Histoire e de Géographie* ["Fjalor universal i historisë dhe i gjeografisë"]. Botuesi Mihran, Stamboll. 6 vëllime në vitet 1889-1898: vëll. I f. 1-800; vëll. II f. 801-1600; vëll. III 1891 f. 1601-2400; vëll. IV 1894 f. 2401-3200; vëll. V 1896 f. 3201-4000; vëll VI 1898 f. 4001-4830.

Është ribotuar turqisht më 1996.

Zëra për trevat shqiptare dhe figurat janë botuar në përkthimin shqip më 1988; 1992; 1994

Ky botim përfshin gjithsej 90 zëra. Libri është pajisur në fund edhe me një "Fjalor të termave", f. 207-238.

**Vëll. 3:** *Viset shqiptare në Kamûs al-Alâm*. I përktheu Z. Baku. 297 f.

Ashtu si dhe Vëllimi 2 *Personalitetet shqiptare në Kamûs al-Alâm*, edhe kjo vepër është përgatitur me zërat e marrë prej enciklopedisë *Kamûs al-Alâm*. Janë zgjedhur qytetet, krahinat, fshatrat, lumenjtë, malet, fushat kryesore të Shqipërisë me shtrirjen etnike, siç e kërkonin rilindësit atdheun e pavarur e të lirë. Jepen të dhënat kryesore gjeografike, demografike, administrative, ekonomike e arsimore, duke ngulitur gjendjen e tyre në atë periudhë në fund të shek. XIX, e kështu kemi një pasuri të vërtetë me vlera të paçmueshme për historiografinë shqiptare.

Vepra e plotë e S. Frashërit u botua në gjuhën turke-osmane me titullin *Kamus al-A'lâm* dhe nëntitullin *Dictionnai-*

*re Universel d'Histoire e de Géographie* ["Fjalor universal i historisë dhe i gjeografisë"]. Botuesi Mihran, Stamboll. 6 vëllime në vitet 1889-1898: vëll. I f. 1-800; vëll. II f. 801-1600; vëll. III 1891 f. 1601-2400; vëll. IV 1894 f. 2401-3200; vëll. V 1896 f. 3201-4000; vëll VI 1898 f. 4001-4830.

Është ribotuar turqisht më 1996.

Zëra për trevat shqiptare dhe figurat janë botuar në përkthimin shqip më 1984; 1988; 1992.

Në këtë botim janë përzgjedhur 171 zërat përkatës nga *Shqipëria dhe shqiptarët*; nxjerrë dhe renditur prej veprës "Diksioneri historik e gjeografik", përkthyer nga Z. Baku. (Dajti, Tiranë. 319 f.). Bashkë me 90 zëra të Vëllimit 2 në këtë seri, bëhen gjithsej 261 zëra tashmë të përkthyer shqip nga kryevepra e Sami Frashërit.

**Vëll. 4:** *Abetare e gjuhës shqip*. 96 f.

Shkolla shqipe ishte një nga synimet madhore të Rilindjes Kombëtare. Pasi kishte qenë autori kryesor i "Alfabetares së gjuhës shqip" më 1879, Sami Frashëri botoi më 1886 këtë vepër për nevojat e shkollarëve të parë shqiptarë, por edhe të gjithë atdhetarëve që donin të mësonin shkrimin e këndimin shqip. Autori ndoqi modelin e abetareve për shkollat fillore turke të kohës në Shqipëri, që po ata mësues ta kishin të lehtë të jepnin edhe shqipen. Mësimet janë plot me thënie të urta ose trajtojnë tema të përshtatshme për moshën.

Është shtypur për herë të parë me alfabetin e Stambollit, u rishtyp më 1900 e 1909, pastaj është rishtypur me alfabetin e sotëm më 1988 dhe këtu po ashtu.

**Vëll. 5:** *Shkronjëto e gjuhës shqip*. 175 f.

E para gramatikë e gjuhës shqipe, e shkruar shqip. U botua më 1886 njëkohësisht me *Abetaren e gjuhës shqip* (në këtë seri Vëll. 4). Duke ndjekur modelin e gramatikave të frëngjishtes, të cilin e kishte zbatuar edhe për librat përkatës më të rinj të turqishtes e të arabishtes, Samiu hartoi

për sistemin morfologjik të shqipes veprën më të përparuar kundrejt gjithë gramatikave të mëparshme të shqipes. Përpikëria shkencore e trajtimit shoqërohet me një pasuri shembujsh, duke përfshirë edhe të dhëna nga dialektet e shqipes. Një pjesë e termave të krijuar nga Samiu në këtë libër zunë vend përgjithmonë në gjuhësinë shqiptare.

Vepra u botua me alfabetin e Stambollit dhe është ribotuar me rishtypje e transliterim më 1979, kurse vetëm me alfabetin e sotëm më 1988 dhe në këtë botim.

**Vëll. 6:** *Dheshkronjë*. 143 f.

I pari tekst shkollor shqip për gjeografinë, i botuar më 1888, menjëherë pas hapjes së Shkollës shqipe në Korçë. Samiu një vit më vonë do të niste botimin e Enciklopedisë së përgjithshme për historinë e gjeografinë në 6 vëllime, prandaj ky tekst mund të shihet si prova e parë e veprës së tij madhore. Pas të dhënave të përgjithshme gjeografike, autori përshkruan vendet e Europës e të Azisë dhe, natyrisht, numrin më të madh të faqeve ia kushton Shqipërisë. Libri kishte vlerë jo vetëm për shkollarët, por edhe për kulturën shqiptare përgjithësisht, e në veçanti, për terminologjinë gjeografike.

Libri u botua me alfabetin e Stambollit, ndërsa më 1988 dhe këtu është dhënë me alfabetin e sotëm.

**Vëll. 7:** *Gjuha*. E përktheu M. Polisi. 109 f.

Për enciklopedistin, poliglotin dhe autorin e gramatikave të disa gjuhëve, Sami Frashërin, gjuha përbënte një fushë me interes të veçantë, prandaj në serinë e “Bibliotekës së xhepit” ai botoi më 1886 librin *Lisân* [“Gjuha”], Pjesa I. Megjithatë, nuk ka pasur një botim të një pjese të dytë. Duke shfrytëzuar arritjet e deriatëhershme të shkencës gjuhësore, autori trajton probleme të gjera, si: ç’është gjuha njerëzore, kur u shfaq, nëpër çfarë fazash ka kaluar evoluimi i saj, cilët janë tipat kryesorë të gjuhëve dhe afë-



ritë e tyre. Më pas jepen shkurt njohuri për të gjitha familjet dhe grupet kryesore të gjuhëve në botë.

Vepra u shkrua në turqishten osmane, u rishtyp më 1997 me alfabetin e sotëm të turqishtes. Doli e përkthyer për herë të parë shqip më 2001 në Prishtinë, u rishtyp më 2002, botim i Logos-A, Shkup. Këtu botohet përkthimi i rishikuar nga Xh. Lloshi.

**Vëll. 8:** *Besa*. E përktheu Abdyl Ypi. 179 f.

Drama e parë e një autori shqiptar dhe me temë shqiptare. Subjekti i saj, i vendosur në një mjedis shqiptar, kish-te edhe tingëllim politik: të viheshin në pah virtytet dhe zakonet e popullit shqiptar. Ngjarja zhvillohet në fshatin Progonat, duke theksur bukurinë e madhështinë e natyrës së atdheut. Drama është një zbërthim i thënies “Shqiptari kur jep fjalën, ther djalën”, duke vënë në dukje vlerën e fjalës së dhënë, por edhe tragjedinë kur ajo thënie bëhet realitet. Drama u shfaq në Stamboll më 1874.

Pjesa u shkrua turqisht dhe gjithashtu për atë gjuhë është një ndër krijimet e para në këtë gjini. U botua në Stamboll më 1875 me titullin *Besa yahud Abde vefa. Altı fasiladan ibaret facia* [“Besa ose mbajtja e fjalës së dhënë”. Pjesë teatrale në gjashtë akte]. Me *Parathënie* nga autori, 176 f.

U botua shqip në të gjallë të autorit më 1901 e përkthyer nga Abdyl Ypi dhe u ribotua më 1913. Më 1970 u botua në një përkthim të ri nga A. Kolonja. Prishtinë, 126 f. Më 1988 u botua në Vëllimin 2 të “Veprave” me një përkthim të ri nga V. Buharaja.

Drama është përkthyer e botuar edhe në gjuhë të huaja: 1902 bullgarisht nga L. J. Siljanov; 1908 italisht nga A. Ribecco dhe 1945 anglisht nga Nelo Drizari.

Këtu është parapëlqyer përkthimi i vitit 1901, duke ruajtur ngjyrat krejt të veçanta të gjuhës së kohës.

**Vëll. 9:** *Dashuria e Talatit me Fitnetin*. E përktheu M. Polisi. 139 f.

Romani i parë i shkruar në gjuhën turke-osmane me titullin *Taaşuk-ı Tal'at ve Fitnat*, botuar në Stamboll më 1872. Edhe për Samiun ishte vepra e tij e parë, e shkruar turqisht. Është historia e dashurisë së dy të rinjve në mjedisin e zakoneve prapanike, që sjell fundin tragjik, të ndërthurur edhe me ndërlikimin familjar të personazheve. Ndjek besnikërisht trajtimin e temës së dashurisë sipas rrymës së sentimentalizmit europian.

Vendin e tij në historinë letrare turke e dëshmon edhe ribotimi në Turqi me alfabetin e sotëm më 1964, më 1979, 1990 dhe më 1997.

U përkthye nga M. Polisi e R. Lata dhe u botua për herë të parë shqip më 1984 në Vëllimin 6 të *Veprave* në Prishtinë. U ribotua me përmirësime më 1994 në Tiranë dhe më 2002 nga SHB Logos-A në Shkup.

Ky është botimi me gjuhën më të përpunuar nga ana artistike, redaktuar nga Xh. Lloshi.

**Vëll. 10:** *Fjalë të urta*. I përktheu Z. Bakiu. Parathënie nga Z. Bakiu (f. 15-18). 209 f.

Në gazetat që drejtonte Sami Frashëri lexuesit pëlqenin shumë thëniet dhe fjalët e mençura nga autorë të ndryshëm botërorë. Prandaj ai i përzgjedhi shumë prej tyre, por edhe mjaft të tjera i përshtati ose i ndërtoi vetë dhe i botoi më 1879 si një vëllim më vete, në serinë “Biblioteka e xhepit”, nr. 11-14, që përfshinte afër 3000 fjalë të urta, me titullin *Emsâl*. Në të vërtetë vëllimi ishte një, por i ndarë në katër broshura dhe prandaj kishin numrat 11 deri 14. Një pjesë e tyre u botuan të përkthyer shqip nga Zyber Bakiu me titullin *Fjalë të urta të zgjedhura* në: “Nëntori”, nr. 6, f. 133-173. Si libër më vete u botuan më 2002 me titullin *Fjalë të urta dhe tregime zbavitëse nga Sami Frashëri*. Mbledhur dhe shqipëruar nga Z. Bakiu. Tiranë. 348 f. Në këtë rast përkthyesi përfshiu edhe anekdota e thënie, të mbledhura ndër botime të tjera të Samiut.



Ky botim përfshin vetëm fjalët e urta, të botuara si një vëllim nga Sami Frashëri. Në fund, në faqet 203-209, jepet *Treguesi i temave*.

**Vëll. 11:** *Anekdotat*. I përktheu M. Polisi. 178 f.

Nën titullin “Andej-Këndej” Samiu botonte në gazetën “Sabah” thënie të mençura dhe tregime argëtuese. Po këtë traditë e vijoi edhe në gazetën “Zëdhënësi i Lindjes” (Terxhumanî Shark). Me kërkesën e lexuesve i përmbledhë në dy libra të serisë “Biblioteka e xhepit”, i pari *Emsâl*, 1879, që botohet i përkthyer shqip në këtë seri si Vëllimi 10. I dyti doli më 1883 me titullin *Letaif* [“Anekdotat”], nr. 17-18, ng botuesi Mihran në Stamboll, 224 f. Ndonëse jepen dy numra si dy broshura të serisë, në fakt është një libër i vetëm. Përmbledh rreth 460 rrëfime argëtuese. Edhe këto janë pjesërisht përkthime e përshtatje nga burimet letrare të Perëndimit e të Lindjes, e pjesërisht janë hartuar nga vetë autori. Ato synonin t’u përgjigjeshin rrethanave dhe shijeve të lexuesit të kohës, por nuk e kanë humbur forcën tërheqëse e ndikimin gazmor edhe te lexuesi i sotëm.

Përkthimi i parë shqip është bërë pjesërisht nga Z. Bakiu më 2002 me titullin *Fjalë të urta dhe tregime zbatëse nga Sami Frashëri*. Mbledhur dhe shqipëruar nga Z. Bakiu. Tiranë.

M. Polisi bëri një përkthim sipas librit të S. Frashërit me titullin *Anekdotat*, u botua më 2003 nga SHB Logos-A, Shkup. 155 f. Ky është botimi i dytë i këtij libri nga SHB Logos-A, Shkup.

**Vëll. 12:** *Përpyekjet e heronjve në përhapjen e Islamit*. E përktheu I. Ahmedi. *Parathënie* nga I. Ahmedi (f. 7-15). 49 f.

Një sintezë e rrethanave historike se si popujt e kanë pranuar fenë islame, duke dhënë një pasqyrë objektive, të mbështetur edhe në mendimet e autorëve Perëndimorë. Samiu e vinte theksin sidomos te rruga e bindjes, duke

hedhur poshtë rrugën e dhunës apo mënyrat e tjera të shtypjes.

Libri u botua më 1884 në gjuhën arabe me titullin *Himmet-ul-Himâm fi Neşri'l-Islâm* nga botuesi Mihran në Stamboll, 29 f. Ishte si vazhdim i veprës tjetër të kësaj natyre *Qytetërimi islam*, që botohet në këtë seri si Vëllimi 13.

U përkthye shqip për herë të parë nga M. Ajdini dhe u botua në Prizren më 1989 me titullin *Përhapja e Islamizmit*. Botimi më i plotë u bë me një përkthim të ri nga prof. dr. Ismail Ahmedi me titullin *Përpjekja e heronjve në përhapjen e Islamit*, SHB Logos-A Shkup. 43 f.

Ky është ribotim i përmirësuar i përkthimit të prof. dr. Ismail Ahmedit.

**Vëll. 13:** *Qytetërimi islam*. E përktheu M. Polisi. *Sami Frashëri në fushën e islamistikës* nga M. Polisi (f. 7-17). 113 f.

Vepra që mban numrin 1 në serinë “Biblioteka e xhepit” (Cep Kütüphanesi), e cila nisi të botohej në Stamboll më 1879 me botues Mihranin në Stamboll. Biblioteka përfshiu 32 libra, prej të cilëve 13 (për shkak të botimit të disa librave në disa fashikuj të veçantë) patën autor Sami Frashërin.

Ky është një punim jo thjesht i islamologjisë, por edhe një trajtesë e sociologjisë. Thelbin dallues të qasjes në këtë vepër e shpreh vetë titulli, i cili flet për qytetërimin islam, një këndvështrim, i cili mbetet edhe sot aktual e më me peshë në diskutimet e mëdha për botën. Prandaj janë përmendur ndihmesat madhore të këtij qytetërimi në fusha, si astronomia, matematika, gjeografia, mjekësia, filozofia, drejtësia, letërsia, historia etj.

Botimi i parë në turqishten osmane mbante titullin *Medeniyet-i Islâmiyye* [“Qytetërimi islam”], 126 f. Është ribotuar më 1885 po nga ai botues në Stamboll, si dhe nga E. Çalık *Şemseddin Sami ve Medeniyet-i Islamiyye*. [Shemsedin Samiu dhe Qytetërimi islam]. İnsan Yayınları, Stamboll, 1996.

Përkthimi i parë shqip u bë nga prof. dr. Mehdi Polisi dhe u botua në Prishtinë më 1999 si *Vepra*, 10. U ribotua më 2002 nga SHB Logos-A në Shkup.

Ky është botim i ri i përmirësuar i atij përkthimi.

**Vëll. 14:** *Zëdhënësi i Lindjes* [Artikuj nga “Terxhumani Shark”]. I përkthyer: K. Prifti, V. Buharaja. 179 f.

Gjatë vitit 1878 Sami Frashëri drejtoi afër 100 numra të gazetës ‘Zëdhënësi i Lindjes’ në Stamboll. Ishte koha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe e Kongresit të Berlinit. Samiu në faqet e gazetës shtroi aspektet e ndryshme të çështjes shqiptare, hodhi poshtë orvatjet e shovinistëve që i mononin popullit shqiptar historinë, trashëgiminë kulturore dhe të drejtën për të pasur shtetin e tij në trojet e veta.

Më 1988 në vëllimin e parë të *Veprave* në dy vëllime, u botua në Tiranë një përmbledhje me përkthimin shqip të artikujve të Samiut në këtë organ nga 23 qershor 1878 deri më 19 gusht 1878, përkthyer nga K. Prifti, dhe nga 22 gusht 1878 deri më 16 tetor 1878 nga Vexhi Buharaja, gjithsej 63 shkrime.

Ky është botimi i tyre i parë si libër më vete.

**Vëll. 15:** *Gratë*. E përktheu H. Bushati. 64 f.

Një broshurë që edhe sot mbetet e freskët për trajtimin e një çështjeje të madhe shoqërore, sepse që në rreshtin e parë thekson se gjendja e gruas është një temë e gjerë dhe tepër e rëndësishme për ta diskutuar. *Vepra* i qaset kësaj teme kaq të vjetër të historisë së njerëzimit: barazisë së gjinive, duke mbrojtur pikëpamjet bashkëkohore më përparimtare. E çmon lart rolin e gruas në shoqëri, flet për qëndrimin e fesë ndaj femrës dhe njëherit për detyrat e saj në shoqëri, për rolin e pazëvendësueshëm të familjes.

Samiu e shkroi në gjuhën turke-osmane me titullin *Kadmlar* [“Gratë”] dhe e boti më 1879 në serinë “Bibliotekat e xhepit” me nr. 3 te Mihrani në Stamboll, 96 f. Një botim i dytë pa ndryshime u bë në Stamboll më 1894. Përk-



thimi i parë shqip është bërë nga H. Bushati dhe është botuar më 1973 në Shkodër. U ribotua në vitin 2004 nga SHB Logos-A në Shkup.

Ky është botimi i dytë i përkthimit nga SHB Logos-A, Shkup.

**Vëll. 16:** *Qielli*. E përktheu M. Polisi. *Parathënie* nga M. Polisi (f. 7-12). 97 f.

Një nga broshurat shkencore-popullore, që Sami Frashëri i përgatiti për të përhapur dijet dhe fjalën e fundit të shkencës deri te lexuesit e gjerë. Duke shfrytëzuar arritjet e kohës në fushën e kozmologjisë, autori hedh poshtë paragjykimet e përhapura për ndërtimin e universit dhe ndjek përfytyrimet e kulturave të ndryshme gjatë historisë deri te zbulimet e shkencëtarëve të shquar të Lindjes e të Perëndimit.

Edhe ky libër bënte pjesë në serinë e “Bibliotekës së xhepit”, ku doli më 1879 me titullin turqisht *Gök* [“Qielli”], me nr. 4. te Mihran Matbaası në Stamboll, 112 f.

Përkthimi shqip u bë posaçërisht për këtë seri të Veprave të S. Frashërit nga SHB Logos-A në Shkup, me rastin e njëqindvjetorit nga vdekja e autorit.

**Vëll. 17:** *Toka*. E përktheu M. Polisi. *Parathënie* nga M. Polisi (f. 7-10). 97 f.

Një broshurë shkencore-popullore, e lidhur ngushtë me librin *Qielli*, i cili botohet në këtë seri me nr. 16. Duke shfrytëzuar arritjet e kohës në fushën e gjeologjisë, shpjegon me gjuhë të kuptueshme për lexuesin e zakonshëm historinë e formimit të Tokës dhe etapat kryesore të evoluimit të saj si trup qiellor, si dhe shfaqjen e jetës, evoluimin e bimëve dhe të kafshëve deri në gjendjen e sotme.

Vepra u shkrua në gjuhën turke-osmane për serinë “Biblioteka e xhepit”, ku u botua më 1879 me titullin *Yer* [“Toka”], nr. 5 nga Mihrani në Stamboll, 119 f.

Përkthimi shqip edhe i kësaj broshure u bë posaçërisht për këtë seri të Veprave të S. Frashërit nga SHB Logos-A në Shkup, me rastin e njëqindvjetorit nga vdekja e autorit.

**Vëll. 18:** *Njeriu*. E përktheu M. Polisi, *Parathënie* nga M. Polisi (f. 7-9). 89 f.

Një nga veprat shkencore-popullore, në të cilën, duke u mbështetur në arritjet bashkëkohore të dijeve për shfaqjen e njeriut në Tokë, autori e sjell përshkrimin e njeriut deri te gjendja e sotme, te karakteristikat fizike dhe intelektuale të tij. Bashkë me vijimin e saj *Përsëri njeriu*, që botohet po në këtë seri me nr. 19, ai jep edhe një tablo të racave të njeriut, të karakteristikave të tyre, të përhapjes dhe të lidhjeve të tyre, sidomos duke shtruar çështjet e ndërlikuara të prejardhjes së veçorive dalluese.

Vepra u shkrua në gjuhën turke-osmane me titullin *İnsân* ["Njeriu"] dhe u botua më 1879 në serinë "Biblioteka e xhepit" me nr. 10. nga Mihrani në Stambol, 115 f.

Përkthimi shqip edhe i kësaj broshure u bë posaçërisht për këtë seri të Veprave të S. Frashërit nga SHB Logos-A në Shkup, me rastin e njëqindvjetorit nga vdekja e autorit.

**Vëll. 19:** *Përsëri njeriu*. E përktheu M. Polisi. *Parathënie* nga M. Polisi (f. 7-11). 123 f.

Vazhdim nga përmbajtja i broshurës *Njeriu*, që botohet në këtë seri me nr. 18, si botime shkencore-popullore për lexuesin e gjerë.

Vepra u shkrua në gjuhën turke-osmane me titullin *Yine İnsân* dhe u botua më 1885 në serinë "Biblioteka e xhepit" me nr. 26 nga Mihrani në Stamboll, 115 f.

Përkthimi shqip edhe i kësaj broshure u bë posaçërisht për këtë seri të Veprave të S. Frashërit nga SHB Logos-A në Shkup, me rastin e njëqindvjetorit nga vdekja e autorit.

**Vëll. 20:** *Mitologjitë*. E përktheu M. Polisi. *Parathënie* nga M. Polisi (f. 7-8). 87 f.



Një përmbledhje e shkëlqyer e miteve të popujve kryesorë të lashtë, në veçanti e zotave dhe e heronjve të mitologjisë greke, krahas me përvetësimin dhe përpunimin e tyre në mitologjinë romake. Enciklopedisti Sami Frashëri e zgjeron horizontin e lexuesit me botën e miteve që nga India e deri te popujt e Amerikës Latine. Për shkak të natyrës historike të këtyre njohurive, ato mbeten njësoj interesante edhe në ditët tona.

Vepra u shkrua në gjuhën turke-osmane dhe u botua me titullin *Esâtir* ["Mitologjitë"] në serinë e "Bibliotekës së xhepit" më 1879 me nr. 2 nga Mihrani në Stamboll, 108 f. Është ribotuar po turqisht më 1893 përsëri nga Mihrani në Stamboll.

Përkthimi shqip edhe i kësaj broshure u bë posaçërisht për këtë seri të Veprave të S. Frashërit nga SHB Logos-A në Shkup, me rastin e njëqindvjetorit nga vdekja e autorit.

**BIBLIOGRAFI E SHKRIMEVE**  
**PËR SHEMSEDIN SAMI FRASHËRIN**

---

**1880**

----*Lajme të posaçme nga Parisi* [Mbi përkthimin e "Të mjerëve" nga S. Frashëri], në: "Zaman", Stamboll. 30 mars.

Mithat, A. *Sefiller* [Mbi përkthimin e "Të mjerëve"], në: "Tercüman-i Hakikat", 10 maj.

**1883**

Vehbi. *Üdebamızdan Şemsettin Sami Bey-efendi'ye* [Njërit prej letrarëve tanë, zotit Shemsedin Sami Beut], në: "Tercüman-i Hakikat", 8 shkurt 1883.

Ismail, H. (Eldem). "Şemsettin Sami Bey", në: *On Dokuzuncu Asrin Türk Muharrirleri* [Shkrimtarët turq të shek. XIX], flet. 4. Kasbar Basımevi, Stamboll, 32 f.

**1896**

Ahmet, I. (Tokgöz). *Şemsettin Sami Bey* [Intervistë dhe letër prej S. Frashërit në qershor], në: "Servet-i Fünun", Stamboll, vëll. 11, nr. 275, 18 gusht, f. 220-228; ribotuar në: "Servet-i Fünun", Stamboll, më 10 (23) qershor 1904.

**1898**

Abdullah, Z. *Kamus al A'lam Huzurunda* [Mbi fjalorin e Kamus al-A'lamit], në: "Sabah", 17 shkurt.

**1899**

Cahit (Yalçın), H. *Kısa Birkaç Söz* [Disa fjalë shkurt], në: "Serveti Fünun", vëll. 16; 12 (24) janar, f. 340-343.

Mefhari. *Kamûs al-A'lâm* [Fjalori universal enciklopedik], në: "Sabah", 15 (28) mars.

Midhat, A. *Kamûs al-A'lâm* [Fjalori universal enciklopedik i gjeografisë dhe i historisë], në: "Tarik", Stamboll. 22 mars (3 prill).

Zühtü, A. *Kamus al-A'lam Huzurunda* [Mbi Fjalorin universal enciklopedik të gjeografisë dhe të historisë], në: "Sabah", Stamboll. 17 shkurt (1 mars).

----- *Sami bei*, "La Nazione Albanese", Catanzaro. 30 maj, f. 8.

## 1900

(Gurakuqi, L.) *A proposito di un libro*, në: "La nazione Albanese", Catanzaro. 31 mars.

----- *Kamus-i Türki Hakkında Mütalaat* [Mendime mbi Fjalorin shpjegues të gjuhës turke], në: "Mecmua-i Edebiye", Stamboll, nr. 5-8, 22 nëntor, 29 nëntor, 9 dhjetor, 13 dhjetor.

Rasime, E. *Kamus-i Türki Hakkında* [Mbi Fjalorin e gjuhës turke], në: "Hanımlara Mahsus", Stamboll, 7 (20) shtator; ribotuar në: "İkdam", 9 (22) shtator.

Seyda, M. N. *Musahabe-i Edebiye* ["Biseda letrare", kritikë për Përmbledhjen e vjershave të Bakiut nga S. Frashëri], në: "Mussaver Malumat", vëll. 10, nr. 230, 5 prill.

## 1901

----- *Besa* (mendime mbi dramën), në: "Toska", Kajro, nr. 2, tetor.

----- *Disa mendime mbi Fjalorin shpjegues të turqishtes*, në: "Revista letrare", katër artikuj: 22 janar- 12 shkurt.

## 1904

Gurakuqi, L. *Sami Beg Frashëri*, në: "La Nazione Albanese", Catanzaro, 15 korrik, f. 3.

[Kolonja, Sh.] *Sami Frashëri mbaroi jetën ditën e shtunë*, në: “Drita”, Sofje, nr. 46, 14 (27) qershor, f. 1. Ribotuar në: “Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare”, vëll. I, Tiranë, 1971, f. 130-131.

Tokgöz (Ihsan), A. *Ziya-i Elim, Merhum Şemsettin Sami Bey* [Humbje e dhimbshme, i ndjeri Shemsedin Sami Beu], në: “Servet-i Fünun”, nr. 687, Stamboll, 10 (23) qershor, f. 162-164.

Tokgöz (Ihsan), A. *Elim Bir Ziya* [Një humbje e dhimbshme], në “Serveti Fünun”, Stamboll. 23 gusht.

-----*Bir Haber-I Elim, Şemsettin Sami Bey'in İrtihali* [Një lajm i dhimbshëm, vdekja e Shemsedin Sami beut], në: “İkdam”, Stamboll. 6 (19) qershor.

-----*Ziya-i Azim* [Iluministi i madh], në: “Sabah”, 6 (19) qershor.

-----*Defin. İhya-yı* [Varroset. Vepra mbetet e gjallë], në: “İkdam”, Stamboll. 7 (20) qershor.

-----*Sami Beg Frashëri* (Njoftim mbi vdekjen), në: “La Nazione Albanese”, Catanzaro. 30 qershor.

-----*Bir Ziya-i Azim* [Një iluminist i madh], në: “Türk”, Kajro. 16 dhe 23 qershor (30 qershor dhe 7 korrik).

-----*Şemsettin Sami Merhum*, në: “Osmanlı”, nr. 141, 15 Teşrin-i Sani, Stamboll. f. 10-12.

## 1905

Abdullah, Ch. Ş. *Sami Bey*, në: “İçtihad”, nr. 2. Dergah, Stamboll.

Cevdet, A. *Şemsettin Sami Bey*, në: “İçtihad”, nr. 2, Gjenevë, janar; ribotuar me shkurtime në nr. 1, korrik 1906.

Luarasi, P. N. *Kujtimit të Sami Frashërit* [vjershë], në: “Kalendari Kombiar”, Sofje, f. 31.

----- (Njoftim mbi botimin e veprës “Shqipëria ç’ka qënë, ç’është dhe ç’do të bëhetë”), “La nazione Albanese”, Catanzaro, 15 prill, f. 4.

----- *Vdekjet e motit 1904* (Mbi vdekjen e Sami Frashërit), në: “Kalendari Kombiar”, Sofje, f. 30-31.

### 1907

----- *Libra të reja* (Shënim i shkurtër mbi “Shqipëria ç’ka qënë, ç’është dhe ç’do të bëhetë”), në: “Drita”, Sofje, 15 nëntor, f. 3.

### 1909

Veled Çelebi Izbudak), M. *Lisanımızın Esasları ve Şemsettin Sami Bey* [Bazat e gjuhës sonë dhe Shemsedin Samiu], në: “Resimli Kitap”, Stamboll, nr. 1, 1 shtator 1909. f. 24-29.

### 1910

Tevfik, E. *Yeni Osmanlılar* [Osmanët e rinj], në shtojcën e “Yeni Tasvir-i Efkar”, 11 shtator dhe 31 dhjetor.

### 1911

----- *Drama ‘Besa’ e S. Frashërit*, në: “Dielli e Flamuri”, 13 janar, f. 4.

----- *Drama ‘Besa’*, Luajtur nga teatro “Band’ e Lirisë” në Korçë, në: “Dielli e Flamuri”, 21 prill, f. 4.

### 1912

----- *Drama “Besa” në Natick Mass* [Mbi shfaqjen nga Kompania teatrale “Shqipëria”], në: “Dielli”, Boston, 15 shkurt, f. 3.



## 1914

Kramers, J. H. *Ş. Sami*, në: "Encyclopedie de l'Islam", vëll. 4, Leiden 1914-1934.

## 1919

Kemal, A. *Türkçemizin en Son Tekamülünü Hazırlayanlar: Ş. Sami bey* [Përgatitësit e zhvillimit më të fundit të turqishtes: Sh. Sami bej], në: "Peyami-Edebi", shtojca letrare, nr. 2, 21 gusht 1919.

Nazif, S. *Sully Prudhomme* [Mbi përkthimin e "Të mjerëve"], në: "Serveti Fünun", vëll. 56, 4 dhjetor, f. 92.

## 1920

Kemal, Ali. *Kamus-i Türki'ye Dair* [Mbi Fjalorin e gjuhës turke], në: "Peyami-Sabah", nr. 30, 4 mars 1920.

Necmi (Dilmen), I. *Tarih Edebiyat Dersleri* [Ligjërata për historinë e letërsisë], vëll. II, Stamboll. f. 217

Şeref, A. E. *Teracim-i Ahval: Kamus al-A'lam ve Sicill-i Osmani* [Çështje historike: Fjalori universal enciklopedik dhe regjistrat osmanë], në: *Tarih-i Müsahaberleri*, ["Bisedime mbi historinë", botuar në fillim si artikuj në "Sabah" më 1917-1918], Stamboll. f. 336-341.

## 1921

*Drama 'Besa' e S. Frashërit*, në: "Koha", Korçë, 21 prill, f. 4.

## 1923

Şeref, A. E. "Shoqëruesit e historisë: Sami Frashëri dhe Hasan Tahsini", në: *Tarih-i Müsahaberleri*, Stamboll; ribotuar më 1985 në Ankara.

## 1924

Bursali, M. T. *Şemsettin Sami Bey*, në: "Osmanli Müellifleri", Stamboll.

## 1926

Nazif, S. *Franstzçadan Türkçeye Kamus Meselesi* [Çështja e Fjalorit frëngjisht-turqisht], në: “Serveti Fünun”, vëll. 60, 3 qershor 1926, f. 34-36.

## 1928

Akçura, Y. *Şemsettin Sami Bey* [“Shemsedin Sami Beu” me të dhëna për biografinë e tij, të marra nga i biri, Ali Samiu], në: “Türk Yılı”, Türk Ocakları, Ankara f. 352-355; ribotuar më 1990: *Türkçülük ve Dış Türkler*. Toker Yayınları, Stamboll.

## 1929

Asim (Yazıksız), N. *Şemsettin Sami*, në: “Türk Tarih Encümeni Mecmuası”, Stamboll, vëll. I, nr. 2, shtator-nëntor, f. 24-34.

## 1930

Tokgöz, A. I. *Matbuat Hatırları* [“Kujtimet e botuara”, për Fjalorin frëngjisht-turqisht], vëll. 1, Stamboll. f. 34.

## 1931

Nüçet, S. “Gazeta ‘Sabah’”, në: *Türk Gazetecilik (1831-1931)*, Stamboll, f. 71-72.

## 1932

Sami, M. Turhan Tan). *Şemsettin*, në: “Hayat Ansiklopedisi”, botim i gazetës “Cumhuriyet”, vëll. 9, Stamboll 1932-1936.

Nuretin, V. *Dil Kurultayı ve Şemsettin Sami* [Kongresi i gjuhës dhe Shemsedin Samiu], në: “Akşam”, 23 shtator.

### 1933

Gövsa, I. A. *Şemsettin Sami*, në: “Meşhur Adamlar”, vëll. 4, Yediğün Yayınevi, Stamboll, 1933-1938. f. 367-368.

-----*Dil İnkilabında Şemsettin Sami Merhum* [I ndjери Shemsedin Sami në revolucionin gjuhësor], në: “Uyanış-Servet-i Fünun”, Stamboll, 16 mars, f. 250-251; ribotuar me titullin *Bir anı: Şemsettin Sami* [Një përkujtimore për Shemsedin Samiun], në: “Hakimiyeti Milliye”, 28 mars.

### 1934

Dağlioğlu (Turhan), H. *Şemsettin Sami. Hayati ve Eserleri*. [“Shemsedin Samiu. Jeta dhe veprat”]. Resimli Ay Matbaası, Stamboll, 72 f.

Levend, A. S. *Edebiyat Tarihi Dersleri: Tanzimat Edebiyatı* [Leksione të historisë së letërsisë: letërsia e Tanzimatit]. Stamboll.

----- *Sami Frashëri*, në: “Illyria”, nr. 7, f. 3.

Stërmilli, H. *Sami Frashëri*, në: “Tomori”, 4 mars.

### 1935

Yalçın, H. C. *Edebi Hatıralar* [“Kujtime letrare”, për Fjalorin frëngjisht-turqisht]. Stamboll. f. 109-11.

-----“Şemsettin Sami”, në: *Hayat Ansiklopedisi*. Stamboll. Vëll. 9, f. 3889.

### 1936

Uşaklıgil, H. Z. *Kırk Yıl* [“Dyzet vjet”, për përkthimin e “Të mjerëve”], Stamboll. Vëll. I, f. 89.

### 1938

-----*Gıpta Ettiğim İki Müneverimiz* [Dy intelektualë që i kam smirë], në: “Akşam”, Stamboll, 7 korrik.

## 1939

Sevük, I. H. B. *İsmail Habib Diyor Ki... Bir Şemsettin Sami Çıkar, Bir Akademinin Nesilerce Yapamıyacağı İşi Başarır* [İsmail Habibi thotë... del një Shemsedin Sami dhe kryen me sukses një punë që nuk mund ta bëjë për breza të tërë një akademi], në: "Akşam", 7 shkurt 1939.

## 1940

Gezgin, H. S. *Şemsettin Sami*, në: "Yeni Mecmua", Stamboll, vëll. 4, 30 gusht.

Süha, H. *Şemsettin Sami*, në: "Yeni Mecmua", Stamboll, 30 gusht.

Uşaklıgil, H. Z. *Kırk Yıl* ["Dyzet vjet", Stamboll. Vëll. IV, f. 139-141.

## 1942

Ftera, F. Dy fjalë për dramën "Besa" të Sami Frashërit, në: "Tomori i vogël", nr. 18.

## 1943

Gurra, M. S. *Sami bej Frashëri. Rreth abetarit të Stambollit*, në: "Bashkimi i Kombit", 23 dhjetor.

Nuretin, V. *Şemsettin Sami Sinsi Bir Türk Düşmanı mı idi? Haşa!* [A qe Sami Frashëri një armik fsheharak i turqve? E pamundur!], në: "Akşam", 15 tetor.

Oksal, S. *Şemsettin Sami ve Eserleri* [Shemsedin Samiu dhe veprat e tij], në: "Tanin", Stamboll, 23 tetor.

Orhon, O. S. *Koynumuzda Beslediklerimiz. Bir Hıyanet ve Nankörlük Vesikası* [Ata që kemi mbajtur në gji. Një rast pabesie e mosmirënjohjeje], në: "Çınaraltı", vëll. 5, nr. 106-113, 2 tetor-20 nëntor.

-----*Şemsettin Sami-nin Hatırası* [Në kujtim të Shemsedin Samiut], në: "Akşam", 24 korrik.



## 1944

Feridun Es, H. *Bilmediğimiz bir Fikri Devi: Şemsettin Sami* [Një gjigant i panjohur: Shemsedin Samiu], “Tanimadığımız Meşhurlar” [Të famshmit e panjohur, seri artikujsh], në: “Akşam”, Stamboll. 26 dhjetor.

Feridun Es, H. *Hava Kararırken bir Şemsettin Samiye Gelen Misafirler* [Miqtë që vizitonin Shemsedin Samiun kur ngrysej], në: “Akşam”, Stamboll. 27 dhjetor.

Feridun Es, H. *Şemsettin Saminin 20.000 Ciltlik Kütüphanesi Kaça Satılmıştı?* [Sa u shit biblioteka e Shemsedin Samiut me 20.000 vëllime?], në: “Akşam”, Stamboll. 28 dhjetor.

Feridun, H. *Şemsettin Sami Kırk Yaşında İken Sekseninde Gösteriyordu* [Shemsedin Samiu kur ishte 40 vjeç dukej si të ishte 80 vjeç], në: “Akşam”, Stamboll. 30 dhjetor.

Feridun, H. *Heybeleri Heykellerle Dolu, Eşek Sirtında Gelen Resim Hocası* [Mësuesi i pikturës që vinte mbi gomarin me hejbet plot skulptura], në: “Akşam”, Stamboll. 31 dhjetor.

-----*Sami Frashëri*, në: “Revista letrare”, nr. f. 8.

## 1945

Drizari, N. “Foreword”, në: Sami Frashëri, *Pledge of Honor*. New York, 1945, f. 7-9.

Esler, S. *Babassi Şemsettin Sami* [“Im atë, Shemsedin Sami”], në: “Resimli Hayat Mecmuası”, gusht, Stamboll. f. 262.

Feridun Es, H. *Şemsettin Sami'nin Dükkanı Nasıl Yağma Edilmişti?* [Si u plaçkit dyqani i Shemsedin Samiut?] në: “Akşam”, Stamboll. 2 janar.

Feridun Es, H. *Yedi Çocuk Strayla Şemsettin Sami'in Dizlerini Ovardı*, [Shtatë fëmijët i fërkonin me radhë gjunjët Shemsedin Samiut], në: “Akşam”, Stamboll. 3 janar.

Feridun Es, H. *Ölürken Şemsettin Sami'nin Ağzından Çıkan Son Cümle*, [Fjalët e fundit që shqiptoi Shemsedin Samiu para se të vdiste], në: “Akşam”, Stamboll. 4 janar.

-----*Şemsettin Sami*, në: “Türk Meşhurları”, Yedigün Yayınevi, Stamboll.

### 1946

Kuntay, M. C. *İki Eksik* [Dy mangësi], në: “Son Posta”, Stamboll, 1 mars.

### 1947

Kuntay, M. C. *Ahmet Asım Efendi ve Şemsettin Sami Bey* [Ahmet Asim Efendiu dhe Shemsedin Sami Beu], në: “Son Posta”, Stamboll, 30 janar.

### 1948

Gencan, T. N. *Şemsettin Sami*, në: “Ergene”, Stamboll, nr. 8, maj, f. 6-9.

### 1949

Levend, A. S. *Türk Dilinde Gelişme ve Sadeleşme Safhaları* [Etapat e zhvillimit dhe të thjeshtëzimit të gjuhës turke], Ankara; bot. 2 Ankara, 1960.

### 1950

Domi, M. *Sami Frashëri*, në: “Rinia”, 15 qershor.

Ediz, H. A. *8 Lisan Bilen ve 54 Eser Yazmış Olan Büyük Alim Şemsettin Sami* [Dijetari i madh Semsedin Sami, njohës i 8 gjuhëve dhe autor i 54 veprave], në: “Bütün Türkiye”, Stamboll. 2 korrik 1950, f. 146-149.

Kodra, Z. *Sami Frashëri, themelonjës i ideve të Rilindjes*, në: “Shqiptarja e re”, nr. 7, f. 27-28.

Ndoja, M. *Sami Frashëri – shkrimtar patriot i Rilindjes*, në: “Zëri i popullit”, 13 qershor.

Sako, Z. *Sami Frashëri*, në: “Arësimi popullor”, nr. 2, f. 18-20.

Sako, Z. *Sami Frashëri*, në: “Letërsia jonë”, nr. 6, f. 45-62.

Sako, Z. *Sami Frashëri, shkrimtar dhe patriot i çquar i Rilindjes*, në: "Zëri i popullit", 15 qershor; "Bashkimi", 15 qershor; "Letërsia jonë", nr. 6.

Spasse, S. *Sami Frashëri*, në: "Pionieri", 1 qershor.

Shuteriqi, Dh. *Burrë i çquar i të kaluarës sonë patriotike*, në: "Bashkimi", 14 qershor.

Shuteriqi, Dh. "Sami Frashëri", në: Letërsia e re shqipe dhe Antologji e komentuar për shkollat e mesme, f. 62-63.

Varfi, A. *Sami Frashëri*, në: "Letrari i ri", 31 maj.

-----Mbrëmje akademike për kujtimin e 100-vjetorit të ditëlindjes së Sami Frashërit, në: "Bashkimi", 14 qershor.

-----*Sami Frashëri*, në: "Luftëtari", 15 qershor.

-----*Sami Frashëri*, në: "10 Korriku", nr. 6, f. 8.

## 1951

-----Mbi dramën "Besa" të Sami Frashërit, në: "Zëri i popullit", 8 qershor.

## 1952

Dizdaroğlu, H. *Şemsettin Sami bey ve Dil Anlayışı* [Shemsedin Sami Beu dhe mendimet e tij mbi gjuhën], në: "Türk Dili", nr. 9, qershor, f. 76.

## 1954

Frashëri, K. *Sami H. Frashëri*, në: "Nëndori", nr. 6, f. 95-109.

Janicaj, P. *Sami Frashëri në letërsinë shqiptare*, në: "Flaka e vllaznimit", 3 gusht 1954.

Kaleshi, H. *Mbi veprat e Sami Frashërit*, në: "Flaka e vllaznimit", 15 nëntor 1954.

-----Një letër e Sami Frashërit mbi Lidhjen e Prizrenit, në: "Buletin për shkencat shoqërore", nr. 2, f. 114-116.

Özön, M. N. *Veprat dhe gazetatat e Shemsedin Samiut*, në: "Edebiyat ve Tenkit Sözlüğü", İnkılap Yayınevi, Stamboll.

Sako, Z. *Sami Frashëri*, në: “Buletin për shkencat shoqërore”, nr. 2, f. 3-9.

Sako, Z. *Sami Frashëri*, në: “Arësimi popullor”, nr. 2, f. 18-20.

Varfi, A. Sami Frashëri – shkrimtar e patriot i Rilindjes, në: “Zëri i popullit”, 5 qershor.

## 1955

Demiraj, Sh. *Gjuha e Sami Frashërit*, në: “Buletin për shkencat shoqërore”, nr. 3, f. 191-235.

Frashëri, K. *Sami Frashëri (1850-1904)*, në: “Buletin për shkencat shoqërore”, nr. 4, f. 57-109.

Mann, S. E. “Sami Frashëri”, në: *Albanian Literature*. London, f. 41-43.

Prifti, S. *Mbi idetë arësimore të Sami Frashërit*, në: “Arësimi popullor”, nr. 6, f. 56-64.

----- “Sami Frashëri”, në: *Enciklopedičeskij Slovar*, 3. Moskva, f. 535.

Shuteriqi, Dh. “Sami Frashëri”, në: *Histori e letërsisë shqipe për shkollat e mesme*. Bot. I; bot. II 1958, f.131-140.

## 1956

-----“Sami Frashëri”, në: *Bolshaja Sovjetskaja Enciklopedija*, vëll. 45. Moskva. f. 573.

## 1959

Peyami, S. *I kujt është varri i Sami Frashërit?*, në: “Tercüman” [sipas Nevzat Köseoğlu, *Peyami Safa*, Ankara, 2002, f. 220].

Varfi, A. Me rastin e 60-vjetorit të botimit të veprës së Sami Frashërit “Shqipëria ç’ka qënë, ç’është dhe ç’do të bëhetë”, në: “Zëri i popullit”, 5 qershor.

-----“Sami Frashëri”, në: *Histori e letërsisë shqipe*, II, Instituti i Historisë e i Gjuhësisë, Tiranë. f. 277-291.



## 1960

Proietti, R. *Sami Frashëri*, në: "Shejzat", nr. 9-10, f. 309-315.

Reso, E. Pikëpamjet filozofike dhe shoqërore-politike të Sami Frashërit, në: "Rruga e partisë", nr. 6, f. 34-41.

-----"Sami Frashëri", në: *Mallaja sovjetskaja enciklopedija*. Vëll. 9. Moskva. f. 1154.

## 1961

Gordlevskij, V. A. "Šemseddin Sami-bej", në: *Izbrannye soçinenija*, tom II, Moskva, f. 385-387.

----- *Şemsettin Sami*, në: "Hayat Ansiklopedisi", vëll. 6. Hayat Yayın, Stamboll, 1961-1963.

## 1962

Bulka, N. Apostujt e shqiptarizmit u hodhën në beteja. Themelonjësit e Shoqërisë së Stambollit: S. Frashëri, V. Pasha, J. Vreto, në: "Luftëtari", 11 tetor.

Frashëri, K. Mjeshtri i madh (Shënime nga jeta e Sami Frashërit), në: "Mësuesi", 16 nëntor.

Frashëri, K. *Tre vëllezër pishtarë*, në: "Ylli", nr. 10, f. 6-9.

----- "Frashëri", në: *Grand Larousse Encyclopedique*, vëll. 5, Paris. f. 253.

Reso, E. Sami Frashëri – Pikëpamjet filozofike, shoqërore dhe politike, SHB Naim Frashëri, Tiranë, 72 f.

Reso, E. Sami Frashëri - linguist dhe lëvrues i shquar i gjuhës shqipe, në: "Zëri i popullit", 15 nëntor.

Sevengil, R. A. *Saray Tiyatrosu* [Teatri i Sarajit]. Vëll. 4 i "Türk Tiyatrosu Tarihi" [Historia e teatrit turk], Stamboll. f. 150-151.

Toçi, V. Ballafaqim me dëshirat patriotike të S. Frashërit në librin "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë", në: "Ekonomia popullore", nr. 5, f. 19-28.

Xoxe, S. *Mendimet ekonomike të Sami Frashërit*, në: “Referate e kumtesa të Sesionit shkencor të Fakultetit Ekonomik”, nr. 1, f. 27-40.

### 1964

Kastrati, J. [*Shkronjëto e gjuhësë shqip*], në: “Gramatikat e shqipes. II”, “Buletin shkencor i Institutit Pedagogjik Dvjeçar të Shkodrës”, f. 258-265; ribotuar në: “Histori e gramatologjisë shqiptare (1635-1944), Rilindja, Prishtinë, 1980.

Sako, Z. Sami Frashëri filozof dhe mendimtar i madh, në: “Bashkimi”, 18 qershor.

Shita, V. Sami Frashëri: Besa. Skena shqipe. Prishtinë.

Yüksel, S. “Parathënie”, në: *Taaşuk-ı Tal’at ve Fitnat, ikinci baskı*. [“Dashuria e Talatit me Fitneten”, përg. për botim dr. Sedit Yüksel]. Universite Basımevi, Ankara. f. III-V.

### 1965

Gaçe, B. *Mendimtari i madh i Rilindjes*, në: “Puna”, 1 qershor.

Gurakuqi, M. Mendimet e Sami Frashërit për të ardhmen e Shqipërisë, në: “Zëri i rinisë”, 2 qershor.

Hysi, G. Mendimet e Sami Frashërit për shtetin e ardhshëm shqiptar, në: “Drejtësia popullore”, nr. 1, f. 39-48.

Islami, F. *Sami Frashëri dhe mendimet ekonomike të tij*, në: “Ekonomia popullore”, nr. 6, f. 38-53.

Panajoti, J. Sami Frashëri – ideolog i shquar i Rilindjes sonë, “Bashkimi”, 1 qershor.

Reso, E. “Diskutim rreth kumtesës së Z. Xholit e A. Uçit”, në: *Konferenca e parë e studimeve albanologjike*, f. 688-689.

Shaplo, S. Pikëpamjet e Sami Frashërit për organizimin e arësimit në Shqipëri, në: “Mësuesi”, 22 nëntor.

----- “Sami Frashëri”, në: *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, Instituti i Historisë e i Gjuhësisë, Tiranë. f. 250-255.

## 1966

Frashëri, K. Şemsettin Sami. L'ideologue du mouvement national albanais, në: "Studia albanica", 1, f. 95-110.

Riza, S. Me rastin e një 80 vjetori - S. Frashëri, Shkronjëto e gjuhësë shqip, në: "Ylli", nr. 8, f. 27.

Sertkaya, O. Şemsettin Sami ve son Kamus-i Turki [Shemsedin Samiu dhe Fjalori i tij i turqishtes], në: "Cultura Turcica", Ankara, vol. III, nr. 1, f. 46-51.

## 1967

Alpan, N. *Türkçü ve Türkçeci Şemsettin Sami Bey-i unutmazım* [Të mos e harrojmë punën e Shemsedin Samiut për turqishten dhe turqizmin], në: "Önyasa", nr. 22, qershor.

Bajraktarević, F. *Najveći balkanski leksikograf*, në: "Anali Filološkog Fakulteta", Beograd, Knj. 7, f. 149-151.

Dizdari, T. *Skënderbeu sipas Kamus ul-A'lamit të Sami Frashërit*, në: "Ylli", nr. 3, ribotuar në: *Skënderbeu dhe epoka e tij* (përgatitur nga Xh. Lloshi), SHB Naim Frashëri, f. 105-109.

Frashëri, K. Shemsedin Sami Frashëri – ideolog i lëvizjes kombëtare shqiptare, në: "Studime historike", nr. 2, f. 79-93.

Özön, M. N. – Dürder B. "Veprat e Sh. Samiut", në: *Türk Edebiyatı Ansiklopedisi*, Remzi Yayınevi, Stamboll. f. 187.

Sertkaya, O. F. *Şemsettin Sami ve Kamus-i Turki* [Shemsedin Samiu dhe Fjalori shpjegues i turqishtes], në: "Türk Kültürü", nr. 56, qershor., f. 577-581.

## 1968

Akün, Ö. F. "Şemseddin Sami", në: *İslam Ansiklopedisi*, Cüz 115. Milli Eğitim Basımevi, Stamboll; ribotim 1997: Cilt 11, Anadolu Üniversitesi Güzel Sanatlar Fakültesi, Eskişehir, f. 410-422.

Kaleshi, H. Veprat filologjike e dialektologjike të Sami Frashërit, në: "Fjala", Prishtinë, nr. 2.

Kaleshi, H. Veprat leksikografike dhe enciklopedike të Sami Frashërit, në: "Jehona", Shkup, nr. 8, tetor.

Kaleshi, H. *Sami Frashëri – popullarizues i shkencave moderne*, në: "Jehona", nr. 10, Shkup, f. 25-43.

Kaleshi, H. *Sami Frashëri në letërsinë dhe filologjinë turke*, në: "Gjurmime albanologjike", nr. 1, f. 33-116.

Necatigil, B. *Şemsettin Sami*, në: "Edebiyatımızda İsimler Sözlüğü", bot. 5. Varlık Yayınevi, Stamboll.

Shpuza, G. Vëllezërit Frashëri në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në: "Nëntori", nr. 6. Tiranë, f. 65-75.

## 1969

Alpan, N. *Dünyaca Paylaşılmayan Bir Sima: Şemsettin Sami* [Sami Frashëri: një figurë e rrallë në botë], në: "Onasya Dergisi", shkurt; ribotuar në: "Yeni Tanin", Ankara. 3 prill.

Kaleshi, H. *Recension për librin e A. S. Levend*, në: "Gjurmime albanologjike, Seria shkencat historike", nr. 1, f. 300-303.

Kaleshi, H. *Sami Frashëri gazetar*, në: "Jehona", Shkup, nr. 1-2.

Levend, A.S. *Şemsettin Sami*. Türk Dil Kurumu, Ankara. 212 f., përkth, shqip më 2004.

## 1970

Buxhovi, J. Mendimtari i madh i shekullit të kaluar, në: "Rilindja", 31 maj.

Çarçani, S. "Fjalët e urta" të Sami Frashërit, në: "Nëndori", nr. 6, f. 128-132.

Çollaku, Sh. Patrioti, ideologu dhe shkencëtari Sami Frashëri, në: "Zëri i popullit", 31 maj.

----- Ideologu dhe gjuhëtari i shquar (Sami Frashëri), në: "Drita", 31 maj.



Kaleshi, H. Le rôle de Chemseddin Sami Frachery dans la formation de deux langues littéraires: turc et albanaise, në: "Balcanica", nr. 1, Beograd, f. 197-216.

### 1971

Kaleshi, H. *Burimet lidhur me studimin e Sami Frashërit*, në: "Buletin i Punimeve Shkencore të Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Zbornik Filozofskog Fakulteta u Prištini", nr. 8, Prishtinë. f. 35-54.

Kaleshi, H. *Şemsettin Sami'nin Siyasi Görüşleri ve 'Megalo-idea' Hakkındaki Düşünceleri* [Kundërshtimet politike të Shemsedin Samiut kundrejt pikëpamjeve të Megali-idesë], në: "Belgelerle Türk Tarihi Dergisi. Dün, Bugün, Yarın", janar, nr. 40.

### 1972

Çollaku, Sh. Gratë – gjysma e njerëzimit. (Mbi veprën "Gratë" të Samiut), në: "Nëndori", nr. 2, f. 33-38.

### 1973

Çollaku, Sh. *Recension: A. S. Levend, "Şemsettin Sami"*, Ankara 1969, në: "Studime historike" nr. 1, f. 55-81.

Kurdakul, Ş. "Şemseddin Sami", në: *Şairler ve Yazarlar Sözlüğü* [Fjalor i shkrimtarëve dhe i poetëve], Ankara. f. 357-358.

Mollova, M. Étude phonétique sur les mots transcrits dans le Dictionnaire turc-français de Samy Bey, në: "Zeitschrift für Balkanologie", Band IX, H. 1-2, f. 128-173.

### 1974

Çollaku, Sh. *Patrioti dhe enciklopedisti Sami Frashëri*, në: "Bashkimi", 18 qershor.

Dedja, B. *Mbi mendimin pedagogjik të Rilindjes (Sami Frashëri)*, në: "Revista pedagogjike", nr. 3, f. 121-139.

- Frashëri, K. *Samiu ynë i madh*, në: "Ylli", nr. 6, 26-27, 37.
- Haxhihasani, Q. *Rreth një dorëshkrimi me këngë popullore të Sami Frashërit*, në: "Studime filologjike", nr. 2, f. 83-91.
- Mehdiu, F. *Kosova në "Kamus-al'A'lam" të Sami Frashërit*, në: "Kosova", nr. 3, f. 473-486.
- Pëllumbi, S. – Spahiu, S. "Sami Frashëri", në: *Fjalor i filozofisë*. Botime Enciklopedike, Tiranë. f. 108-110.
- Reso, E. *Ëndrra e Sami Frashërit dhe realiteti i Shqipërisë socialiste*, në: "Zëri i popullit", 16 mars.
- Roshi, N. – Dhimitri, P. *Ëndrrat e guximshme të rilindësve dhe realiteti ynë madhështor (Me rastin e botimit të veprës së Sami Frashërit)*, në: "Bashkimi", 7 mars.
- Sami Frashëri – figurë e shquar e Rilindjes sonë Kombëtare, në: "Drita", 16 qershor.
- Spahiu, Xh. *Që të tre burra të ndjerë, na nderuan mëmëdhenë*, në: "Zëri i popullit", 18 qershor.
- Shema, I. *Mendimet aforistike të të Sami Frashërit*, në: "Jeta e re", nr. 2.
- Shuteriqi, Dh. *Tre vëllezërit Frashëri: Abdylë, Samiu e Naimi*, në: "Drita", 23 qershor, f. 2, 14.
- Xholi, Z. *Filozofi, dijetari, statisti i shquar i Shqipërisë*, në: "Zëri i popullit", 16 qershor; ribotuar në: *Sami Frashëri*, 1978, f. 176-185.
- Xholi, Z. *Duke lexuar Sami Frashërin*, në: "Nëntori", nr. 3, f. 28-35; ribotuar në: *Sami Frashëri*, 1978, f. 69-135.
- Xholi, Z. *Au 75-e anniversaire de la parution de l'oeuvre de Sami Frasher* "L'Albanie, son passé, son présent, son avenir", në: "Studia albanica", nr. 1, f. 55-81.

## 1975

- Abdiu, N. *Mbi mendimin psikologjik të Sami Frashërit*, në: "Buletin Shkencor i Institutit të Lartë Pedagogjik", Shkodër, nr. 1, f. 121-130.

Bakiu, Z. *Veprat letrare të Sami Frashërit*, në: “Nëntori”, nr. 6, f. 150-154.

Bakiu, Z. Sami Frashëri – patriot dhe dijetar i shquar (Bibliografi me përmbajtje të veprave). Botim i Bibliotekës Kombëtare, Tiranë.

Bulo, J. “Shqipja u bë...” (Një letër e pabotuar e Naimit dhe e Samiut), në: “Drita”, 1 qershor, f. 12.

Çollaku, Sh. *Patriot, ideolog, shkencëtar*, në: “Shqipëria e re”, nr. 4.

Frashëri, K. *Optimizmi i Samiut*, në: “Ylli”, nr. 5, f. 28-29.

Kondo, A. Militant i shquar i Rilindjes sonë Kombëtare, në: “Mësuesi”, 4 qershor.

Reso, E. Sami Frashëri, figurë e shquar e Rilindjes sonë kombëtare, në: “Bashkimi”, 1 qershor.

Shpuza, G. Sami Frashëri, punëtor i palodhur, mendimtar i shquar, në: “Zëri i rinisë”, 31 maj.

Xholi, Z. Mendimtar i madh dhe përfaqësues i shquar i kulturës shqiptare, në: “Zëri i popullit”, 1 qershor.

## 1976

Bakiu, Z. *Të thënme të S. Frashërit mbi arsimin dhe librin*, në: “Revista pedagogjike”, nr. 3, f. 114-115.

## 1977

Ejntrej, G. Nacionalno-patriotçeskaja drama S. Frashëri “Besa” kak voploshçeniye socialno-estetičeskikh idej Rilindje konca XIX veka, në: “Vestnik Leningradskogo Universiteta”, nr. 14.

## 1978

Çarçani, S. “Fjalë të urta të Sami Frashërit”, në: S. Frashëri, *Vepra*. Rilindja, Prishtinë, Vëll. 3: *Fjalë të urta*, f. 7-11.

Çollaku, Sh. Sami Frashëri – udhëheqës dhe ideolog i shquar i Rilindjes Kombëtare, në: “Puna”, 26 maj.

Çollaku, Sh. Sami Frashëri – patriot, ideolog dhe enciklopedist i shquar, në: “Bashkimi”,

2 qershor.

Demiraj, Sh. “Disa shënime të përmbledhura rreth gjuhës së veprës [Shqipëria ç’ka qënë, çështë e ç’do të bëhet?], në: S. Frashëri, *Vepra*. Rilindja, Prishtinë, Vëll. 2, f. 111-116.

Frashëri, K. Tre vëllezër pishtarë: A. Frashëri, N. Frashëri, S. Frashëri (Album), SHB 8 Nëntori, Tiranë, 95 f.

Kastrati, J. *Shkronjëto e gjuhësë shqip (1886)*, në: “Buletin Shkencor”, Shkodër, nr.1, f. 65-80; nr. 2, f. 59-78.

Lito, Z. Një polemikë luftarake e Sami Frashërit, në: “Mësuesi”, 3 janar.

Mufaku, M. *Nga letërshtëmbimet e Samiut me De Radën* (Letra e Dora D’Istrias Sami Frashërit), në: “Jeta e re”, Prishtinë, nr. 3

Rapaj, I. Shpëtimi a humbja e Shqipërisë është në duar të shqiptarëve, në: “Luftëtari”, 21 maj.

Reso, E. Sami Frashëri – udhëheqës dhe ideolog i shquar, në: “Zëri i popullit”, 23 maj.

Reso, E. *Sami Frashëri filozof dhe patriot i madh*, në: “Studenti i bujqësisë”, 30 maj, 16 qershor.

Reso, E. Sami Frashëri - dijetar e patriot i shquar shqiptar, në: “Nëntori”, nr. 5, f. 207-226

Reso, E. “Parathënie”, në: S. Frashëri, *Vepra*. Rilindja, Prishtinë, Vëll. 2, f. 7-19.

----- Şemsettin Sami, në: *Yeni Hayat Ansiklopedisi*. Dogan Kardeş Yayınları, Stamboll, vëll. 6, f. 2985.

Shita, V. “Pashënie”, në: S. Frashëri, *Vepra*. Rilindja, Prishtinë, Vëll. 1: *Besa*, f. 145-169.

Shpuza, G. *Vëllezërit Frashëri në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, në: “Nëntori”, nr. 6, f. 65-75; ribotuar në: “Gjurmime në epokën e Rilindjes Kombëtare shqiptare”, 1980; ribotuar në përkthim frëngjisht *Les frères Frasherî a la veille*



*de la fondation de la Ligue Albanaise de Prizren*, në: “Les lettres albanaises”, nr. 2, 1982, f. 165-181; ribotuar në përkthim turqisht: *Şemseddin Sami'den kardeşlerine mektuplar*, në “Tarih ve Toplum”, Stamboll, shkurt 1997, f. 20-22.

Xholi, Z. *Sami Frashëri (Nga jeta dhe vepra)*, SHB 8 Nëntori, 186 f. Ribotuar: Sami Frashëri, *Vepra*, vëll. 4, *Sami Frashëri (Monografi)*, Rilindja, Prishtinë, 1978.

## 1979

Agalliu, F. “Shkronjëto e gjuhës shqip” e S. Frashërit – vepër e rëndësishme e gramatologjisë shqiptare, në: “Studime filologjike”, nr. 3, f. 13-29.

Alidemi, H. *Roli i Sami Frashërit në hartimin e projekt-kushtetutës së shtetit shqiptar*, në: “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”<sup>5</sup>, Prishtinë, f. 201-206.

Alpan, N. “Alfabeti i Stambollit dhe Sami Frashëri”, në: *Arnavut alfabesi nasıl doğdu?* [“Si lindi alfabeti i shqipes?”]. Ankara. f. 14-48.

Bala, V. Ai që lufton për të drejtën është dy herë trim (Me rastin e 80-vjetorit të botimit të veprës së S. Frashërit), në: “Mësuesi”, 7 mars.

Buchholz, O. – Fiedler, W. *Zur gesellschaftlichen Wortschatz bei Sami Frashëri*, në: “Zur Herausbildung des modernen gesellschaftlichen Wortschatzes im Albanischen”, Linguistischen Studien, Reihe A, nr. 58, Berlin, f. 121-126.

Demiraj, Sh. Ndhimesa e Sami Frashërit në lëvrimin e gjuhës shqipe, në: “Studime filologjike”, nr. 3, f. 3-12; ribotuar në: *Gjuha shqipe. Probleme dhe disa figura të shquara të saj*. Globus R. Tiranë, 2003, f. 215-229.

Gega, Xh. *Një vështrim mbi Abetaren e gjuhës shqip të S. Frashërit*, në: “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”<sup>5</sup>, Prishtinë, f. 269-277.

Ismajli, R. "Parathënie", në: S. Frashëri, *Vepra*. Rilindja, Prishtinë, Vëll. 5: *Shkronjëtove e gjuhës shqipe*, f. 7-13.

Kashari, Q. Filozofi, dijetari dhe statisti i shquar i Shqipërisë, në: "Mësuesi", 20 qershor.

Lito, Z. Një polemikë luftarake e Sami Frashërit, në: "Mësuesi", 3 janar.

Mahilaj, K. "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë", në: "10 Korriku", nr. 3, f. 29-30.

Mehdiu, F. *Prezentimi i Sami Frashërit në gjuhën serbokroate*, në: "Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare" 5, Prishtinë, f. 259-268.

Nika, Th. Patrioti dhe mendimtari i madh i Rilindjes sonë Kombëtare, në: "Zëri i popullit", 19 qershor.

Nushi, M. *Gramatika e Sami Frashërit*. Universiteti i Prishtinës.

Pirra, M. *Kontributi i vëllezërve Frashëri në historiografinë shqiptare*, në: "Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare" 5, Prishtinë, f. 165-200.

Reso, E. Bashkimi dhe uniteti i popullit – kusht vendimtar i pamposhtëm i fitores (Me rastin e 80-vjetorit të botimit të "Shqipëria ç'ka qenë..."), në: "Zëri i rinisë", 28 shkurt.

Reso, E. Sami Frashëri – patriot dhe filozof i madh shqiptar, në: "Zëri i rinisë", 16 qershor.

Shpuza, G. Të dhëna të reja rreth veprimtarisë së hershme letrare të S. Frashërit, në: "Drita", 17 qershor.

Shuteriqi, Dh. "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë", në: "Bashkimi", 9 mars.

Treska, Sh. "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë?" – manifest i Rilindjes sonë Kombëtare, në: "Puna", 13 mars.

Xholi, Z. *Manifesti i Rilindjes Kombëtare Shqiptare (Me rastin e 80-vjetorit të botimit)*, në: "Zëri i popullit", 15 mars; ribotuar në: "Shqipëria e re", nr. 3.

## 1980

Berati, L. Sami Frashëri – figurë e shquar e Rilindjes sonë Kombëtare, në: “Mësuesi”, 28 maj.

Çollaku, Sh. Patrioti i madh dhe dijetari enciklopedist Sami Frashëri, në: “Zëri i popullit”, 3 qershor.

Faensen, J. *Die albanische Nationalbewegung*. Osteuropa-Institut an der Freien Universität Berlin. Balkanologische Veröffentlichungen 4, f. 105-112.

Ismajli, R. *Gramatika e Sami Frashërit*, në: “Fjala”, nr. 1. Prishtinë.

Osmani, Sh. Filozofi, dijetari, statisti ynë i shquar Sami Frashëri, në: “Drita”, 1 qershor.

Reso, E. Sami Frashëri luftoi me shpirt e me zemër për popullin shqiptar, në: “10 Korriku”, nr. 5, f. 24-25.

Reso, E. Pikëpamjet filozofike, politike dhe shoqërore të Sami Frashërit, SHB 8 Nëntori, 162 f.

Sako, Z. Sami Frashëri – mendimtar i shquar e patriot i flaktë, në: “Bashkimi”, 1 qershor.

Trepça, M. Sami Frashëri lëvrues dhe propagandues i gjuhës shqipe, në: “Ushtima e maleve”, Dibër, 31 maj.

Xoxi, K. *Sami Frashëri*, në: “Zëri i rinisë”, 31 qershor 1980.

Xholi, Z. “Parathënie”, në: *Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhet?* SHB e Librit Shkollor. f. 3-26.

## 1981

Çollaku, Sh. *Ribotimi i Kamus-i Turki*, në: “Drita”, 4 janar 1981.

Çollaku, Sh. “Çështja shqiptare në shkrimet publicistike të Sami Frashërit botuar në gazetën Terxhuman-i Shark”, në: *Studime për letërsinë shqiptare*, I.

Osmani, T. Rreth përpjekjeve të Sami Frashërit për alfabetin e gjuhës shqipe, në: “Buletin shkencor”, Shkodër, nr. 2, f. 145-151.

-----*Şemsettin Sami për gjuhën turke*, në: "Türk Dili", nr. 355, f. 15-35.

-----Şemsettin Sami, në: *Türk Ansiklopedisi*. Milli Eğitim Basımevi, Ankara, vëll. 30, f. 251.

## 1982

Bakıu, Z. H. *Bibliografi e zgjeruar e veprave të Sami Frashërit*, SHB 8 Nëntori, 289 f. Ribotuar nga Rilindja, 1984.

Çollaku, Sh. *Sami Frashëri për bibliotekat*, në: "Drita", 25 prill.

Çollaku, Sh. Sami Frashëri për problemet e familjes dhe të emancipimit të gruas, në: "Studime historike", nr. 3, f. 117-138.

Çollaku, Sh. *Sami Frashëri si krijues dhe kritik letrar*, në: "Studime filologjike", nr. 4, f. 151-175.

Idrizi, F. [Recension] Z. H. Bakıu, *Bibliografi e zgjeruar e veprave të Sami Frashërit*, në: "Drita", 2 gusht.

## 1983

Mehdiu, F. *Vilajeti i Manastirit në Kamus-al-A'lam*, në: "Gjurmime albanologjike, Seria shkencat historike", XIII, f. 225-246.

Osmani, Sh. "Sami Frashëri", në: *Fjalor i pedagogjisë*. SHB 8 Nëntori, Tiranë, f. 212-214.

Qosja, R. *Estetika e gjuhës së Sami Frashërit*, në: "Jeta e re", Prishtinë, nr. 5, f. 861-890.

-----"Sami Frashëri", në: *Historia e letërsisë shqiptare*, Instituti i Gjuhësisë e i Letërsisë, Tiranë. f. 164-175.

-----"Şemsettin Sami" në: *Türk ve Dünya Ünlüleri Ansiklopedisi*. Anadolu Yayıncılık, vëll. 10, Stamboll, f. 5206.

## 1984

Bakıu, Z. H. *Bibliografi e zgjeruar e veprave të Sami Frashërit*, Tiranë, ribotuar në: S. Frashëri, *Vepra*. Vëll. 8, Rilindja, Prishtinë.



Bulo, J. Një dëshmi e re për fjalorin e gjuhës shqipe të Sami Frashërit, në: "Drita", 15 prill; ribotuar në: *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, Tiranë, 1998, f. 231-235.

Finn, R. *İlk Romanlar. ve Ahmet Mithat Efendi* [Romancierët e parë. Shemsedin Samiu dhe Ahmet Mithat Efendiu], në: "Türk Romani (İlk Dönem 1872-1900)". Bilgi Yayinevi, f. 17-39.

Gusho, F. *Atdhetari mendjendritur*, në: "Bashkimi", 18 qershor.

Gjokutaj, Ç. *Kurdoherë me zemrën dhe mendjen te Shqipëria*, në: "Zëri i popullit", 17 qershor.

Hetzer, A. [Recension] Zyber Hasan Bakiu: *Bibliografi e zgjeruar e veprave të Sami Frashërit*. Tiranë, 1982; në: "Südost-Forschungen", München, XLII, f. 337-342.

Krasniqi, B. *Romani i Sami Frashërit*, në: "Fjala", 15 dhjetor.

Mujaj, H. *Sami Frashëri dhe kontributi i tij në fushën e gjuhësisë*, në: "Rilindja", Prishtinë, 17 mars; ribotuar në: "Fjala", Prishtinë, nr. 1-12.

Nushi, M. "Kontributi i Sami Frashërit për terminologjinë gramatikore të gjuhës shqipe", në: *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare* 9, Prishtinë.

Nushi, P. Tipologjia e njësive enciklopedike të Fjalorit të përgjithshëm të historisë e të gjeografisë të Sami Frashërit dhe misioni i tij, në: "Fjala", nr. 15, 16.

Prifti, K. "Traktati politik "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë". "Pikëpamjet politiko-shoqërore të S. Frashërit", në: *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, f. 344-348; 374-380.

Shpuza, G. Mendimi publicistik i Sami Frashërit për çështjen agrare, në: "Drita", 17 qershor.

Shpuza, G. Shemsedin Sami Frashëri – enciklopedist i madh i kohës së vet, në: "Nëntori", nr. 10, f. 152-168.

Tako, P. "Drita" në zi. "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë?", në: *Shahin Kolonja*, SHB 8 Nëntori, Tiranë. f. 166-172.

Tarifa, F. *Sami Frashëri dhe Rilindja Kombëtare*, në: “Zëri i rinisë”, 16 qershor.

Vangjeli, Sh. Ideolog dhe luftëtar për çështjen e mëmëdheut, në: “Luftëtari”, 17 qershor.

Xholi, Z. “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë”, në: “Bashkimi”, 1 mars.

Xholi, Z. Sami Frashëri – mendimtari, gjuhëtari e atdhetari i shquar shqiptar, në: “Gjuha jonë”, nr. 1, f. 100-108.

## 1985

Çollaku, Sh. “Sami Frashëri”, në: *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë, 1985, f. 290-291.

Boriçi, H. *Sami Frashëri – publicist*, në: “Drita”, 26 qershor.

Raka, F. Kontributi i Sami Frashërit për zhvillimin e shqipes letrare, në: “Bota e re”, 15 janar.

Ramadan, R. *Përkthimi që e lëndoi Sami Frashërin*, në: “Rilindja”, 5 janar.

## 1986

Çollaku, Sh. *Mendimi iluminist i Sami Frashërit*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 315 f.

Dodi, A. *Një vepër me rëndësi për historinë e arsimit dhe të gjuhës amtare* [Abetare e gjuhësë shqip], në: “Gjuha jonë”, nr. 2, f. 104-110.

Elsie, R. “Sami Frashëri”. *Dictionary of Albanian Literature*. Greenwood Press, Westport, Connecticut. f. 46-47.

Kastrati, J. “Shkronjëto e gjuhësë shqip” (1886) – më e para gramatikë në gjuhën amtare, në: “Gjuha jonë”, nr. 1, f. 90-96.

Qosja, R. “Sami Frashëri”, në: *Historia e letërsisë shqipe. Romantizmi*. Prishtinë. Ribotuar nga Toena, Tiranë, 2000. f. 345- 400.

-----“Şemsettin Sami”, në: *Büyük Larousse, Sözlük ve Ansiklopedi*. Gelişim Yayınları, Stamboll, vëll. 7, f. 4284.

## 1987

Desnickaja, A. V. "Sami Frasheri", në: *Allbanskaja literatura i albanskij jazyk*. Nauka, Leningrad. f. 80-82.

Kraja, M. Shaban Çollaku – 'Mendimi iluminist i S. Frashërit; në: "Drita", 5 korrik.

Özkırımlı, A. *Şemsettin Sami*, në: "Türk Edebiyatı Ansiklopedisi", Cilt 4. f. 1071-1073.

Xholi, Z. Mendimtarë të Rilindjes Kombëtare. SHB 8 Nëntori, Tiranë.

## 1989

Parlatır, I. "Şemsettin Sami (1850-1904)", në: *Başlangıcından Günümüze Büyük Türk Klasikleri, Tarih-Antoloji-Ansiklopedi*, [Periudha e fillimit të klasikëve të mëdhenj turq. Histori, antologji, enciklopedi]. Cilt 9, f. 111-119.

-----Şemsettin Sami, në: *Maydan Larousse*. Meyda Yayınevi, Stamboll, vëll. 11, f. 758.

## 1990

Rijahi, M. E. *Zeban ve adabi farisi der kalemnavi Othman* [Gjuha dhe letërsia persiane në trevat e ndikimit osman]. Teheran. 308 f.

Shpuza, G. Sami Frashëri dhe kritika letrare e kohës, në: "Bashkimi", 1 qershor.

Vila, B. Konferencë përkujtimore me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Sami Frashërit, në: "Studime filologjike", nr. 2, f. 247.

## 1991

Hetzer, A. *Die Frau im Unglück. Skizzen zu den Anfängen der albanischen Prosaliteratur (Sami Frasheri und Pashko Vasa)*, në: "Albanien in Vergangenheit und Gegenwart". Südosteuropa-Studien 48. Südosteuropa Gesellschaft, München, 1991, f. 135-152.

Ismajli, R. *Gramatika e Sami Frashërit*, parathënie në: Sami Frashëri, *Veptra*, Vëll. 5. Rilindja, Prishtinë, 1979. Ribotuar në: "Gjuhë dhe etni", Rilindja, Prishtinë, f. 213-219.

## 1994

Duro, A. *Konferencë shkencore ndërkombëtare për Sami Frashërin në Sankt-Peterburg*, në: "Studime filologjike", nr. 1-4, f. 216-218; ribotuar në "Gjuha jonë", nr. 1-4, f. 113-114.

Ejntrej, G. *Teatri i Sami Frashërit*, kumtesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare për Sami Frashërin në Sankt-Peterburg, qershor.

Ejntrej, G. *Monografia e Sh. Çollakut mbi Sami Frashërin*, kumtesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare për Sami Frashërin në Sankt-Peterburg, qershor.

Kaplan, M. *Taaşşuk-i Talat ile Fitnat*, në: "Türk Edebiyatı Üzerinde Araştırmalar", 2. Dergah Yayınları, Stamboll. f. 73-92.

Pano, N. Problemet, idetë dhe gjuha në traktatin social-politik të S. Frashërit 'Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe çdo të bëhetë?', kumtesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare për Sami Frashërin në Sankt-Peterburg, qershor.

Polisi, M. "Sami Frashëri dhe Kamus al-A'lâm," në: S. Frashëri, *Veptra* Vëll. 9. Logos-A, Shkup. f. 7-20.

-----"Sami Frashëri", në: *Historia e popullit shqiptar*, Tiranë. f. 112-113.

Smirnova, H. *Sami Frashëri si historian*, kumtesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare për Sami Frashërin në Sankt-Peterburg, qershor.

-----Şemsettin Sami, në: *Türkiye Gazetesi Yeni Rehber Ansiklopedisi*. Cilt 18. İhlas Holding, Stamboll. f. 259.

Velikov, A. P. *Studimet turkologjike të Sami Frashërit*, kumtesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare për Sami Frashërin në Sankt-Peterburg, qershor.



Voronina, I. *Mbi rolin e Sami Frashërit në krijimin e terminologjisë gjuhësore*, kumtesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare për Sami Frashërin në Sankt-Peterburg, qershor.

Zhugraja, A. *Terminologjia në veprën shkencore të Sami Frashërit*, kumtesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare për Sami Frashërin në Sankt-Peterburg, qershor.

## 1995

Elsie, R. "Sami Frashëri", në: *History of Albanian Literature*. Columbia University Press, New York. Përkthyer shqip *Histori e letërsisë shqiptare*. Dukagjini, Pejë, 1997, f. 181-185; ribotuar me pak shkurtime në: *Albanian Literature: a Short History*, London 2005; përkthyer shqip: *Letërsia shqipe. Një histori e shkurtër*. Skanderbeg Books, Tiranë, 2006, f. 77-82.

Hamiti, S. *Besa simbas Sami Frashërit*. në: "Studime. 2", ASHK, Prishtinë, f. 149-156; ribotuar në: *Letërsia shqipe. Sprova për një poetikë. 5*. Dukagjini, Pejë, f. 72-77; ribotuar në: "Letërsia filobiblrike. Letërsia romantike", Faik Konica, Prishtinë, 2002, f. 377-384; ribotuar në: *Letërsia romantike shqiptare për kl. XI*. Albas, Prishtinë, 2004, f. 131-141.

Rexhepagiq, J. Sami Frashëri dhe pedagogjia e Rilindjes Kombëtare. ASHAK, Prishtinë. 242 f.

## 1996

Ajeti, I. Sami Frashëri në vijën e krijimit të gjuhës letrare shqipe, në: "Studime. 2", ASHAK, Prishtinë.

Çalık, E. *Şemseddin Sami ve Medeniyet-i Islamiyye*. [Shemseddin Samiu dhe qytetërimi islam]. İnsan Yayınları, Stamboll.

Ismajli, R. *Sami Frashëri si studios i gjuhës*, në: "Studime. 2", Prishtinë.

Shpuza, G. Shemsedin Sami Frashëri për qytetërimin islam, në: "Perla", nr. 1, f. 20-27.

Shpuza, G. *Vëllezërit Frashëri në një botim iranian*, në: "Perla", nr. 1, f. 102-105.

### 1997

Demiraj, Sh. Sami Frashëri – një ndër themelvënësit e shqipes së sotme letrare, në: "Perla", nr. 1, f. 33-39.

Grillo, O. "Sami Frashëri", në: *Sbkrimtarët shqiptarë për fëmijë (1872-1995). Leksikon. Botimet Enciklopedike*, Tiranë, f. 63-64.

Nuro, K. *Përmbledhja e Shahnamesë*, në: "Perla", nr. 4, f. 80-81.

Shpuza, G. "Libër për idetë iluministe të Shemsedin Sami Frashërit". (Recension për monografinë e Sh. Çollakut). Botuar në: "Në vazhden e gjurmimeve ...", Toena, Tiranë, f. 341-343.

Yerguz, I. *Şemsettin Sami, Yaşamı, Sanatı, Yapıtları*. [Shemsedin Samiu. Jeta, arti, vepra]. Engin Yayıncılık Stamboll.

### 1998

Bulo, J. "Figura e Sami Frashërit në dritën e një studimi të ri", në: *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, Tiranë, f. 287-296.

Bulo, J. "Sami Frashëri mendimtar iluminist", në: *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, Tiranë, f. 297-303.

Osmani, Sh. "Dimensione të kulturës persiane në opusin e Sami Frashërit", në: *Panteoni iranian dhe iranologët shqiptarë*. SHB Saadi Shirazi, Tiranë, f. 92-108.

Raka, F. "Vlerat shkencore të veprave filologjike të Sami Frashërit" në: *Çështje të shqipes letrare*, Shkupi, Shkup. f. 143-163.

Shkodra, F. "Sami Frashëri si dijetar eurdit dhe filozof", në: *Nga tradita tek e sotmja*, Rozafa, Prishtinë, f. 37-43.

Shpuza, G. *Shemseddin Sami Frashëri*, në: "Cheshmandaz" (Panorama). Monthly Magazin on International Cultural Relations of Iran and Islam. Shkurt, f. 32-34.

## 1999

Bici, V. Fillimet e terminologjisë së gjeografisë në gjuhën shqipe (Ndihmesa e vëllezërve Frashëri), në: “Gjuha jonë”, nr. 1-2, f. 34-41.

Duro, A. Veçori të leksikut dituror në dy vepra të Sami Frashërit, në: “Gjuha jonë”, nr. 1-2, f. 31-34.

Kurdakul, Ş. *Şemsettin Sami*, në: “Şairler ve Yazarlar Sözlüğü”, Stamboll, f. 613-614.

Parlatır, I. – Çetin, N. *Genç Kalemler Dergisi*. [“Revista e letrarëve të rinj”, revistë në të cilën në prill 1912 u ribotua artikulli i S. Frashëri “Gjuha dhe letërsia jonë”]. Türk Dil Kurumu, Ankara, f. 421-426.

Polisi, M. *Sami Frashëri në fushën e islamistikës*, në: Sami Frashëri, *Vepra*. Vëll. 10. Prishtinë.

Shpuza, G. *Firdusiu dhe Samiu*, në: “Perla”, nr. 1, f. 61-69.

Trix, F. The Stamboul Alphabet of Shemseddin Sami Bey: Precusor to Turkish Script Reform, në: “International Journal of Middle East Studies”, nr. 31.

Tural, Ş. *Şemsettin Sami*. Şule Yayınları, Stamboll. 151 f.

## 2000

Mansaku, S. *Sami Frashëri – gjuhëtar i shquar dhe atdhetar*, në: “Gjuha jonë”, nr. 3-4, f. 115-121.

Rexhepagiq, J. Naimi dhe Samiu në pedagogjinë e Rilindjes Kombëtare, në: “Koha ditore”, 28 tetor.

Shkurti, S. Simpozium shkencor kushtuar 100-vjetorit të veprës së Sami Frashërit “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë?”, në: “Studime filologjike”, nr. 1-2, f. 244-246.

Shpuza, G. Koncepti i Shemseddin Sami Frashërit për qytetërimin, në: “Perla”, nr.1, f. 76-83.

## 2002

Baku, P. “Sami Frashëri”, në: *Fjalor enciklopedik*, SHB Bacchus, Tiranë. f. 226-227.

Hamiti, S. "Sami Frashëri. Besa simbas Samiut", në: *Letërsia filobiblike. Letërsia romantike. Vepra letrare 7*, Faik Konica, Prishtinë, f. 377-384.

Işık, I. *Şemsettin Sami*, në: "Türkiye Yazar Ansiklopedisi", bot. 2 i zgjeruar. Elvan Yayınları, Ankara.

Kulla, N. "Sami Frashëri", në: *Antologji e mendimit shqiptar*. Plejada.

Özgürel, A. *Dil Ustası Şemsettin Sami*, në: "Radikal", 31 mars 2002.

Polisi, M. "Parathënie", në: Sami Frashëri, *Gjuba. Logos-A*, Shkup. 2002, f. 11-15.

Sedaj, E. "Sistemi i homogjenizimit gjuhësor i S. Frashërit", në: *Shqipja arbërore*, Prishtinë, f. 306-310.

Shpuza, G. Përpyetje për periodizimin e veprimtarisë së Sami Frashërit, në: "Univers", Tiranë, nr. 2, f. 29-46.

Shpuza, G. *Përfytyrimi gjeografik i Sami Frashërit për Iranin e kohës së tij*, në: "Perla", nr. 3, f. 15-26; ribotuar në: "Studime orinetale", nr. 2, Prishtinë. f. 143-150.

Shpuza, G. Hyrje në historinë e lashtë perso-iraniane sipas Shemsedin Sami Frashërit, në: "Perla", nr. 4, 3-14.

## 2003

Ahmedi, I. *Parathënie*, në: *Përpyekja e heronjve në përhapjen e Islamit*. Përkth. nga arabishtja Ismail Ahmedi. SHB Logos-A Shkup.

Bilmez, B. Sami Frashëri apo Shemsedin Sami? Mitologjizimi i një intelektualit otoman në historiografinë moderne turke dhe në historiografinë socialiste shqiptare nëpërmjet perceptimit selektiv, në: "Përpyekja", nr. 18, f. 118-145.

Çetaku, D. "Taaşuk" i Sami Frashërit dhe gratë, në: "Perla", nr. 2, f. 104-115.

Hasani, H. "Sami Frashëri", në: *Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë 1501-2001*. Faik Konica, Prishtinë, f. 146-147.



Shpuza, G. “Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhetë?” e Sami Frashërit, në: “Perla”, nr. 3-4, f. 64-74.

## 2004

Ahmeti, I. *Drama ‘Sejdi Jabja’ e Samiut dhe ‘Princesha e Andaluzisë’*, kumtesë në Seminarin XXIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 20 gusht.

Ahmedi, I. *Parathënie*, në: S. Frashëri, *Vepra*. 12. SHB Logos-A, Shkup. f. 7-15.

Ajeti, I. *Sami Frashëri – 100 vjet pas*, kumtesë në Seminarin XXIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 20 gusht.

Bakui, Z. *Parathënie*, në: Sami Frashëri, *Vepra*, Vëll. 10: *Fjalë të urta*. SHB Logos-A, Shkup. (f. 15-18).

Bilmez, B. *Një libër në diskutim: “Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhetë?”*, kumtesë në Konferencën shkencore “Sami Frashëri dhe vepra e tij”, në Tiranë, 18 qershor 2004.

Bulo, J. *Fjalori i gjuhës shqipe i Sami Frashërit – një projekt apo realitet?*, në: “Studime filologjike”, nr. 3-4, f. 103-108.

Çetaku, D. *Sami Frashëri për emancipimin e gruas*, në: “Perla”, nr. 2, f. 91-97.

Ejntrej, G. – Kaminskaja, L. *Gramatika e Sami Frashërit në konceptin e sotëm gjubësor*, në: “Studime filologjike”, nr. 3-4, f. 29-40.

Fortino, I. C. *Sami Frashëri Jeronim de Radës: Shënime rreth një letre*, në: “Perla”, nr. 2, f. 57-67.

Hamiti, S. “Sami Frashëri”, në: *Letërsia romantike shqiptare për kl. XI*. Albas, Prishtinë, f. 131-141.

Ismaili, A. *Dy fjalë për serinë e veprave të Sami Frashërit*, në: Sami Frashëri, *Vepra*. Vëll. 1 (f. 7-12). SHB Logos-A, Shkup.

Ismajli, R. *Sami Frashëri dhe gjubësia*, në: “Perla”, nr. 2, f. 51-56.

Kabo, M. *Sami Frashëri themelues i gjeografisë kombëtare*, kumtesë në Seminarin XXIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 20 gusht.

Karami, R. Roli i Sami Frashërit në përhapjen e kulturës dhe letërsisë perse, në: "Perla", nr. 2, f. 15-18.

Kodra, K. *Drama "Besa" e Sami Frashërit*, në: "Perla", nr. 2, f. 108-112.

----- *Konferencë shkencore "Sami Frashëri dhe vepra e tij"*, në: "Studime filologjike", nr. 1-2, f. 212-214.

Lafe, E. *Sami Frashëri për formimin e gjuhës letrare të përbashkët*, në: "Perla", nr. 2, f. 84-90, ribotuar në: "Gjuha shqipe", nr. 3, f. 11-15.

Levend, A. S. *Sami Frashëri*. Dituria, Tiranë. 141 f.; botimi turqisht: 1969.

Mansaku, S. Probleme të historisë së gjuhës shqipe në veprën e Sami Frashërit, në: "Perla", nr. 2, f. 98-104.

Naska, K. Fondi dokumentar i Sami Frashërit në Arkin Qendror Shtetëror, në: "Perla", nr. 2, f. 113-118.

Özerdim, S. N. "Bibliografi e veprës së Sami Frashërit", në: A. S. Levend, *Sami Frashëri*. Dituria, Tiranë. f. 134-141.

Polisi, M. *Kamus al-A'lam vepër me përmasa ndërkombëtare*, kumtesë në Seminarin XXIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 20 gusht.

Polisi, M. *Sami Frashëri në fushën e islamistikës*, në: Sami Frashëri, *Vepra*. Vëll. 13. SHB Logos-A, Shkup. f. 7-17.

Polisi, M. *Parathënie* në: S. Frashëri, *Vepra*, Vëll. 16. SHB Logos-A. f. 7-12.

Polisi, M. *Parathënie* në: S. Frashëri, *Vepra*, Vëll. 17. SHB Logos-A. f. 7-10.

Polisi, M. *Parathënie* në: S. Frashëri, *Vepra*, Vëll. 18. SHB Logos-A. f. 7-9.

Polisi, M. *Parathënie* në: S. Frashëri, *Vepra*. Vëll. 19. SHB Logos-A. f. 7-11.

Polisi, M. *Parathënie* në: S. Frashëri, *Vepra*, Vëll. 20. SHB Logos-A. f. 7-8.

Polisi, M. *Interesimi i Sami Frashërit për shkencat natyrore*, në *Filologji*, nr. 12, f. 143-155, Prishtinë. Ky punim është lexuar edhe në Konferencën shkencore “*Sami Frashëri dhe vepra e tij*”, organizuar më 18 qershor 2004 në Tiranë.

Prifti, K. Sami Frashëri – statist i shquar shqiptar, në: “*Perla*”, nr. 2, f. 19-31.

Qosja, R. *Sami Frashëri krijues në dy kultura*, kumtesë në Seminarin XXIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 20 gusht.

Rexha, I. *Projekti kulturoro-arsimor i S. Frashërit*, kumtesë në Seminarin XXIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 20 gusht.

Sinani, Sh. *Sami Frashëri, ideolog pa ksenofobi*, në gazetën “*Metropol*”, 18 qershor.

Sinani, Sh. “*Tjetri*” në traktatin ideologjik të Samiut, në: “*Perla*”, nr. 2, f. 32-45.

Sinani, Sh. Recension për: G. Shpuza, *Bota iraniane në veprën e Sami Frashërit*, në: “*Perla*”, nr. 2, f. 133-138.

Shpuza, G. *Bota iraniane në veprën e Sami Frashërit*. Onufri, Tiranë, 223 f.

Shpuza, G. Sami Frashëri dhe Lëvizja nacionaliste turke, në: “*Perla*”, nr. 2, f. 68-83.

Shpuza, G. Hyrje në historinë e lashtë perso-iraniane sipas Shemsedin Sami Frashërit, në: “*Perla*”, nr. 4, f. 3-14.

Vila, B. Konferenca shkencore “*Sami Frashëri dhe vepra e tij*”, në: “*Perla*”, nr. 2, f. 149-152.

Vila, B. Përkujtohet 100-vjetori i vdekjes së Sami Frashërit, në: “*Perla*”, nr. 4, f. 193-194.

Xholi, Z. Sami Frashëri – një patriark i kulturës dhe i kombësisë shqiptare, në: “*Perla*”, nr. 2, f. 46-50.

Xholi, Z. *Parathënie*, në: Sami Frashëri, *Vepra*. Vëll. 1 (f. 13-16). SHB Logos-A, Shkup.

Zeço, M. Sami Frashëri dhe përmendoret e Orhunit, në: "Perla", nr. 2, f. 105-107.

## 2005

Abazi-Egro, G. Sami Frashëri dhe letërsia e bejtexhinjve: Një sprovë e parë për botimin e Divanit të Nezim Frakullës, në: "Studime filologjike", nr. 1-2, f. 119-164.

Boriçi, H. "Sami Frashëri", në: Gazetarë dhe publicistë shqiptarë. Fjalor enciklopedik. Tiranë, f. 133-134.

Polisi, M. Kamus al-A'lami i Sami Frashërit – vepër me përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare, në: "Jeta e re", nr. 1-2, Prishtinë. f. 177-188.

Rexhepagiq, J. *Opusi dhe rëndësia e veprës së Sami Frashërit*, në: "Perla", nr. 1, f. 27-39.

## 2006

Demo, E. "Gjaveja" e rinisë, shqip pas 130 vjetësh, në: "Shekulli", 28 gusht.

Ilnica, E. "Thesare" në kullën e Frashërlinjve, 8 fjalorë të rrallë me firmën e Samiut, në: "Shekulli", 20 nëntor.

*I përgatiti: prof. dr. Xhevat Lloshi*



## PJESA E DYTË

Hapja e Konferencës shkencore  
"Sami Frashëri 100 vjet pas"  
dhe promovimi i vëllimit  
Sami Frashëri 1-20  
19-20 nëntor 2004



## FJALA E ORGANIZATORIT

---

Të dashur miq, të nderuar mysafirë e kolegë, Ju që son-  
te keni ardhur këtu për ta nderuar emrin e Sami Frashërit,  
më lejoni që në emër të organizatorëve të këtij tubimi t'ju  
përshëndes dhe t'ju dëshiroj mirëseardhje në këtë mani-  
festim me rastin e njëqindvjetorit të vdekjes së Shemsedin  
Sami Frashërit.

Të nderuar të pranishëm!

Mendimtari, shkencëtari, enciklopedisti dhe themelvë-  
nësi i leksikografisë së re, si dhe i mjaft fushave të tjera në  
kulturë e në shkencë, njeriu i shtrirë në gjashtë gjuhë e  
kultura, e duke lënë vragë të pashlyeshme në kulturën  
shqiptare dhe atë turke, Sami Frashëri, ka lënë një trashë-  
gimi të gjerë librash të botuar, që përfshin rreth 60 vepra,  
po edhe mjaft dorëshkrime të pabotuara. Gjerësia e lën-  
dës dhe numri i gjuhëve kanë qenë arsyet, që lexuesi  
shqiptar ka pasur në duar vetëm një pjesë të vogël të këtij  
thesari dituror. Kështu kërkesa për ta pasur të botuar sa  
më gjerë shqip veprën e Sami Frashërit ka ardhur duke u  
bërë më këmbëngulëse, sidomos për të mos lënë një zbra-  
zëti të ndjeshme kundrejt botimeve të tjera për autorët e  
shquar shqiptarë të periudhës së Rilindjes. Mungesa është  
ndier sidomos për studiuesit dhe për studentët e shkolla-  
ve të larta. Një hap me rëndësi u bë me dy vëllimet (*Vepra 1*,  
*Vepra 2*), të përgatitura nga Akademia e Shkencave e  
Shqipërisë, që dolën më 1988, dhe me përmbledhjen si  
një seri në shumë vëllime që u realizua nga NGB "Rilind-  
ja" në Prishtinë (në 8 vëllime). Duke qenë i mbyllur numri  
i librave shqip, përparimet e tjera, natyrisht, do të bëhe-  
shin nëpërmjet punës së përkushtuar të përkthyesve.

Kështu paraqitja shqip e visarit të Sami Frashërit mbetej një detyrë e pakryer edhe për shkak të ndërlikimeve në historinë e botës shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shekullit që sapo u mbyll, të cilat e pengonin kulturën shqiptare të plotësonte thirrjen për ta mbajtur të gjallë zërin e Sami Frashërit për brezat që vijnë.

Shtëpia Botuese Logos-A në Shkup prej kohësh e kishte ndier se i përkiste të jepte ndihmesën e saj në këtë punë, që kërkon forcat e përbashkëta të një grupi të madh njerëzish të përgatitur për të qenë në lartësinë e detyrës përpara një kolosi të tillë të dijes së gjithanshme.

Viti 2004 është njëqindvjetori i vdekjes së rilindësit dhe enciklopedistit tonë të madh. Përvjetorët për figurat e mëdha nuk janë thjesht data përkujtimore, një kthim te faqja e historisë që ata kanë shkruar, por janë edhe nxitje për të parë se çfarë ka mbetur e pashuar nga mesazhi i tyre, çfarë kemi arritur të përballojmë në detyrën e nderit që kemi kundrejt tyre dhe çfarë na kërkohet më tej. Prandaj SHB Logos-A vendosi të bënte një hap tjetër dhe t'i paraqiste lexuesit shqiptar një botim më të plotësuar, si një seri *Biblioteka e Veprave të Sami Frashërit* në 20 libra, gjithnjë duke u orvatur që t'i qëndrohet sa më besnik veprës origjinale të Samiut, pa mos shtuar e hequr asgjë nga ajo që e ka thënë Samiu vetë.

Hapi i parë ishte të përzgjedheshin botimet shqip. Këshilli Botues i Logos-A për këtë shfrytëzoi përvojën e mëparshme, si dhe iu drejtua për këshillime të posaçme bashkëpunëtorëve të tij, prof. dr. Xhevat Lloshit, prof. dr. Mehdi Polisit, prof. dr. Ismail Ahmedit dhe njohësve e dashamirësve të tjerë të veprës së Samiut. Nga analizat e këshillimet e bëra, u pa si më e përshtatshme të ndërtonim një seri të re, pa ndjekur ndonjë botim të mëparshëm. Të prirë nga kjo, natyrisht pas konsultimeve me bashkëpunëtorët tanë, bëmë një kombimin të botimeve të



deriatëhershme në gjuhën shqipe, duke marrë diçka nga ASHSH-ja, diçka nga Rilindja, diçka nga botues të tjerë e familjarë të përkthyesve tashmë të ndjerë, duke i shtuar edhe gjashtë veprat që Logos-A i kishte botuar më parë dhe gjashtë të tjera që tash për herë ta parë po botohen në gjuhën shqipe. Kështu numri i përgjithshëm arriti në 20 libra.

Duke e bërë një punë që, sipas nesh, deri tash mezi ka pritur që të bëhet, gjithnjë duke dashur që Sami Frashërin në këtë përvjetor ta përkujtojmë sa më denjësisht, vendosëm që botimit të këtyre librave t'i bashkangjisim edhe një konferencë ndërkombëtare shkencore. Kur jemi këtu, pa mos u zgatur në aktivitetet rreth organizimit të kësaj konference, ndiejmë për detyrim që nga zemra t'i falënderojmë Akad. Luan Starovën dhe Akad. Ali Aliun, pa ndihmën e të cilëve kjo konferencë ndoshta as që do të mund të paramendohej si e tillë, si dhe bashkorganizatorët e këtij tubimi, Agjencinë Turke për Bashkëpunim Ndërkombëtar (TIKA) dhe OKH "Merhamet" nga Shkupi. Kur jemi te falënderimet, më lejoni që t'i falënderoj edhe ata që në një mënyrë a tjetër ndihmuan në botimin e këtyre librave: Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, NGB "Rilindja", z. Mentor Bakiun, z. Nexhmi Bushatin, si dhe të gjithë ata që derdhën mundin e tyre për të arritur këtë nivel të ri, në veçanti redaktorin e përgjithshëm, prof. dr. Xhevat Lloshin që siguroi njësinë e serisë, recensentët tanë, në veçanti prof. dr. Ismail Ahmedin, përkthyesin e përkushtuar prof. dr. Mehdi Polisin, që e ka përcjellë këtë punë prej kaq vjetësh, redaktorin artistik dhe formuluesin e dizenjës Edi Agagjyshin, që i dha fytyrën serisë, pa të cilët ne dhe lexuesit nuk do të kishin në dorë këtë punë të bukur nga pamja dhe me cilësi nga përmbajtja për nder të Samiut. Falënderime u shprehim edhe gjithë të tjerëve, që për këtë rast shfaqën frymë të vërtetë bashkëpunimi dhe

entuziazmi për ta çuar projektin deri në fund. Meritat e tyre janë të mëdha, emrat e tyre janë përmendur në secilin libër dhe vetëm do të bëheshin shumë po t'i jepnim thjesht si listë.

Sonte kemi edhe një risi. Organizatori i këtij tubimi në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave Shtetërorë të R. së Shqipërisë dhe Arkivin e Kosovës, si dhe Muzeun Historik Kombëtar të Shqipërisë, për kënaqësinë e të gjithëve, ndërsa nën mbikëqyrjen e artistit të ri, njëherit bashkëpunëtori ynë, Edi Agagjyshi, para nesh kanë shfaqur një ekspozitë me plot fotografi deri tash të njohura e të panjohura nga jeta e Sami Frashërit dhe faksimile të veprës së tij që natyrisht janë me interes për të gjithë ne.

Duke qëndruar sonde në përkujtimin e 100-vjetorit qëkur Sami Frashëri nuk është më me ne, më lejoni të them edhe diçka: sivjet mbushet një shekull që shkenca e kultura po përpiqen të japin përmasat e veprimtarisë dhe të veprës së Samiut, por ka mbetur edhe shumë për t'u bërë; Samiu është bërë dhe akoma do të qëndrojë si kandil edhe për shumë e shumë gjenerata. Zoti e bekoftë!

Ju falemnderit!

*Shkup, 19 nëntor 2004*  
*Mr. Adnan Ismaili*

*Prof. Dr. Remzi Nesimi\**  
(Maqedoni)

**VEPRAT GJUHËSORE  
TË SAMI FRASHËRIT**

---

Zonja dhe zotërinj,

Për mua është kënaqësi dhe nder i madh që, me rastin e përrimit të veprës madhore të kolosit të letrave shqipe Sami Frashëri, të them disa fjalë edhe për veprat gjuhësore të krijuesit letrar, të shkencëtarit erudit, të mendimtarit vizionar që me të drejtë mund të quhet koka universale dhe figura qendrore e kulturës shqiptare dhe e gjithë lëvizjes së Rilindjes Kombëtare.

Sonte, në kuadër të 20 veprave me vlera të shumëfishta të dijetarit të shkallës botërore, përurojmë edhe tri vepra gjuhësore të këtij eruditi të rrallë: "Abetaren e gjuhës shqipe", "Shkronjëtoeren e gjuhës shqipe" dhe veprën nga gjuhësia e përgjithshme "Gjuha". Këto u shkruan kur trojet tona i kishte kapluar errësira e prapambetjes së thellë. Prandaj rrethanat e kohës kërkonin që thuajse të gjitha figurat më të shquara të Rilindjes në krijimtarinë e tyre të shtriheshin në fusha të ndryshme: përpiqen të krijojnë një alfabet të vetëm, ta ngrenë shqipen në nivel të gjuhës letrare dhe ta studiojnë e përpunojnë atë, sepse, siç dihet,

■

\* Universiteti "Shën Qirili dhe Metodi" - Shkup

gjuha e shkruar nuk është vetëm thesari më i madh i një populli, por edhe tipari kryesor dhe hallka më e rëndësishme e bashkimit të kombit. Lidhur me këtë Samiu thotë: "Kombet mbahenë me gjuhëtë; Një komb që humbetë gjuhën e vet është i humbur e i harruar" e gjuha, siç thotë populli, ruhet atje ku shkruhet. Prandaj, vazhdon Samiu "Sot është dita që edhe shqiptarët të zënë të shkruajnë e të këndojnë gjuhën e tyre që të ruajnë kombin".

Prandaj s'është për t'u habitur që një kokë enciklopedike të krijojë njëkohësisht vepra leksikografike të nivelit shumë të lartë, të hartojë manifeste politike, siç është "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet", të krijojë vepra shkencore dhe të merret edhe me përpilimin e abetares së gjuhës shqipe.

Si njëri ndër themeluesit e Shoqërisë së të shtypurit shkronja shqip në Stamboll, Samiu dha kontributin më të madh në krijimin e alfabetit të shqipes, i cili njihet si alfabet i Shoqërisë së Stambollit, por, siç thotë profesor Mahir Domi, në formën e tij përfundimtare del si vepër e Samiut.<sup>1</sup> Siç dihet, me këtë alfabet u shkrua abetarja dhe shkronjëtorja e Samiut, veprat poetike të Naimit dhe të Rilindësve të tjerë. Prandaj mund të thuhet se me botimin e Abetares së Samiut fillon një etapë e re për gjuhën shqipe e sidomos për shkollat e para.

Samiu si poliglot - ai përveç gjuhëve klasike, zotëronte edhe disa gjuhë orientale dhe evropiane, si mendimtar, si shkencëtar i një kalibri të veçantë e mbi të gjitha si atdhetar, qysh në atë kohë, do të thotë afër 100 vjet para Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, shtroi para kulturës dhe lëvizjes së madhe shqiptare nevojën e krijimit të

■

<sup>1</sup> M. Domi, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit* (14-22 nëndor 1908), f. 24, Tiranë, 1972.



një gjuhë të përbashkët letrare, e cila do të dilte nga gjuha e gjithë shqiptarëve <sup>2</sup>.

Krijimi i një gjuhë të përbashkët ishte ëndërr edhe e rilindësve të tjerë. Kjo ëndërr u bë realitet me njësimin e saj dhe sot, sipas vlerësimit edhe të albanologëve të huaj, shqipja ka arritur në atë shkallë zhvillimi sa të mund të shprehë çdo koncepton letrar, shkencor etj. dhe të mos ngelë prapa edhe gjuhëve të zhvilluara të popujve të mëdhenj.

Për shkencat albanologjike rëndësi të veçantë ka vepra "Shkronjëtorja e gjuhës shqipe" që u botua më 1886 në Bukuresht - katër vjet pas botimit të gramatikës së Kristoforidhit dhe një vit para gramatikës së Pashko Vasës. Kjo vepër shquhet me rregullat dhe përkufizimet koncize dhe me shpjegimet e drejta shkencore. Samiu të gjitha çështjet që i preku i trajtoi me syrin dhe ndjenjën e një gjuhëtari me formim të plotë teorik e shkencor.

Por rëndësia më e madhe e kësaj vepre qëndron në faktin se ajo, jo vetëm që u hartua nga një dijetar i profilit të Samiut, por edhe për arsye se është teksti i parë gramatikor i shkruar në gjuhën shqipe. Do të thotë, autori u ballafaqua edhe me detyrën e rëndë të sajimit të termave gjuhësorë dhe kësaj detyre ia doli në anë.

Nëse për veprimtarinë e tij aq të pasur dhe për përpjekjet për zgjimin e kombit u quajt zëdhënës i ideve përparimtare e patriotike, në gjuhësinë tonë lirisht mund të quhet paraprijës i farkimit të terminologjisë gramatikore; shumica e tyre përdoren edhe në tekstet e sotme gramatikore pa kurrfarë ndryshimesh, një numër i vogël me pak ndryshime fonetike. Ndërkaq disa terma nuk u përvetësuan nga autorët pasardhës.

■

<sup>2</sup> Zija Xholi, *Sami Frashëri - figurë qendrore e Rilindjes Kombëtare Shqiptare*.

Që bëhet fjalë për një shkencëtar të mirëfilltë dhe filolog të shquar, flet edhe vepra e tretë që tani na ra në dorë herë të parë bashkë me kompletin që po e promovojmë.

**Fahri Kaja\***  
(Maqedoni)

**SHEMSETIN SAMI BEU**

---

Miq të nderuar, mirëmbërëma!

Me kënaqësi e pranova ofertën e organizatorëve që në këtë tubim solemn kushtuar jetës dhe veprës së personalitetit vërtet madhështor të hapësirave ballkanike, të them edhe unë dy-tri fjalë. Në veçanti jam i nderuar që sonte para atyre që e njohin dhe e respektojnë krijimtarinë e Sami Bej Frashërit kam nderin të flas në gjuhën e krijimtarisë së tij, për zhvillimin e së cilës ai ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm.

Tashmë është e njohur në historinë e kulturës së Perandorisë Osmane se përveç turqve aty ka pasur edhe personalitete të etnive të tjera që kanë jetuar në atë shtet. Në mesin e këtyre kolosëve që me mendjen dhe punën e tyre e kanë pasuruar thesarin kulturor dhe shkencor të kësaj perandorie të madhe, është edhe shkrimtari dhe mendimtari Shemsetin Sami Beu.

Shemsetin Sami Beu lindi më 1 korrik 1850 në qytezën Frashëri si fëmija i tretë i Halid Beut, babai i të cilit, Dermus Beu, në këtë vend ishte shpërngulur nga Berati. Pas mbarimit të shkollimit fillor në vendlindje, mësimet i vazhdoi në gjimnazin e Janinës. Këtë shkollë tetëvjeçare të njohur dhe të çmuar të kohës ai e mbaroi vetëm për

■

\* Shkrimtarë - publicist, Shkup

gjashtë vjet. Në këtë lice grek Shemsetin Sami Beu, përveç greqishtes së vjetër dhe të re, jashtëzakonisht mirë mësoi edhe frëngjishten dhe italishten. Jashtë mësimit të rregullt, nga myderrizët e medreseve të Janinës mësoi edhe arabishten e persishten. I arsimuar rrënjësisht, me njohje të shkëlqyer të gjashtë gjuhëve dhe me vetëm njëzet e dy vite moshë, ai erdhi në selinë e perandorisë së madhe, ku me pak ndërprerje ka qëndruar deri në fund të jetës së tij.

Në historinë e letërsisë turke, veçanërisht të gjuhës turke, Shemsetin Sami Beu ka rëndësi të jashtëzakonshme dhe vend të merituar. Ai është i njohur si romancier, autor dramash, publicist, historiograf, leksikograf, enciklopedist dhe gjuhëtar. Megjithatë ky reformator dhe ithtar i tanzimatit është i njohur edhe si gazetar me laps të mprehtë. Pas ardhjes së tij në qytetin e mbretërve, puna e parë që filloi të bënte ishte gazetaria. Ndërkaq në atë kohë në Perandorinë Osmane ajo ishte në rritje dhe po i shkaktonte kokëdhimbje të mëdha sulltan Abdylhamidit i cili edhe ashtu ka pasur probleme të vështira, para së gjithash me popujt e Ballkanit që luftonin për të drejta autonome dhe për shtete të pavarura. Shemsetin Sami Beu së pari filloi të shkruajë në gazetën "Ibret", e pastaj në "Hadika". Pas përvetësimit të përvojës dhe njohjes së nevojshme në gazetari, redaktoi katër numrat e parë të revistës "Muharrir", ndërsa më vonë qëndroi në ballë të gazetës së re "Sabah". Ka shkruar edhe për gazeta të tjera, që në kohën e tij ishin të rëndësishme në krijimin e opinionit publik në kryeqytetin e shtetit. Disa nga gazetatat me të cilat ai kishte bashkëpunim, për shkak të kundërshtimit të drejtpërdrejtë ose indirekt ndaj politikës së Portës së Lartë, u ndaluan, ndërsa Shemsetin Sami Beu, për shkak të disa teksteve, si edhe shumë të autorë të tjerë të fundit të shekullit XIX,



ishte i detyruar të shpërngulej dhe të jetonte në ishullin Rodos.

Në tekstet e tij gazetareske, po edhe publicistike, kryesisht zënë vend temat e politikës ditore. Ai si një gazetar me angazhim të skajshëm shkruante edhe për pasojat e pavolitshme nga vendimet e Kongresit të Berlinit në raport me Ballkanin dhe Rumelinë. Si kryeredaktor i gazetës “Terxhumani shark” (Zëdhënësi i Lindjes), intensivisht ka shkruar për problemet e Ballkanit, në veçanti për çështjen shqiptare, duke synuar të dëshmojë se shqiptarët nuk dëshirojnë të jenë jashtë Perandorisë Osmane. Pikëpamjet dhe botëkuptimet e tij për zgjidhjen e problemit shqiptar më së miri janë paraqitur në tekstin “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë” të botuar në Bukuresht në gjuhën turke, shqipe dhe frënge. Përveç artikujve dhe shkrimeve të politikës ditore për ngjarje aktuale me rëndësi historike, Shemsetin Sami Beu ka botuar edhe një numër të madh tekstesh socio-kulturore, duke u përpjekur për evropjanizmin e shoqërisë osmane. Një pjesë të madhe të teksteve të tij gazetareske-publicistike ua ka kush-tuar edhe çështjeve gjuhësore.

Shemsetin Sami Beu në jetën e tij jo aq të gjatë është marrë edhe me veprimtari botuese, duke krijuar për këtë *Bibliotekën e xhepit*, në të cilën ka botuar disa doracakë popullarizues, siç janë: “Qielli”, “Toka”, “Njeriu”, “Përsëri njeriu”, “Gratë”, “Gjuha”, “Dheshkronja” dhe “Qytetërimi islam”. Këtë aktivitet iluminist e ka plotësuar edhe me shumë tekste të tjera nga fusha e astronomisë, astrologjisë dhe mitologjisë. Me qëllim që t’i bënte sa më popullarizuese njohuritë shkencore të Perëndimit, përveç këtyre libër-thave të vegjël, ai i ka botuar edhe revistat javore “Aile” dhe “Hafta” në të cilat duke filluar që nga temat gjuhësore dhe letrarë e deri te ata moralë, me një gjuhë mjaft të qartë përpunon një sërë çështjesh jetësore. Në tekstet e botuara

në këto revista fillon ta shfaqë qartë qëndrimin e tij ndaj standardizimit dhe pastërtisë së gjuhës turke.

Shemsetin Sami Beu është autor i romanit të parë turk të shkruar sipas modelit të romaneve të atëhershme të botuara në Perëndim. Ky është romani me titull “Taşşuki Talat ve Fitnat” (Dashuria e Talatit me Fitneten) të botuar në vitin 1872. Në këtë roman përpunohet tema e martesës së detyruar, që është një nga tiparet më të mprehta të kohës së tij. Analistët e kësaj vepre letrare thonë se ajo është shumë didaktike dhe se, përveç përshkrimit plastik të personazheve, dialogut të suksesshëm dhe pastërtisë së gjuhës, nuk ka vlera të veçanta letrare, andaj edhe nuk i ka siguruar Samiut ndonjë popullaritet të madh. Edhe pse sipas stilit të krijimit të letërsisë së tanzimatit është vepra e parë, mbeti nën hijen e romaneve të mëvonshme, andaj edhe nuk ka ndonjë vend të veçantë në opusin e tij krijues.

Ky autor i gjithanshëm dhe shumë i frytshëm i ka shkruar edhe tri drama. Në dramën e parë të titulluar “Sejdi Jahja” përpunon një temë historike që ka të bëjë me Andaluzinë. Në dramën e dytë “Besa” bëhet fjalë për traditën, gjegjësisht për mbajtjen e fjalës të shqiptarët, ndërsa tekstin e tretë “Gave” e ka shkruar i frymëzuar nga heroi kryesor Gave në *Shahnamenë* e poetit të madh pers Firdeusi (934-1020). Teksti dramatik “Besa” si për nga tematika ashtu edhe në pikëpamje të vlerave letrare është shumë më i suksesshëm se dy tekstet e tjera. Prandaj aq shpesh është vënë në skenë. Megjithatë edhe përkundër paraqitjes së suksesshme të subjektit, dialogëve të mirë dhe pastërtisë së gjuhës dhe paraqitjes së qëlluar skenike, edhe këto tekste letrare të Shemsetin Sami Beut nuk kanë ndonjë vlerë estetike-letrare. Studiuesit e krijimtarisë letrare të këtij autori thonë se ai ka arritur famë më të madhe me përkthimin e romanit “Të mjerët” të Viktor Hygosë, sesa me romanin dhe me dramat e veta.

Shemsetin Sami Beu në zenitin e famës është ngritur me punime shkencore të fushës së gjuhës dhe leksikografisë. Ai u qasej çështjeve gjuhësore si një shkencëtar i vërtetë dhe angazhohej për ndryshimet në gjuhën turke. Duke përkujtuar se turqit kanë ekzistuar edhe para themeluesit të Perandorisë Osmane, Gazi Osman, ai thotë se gjuha turke është e vjetër dhe nuk është e drejtë të përdoret termi gjuhë osmane. Sipas tij, gjuha e turqve është turqishtja dhe në të duhet të bëhen ndryshime revolucionare. Duke e vlerësuar gjuhën turke, ai do ta theksojë pasurinë e kësaj gjuhe dhe do të thotë se me fondin e pasur të fjalëve që i ka me të mund të shprehen edhe ndjenjat më të holla. Ai u kundërvihet gjuhëtarëve që thoshin se turqishtja është krijuar nga fjalët arabe e perse. Sipas tij, fjalët arabe dhe perse në gjuhën turke duhet të kuptohen si fjalë të huaja dhe ato assesi nuk e ndryshojnë bazën dhe rregullat gramatikore të kësaj gjuhe. Pikërisht për shkak të kësaj ai është i pari që fjalorin e parë shpjegues do ta titullojë si *i gjuhës turke* (Kamusi turki), e jo si fjalor i gjuhës osmane (Kamusi osmani), siç i titullonin fjalorët shumë pararendës dhe bashkëkohas të tij.

Fjalori shpjegues i turqishtes (Kamusi turki) është vepra më e vlefshme e Shemsetin Sami Beut në fushën e leksikografisë. Në këtë fjalor, të menduar si thesar të fondit gjuhësor turk, autori në 1.600 faqet në mënyrë koncize shpjegon shumicën e fjalëve që ishin në përdorim në kohën e tij, si në tekstet shkencore-letrare ashtu edhe në tekstet publicistike ose që përdorshin në komunikimin e përditshëm të njerëzve. Me qëllim që të jetë të më i qartë, autori disa nga fjalët i shpjegon me fjalë frënge. Ky fjalor, i cili për shumë vite ishte në përdorim për shkak se ishte i lehtë dhe praktik, edhe tash është një burim i pazëvendësueshëm në hartimin e fjalorëve. Viteve të fundit ai është



përshtatur në alfabetin e ri dhe si i tillë deri tash është botuar disa herë.

Shemsetin Sami Beu është autor edhe i *Fjalorit frëng*. Në parathënien e këtij fjalori që përmban 40.000 fjalë autori thotë se i ka hyrë krijimit të një vepre të këtillë, sepse në fjalorët e botuar deri atëherë kishte pasur gabime të mëdha. Ky fjalor i cili në kohën e tij është botuar tri herë, ka marrë mirënjohje dhe lëvdata të vlefshme, madje edhe nga autorët e veprave të ngjashme të fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe ua ka hapur rrugën për krijimin e fjalorëve më të përsosur frëngjisht-turqisht. Shemsetin Sami Beu është autor edhe i një fjalori të tretë, arabisht-turqisht (Kamusi arabi), i cili ishte menduar të bëhej në dy vëllime me 4.000 faqe, por autori nuk arriti ta botonte.

Përveç fjalorëve të përmendur, edhe enciklopedia historiko-gjeografike “Kamus al-A'lâm” zë vend të merituar në opusin leksikografik të këtij kolosi. Në këtë vepër madhështore me rreth 5.000 faqe ka informacione jashtëzakonisht të dobishme edhe për hapësirat tona ballkanike. Autori edhe në krijimin e kësaj enciklopedie ka dhënë mund të madh që t'i përmirësojë informacionet e gabuara të enciklopedistëve perëndimorë. Në parathënie në një vend do të thotë: *“Njerëzit për nga prejardhja e njohin historinë dhe gjeografinë. Këto dy shkencat janë të pandara. Historia e interpreton kohën, ndërsa gjeografia hapësirën. Koha kalon, ndërsa hapësira ndryshon. Që të informohesh për njerëzit, duhet ta dish të kaluarën e tyre dhe vendbanimin e tyre”*.

Ky erudit i madh, i cili me mendimet dhe idetë e ka tejkaluar kohën në të cilën ka jetuar, në jetën e tij të shkurtër prej vetëm 54 vjetësh ka botuar 57 vepra dhe me këtë ka lënë gjurmë të thellë në historinë kulturore, e aq më tepër në historinë leksikografike të turqve.

Prandaj është mjaft i bukur dhe bujar shënimi i njëqindvjetorit të vdekjes së Sami Beut. Mbajtja e këtij tubimi shkencor në Shkup ka domethënie të shumta. Organizatorët



e këtij tubimi dhe agjencinë donatore TIKa duhet t'i urojmë  
sinqerisht për bashkëpunimin. Botimi i opusit të tij më të  
plotë në gjuhën e tij amtare nga Shtëpia Botuese "Logos-A"  
ka rëndësi historike dhe të jashtëzakonshme. Kjo është një  
mundësi e mirë për riafirmimin e këtij autori të madh.



*Dr. Milazim Krasniqi\**  
(Kosovë)

**MUNDËSITË E PASHFRYTËZUARA  
TË NJOHJES SË VETES SONË**

---

Të nderuar kolegë dhe miq,

Shtëpia Botuese Logos A, na ka tubuar sonte në një ngjarje të jashtëzakonshme kulturore, kombëtare dhe morale, e cila mund të përcaktohet si një rizbulim i vonuar i një pjese esenciale të vetes sonë. Botimi i njëzet veprave të dijetarit të madh, Sami Frashërit, në njëqindvjetorin e vdekjes së tij, disa nga të cilat shohin dritën e botimit për herë të parë në gjuhën shqipe, është provë e një harrese të gjatë me të cilën e kemi mbuluar njërin prej dijetarëve tanë më të mëdhenj, edhe pse idetë e tij janë në vetë themet e identitetit tonë kulturor e kombëtar.

Përpyekja për të ikur nga kjo shtresë e identitetit tonë kulturor, sado insistuese dhe e gjatë, duket të ketë qenë fatkeqe dhe e pasuksesshme.

Por, përpyekja për ta fshirë një pjesë të kujtesës sonë kulturore dhe historike, ka qenë mjaft tinëzare. Nën pretekstin e mbajtjes inat të pushtuesit shumëshekullor, është krijuar strategjia e fshehjes dhe e fshirjes sa më të madhe të gjurmëve kulturore që kanë burim Islam.

■

\* "Universiteti i Prishtinës", Prishtinë

Pretekstin për ta eklipsuar shtresën kulturore me burim Islam, ideologjia nacionale që zotëroi në procesin e fundit të formësimit të kombit shqiptar mbi modelin e nacionalizmave ballkanikë me rrënjë ortodoske dhe të kulturës shqiptare me rrënjë gjoja ekskluzivisht kristiane, u sajua mbi ngjarjet që rrodhën nga reformat trazuese të Tanzimatit dhe prej ngjarjeve tragjike pas Kongresit të Berlinit. Por, kjo ideologji nacionale e përftuar nga receta të hua-zuara, mori për bazë pasojat dhe jo shkaqet.

Konfliktet shqiptaro-osmane, pas shpalljes së reformave të Tanzimatit e kishin shkakun te devijimi që iu imponua nga Fuqitë e Mëdha Perandorisë Osmane, për krijimin e shtetit-komb, sipas modelit francez, anglez dhe gjerman. Ky koncept i organizimit shtetëror synonte integrimin e identiteteve të tjera etnike dhe kombëtare të kombeve me përkatësi myslimane, në identitetin nacional turk.

Ky ishte një paradoks, që zbulonte dobësinë shtetërore dhe rënien morale të Perandorisë Osmane. Përderisa kjo perandori kishte pranuar protektoratin e Ruisë mbi ortodoksët dhe Kultusprotektoratin austriak mbi katolikët që ishin shtetas të saj, asaj i ishte imponuar që myslimanëve shqiptarë t'ua injoronte kërkesat për identitet kombëtar e kulturor shqiptar dhe njëherësh islam.

Ky konflikt u përshkallëzua pas imponimit që iu bë Perandorisë Osmane nga Fuqitë e Mëdha, për të dorëzuar territore shqiptare në favor të fqinjëve ballkanikë. Kështu, një bashkëjetesë shumëshekullore e shqiptarëve me turqit nën mesazhin Hyjnor të Islamit, u shprish dhe u shndërrua në armiqësi politike dhe konflikt të armatosur.

Edhe fryma e armiqësisë që bartën me vete themeluesit e shtetit shqiptar në vitin 1912, nga konfliktet e ashpra me xhonturqit, u fut në propagandë, në historiografi, në kulturë, në programet arsimore, e prej andej edhe në kujtesën kombëtare



Në një ambient të tillë, ku urrejtja ndaj Turqisë dhe ndaj Islamit u konservua në një ideologji dogmatike, është krejt e qartë se edhe në rastin e një kolosi si Sami Frashëri, do të bëhej seleksionim i rreptë i veprës së tij, duke shmangur nga qarkullimi dhe afirmimi ato vepra që ishin shkruar në gjuhën turke dhe ato që kanë pëmbajtje dhe ide islame.

Seleksionimi mbi bazën ideologjike antiturke dhe antiislame, bashkë me Samiun, ka gjymtuar edhe autorë të tjerë, si puna e A'lamiadistëve shqiptarë, të cilët ishin pararendës të Samiut e veçmas të Naimit. Ata edhe sot trajtohen në mënyrë selektive, negative dhe zhvlerësuese. Në rastin e autorëve që kanë përdorur alfabet grek ose alfabete që i kanë sajuar vetë, çështja e alfabetit nuk përdoret si kriter zhvlerësues, ndërsa në rastin e A'lamiadistëve shqiptarë, pashmagshëm theksohet se shkrimi me alfabet arab ishte një rrethanë problematike.

Për këto shkaqe, rikthimi te Samiu është rikthim te një pjesë esenciale e vetes sonë, për ta njohur atë pjesë dhe për të gjetur përgjigje më të plota të difekteve e të fateve tona. Vepra e Samiut, kjo që tash po i jepet lexuesit shqiptar, në mënyrë mjaft solide dhe solemne, ka një shumësi përgjigjesh në këto aspekte.

Fjala vjen, traktati “Shqipëria ç’ka qënë ç’është e ç’do të bëhetë”, sa herë që ribotohet, shërben si një përkujtues i traditave dhe i projeksioneve ideale të një kombi dhe të një shteti shqiptar, i cili nuk është formësuar plotësisht as sot. Po t’i krahasojmë disa projeksione të viteve të fundit, duke përfshirë edhe atë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, do të shohim përparësitë e filozofisë së Samiut lidhur me shtetin dhe kombin shqiptar. Projeksionet e reja kanë zbatuar rrëgjimin reduksionin e ambicieve kombëtare dhe e kanë legjitimuar inferioritetin tonë ndaj fqinjëve, ndërsa në projeksionin e Samiut nuk ka as gjurmë të

ndonjë inferioriteti. Prandaj, nga ana konceptuale, ky traktat mund të na shërbejë edhe sot si pikë referimi dhe si pikënisje e ringritjes së mirëfilltë kombëtare.

Po ashtu, traktati “Gratë”, i cili botohet në shqip për herë të parë, është një analizë sociologjike, etike dhe politike e rolit të gruas në familje dhe në shoqërinë njerëzore, duke e afirmuar gruan si edukatoren më të mirë në familje dhe në shoqëri.

Fatkeqësisht, as ky projeksion i Samiut ende nuk është përmbushur në shumicën e shoqërive, e më së paku të atyre që pretendojnë të jenë islame. Prandaj edhe kjo veprë mund të shërbejë si pikë referimi për shërimin e plagëve sociale dhe morale edhe të shoqërisë sonë, ku kriza e familjes dhe kriza e pozitës së gruas është dramatike.

Në kohën kur janë intensifikuar akuzat ndaj Islamit edhe ndër shqiptarë, veprat si “Gratë”, “Qytetërimi islam”, “Përpyjekjet e heronjve në përhapjen e Islamit”, janë thesare që mund të shndërrohen në argument për natyrën tolerante të Islamit të vërtetë dhe për ndarjen e Islamit nga ideologjitë e ndryshme nacionale dhe ekstreme, që paketohen si Islam, por që në fakt shërbejnë për të përligjur sulmet ndaj tij.

Ndërsa veprat si “Personalitetet shqiptare në Kamus al-A’lam” dhe “Viset shqiptare në Kamus al’ A’lam”, rinxjerrin nga harresa një varg vlerash kombëtare që duhet të integrohen në tërësinë e kulturës sonë. Riafirmimi i koncepteve themelore të Samiut për gjeografinë kombëtare, qoftë dhe vetëm në planin e ruajtjes së kujtesës sonë historike, mund t’i shërbejë ndërprejes së tendencave të copëzimeve e të tkurrjeve të reja. Edhe metodologjia e tij e sistemimit të të dhënave dhe e vlerësimit të tyre, mbetet një qasje e vlefshme, aq më tepër që edhe njëqind vjet pas Samiut, me gjithë konsolidimin evident kombëtar, bota shqiptare vuan mungesën e prirjes për të hartuar statistika

dhe për të sistemuar dokumentacionin që argumenton shtetësinë dhe kombësinë.

Të nderuar kolegë dhe miq,

Dijetarët e mëdhenj u përgjasojnë kodrave që janë të futura në thellësi dhe ashtu e mbajnë stabilitetin e tokës, nëpër të cilën lëvizin njerëzit. Kur këta dijetarë rrallohen, është e ditur se dridhjet e identitetit janë më të forta dhe pasojat e lëkundjeve të tij, janë më të rënda. Kjo i ka ndodhur kulturës sonë tash një shekull me Samiun, po edhe me shumë dijetarë të tjerë të harruar e të rralluar me anë ndalimesh, ndjekjesh e madje edhe eliminimesh.

Eksperimentet që janë bërë në kulturën shqiptare, duke përjashtuar një pjesë esenciale të traditës, kanë prodhuar ideologji agresive si doktrina e realizmit socialist, e cila e ka shfityruar jashtë mase kulturën shqiptare. Në gjysmën e dytë të shekullit XX, doktrinën e tilla jo vetëm kanë shmangur nga kujtesa kulturore kombëtare dijetarët dhe artistët e traditës, por kanë ngrënë koka dijetarësh e artistësh, që nuk i janë përkulur plotësisht dogmës.

Edhe pse eksperimentet shfityruese kanë qenë të gjata dhe kokëforta, ato nuk kanë dhënë rezultatet që janë kërkuar nga zbatuesit e tyre. Kombi shqiptar ka mbetur një komb specifik dhe kultura shqiptare poashtu një kulturë specifike, në të cilën kanë kontribuar krah për krah dijetarë të prejardhjes islame, të asaj katolike, ortodokse e madje edhe protestane. Ky realitet mund të injorohet përkohehtësisht, por nuk mund të zhbëhet kurrë plotësisht.

Për ta ruajtur këtë natyrë specifike të kulturës sonë kombëtare, dhe vetë tolerancën fetare brendashqiptare, duhet që të evitohen praktikët e deritashme të seleksionimeve arbitrare edhe mbi dijetarët dhe artistët e prejardhjes islame. Ata duhet të rehabilitohen plotësisht dhe ashtu të plotësohet pamja e identitetit tonë kulturor e kombëtar.

Shembulli që na jep kësaj radhe Shtëpia Botuese Logos-A me botimin e njëzet veprave të Sami Frashërit, dhe me organizimin e konferencës shkencore në njëqindvjetorin e vdekjes së autorit, është një ogur i mirë.

Këto aktivitete me siguri e konfirmojnë rëndësinë e veprës së Samiut në formësimin e identitetit tonë kulturor e kombëtar dhe në mundësitë që na ofron tradita për të projektuar një të ardhme më të mirë.

Veprat që po përurojmë këtu, na i zbulojnë mundësitë e pashfrytëzuara të njohjes së vetes sonë dhe të aktivizimit të vetërespektit të munguar për një kohë të gjatë.

*Në Shkup, 19 nëntor 2004*



***Fjala e ministrit të Arsimit  
dhe Shkencës, dr. Aziz Pollozhani\****

---

I nderuari kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, z. Cvetan Grozdanov.

E nderuara mbesë e Sami Frashërit, zonja Samie

Të nderuar akademikë,

Të nderuar të pranishëm!

"Njerëzit e mëdhenj janë pishtarë që ndriçojnë rrugën e përparimit në kohën e vet dhe që vazhdojnë të mbeten të ndezur përgjithmonë në rrugën e njerëzimit". Janë pikërisht fjalët e Sami Frashërit të madh këto, me të cilat, në shenjë nderimi të kësaj figure të ndritur dhe enciklopedike e filloj këtë fjalë të shkurtër.

Sami Frashëri, me talent dhe dije përmasash universale, jetoi dhe veproi në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, periudhë kjo e lëngimit të madh të Perandorisë Osmane. duke shkelur edhe në shekullin njëzet, kur ndodhi edhe fundi i saj. Lindur dhe formuar në gjirin e familjes së madhe të kombit të frashërllinjve, me dhunti të shquar dhe formim elitist, si edhe personalitete tjera të shquara të kësaj pjese të perandorisë, kishte si vizion reformimin e mjedisit ku jetonte dhe vepronte, shembëllueshëm Evropës përparimtare. E kishte të qartë se rrugët e këtij ndriçimi nga brenda të shoqërisë njerëzore, kudo dhe kurdo qoftë, janë ato të arsimit dhe dijes. Tërë

■

\* Në hapjen e tubimit shkencor, mes tjerash, fjalë rasti mbajti edhe ministri i Arsimit dhe Shkencës, dr. Aziz Pollozhani.

vepra e tij monumentale prandaj synonte këtë objektiv. Kështu e përfytyronte ai të nesërmen e atdheut të vet, rrugën drejt lirisë dhe shtetit, kështu i projektonte në vizionin e vet edhe popujt e tjerë fqinjë me Shqipërinë. Sami Frashëri, me veprën e tij letrare dhe shkencore, me përmasa enciklopedike, duke shkruar shqip, turqisht dhe arabisht dhe i frymëzuar prej modeleve perëndimore, sidomos prej iluministëve francezë, siç ishin Volteri dhe Dideroi, mbeti për gjithë kohërat njeriu që bashkonte popuj, qytetërime, besime, vlera njerëzore universale. Këto ide të Samiut kishin zanafillën në një periudhë dramatike në Gadishullin Ballkanik dhe më gjerë, të lindura prej kundërthënieve kur kryqëzoheshin dy epoka: fundi Perandorisë Osmane dhe zgjimi i ndërgjegjes së popujve për pavarësi.

Në këtë kontekst, në këto hapësira, lindën personalitete të shquara që u bënë bartës të ideve dhe përparimit evropian në Perandorinë Osmane. Dhe pikërisht këta qenë projektuesit e mëdhenj edhe të idesë për pavarësinë e popujve të vet të robëruar. Sami Frashëri, padyshim që njëri nga figurat më të shquara në këtë hapësirë. Veprimtarë të tillë dhe me vizione të ngjashme kanë edhe popujt e tjerë. I tillë është edhe rasti i rilindësit maqedonas Grigor Përliçev, i cili arriti famë të madhe duke shkruar edhe në gjuhën greke, edhe duke u frymëzuar prej së kaluarës së shqiptarëve në veprat epike të njohura të tij **Serdari dhe Skënderbeu**. Të tillët mbeten **njerëz -ura** të përhershme midis popujve me gjuhë dhe kultura të ndryshme, që synojnë vlerat e njëjta universale dhe kanë për bazë interesin e vërtetë të popujve të tyre. Kjo traditë, bazuar mbi këto parime, që dolën nga ndjenjat sublime të kësaj periudhe, është bazë legjitime e koncepteve të reja që natyrshëm po krijohen edhe sot në Ballkan dhe më gjerë, për një të ardhme më të mirë në interes të ndërsjellë. Koha

dëshmon se sa herë që lëmë në harresë këtë traditë të përbashkët, hasim në ngecje dhe konfuzion.

Në kohën e sotme, kur janë të pranishme tezat ekstreme, siç është ajo e përplasjeve të qytetërimeve, me pasoja mbi fetë, besimet, identitetin, Sami Frashëri me jetën dhe veprat e tij, edhe pse janë shkruar para më shumë se një shekulli, parashtron të kundërtën: afrimin dhe bashkimin e vlerave të civilizimeve të ndryshme. Ne sot, këtu në Maqedoni, në kryeqytetin tonë - Shkup, ku janë kryqëzuar shumë kultura, tradita dhe civilizime, krenohemi që mund t'ia bëjmë këtë homazh rilindësit të madh Sami Frashërit, duke botuar dhe paraqitur në mënyrë dinjitoze një pjesë të veprave të tij.

Prandaj, e shoh si jashtëzakonisht të rëndësishëm edhe këtë tubim që duhet të hapë rrugë drejt përkujtimit edhe të figurave tjera të rëndësishme për të tanishmen dhe të nesërmen tonë dhe të brezave pas nesh, të figurave pra që nuk i munguan hapësirës sonë.

Më lejoni që ta mbyll këtë fjalë për Sami Frashërin e madh, pikërisht me disa nga sentencat filozofike të tij, të botuara në vëllimin e veçantë, me titullin Fjalë të urta: "Njerëz të mëdhenj janë ata që lënë pas vepra të mëdha", "Vepra të mëdha janë ato që u sjellin dobi njerëzve", "Më i përbuzuri është ai që nuk i bën shërbim botës"...

Dhe në fund fare më lejoni të përgëzoj gjestin e botuesit Logos-A, për organizimin e këtij tubimi shkencor në kuadër të njëqindvjetorit të vdekjes së Sami Frashërit dhe për nxjerrjen në dritë të njëzet vëllimeve të tij, me urimin që të vazhdojë me punën e filluar për kompletimin e veprave të Samiut në gjuhën shqipe, vepra këto që në numër arrijnë në rreth 60.

Të nderuar pjesëmarrës, ndiej detyrim dhe kënaqësi që pas tubimit shkencor të mbajtur në këtë shtëpi muaj më parë, me rastin e 95 vjetorit të Kongresit të Manastirit,

edhe me këtë rast të falënderoj sinqerisht Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë e cila e përkrahu mbajtjen e këtij tubimi shkencor dhe sidomos kryetarin e saj, për praninë dhe kontributin e tij personal.

Tribunës shkencore i uroj punë të mbarë!

*Shkup, 20.11.2004*



## PJESA E TRETË

Kumtesat e Konferencës  
Shkencore

"Sami Frashëri 100 vjet pas"  
19-20 nëntor 2004



*Akad. Ali Aliu\**  
*(Maqedoni)*

**PRIMESA LETRARE**  
**NË VEPRËN E SAMI FRASHËRIT**

---

Sami Frashëri është autor edhe i dy veprave letrare: "Dashuria e Talatit me Fitneten", roman, dhe "Besa", dramë. Që të dyja veprat janë të shkruara në gjuhën turke dhe të përkthyer në gjuhën shqipe - drama Besa, që në gjallje të autorit (1901), ndërsa romani këtu e njëzet vjet të shkuara. Dhe sipas një ligji të prerë në këtë fushë, përkatësisht në atë të shkencës mbi letërsinë, çdo vepër letrare, nga kushdoqoftë autor, bën pjesë, i takon asaj letërsie dhe historie të letërsisë, në gjuhën në të cilën është shkruar. Që do të thotë, të dy veprat letrare të përmendura, i takojnë, para së gjithash, traditës kulturore dhe letrare turke. Pastaj edhe asaj universale. Tradita jonë kulturore-letrare, si çdo kulturë e zhvilluar, sjell të përkthyer në shqipen vlera nga gjuhët e kulturave tjera. me çfarë e pasuron dhe nxit, përmes përvojave të të tjerëve, kreativitetin e vet, kulturën e vet.

Por për t'i bërë pjesë të traditës sonë shpirtërore, dy veprat letrare të Sami Frashërit, pos argumentit të përmendur më sipër, kemi edhe ngasës plus, të natyrës, do të thosha psikologjike dhe sentimentale: autori i tyre është i

■

\* Anëtar i ASHAK, Prishtinë

gjakut tonë dhe, është vëllai më i vogël i bardit kombëtar, Naim Frashëri, është i familjes së atdhetarëve të mëdhenj të kombit, - frashërllinjve...

Romanin " Dashuria e Talatit me Fitneten", Sami Frashëri e botoi më 1872, kur sapo kishte mbushur njëzet e dy vjeç, përkatësisht kur, pas gjashtë-shtatë viteve të shkollimit në Janinë, shkeli në kryeqytetin e perandorisë, në Stamboll. Në ç'masë do ta kishte sjellë me vete temën e romanit, historinë e dashurisë mes Talatit dhe Fitnetes nga librat e lexuara në Janinë dhe në ç'masë do ta kishte frymëzim të parë nga kontakti me qytetin e madh, nuk mund të dihet me saktësi. Nga sa shenjëzon vetë fabula, duhet të jetë në pyetje njëra dhe tjetra...

Romani në fjalë sjell një histori sentimentale, me shumë lot e ofshama dhe që degëzohet në dy rrjedha: dashuria e pafat dhe fundi tragjik i dy të rinjve, dhe në përshkrimin e ambientit oriental ku sundojnë rregulla të rrepta dhe kundërshtimi ndaj manifestimit të lirë të ndjenjave - ndaj femrës bashkë me shenjat e degjenerimit të moralit si rrjedhim i këtyre konvencave të rrepta, degradim që në çaste kufizon me incest e në këtë rast deri në prag të kurorës mes atit dhe bijës...

Fitnetja, e dashura e Talatit, njësoi si edhe e ëma e saj dhe ngjashëm me fatin e shumë vajzave dhe femrave të atij ambienti, nuk ka të drejtë të vendosë për fatin e vet, pra as ta dojë dhe të martohet për Talatin. Përkundrazi, asaj i caktojnë për burrë një të moshuar, vejan, dhe pa e pyetur e çojnë në shtëpinë e tij. Nga kjo pozitë dhe perspektivë ajo do të bëjë vetëvrasje, rrugë pas së cilës, nga dhimbja, do të ecë edhe Talati. Pas këtij fundi tragjik, beu i paracaktuar për të qenë burri i saj, zbulon se është i ati i Fitnetes dhe çmendet. Pak a shumë kështu do të përfundojnë edhe personazhet e tjerë, kryesisht të afërmit e Fitnetes... Kjo është shkurtimisht fabula e romanit...



Pa hyrë në vlerësime artistike, zhanrore, me këtë rast, mbase duke theksuar se ai në roman edhe mund të ketë ndonjë peshë në zhvillimin historik të këtij zhanri në gjuhën që është shkruar, deshirojmë të sjellim një përshtypje në vargun asociativ: fabula që në strukturën e vet ndërton të ashtuquajturin faj tragjik, përkatësisht fundin tragjik, të përkujton fajin dhe fundit tragjik të tragjedive të Antikitetit dhe, akoma më konkretisht, fajin tragjik të Mbretit Edip që vret të atin - duke mos e ditur. Dhe faji është aq tragjik, sa fundi, po ashtu tragjik, me këtë rast është i pavitueshëm. Natyrisht që nuk gjejmë as edhe një dëshmi për ndonjë lidhje të tillë si ndikim me diç të ngjashme, edhe pse në gjimnazin e Janinës, gjuha e vjetër greke dhe arti antik grek kanë qenë shtylla kryesore e dijes...

Drama "Besa" ndërsa ka dy veçori dalluese nga vepra e parë letrare, e cila u shkrua vetëm dy vite më pas (1874): për nga mjeshtëria letrare është më e artikuluar se romani dhe, ngjarja e rrëfyer, personazhet, vendi janë të trollit shqiptar.

Subjekti i dramës paralajmërohet që në titullin e saj - do të bëhet fjalë për besën shqiptare. Në shqip do të përkthehet 26 vjet pas botimit, pra më 1901. Deri atëhere drama "Besa" ka bërë edhe jetë skenike nëpër teatrot e Stambollit...

Edhe këtu subjekti degëzohet në dy drejtime: dashuria mes dy të rinjve në ambientin baritor të Shqipërisë së jugut - mes Rexhepit dhe Merushes, që është boshti i parë dhe, shpënia në vend e fjalës së dhënë, besës... Rexhepi dhe Merushja dashurohen dhe, në vend të ndalesës së kësaj lidhjeje, si në roman dhe në ambientin e Stambollit, me këtë rast, dy të rinjtë marrin betimin e familjeve. Pengesa para tyre shfaqet nga një i ri tjetër, një kalorës-trim i Beut të asaj ane, me emrin Selfo, i cili është marrëzisht i dashuruar edhe ai me Merushen. Ai provon të gjitha rrugët për ta prishur fejesën mes Rexhepit dhe Merushes, duke patur në krah edhe ndihmën e Demir beut që ush-

tron kërcënim mbi familjet e të rinjve, por pa sukses... I dëshpëruar në kulm, Selfo atëherë ngre dorë dhe vret të atin e Merushes...

Pas këtij akti tragjik, në fshat kthehet i ati i Selfos vrasësit, Fetahu, që për njëzet vjet paskësh qenë në shërbime të largëta të perandorisë. Në hyrje të fshatit atij pra, të atit të Selfos, i vë pritë një hasëm i tij i motshëm, nga e cila e shpëton e ëma e Merushes, tani e ve, pas vrasjes së burrit të saj nga Selfoja. Pas këtij akti, Fetahu i jep besën gruas së ve e cila i shpëtoi jetën se do t'ia marrë hakun e të shoqit, duke mos ditur se dorasi do të dalë i biri... Megjithatë, edhe kur e mëson gjëmën se vrasësi është i biri, ai do ta shpjerë në vend fjalën e dhënë, pra do ta vrasë të birin dhe, në fund do vrasë edhe veten... Kjo në fakt është tërë historia e dramës Besa. E sollëm shkurtimisht atë, për të tërhequr vëmendjen në një çështje tjetër, që pashmangshëm shfaqet si dilemë: peshon vërtetë kaq rëndë besa e dhënë, sa të mos thyhet edhe kur duhet shkrehur mbi pje-llën tënde?

Por le të kthehemi te ngasja e Sami Frashërit shkrimtar për të rrahur një subjekt të tillë përmes dramës "Besa". Mund të kenë qenë dy shtytëse: t'i paraqesë shqiptarët faqe botës me këtë tipar të veçantë nga njëra anë dhe, siç do të thotë përmes personazhit, Fetahut, që t'i japë fund gjakmarrjes mes shqiptarëve, duke thënë se po e vret me dorën e vet të birin, duke e marrë hakun e hasmit, me porosi që kështu të mbyllet rrethi i gjakmarrjes.. Ja në të vërtetë çfarë thotë vetë Sami Frashëri lidhur me frymëzimin dhe shqetësimin krijues që e kishte përfshirë që në moshë të re: "Që prej kaq kohë ma pati pushtuar imagjinatën ideja të shkruaja një pjesë teatrale, në të cilën do të viheshin në pah disa virtyte e zakone të popullit shqiptar. Dhe kjo, jo pse isha bir i këtij populli, por sepse të ky kisha vënë re disa virtyte burrërore të larta, të denja për skenë, siç ishin

dashuria për atdhe, shpirti i sakrificës, besa dhe fakti se ata nuk e kishin për gjë jetën..."

Sa, në të vërtetë i hiperbolizonte edhe Sami Frashëri, njësoj si edhe vëllai i tij, virtytet e bashkëkombësve të vet duke qenë larg vendlindjes, pra duke qenë edhe nën zjarrin e mallit dhe kujtimit? Dhe, lexuesi shqiptar, sa herë që do të kontaktojë me këtë tekst letrar të zhanrit dramatik, gjithmonë do të ndisejë një si keqardhje duke pyetur: ku do të mbërrinte Sami Frashëri, po t'i nënshtrohej zërit të shkrimtarit, po të mos zotëronte në të ai i shkencëtarit përmasash të mëdha.

### **Fiction among Sami Frasher's works**

Among the vast work of Sami Frasher we also meet him as the author of two fiction books: "The love of Talat and Fitnet" a novel, and "The Pledge of Honor" a play. Both works were written in Turkish, and later were translated into Albanian. We have to admit that such works belong to that literary world in which language they were originally written. In this case they belong to the Turkish literary and cultural tradition. This doesn't exclude their place in the fiction in general, but the real problem is the fact, that their author at the same time was a distinguished figure of the Albanian Renaissance movement. The translation into Albanian of the novel integrated it into the Albanian culture in a specific way, because the common reader perceives it as a product of an Albanian author. There is more to be noted about the play "Pledge of Honor", written only two years later, in 1874. It is distinguished by two characteristics: first, it is written better from the point of view of the literary art, and the second, the plot, the characters, and the place are typical Albanian. The subject of the play is foretold from the

title. There will be told the Albanian Besa. This play had its theatrical life on the Istanbul stages, and was translated into Albanian only 26 years later.

What were the author's motives to elaborate such a subject in a play? He wished to represent Albanians to the world from this specific aspect, but at the same time he was eager to guide his compatriots to another way, abandoning the blood feud and closing the blood circle.



**Prof. Dr. Ismail Ahmedi\***  
(Kosovë)

**VËSHTRIM KRAHASUES MES DRAMËS  
"SEJDI JAHJA" TË SAMI FRASHËRIT  
DHE "PRINCESHA E ANDALUZISË"  
TË AHMED SHEUKI-UT**

---

Për veprimtarinë e Sami Frashërit, e cila është shumëdimensionale: gjuhësore, filologjike, leksikografike, historike, gjeografike, publicistike, letrare etj., janë shkruar shumë studime, vlerësime dhe artikuj të ndryshëm, si në gjuhën shqipe, ashtu dhe në gjuhë të tjera. Por, megjithatë, për veprën e tij të thellë e të shumanshme ka mbetur ende për t'u thënë.

Veprimtarinë krijuese Samiu e kishte filluar që në moshën 21-vjeçare, më 1872 në Stamboll, duke botuar në gjuhën turke-osmane veprën letrare – romanin *Taşşuk-i Tal'at ve Fitnat*.<sup>3</sup> Ndërkaq veprat letrare – dramat: *Besa*, *Sej-*

■

\* "Universiteti i Prishtinës", Prishtinë

<sup>3</sup> "Dashuria e Talatit me Fitnetin". Në gjuhën shqipe e përkthyen Mehdi Polisi dhe Ruzhdi Lata, Rilindja, Prishtinë, 1984 (bot. i parë). Është ribotuar edhe në Tiranë (1994) dhe në Shkup (2002). Së fundi është ribotuar më 2004 nga Shtëpia Botuese Logos-A, Shkup në kuadër të veprës së Samiut (gjithsej 20 vepra) dhe këtu mban numrin 9.

di *Jahja dhe Gave*, të përkthyer tani edhe në gjuhën shqipe, Samiu i kishte botuar në vitet 1874-1876. Në të gjitha këto vepra, ashtu si dhe në mbarë krijimtarinë e tij shihet talenti krijues i Samiut.

Drama *Sejdi Jahja*<sup>4</sup> e Sami Frashërit e botuar më 1875 në Stamboll dhe e përkthyer tash vonë në shqip, paraqet një gjerësi dhe një thellësi shprehëse të rrallë, një shumësi kuptimore të qenësishme mbi historinë e Spanjës arabe të shek. XI. Ngjarja e saj është marrë nga historia e qëndresës dhe tragjikës arabe në Spanjë, më saktësisht në Sevilje. Samiu, duke trajtuar te Sejdi Jahja në mënyrë të lidhur heroizmin dhe tradhtinë, dëshiron të artikulojë dallimin e tyre të tmerrshëm, për të theksuar përfundimisht tmerrin e fatit të popullit në gjirin e të cilit ndodhën këto ngjarje dramatike.

*Princesha e Andaluzisë*<sup>5</sup> e Ahmed Sheuki-ut, neoklasicist arab nga Egjipti, e botuar më 1932 në Kajro, ringjalli epopën e qëndresës heroike të popullit arab në Spanjë.

Ahmed Sheukiu në këtë vepër nuk bën histori, e as nuk mbështetet në argumente të mirëfillta historike të periudhës përkatëse .

Vepra e tij *Princesha e Andaluzisë* para së gjithash është ngjarje reale dhe mesazh i lirë artistik. Ç'është e vërteta, ai nuk e përmbys, e as nuk e mohon historinë, po ka parasysh vetëm të vërtetën e rrjedhës historike të shek. XI në Spanjë.

Në këtë rrjedhë, Ahmed Sheuki, sikurse edhe Samiu, jep një shembull kompleks dhe të rëndësishëm. Ai nisët nga realiteti tragjik i një kohe mjaft të largët - Andaluzia arabe

■  
<sup>4</sup> Shih Sami Frashëri, *Sejdi Jahja*, Sprint, Prizren, 2004. (E përktheu në gjuhën shqipe Raif Morina).

<sup>5</sup> Ahmed Sheuki, *Emiretul-Endulus*, Darul-Audeti, Bejrut, 1981.

e shek. XI, të cilin e gërsheton me ëndrrën, që bëhet përbërës thelbor i realitetit të veprës së tij. Me fjalë të tjera, autori krijoi realitetin, që e shpreh në veprën e tij, i krijoi ngjarjet, personazhet, pastaj, si përcaktohen dhe ndërtohen karakteret në situatat e skajshme të luftës për jetë sa vdekje. Ky mall i pashuar për Andaluzinë arabe, ky pikëllim për arabët e braktisur, që kishin mbetur në ato kohë të liga pikë e pesë, e kanë vënë në lëvizje Sheuki-un, e kanë mbushur me energji të pashterur për të bërë një veper letrare methurje dramatike e cila afron një histori të tërë ngjarjesh e përjetimesh.

Objekt i këtij referimi në këtë rast është një vështrim krahasues mes dramës *Sejdi Jahja* të Sami Frashërit dhe *Princesha e Andaluzisë* të Ahmed Sheuki-ut, i këtyre dy veprave dramatike, të cilat duken të ngjashme, por jo të tilla edhe në strukturimin e tyre të brendshëm.

Ajo që duket se i afron në pamje të parë, është konteksti i tragjedisë së Andaluzisë i lidhur ngushtë me të Sejdi Jahja dhe Princesha e Andaluzisë, që sjellin para nesh kohët e tmerrit me madhështinë e ngjarjeve e lavditë e heronjve, e njëkohësisht me to, një projektim të këtyre ngjarjeve, parë nga njerëz me talent si Samiu e Ahmed Sheukiu. Pra, në sistemin e ideve Samiu dhe Ahmed Sheuki-u kanë ruajtur identitetin atdhetar, heroik e tragjik, duke u dhënë atyre përmbajtje dhe funksion semantik. Kjo strukturë artistike e dramave është përcaktuar nga koncepti i tyre për të dhënë tragjedinë e Andaluzisë së shek. XI përmes fatit të heronjve. Prandaj, në këtë betejë të përhershme dalin përfundimisht në skemën klasike: heronj, tradhtarë, urrejtje dhe dashuri. Duke trajtuar në mënyrë të vazhdueshme heroizmin, tradhtinë dhe urrejtjen, Samiu dhe Sheuki-u arritën që te dramat *Sejdi Jahja* dhe *Princesha e Andaluzisë*, të artikulojnë tmerrin e fatit të popullit arab në Spanjë.



Siç e theksuam, një vështrim krahasues do të luajë rolin e një identifikimi që nxjerr në shesh ngjashmëritë e organizimit të krijimeve të brendshme jo aq identike, por në rastin tonë, e përbashkëta tërësisht identike, do të ishte motivi i Andaluzisë arabe i shek. XI, dhe fakti që secila prej tyre kanë nga pesë akte.

Nëse do t'i shikojmë më nga afër dramën, strukturimi i veprave do të na bënte ta përqendronim vëmendjen në dy drejtime për zberthimin e pjesëve dramatike:

1. Mënyra e veprimeve.
2. Marrëdhëniet mes personazheve.

**1. Mënyra e veprimeve krijon një tërësi zinxhirore, çdo halkë e së cilës është e rëndësishme për organizimin e ngjarjeve.**

Dramat *Sejdi Jahja* dhe *Princesha e Andaluzisë* fillojnë me një skenë kolektive ku vërehet krenaria ndaj armikut spanjoll. Aty artikullohet lavdi i Zotit, lëvdohet fuqia e tyre dhe drejtësia e misionit që i përkasin. Kjo krenari është e lidhur me ndjenjën e epërsisë që del në pah te të dyja dramën.

Te *Sejdi Jahja* "Zoti mua më jep jetë, që unë t'i shpëtoj atdhetarët nga duart e armiqve! Unë, në beteja, isha më shumë në mesin e armiqve se në mesin e shokëve të mi! Sa herë u plagosa nga shpata dhe plumbat e armikut. Edhe pse e desha vdekjen më shumë se çdokush tjetër, megjithatë nuk vdiqa. Me siguri Perendia më jep jetë që unë ta mbroj qytetin"<sup>6</sup>

Te *Princesha e Andaluzisë* krenaria shfaqet me fjalët e princeshës; "Ti zotëri gjykatës je i brengosur për fatin e Andaluzisë, por unë të lus të më dëgjosh se babai im do të përgatitet (dhe ti e di se ai është plaku i Andaluzisë),

■

<sup>6</sup> *Sejdi Jahja*, f. 30.



për t'i sulmuar perëndimorët në mënyrë që arabët të pushojnë prej tyre disa vite”<sup>7</sup>

Hallka e dytë do të ishte parandjenja e rrezikut, që te të dyja dramat është e shfaqur, por në çaste kohore të ndryshme. Te *Sejdi Jahja* kjo parandjenjë, kumtohet shumë shpejt me fjalët e Sejdi Jahjait, që në aktin e parë pamja e nëntë:

“Për çka duhet vendosur? Unë nuk mund të vendos për asgjë, meqenëse janë vetëm dy mundësi: O të vazhdojmë të qëndrojmë të rrethuar, o duhet dorëzuar qyteti. Vendimi i parë nënkupton vdekjen e të gjithë qytetarëve nga uria, ndërsa i dyti, vrasjen e të gjithëve nga shpata e armikut”.<sup>8</sup>

Te *Princesha e Andaluzisë* parandjenja e rrezikut fillon në aktin e katërt me fjalët që princesha i drejton El- Abadijes, gjyshe së saj:

“Gjyshe, a thua është koha që të mendoj për martesën time. A s’i sheh ngjarjet në ç’drejtim ecin. Miskini, babai im, nuk di prej nga mund t’i vijë e keqja: nga Maroku, të udhëhequr nga berberi Jusuf ibn Tashefini apo nga spanjollët me Alfonsin në krye. Mbreti në mes tyre gjyshe, është sikurse gjahu që ndiqet nga të dyja anët”!<sup>9</sup>

Momenti i tretë është rreziku.

Te *Sejdi Jahja* Zejdi e ka tradhtuar vendin e vet, dhe gjithë akti i dytë i dramës është akt që artikulon këtë tradhti. Në anën e armikut me komandatin e ushtrisë spanjolle Zejdi ka hartuar planet e dorëzimit të Sejdi Jahjasë. Zejdi është shitur dhe nuk ka si t’i shpëtojë teorisë vetanake.

Zejdi është paguar që ta dorëzojë kalanë, akti i dytë, pamja e shtatë ku Zejdi ka një monolog të tërë:

■

<sup>7</sup> Ahmed Sheuki, *Emiretul-Endulus*, f.17.

<sup>8</sup> S. Frashëri, *Sejdi Jahja*, f.41.

<sup>9</sup> A. Sheuki, *Princesha e Andaluzisë*, f.60.

“Tani më ka ardhur momenti i fundit. O sonte do t’i fitoj njëzetë mijë talera, o nesër në mëngjes”<sup>10</sup> dhe ky është fundi i Sejdi Jahjait.

Te *Princesha e Andaluzisë*, fjalët e Mutemed ibn Abbadi, mbretit të Seviljes, shënojnë rrezikun. Akti i katërt. “O djalosh, po më thërret që të iki? Jo, kjo nuk do të ndodhë, sepse luani nuk ikën, e as i frikësohet vdekjes. Më thuaj Xheuher, ku janë djelmoshat e Seviljes, më saktësisht ku janë ata tani”?<sup>11</sup>

Kështu në logun e betejës ushtria berbere e Jusuf ibn Tashefinit korr fitore duke himnizuar atdheun, trashëgiminë, qëndresën, fitoren, e mbi të gjitha, prijësin e tyre.

Më pas vjen humbja e pakthyeshme e misionit që heronjtë kanë marrë përsipër ta realizojnë.

Sejdi Jahjai kapet rob dhe dërgohet në burgun e Kashtalës në Spanjë.

Rënia e tij është një humbje për kombin dhe shtetin, sepse bie i tradhëtuar nga të vetët, që nuk kishin vetëdije kombëtare dhe atdhetare. Akti i tretë pamja e pestë.

“Po! Na tradhatoi dhe na dorëzoi një njeri, për të cilin mendonim se e kishim shok! Përndryshe, unë, me shokët vendosëm që, o të vdesim nga uria o nga shpata e armikut. Se do të vinte puna që ne të vdesim në këto qeli të errëta, as që kemi mundur ta marrim me mend!”<sup>12</sup>

Këtu është bartur drama e tradhtisë, e cila në vazhdim do të zhvillohet në vuajtje, robëri e humbje për heroin dhe popullin e tij.

Te *Princesha e Andaluzisë* humbja shfaqet me rënien e heroit nacional, Mutemed ibn Abbadi i cili burgoset dhe

■  
<sup>10</sup> S. Frashëri, *Sejdi Jahja*, f. 82.

<sup>11</sup> A. Sheuki, *Princesha e Andaluzisë*, f.68.

<sup>12</sup> S. Frashëri, *Sejdi Jahja*, f.117.

dërgohet në Agmata të Marokut. Kjo humbje përvijohet shumë shpejt me fjalët e princeshës. Akti i pestë :

“Baba, ditën që është sulmuar Sevilja të pashë duke luftuar vetë dhe me pak shokë... mirëpo ti ishe duke luftuar si luani i cili e mbron viktimën pëllëmbë më pëllëmbë...thashë: unë nuk e kam përmbushur detyrimin ndaj vatanit e as nuk jam duke e mbrojtur shpinën e babait tim, në këtë ditë të vështirë! E mbulovala fytyrën, e mora shpatën dhe fillova luftën pranë teje, derisa një dorë e hekurt m'i mbylli sytë dhe për një kohë të shkurtër jam gjen-  
dur në shtëpinë e një eprori maroken”.<sup>13</sup>

Këtu princesha dëshmon të ndodhurën, dhe merr pjesë emocionalisht në të, pa pasur mundësi të ndërrojë gjë, sepse ngjarjet kanë marrë rrjedhën e pakthyeshme deri në burgosjen e heroit kryesor, Mutemed ibn Abbadit, mbretit të Seviljes, dhe shpërndarjen e ushtrisë së tij.

Vargu i veprimeve përfundon me Fundin e heronjve Sejdi Jahja dhe Mutemed ibn Abbadit, një fund që i përgjigjet madhësisë së tyre, karakterit dhe dinjitetit njerëzor e atdhetar.

**2. Marrëdhëniet mes personazheve do të na detyrojnë të ndjekim një drejtim tjetër: respekt dhe urrejtje, që kanë të bëjnë me heroin kryesor.**

Si te *Sejdi Jahja*, ashtu edhe te *Princesha e Andaluzisë* aktin e parë e karakterizon respekti i popullit ndaj udhëheqësit. Në të dy rastet ata kanë cilësi të larta njerëzore, mendore e fizike që e meritojnë dashurinë. Por mbi të gjitha vlerësohet misioni i drejtë, që ata kanë marrë përsipër ta kryejnë. Mirëpo, sa është i madh respekti i popullit ndaj udhëheqësit, po aq e madhe është urrejtja mes dy popujve.

Te *Sejdi Jahja* (Akti i katërt pamja e parë): ”A thua këta njerëz ishin të këtillë, të trashë nga mendja e të fëlliqur

■

<sup>13</sup> A. Sheuki, *Princesha e Andaluzisë*, f. 86.



edhe kur ishin të lirë? Apo u bënë të tillë prej kur e humbën lirinë dhe pasurinë e tyre.”<sup>14</sup>

Urrejtja arabe kundër spanjollëve është historike dhe e përgjithshme. Ajo vjen si pasojë e dhunës, e vrasjeve, e shkatërrimeve që kanë ushtruar spanjollët ndaj tyre. Urrejtja të *Princesha e Andaluzisë* është shfaqur në shkallë shpalljeje të luftës nga arabët. Akti i parë: “ Zotërinj i thoni mbretit Alfons atë që e dëgjuat, dhe përshkruani atë që e keni parë, si dhe bisedoni për gjatësinë dhe gjerësinë e shtetit tuaj. Le ta dinë të gjithë atje, se luani arab nuk fyhet”.<sup>15</sup>

Pra, të dy drejtimet që krijohen: ai i mënyrës së veprimeve: krenaria, parandjenja e rrezikut, rreziku, humbja e pakthyeshme, fundi i heronjve dhe ajo e marrëdhënieve mes personazheve: respekti, urrejtja na bindin për ngjashmëritë që ekzistojnë në strukturimin e brendshëm të pjesëve të këtyre dramave të krijuara me fuqinë e fjalës artistike, të Sami Frashërit dhe të Ahmed Sheuki-ut, dy krijuesve të mëdhenj me famë botërore.

### **A look on Sami Frasheri play "Sejdi Jahja" compared to "Andalusia Princess" by Ahmed Shewki**

*Sejdi Jahja*, a drama by Sami Frasheri written in Turkish, and published in Istanbul in 1875, only recently was translated into Albanian. The plot was borrowed from the history of Spain during the Arab domination in eleventh century. It is a story about the tragic resistance of the Arabs in Seville. With an exceptionally large and deep expressivity, together with substantial polysemy, it tells

■  
<sup>14</sup> S. Frashëri, *Sejdi Jahja*, f.139.

<sup>15</sup> A. Sheuki, *Princesha e Andaluzisë*, f.29.



about heroism and treachery to finally underline the horrible destiny of the people submitted to the consequences of the events.

*Andalusia Princess* published in Cairo in 1932 by Ahmed Shewki, an Arab neoclassicist from Egypt, revived the epic of the heroic resistance by the Arab people in Spain. The author is not describing the history, and even doesn't rest on proper historical arguments from the respective period. It is a realistic event with a free artistic message. He is not denying history, or overturning it, he simply tries to give the truth of the historical stream during the eleventh century in Spain.

Both dramas have many things in common, first of all, the context of Andalusia tragedy, but they differ in their inner structuring. In the system of the ideas by both authors, Frasher and Shewki, the grandiosity and the horror connected with the events and the glory of the characters, seen from both talented authors, is truthfully preserved. As a result, there are to be noted a number of similarities between the two works, despite their difference in chronology and the climate of the time when they were created. The way the heroes act, their proud, forefeeling of the threat, the danger, the irreversible lost, the relations and the end of the heroes, as well as respect and hate, are shared by both plays.



*Prof. Dr. Dr. Azmi Bilgin\**  
(Turqi)

**VEPRAT DHE IDETË E SHEMSEDDIN  
SAMIUT MBI LETËRSINË**

---

Angazhimi letrar i Shemseddin Samiut (Sami Frashërit) nuk është vënë në pah sa duhet, për arsye se ka mbetur nën hijen e veprimtarisë së tij në fushën e përpilimit të fjalorëve (leksikografisë) e të enciklopedive. Krahas veprave që ia ka dhuruar jetës shkencore, artistike e kulturore turke, ai ka shprehur mendimet dhe vlerësimet e tij lidhur edhe me letërsinë. Në këtë kumtesë unë do t'i shqyrtoj këto dy tema që nuk janë rrahur sa duhet deri në ditët tona. Punimet letrare të Shemseddin Samiut mund të shqyrtohen të ndara në dy grupe kryesore, në: vepra origjinale dhe përkthime.

**A. Veprat origjinale**

1. *Taash-shuk-i Talat ve Fitnet [Dashuria e Talatit dhe Fitnetit]* (1872). Kjo vepër, të cilën Samiu e ka shkruar në moshën njëzetedyvjeçare, zë një vend me rëndësi në historinë e letërsisë sonë, ngase është përpjekja e parë në shkrimin e romaneve në letërsinë turke dhe ngase sjell disa elemente bazë të stilit perëndimor të romanit. Namik Ke-

■

\* "Universiteti i Stambollit", Stamboll.

mali romanet e tij *İntibab* dhe *Cezmi* i ka shkruar pas kësaj kohe.

Në këtë roman theksohen pasojat negative që i shkakton martesat e padëshiruar e të rinjve. Edhe pse nga aspekti i ngjarjes romani nuk duket gjithaq bindës\*, konkretizimet që herë pas here shihen në roman, janë me rëndësi të veçantë për periudhën në fjalë, sepse ai këtu përpiqet të zgjojë mbresat realiste të letërsisë perëndimore, përkundër mesneve\*\* dhe tregimeve popullore që ishin tipike në letërsinë e vjetër turke. Kjo është një risi e rëndësishme që vërehet në roman, përkundër filozofisë së jetës që në letërsinë e vjetër kishte karakter introvert (të kthyer përbrenda; të mbyllur në vetvete). Përshkrimet e bëra nga Samiu, janë skena që mund të hasen kudo në jetën e përditshme. Meqë ngjarjet kryesisht ndodhin brenda shtëpisë dhe si rrjedhojë edhe rrëfimet kryesisht kanë të bëjnë me përshkrimin e brendshëm të saj, në roman shumë pak vend i jepet mjedisit të jashtëm dhe natyrës.

Dashuria që në roman trajtohet si një dukuri njerëzore dhe sociale, bashkohet me idenë e identitetit dhe lirisë njerëzore, e jo si më parë me mistiken. Kjo është ndryshe nga konceptimi i dashurisë në letërsinë e vjetër dhe, në fakt, ky konceptim zë një vend të rëndësishëm në roman.

■

\* Për shembull, thuhet se është e pamundur të mos hetohet Talati i veshur si vajzë. Gjërat si mosdërgimi i msytit për fejesën me Fitneten etj., tregojnë se sa mënjane janë lënë sjelljet normale të periudhës në fjalë.

\*\* *Mesnevi* [*methnevi*]: vepër poetike e hartuar në dyvargësh të rimuar, ku secili dyvargësh ka rimë të ndryshme nga tjetri, por e gjitha në një skemë metrike, *Türkçe-İngilizce Redhouse Sözlüğü*, Stamboll, 1991 - sh. p.)



Personazhet flasin sipas nivelit të tyre dhe me dialektet vendore. Edhe kjo zë një vend të rëndësishëm në letërsinë e re turke. Është rrjedhojë e idesë për ta shpjeguar jetën ashtu siç është, rrjedhojë e idesë “për të dhënë mbresën e realitetit”. Këtë më parë e ka bërë Shinasiu në vepërën e tij *Şair Evlenmesi [Martesa e poetit]* (1860).

Edhe pse figurat kryesore të romanit trajtohen pak më tepër sesa në tregimet tradicionale, prapëseprapë në këtë vepër nuk mund të hasim në analiza të thella psikologjike. Thënë të vërtetën, autori nuk ka tentuar t'i kuptojë mirë personazhet... Edhe pse përpiqet t'i përshkruajë disa gjendje shpirtërore të tyre, ai nuk i kërkon shkaqet e atyre sjelljeve. Gjendjet shpirtërore që janë vështirë për t'u sqaruar, kërkojnë një stil dhe metodë të pasur shpjegimi. Ndërkaq, stili i Samiut këtu është i thjeshtë, sepse këtë vepër ai e ka shkruar qysh në rini. Ai këtu ka mbetur brenda kuadrit të fjalëve të gjuhës së përditshme. Ky qëndrim i tij mund të kuptohet edhe si një kundërshtim i vetëdijshëm që ka dashur ta zhvillojë ai ndaj stilit të zbukuruar të të shprehurit që ka qenë tipike në letërsinë e Divanit.

Në roman përpunohet teza sipas së cilës traditat dhe zakonet që bien ndesh me personalitetin, lirinë dhe natyrën e njeriut, e çojnë njerëzimin drejt shkatërrimit e katastrofës. Kritikohet shtypja e tepruar e familjeve mbi të rinjtë.

Gjuha dhe rrëfimi i romanit konsiderohen të pagdhendta e të çrregullta. Kjo mund të shpjegohet me arsyen se Samiu romanin e ka shkruar në moshë të re dhe se ai vetë është rritur në një mjedis ku më tepër janë folur gjuhë të tjera sesa turqishtja. Në veprat e mëvonshme të tij shihet se kjo mangësi është tejkaluar. Shemseddin Samiu, i cili e ka përpiluar fjalorin më të mirë të gjuhës turke, më vonë

me thesarin e studimeve që i ka bërë në fushën e turqishtes arrin shkallën e tejkalimit të bashkëkohësve të tij.<sup>16</sup>

2. *Besa yahud Ahde Vefa* (1874). Në këtë vepër bëhet fjalë për Fettah again se si ai ia jep fjalën (besën) zonjës Vahide, e cila e shpëton kokën e vet nga dora e një katundari ndërsa kthehej në vendlindje, se do ta marrë hakun për vrasjen e burrit dhe për grabitjen e vajzës nga ana e katundarit. Mirëpo, pasi ai e merr vesh se personi që duhej mbytur ishte djali i tij, për të mos e thyer besën e vret të birin. Në këtë vepër teatrale Samiu na tregon se sa besnikë ndaj traditave e zakoneve janë banorët e viseve malore të Janinës. Si janinas që është, autori në parathënien e kësaj vepre na rrëfen se e ka shkruar për të na treguar ndjenjat kombëtare të këtij populli, si dashuria ndaj atdheut, bujaria, besa etj. Koncepti “kombëtar” që përmendet këtu ka kuptim shumë më të gjerë sesa ai i sotmi. Ai përfshin traditat dhe zakonet, si dhe karakteristikat e veçanta të të gjithë popujve myslimanë që kanë jetuar brenda shtetit osman. Mirëpo, rasti i Fettah agait kur e vret të birin vetëm për ta mbajtur besën, është një çështje që është diskutuar si në kohën e tij, ashtu edhe më vonë. Nuk është shikuar si gjë me vend dhe e arsyeshme që të përligjen dy krime të mëdha si vrasja dhe vetëvrasja në emër të edukimit të popullit; madje është thënë se me këtë nuk përfillen aspak konceptet shtet dhe drejtësi. Drama është ndaluar në vitin 1875, kurse më 1908 është luajtur disa herë.<sup>17</sup> Kjo dramë, ashtu siç thekson Nijazi Akë, na përkujton babanë

■

<sup>16</sup> Për më tepër shih Mehmet Kaplan, *Türk Edebiyatı Üzerinde Araştırmalar*, Stamboll, 1997, vëll. II, f. 71-92.

<sup>17</sup> Nuri Sağlam, “Tanzimat Sonrası Türk Edebiyatında “Milli Tiyatro” Anlayışı ve Şemseddin Sami’nin “Besa yahud Ahde Vefa” Adlı Piyesi”, *İlmi Araştırmalar*, Stamboll, nr. 8, f. 199-207.

që e vret të birin e vet në tregimin *Matteo Falcone* të Prosper Merimesë.<sup>18</sup>

3. *Seydi Yabya* [Sejdi Jahjai] (1875). Ngjarjet e kësaj vepre, që temën e nxjerrin nga historia e Andaluzisë, kanë ndodhur në kalanë Raze të qytetit Kashtale të Spanjës kah fundi i shek. IX dhe fillimi i shek. X hixhri. Jahjai i cili e ruan kalanë Raze, nuk dëshiron që t'ua dorëzojë spanjollëve. Mirëpo një tradhëtar i quajtur Zejd, i paguar nga armiqtë, një natë derisa ai bënte rojen, ua hap dyert e kalasë spanjollëve. Spanjollët e kapin Jahjanë dhe e fusin në burg. Njëri prej të burgosurve i quajtur Petro, e mashtron Jahjanë dhe i vesh teshat e tij me të cilat arratiset prej burgu. Përjashta ai e paraqet veten si Jahjai dhe lidh marrëveshje me armikun. Popullata myslimane mendon se Jahjai i ka tradhtuar. Mirëpo më vonë kuptohen intrigat e Petros, kurse Jahjai lirohet nga burgu dhe bashkohet me vajzën e tij Halimen, që më parë ia kishte dorëzuar robit të tij Osmanit. Djali i Osmanit, Jusufi, që ishte rritur bashkë me Halimen të cilën e kishte ditur si motër të veten, kur merr vesh se nuk e ka motër, martohet me të. Pas Samiut edhe Abdulhak Hamidi ka shkruar drama me tema të marrura nga historia e Andaluzisë.

Risi në këtë vepër është kori, ashtu siç e hasim në tragjedinë greke. Këtu shihen gjurmët e ndikimit të veprës *Comte de Monte Cristo* të Alexandre Dumas Atit.<sup>19</sup>

4. *Gave* (1876). Tema e kësaj vepre është marrë në formë të ndryshuar nga *Şehname-ja* e Firdeusit, që njihet si epika kombëtare e letërsisë persiane.\*

■  
<sup>18</sup> Niyazi Akı, *Türk Tiyatro Edebiyatı Tarihi I: Başlangıçtan Cumhuriyet Devrine Kadar*, Stamboll, f. 171.

<sup>19</sup> *Po aty*, f. 134-136.



Në këtë vepër bëhet fjalë për Dahhakun që, pasi ulet në fronin e Xhemshidit, i cili ishte njëri prej sundimtarëve mitologjikë të Iranit, e udhëhiqte popullin me tiraninë e tij. Më pas vjen Gave nga shkretëtirat e Arabisë bashkë me disa barinj që i kishte marrë me vete dhe e zbrit nga froni Dahhakun, kurse në vend të tij ul Feridunin, nipin e Xhemshidit. Ky tregim është pëlqyer shumë nga ana e intelektualëve të kohës, ngase ua përkujtonte Revolucionin francez.

Sipas Samiut historia është një burim mjaft i pasur për veprat teatrale. Duke qenë se në historinë tonë ka mjaft shembuj trimërie e njerëzimi që mund të na japin mësim, nuk duhet vereshtisur me dashurinë dhe martesat e dhunshme. Edhe pse autori thotë se në një vepër teatrale mund të ndodhet *ashku* (dashuria), prapëseprapë nuk e sheh të udhës që e gjithë vepra të mbushet me dashuri.<sup>20</sup>

Në parathënien e *Gaves* Samiu thotë që, edhe pse ngjarjet e paraqitura në vepër nuk mund gjithaq të quhen si elemente kombëtare, megjithëkëtë këto tema deri në një farë shkalle duhen quajtur si kombëtare, nga arsyeja se janë shumë të njohura në letërsinë islame. Siç mund të vërehet, ashtu si thamë më lart, konceptimi i kombëtares në kohën e shkrimtarit ka qenë shumë më i gjerë sesa sot.

Pika e përbashkët e veprave teatrale të Shemseddin Samiut, krahas elementeve që të çojnë drejt ndjenjave romantike, është edhe lufta midis drejtësisë e tiranisë dhe në fund fitorja e drejtësisë. Përveç kësaj, ajo që vërehet qartë është edhe malli ndaj lirisë. Edhe dramat e Samiut, ashtu

■

\* Për shembull, gjarpërinjtës në shpatullat e Dahhakut, janë ndryshuar në trajtën e hyjnive të sundimtarit tiran. Në Parathënie autori tregon edhe shkaqet e këtij ndryshimi.

<sup>20</sup> *Po aty*, f. 197.



si ato të Namik Kemalit, janë luajtur nga disa herë prej trupave të ndryshme teatrale. Me këto vepra teatrore që ka shkruar, ai ka zënë një vend shumë me rëndësi në fushën e artit të kohës së tij.

Përveç këtyre, dihet se shkrimtari ka shkruar edhe dy vepra teatrale të titulluara *Subrah yabud Ferzendkuş*<sup>21</sup> (*Meditatori*) dhe *Mezalim-i Endülüis*<sup>22</sup> (*Mynxyrat e Andaluzisë*), mirëpo këto kanë mbetur pa u botuar.

## B. Veprat e përkthyera

Të gjitha përkthimet që i ka bërë, janë nga gjuha frënge.

1. *Ihtiyar Onbaşı [Dhjetari plak]* (1873). Këtë përkthim që e ka bërë nga Domanoir dhe Dennery, është një tragjedi me pesë perde. Meqë kjo është luajtur në skenë shumë herë, ka ndikuar edhe në njohjen e Shemseddin Samiut në opinion.<sup>23</sup> 2. *Galatee* (1873). Origjinali i kësaj vepre, të cilën ai e përktheu nga Floriani, është një dramë poetike që ka të bëjë me mitologjinë. Këtë vepër Samiu e përktheu në turqishte si tregim. 3. *Şeytanın Yadigarları [Kujtimet e djallit]* (1878). Këtë roman avanturash që Samiu e përkthen nga Frederic Soulie, është një prej përkthimeve më voluminoze të tij. 4. *Sefiller [Të mjerët]* (1880; 899 faqe, kurse me shkronja latine 1934). Ky është një roman i përkthyer nga vepra *Le Misérables* e Victor Hugo-së. Përkthimin e



<sup>21</sup> *Servet-i Fünun*, Stamboll, 1312, v. XI, f. 275.

<sup>22</sup> Shih: Şemseddin Sami, *Himmatü'l-himam fi neşri'l-İslam*, Stamboll, 1302, f. 32.

<sup>23</sup> Po ai, *Temel Türkçe Sözlük: Sadeleştirilmiş ve Genişletilmiş Kamus-ı Türki*, Stamboll, 1985, v. I, f. xii.

mbetur përgjysmë të kësaj vepre, pas vdekjes së Samiut e ka përfunduar Hasan Bedreddin (pas faqes 645). Metoda e përkthimit së cilës i përmbahej Samiu, sidomos në veprën *Sefiller*, ishte përkthimi i fjalëpërfjalshëm duke i qëndruar besnik vetë tekstit origjinal të veprës, për çka edhe është kritikuar mjaft, ngase kjo e shpërdoronte gramatikën e gjuhës së prozës dhe se binte ndesh me rregullat e gjuhës turke. Gjatë këtyre diskutimeve Ahmet Mit'hat Efendiu e mbronte Samiun, nga ana tjetër Sylejman Nazifi e kritikon ashpër përkthimin e veprës *Sefiller*.<sup>24</sup> Në përgjigjet që Samiu i ka shkruar ndaj këtyre kritikave, ka theksuar se këtë metodë ai e ka përdorur me paramendim dhe se ka qenë i vetëdijshtë për vështirësitë e kësaj pune. Halid Zijau, në kujtimet e tij, thotë se ata që e kanë kritikuar e përqeshur Samiun për përkthimin e fjalëpërfjalshëm të veprës *Sefiller*, me çka e ka ruajtur strukturën e fjalisë së gjuhës frënge, më vonë vetë ata fillojnë zbatimin e kësaj metode.<sup>25</sup> 5. *Robinson* (1885). Është përkthim i veprës me të njëjtin titull i Daniel de Foe-s. Përkthimi nuk është bërë nga origjinali në anglisht, por nga versioni i shkurtuar për fëmijë në frëngjisht. Menjëherë nën titullin e librit Samiu ka shkruar se ky është “një përkthim i fjalëpërfjalshëm”, me çka me siguri ka dashur t’u përgjigjet kritikave lidhur me përkthimet e tij.

Përpos këtyre përkthimeve letrare që Samiu i ka bërë nga gjuhët perëndimore, ka përkthyer edhe nga gjuhët lindore, përkthime këto që gjithsesi mund t’i radhisim në serinë e punimeve të tij letrare, siç janë *Hurdeçin* (1885, tekste e përkthime të zgjedhura nga kujtime të poetëve persia-

■

<sup>24</sup> Për këto diskutime shih Agah Sırrı Levend, *Şemsettin Sami*, Ankaras, 1969, f. 72-75.

<sup>25</sup> Halid Ziya Uşaklıgil, *Kırk Yıl*, Stamboll, 1936, vëll. IV, f. 89-90.

në) dhe *Ali b. Ebi Talib-kerrema'llahü vecheb ve radiyallahu anh efendimizin-Eş'ar-ı Müntehabeleleri ve Şerb ve Tercemesi* (1318/1900).

Idetë e Shemseddin Samiut lidhur me letërsinë turke i mësojmë nga veprat si dhe nga artikujt e tij të botuar nëpër gazeta. Ai ka shfaqur mendimet e tij lidhur me këto tema nëpër gazeta e revista të ndryshme. Këto mendime të tij do t'i shtjellojmë më poshtë në disa nëntituj.

### **a. Idetë lidhur me poezinë**

Shemseddin Samiu, me thënien e tij se nuk është e drejtë që “fjalës së vargëzuar e të rimuar” t'i thuhet poezi, nuk e pranon përdëftimin e poezisë me të cilin ishte i lidhur ngushtë stili i vjetër. Në kohën e Muhammedit a. s. arabët edhe pse ishin shumë të ngritur në poezi, ajeteve kur'anore u thanë poezi. Mirëpo ajetet nuk kishin metër dhe rimë<sup>26</sup>, thotë ai dhe këtë e sjell si dëshmi për mendimin e vet kur i mbron format e reja të vargjeve që vinin nga Perëndimi, ku për poezinë nuk ishte kusht që ajo të kishte metër e rimë. Në këtë drejtim ai e sjell edhe përdëftimin e poezisë të bërë nga ana e Xhamiut, njërit prej poetëve të njohur persianë, i cili ka thënë: “Edhe pse në mesin e të parëve poezia ishte një fjalë me anë të së cilës kur duhej diçka tregohej si e bukur, e kur duhej tregohej si e shëmtuar, në mesin e të mëvonshmëve, ndërkaq, nuk përfillej asgjë pos metrit dhe rimës”. Sidomos rimën nuk e kanë njohur fare poetët e vjetër. Këtë e kanë shpikur poetët arabë, e prej tyre pastaj ka kaluar te persianët dhe turqit. Qytetërimi islam në Azinë e Mesme ka kaluar në Evropë bashkë edhe me veprat e tij. Sot me shumicë ruhet

■  
<sup>26</sup> Şemseddin Sami, “Şiirin Mahiyet ve Hakikati”, *Hafta*, vëll. I, nr. 2, 29 Ramazan 1298, f. 28.



dhe i kushtohet kujdes rimës.<sup>27</sup> Poezia nuk është vetëm të thuash një fjalë metrike. Poeti në njëfarë shkalle duhet të jetë i urtë (filozof), duhet të ketë aftësi poezie, duhet të shquhet me shkathtësinë e fuqisë së imagjinatës. Ata që nuk i kanë patur këto, kanë shkruar gjëra të thjeshta që nuk mund të quhen poezi.<sup>28</sup>

Kur bëhet krahasimi midis qytetërimit lindor dhe atij perëndimor, gjegjësisht qytetërimit të grekëve të vjetër, do të shihet ky dallim kryesor: lindorët gjithnjë i pëlqejnë sendet e larmishme, të skalitura e me lule, kurse grekët e vjetër dhe popujt e tjerë të lidhur pas qytetërimit të tyre janë kujdesur më shumë për sendet e thjeshta e të njëtrajtshme. Ky dallim ashtu siç mund të vërehet në arkitekturë dhe arte të tjera, haset edhe në poezi. Metri dhe rima zënë vendin e ngjyrës dhe zbukurimit të poezisë ose fjalës.<sup>29</sup>

Në poezi nuk kërkohet e vërteta. Ajo që kërkohet është përshkrimi konkret dhe i përkryer i sendit për të cilin duam të flasim. Ashtu si çdo gjë tjetër, edhe fjala ka shkallën e më të lartës dhe më të ultës, të jashtëzakonshmes e të zakonshmes. Poezia është trajta më e lartë dhe më e jashtëzakonshme e fjalës.<sup>30</sup>

Shemseddin Samiu krijon një lidhje ndërmjet poezisë dhe degëve të tjera të arteve të bukura. Ai e përngjason poetin me piktorin. Nëse piktori i përshkruan trupat dhe dukjet e natyrës, poeti i përshkruan me fjalë idetë, ndjenjat dhe gjendjet e ndryshme shpirtërore të njerëzve... Ai thotë se piktori për këtë e përdor brushën, kurse poeti

■  
<sup>27</sup> *Po aty*, f. 28.

<sup>28</sup> Şemseddin Sami, "Şarkta Şiir ve Şuara", *Hafta*, vëll. I, nr. 6, 27 Shevval 1298, f. 89.

<sup>29</sup> Şemseddin Sami, "Şiirin Mahiyet ve Hakikati", *Hafta*, vëll. I, nr. 2, 29 Ramazan 1298, f. 29.

<sup>30</sup> *Po aty*, f. 27.



gjuhën.<sup>31</sup> Më tej thekson se edhe pse poezia shqyrtohet në lëmin e letërsisë, ajo përmendet edhe në mesin e “arteve të bukura”, madje ka lidhje edhe me muzikën dhe arkitekturën. Poezia është shumë më e vjetër se shkrimi dhe arsimi... Njeriu, para se të shkruajë, nga natyra është nxitur të sajojë fjalë për ta shprehur gëzimin dhe dëshpërimin apo frikën e tij, është detyruar që këto fjalë t’i thotë me një zë dhe mekam (melodi) të veçantë. Ja kështu kanë lindur këngët e dashurisë dhe simpatisë; elegjitë që ankohen për ndarjen e fëmijëve, të afërmeve e të dashurve; këngët e luftës që rrëfejnë për trimëritë e njerëzve, për kafshët e të tjera situata. Këto kanë qenë edhe para shkrimit.<sup>32</sup>



<sup>31</sup> *Po aty*, f. 25.

<sup>32</sup> *Po aty*, f. 26.

## b. Idetë lidhur me letërsinë arabe

Shemseddin Samiu thotë se arabët u kanë dalë zot dhe i kanë ruajtur poezitë e Xhahilijetit (kohës para Islamit) edhe pasi ata janë bërë myslimanë, kurse persianët dhe turqit nuk u kanë dalë zot veprave të paraislamit dhe nuk janë munduar t'i tubojnë e t'i ruajnë ato, nga arsyeja se kanë përdorur tjetër alfabet dhe veprat letrare të tyre i kanë konsideruar si vepra *kufri* (mosbesimi). Me këtë ai tërheq vëmendjen në tërësinë dhe kompaktësinë e letërsisë turke të paraislamit me atë të pasislamit.<sup>33</sup>

Tek arabët nuk ka ngecur poezia me pranimin e Islamit. Janë rritur shumë poetë të njohur si Xheriri, Ferazdaku, Ebu Nuvasi, Ebul-Ulai, Bahauddini, Mutenebbiu etj. Këta i kanë ndjekur dhe imituar poetët e periudhës së paraislamit.<sup>34</sup>

Në poezi fama nuk arrihet me të imituar. Për të fituar famë në poezi duhet shkuar në një rrugë që s'ka shkuar njeri më parë. Për këtë arsye dhe parapëlqehen më shumë poetët e vjetër sesa të rinjtë. Poeti nuk duhet të imitojë askë, ai duhet t'i ndjekë ndjenjat e poetësisë së vet dhe duhet të mundohet të hapë një rrugë të re në poezi.<sup>35</sup>

Imagjinata e poetëve arabë është e gjerë dhe e lartë, ata janë të shkathët, që me pak fjalë të thuhet shumë. Edhe pse kanë stërmadhime në rrëfimet lavdëruese të prejar-dhjes e të parëve, të trimërisë e bujarisë së tyre, në poezitë e tyre të shkruara për kënaqësinë dhe ndjeshmërinë e dashurisë, për dhimbjet dhe hekat e ndarjes, për bukurinë e së dashurës, për vlerën e burrërisë, nderit e fisnikërisë si dhe për të tjera gjendje natyrore, këto i kanë përshkruar

■

<sup>33</sup> Şemseddin Sami, "Şarkta Şiir ve Şuara", *Hafta*, vëll. I, nr. 4, 13 Shevval 1298, f. 57.

<sup>34</sup> *Po aty*, f. 58.

<sup>35</sup> *Po aty*, f. 59.

në një formë konkrete, larg stërmadhimeve të poetëve jo-arabë. Këto kanë qenë aq të natyrshme, aq prekëse e të bukura sa që halifët abbasitë për një *bejt* (varg) poetit ose lexuesit të poezive i kanë falur dhurata të pasura. Nuk duhet habitur me të thënat që i lexojmë në veprat *Egani* (*Këngët*) dhe *Elfu'l-lejl ve lejl* (1001 netë) për mbresat e jashtëzakonshme që i lë te dëgjuesi leximi i një strofe.

Nëse poezia arabe ka ndonjë të metë, është kjo: Poetët arabë nuk e kishin bërë zakon që një ngjarje historike apo edhe të trilluar ta merrnin për bazë e ta zbërthenin në formë vargu apo përshkrimi. Ndër veprat e poetëve arabë nuk mund të hasësh në ndonjë vepër të hollësishme e të sistematizuar, që do të mund të krahasohej me veprat e poetëve, si të Homerit, Firdeusit, Dantes, Miltonit etj.<sup>36</sup>

### c. Idetë lidhur me letërsinë iraniane

Shemseddin Samiu historinë e letërsisë iraniane e fillon vetëm me kohën e para dhjetë, njëmbëdhjetë shekujve. Sipas tij edhe pse fillimi dhe shfaqja e Islamit ndodhi tek arabët, letërsia persiane përbëhet vetëm nga letërsia islame. Arsyja kryesore e kësaj është shkrimi (alfabeti); arabët e kanë përdorur të njëjtin shkrim si para ashtu edhe pas pranimit të Islamit, me çka e kanë ruajtur edhe letërsinë e tyre të vjetër. Ndërkaq iranianët me pranimin e Islamit e braktisin edhe shkrimin e tyre të vjetër dhe fillojnë të përdorin shkrimin arab, me çka ata bashkë me shkrimet e vjetra e kanë humbur edhe letërsinë e tyre të vjetër.

Meqë poetët iranianë nuk i kanë ndjekur poetët arabë duke krijuar një rrugë të re për veten, ndërmjet poezisë arabe dhe asaj persiane nuk ka kurrfarë ngjashmëri. Kjo kundërshti ndaj poezisë arabe nga njëra anë, dhe ngjashmëria e poezisë persiane me atë hinduse, greke e me atë të

■

<sup>36</sup> *Po aty*, f. 59-60.

arianëve të tjerë nga ana tjetër, tregon mundësinë që poetët e vjetër persianë t'i kishin ndjekur poezitë e Iranit të paraislamit. Edhe pse sot nuk ka ndonjë vepër poezie e letrare të periudhës së paraislamit, ekziston mundësia që në kohën e Dakikiut e të Firdeusit populli të kishte ruajtur në kujtesën e vet përkujtime të ndryshme nga poezitë e vjetra. Historia e vjetër e Iranit gjithqysh u ka arritur poetëve myslimanë të Iranit.<sup>37</sup>

Ndërsa Samiu thotë se veprat e poetëve iranianë nga fusha e tregimeve të vargëzuara dhe moralit e proverbave meritojnë lavdin e duhur, përkundrazi, poezisë erotike (të dashurisë) ia drejton dy kritika me rëndësi: 1. Ata nuk janë sjellë në mënyrë të natyrshme dhe reale, ngase në poezitë e tyre ku flitet për dashurinë dhe për femrat, nuk u drejtohen femrave në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe konkrete. Fjalët “dilber” (e dashur) dhe “xhanan” (e dashur, shpirt) që përmenden në gazelet e poetëve iranianë në masë të madhe nënkuptojnë një të dashur fiktive. 2. Ata janë kufizuar me disa fjalë të caktuara dhe gjithnjë janë sjellë rreth tyre, si fjalët trëndafil, zefir, selvi, kaçurrela, pikë në faqe, verë, mejhane, mejhanexhi etj. Kanë përdorur përngjasime të ndryshme jo të natyrshme dhe në masë të tepruar i kanë përdorur stërmadhimet (hiperbolat). Këto gjëra ua kanë humbur ëndjen dhe bukurinë shumë poezive iraniane.<sup>38</sup>

Firdeusi është piri dhe mësuesi i të gjithë poetëve persianë. Shkathtësia, joshja, cilësimi dhe përcaktimi – më drejt – personifikimi që hasen në *Shehname*-n e tij, nuk mund t'i hasësh në asnjë vepër tjetër. Ajo që kësaj vepre ia shton edhe më vlerën është gjuha e saj pastër persishte,

■

<sup>37</sup> Şemseddin Sami, “Şarkta Şiir ve Şuara 2”, *Hafta*, vëll. I, nr. 6, 27 Shevval 1298, f. 86-87.

<sup>38</sup> *Po aty*, f. 87-88.



e dëlirë nga fjalët dhe shprehjet arabe dhe shkrimi i saj në një stil mjaft të thjeshtë e të kuptueshëm. Me rastin e përkthimit në prozë të shumë bejteve të tij, thuajse është e pamundur të përdorësh fjalë të tjera pos fjalëve që i ka përdorur vetë Firdeusi. Thuajse këto fjalë qysh në *ezel* (eternitet, parahistori) janë përgatitur vetëm për Firdeusin, thuajse një fuqi e padukshme ia ka frymëzuar në mendjen dhe imagjinatën e tij! Edhe vepra *Penxh Genxh* (pesëvargëshja) e Nizamiut, *Bostani* i Sa'diut, *Heft Erreng-u* i Xhamiut, *Kul-lijati* i Attarit etj. kanë vlerat e tyre të çmuara.

Ndërkaq përshkrimi në formë tregimesh të shkurtra të sjelljeve morale në stilin e *Bostanit* të Sa'diut, është gjëja që për herë të parë është shpikur nga ana e poetëve iranianë.

Sipas Samiut, ndër poetët më në zë të letërsisë persiane janë Sa'diu, Hafizi, Enveriu, Suzeniu, Rudekiu, Xhamiu, Husrevi, Saibi, Shevketi etj. dhe sikur disa nga mangësitë e përmendura më lart të mos ndodheshin edhe te këta poetë, lirisht do të mund të thuhej se shembullin e poetëve iranianë nuk do të mund ta gjeje kund. Vërtet është e drejtë nëse thuhet se persishtja është gjuhë poezie, kurse Irani atdhe poetësh... Poetët si Firdeusi, Dakikiu, Sa'diu, Nizamiu, Xhamiu, Attari etj. janë të kalibrit konkurrues me Homerin dhe Sofokliun e Greqisë së vjetër, me Virgjilin e Romës, me Danten e Italisë, me Miltonin e Anglisë dhe nga një aspekt tjetër me Corneillen, Racine-in, Goethe-n, Schiller-in, Shakespeare-in e ndoshta edhe me poetët e shekullit tonë, si Lamartini, Lord Bayron, Victor Hugo etj.<sup>39</sup>

Ashtu siç mund të shihet, Samiu duke i krahasuar poetët e rritur nga letërsia persiane me poetët dhe shkrimtarët më të njohur të Perëndimit, është munduar të tregojë se poetët iranianë mund të maten me poetët në fjalë.

■

<sup>39</sup> *Po aty*, f. 90.

### ç. Idetë lidhur me letërsinë turke

Edhe letërsia turke, ashtu si letërsia persiane, përbëhet nga veprat e periudhës së pasislamit. Në të vërtetë, poetët e parë të letërsisë turke duhet t'i kërkojmë në Azinë e Mesme. Meqë turqit kishin marrëdhënie të ngushta me iranianët, në lëmin e poezisë fillimisht kanë përdorur gjuhën persiane.<sup>40</sup>

Periudha më e shkëlqyer e letërsisë turke ka qenë periudha e timurëve, kur ka sunduar Timurlengu. Në kohën e Timurlengut Samarkandi është bërë qendra ku janë mbledhur dijetarët e artistët e kohës.

Në sarajin e Timurit krahas shkrimit të veprave në gjuhën persiane, kanë filluar të shkruhen vepra edhe në gjuhën turke dhe janë rritur mjaft poetë turq. Në krye të këtyre gjendet poeti Ali Shir Nevai.

Meqë poetët turq i kanë imituar poetët persianë, edhe të këta vërehen të njëjtat mangësi sikurse tek ata. Edhe pse në terrenin e Anadollit janë rritur mjaft poetë, këta nuk kanë arritur të hapin një drejtim të ri, porse thjesht i kanë imituar poetët e Iranit.<sup>41</sup>

Sipas Samiut, pas themelimit të Shtetit Osman gjuha turke është zhvilluar dita-ditës dhe në kohën e Fatihut, Selimit e Sulejmanit ka lindur një letërsi e mrekullueshme osmane dhe janë paraqitur mjaft poetë e letrarë të famshëm. Që atë ditë e deri më sot, në letërsinë osmane ka sunduar një ngecje, nuk është vërejtur ndonjë zhvillim i

■  
<sup>40</sup> Şemseddin Sami, "Şarkta Şiir ve Şuara 3", *Hafta*, Stamboll, 5 Dhul-Ka'de 1298, vëll. I, nr. 7, f. 105.

<sup>41</sup> *Po aty*, f. 106.

veçantë.<sup>42</sup> Në mesin e poetëve osmanë që meritojnë të pë-  
menden me nder janë: Fuzuliu, Ruhju, Nabju, Baku,  
Hashmeti, Shemi, Nefju, Lejla, Fitneti.

Në këtë shekull disa letrarë si Zija Pasha dhe Kemal  
Beu kanë shkruar poezi në stilin e poetëve tanë të vjetër,  
por me ide të reja dhe me ndjenja të vërteta poeti, larg  
çdo të mete. Ndërkaq viteve të fundit dalngadalë është  
braktisur stili iranian dhe janë hapur nja dy drejtime të sti-  
lit të poetëve të rinj evropianë. I pari që shkruan në këtë  
stil është Abdulhak Hamid Beu, i cili në historinë e letër-  
sisë sonë hap një faqe të re në gjininë e poezisë. Edhe  
poetët tanë të njohur për fuqinë e lapsit e të natyrës së  
poetësisë si Ekrem Beu, nuk e kanë kursyer ndihmën e  
tyre ndaj këtij poeti të ri që duket se do të jetë një Lamar-  
tin i vendit tonë.<sup>43</sup>

Ashtu siç mund të kuptohet nga fjalitë e mësipërme, Sa-  
miu mban anën e risive të kohës së tij në fushën e letërsi-  
së dhe thotë se brenda dhjetë-pesëmbëdhjetë viteve të  
fundit janë vërejtur disa risi shumë rrënjësore. Çdo peri-  
dhë, çdo shekull ka gjendjen dhe fizionominë e vet perso-  
nale si në arkitekturë e muzikë, ashtu edhe në orendi,  
veshje e në shumë aspekte të tjera. Po kështu, edhe në fu-  
shën e poezisë dhe letërsisë, secili shekull ka stilin e vet  
karakteristik. Mirëpo, për shekujt e kaluar nuk mund të  
thuhet se në letërsinë turke ka patur një zhvillim dhe për-  
mirësim të vazhdueshëm. Në mesin e veprave të shek.  
XIV të cilat kronistët e vjetër i kanë emërtuar me një term  
si tallës 'kelam-ı mevzun' (fjalë e metruar) ka shumëçka që  
mund të preferohet kundruall poezive të shek. XVI dhe

■  
<sup>42</sup> Şemseddin Sami, *Kamusu'l-A'lam*, "Türk",  
Stamboll, III, 1641.

<sup>43</sup> Po ai, "Şarkta Şiir ve Şuara 3", *Hafta*,  
Stamboll, 5 Dhul-Ka'de 1298, vëll. I, nr. 7, f.  
107.



XVII. Të gjithë poetët e shek. XVI nuk i ngjajnë Nafiut. Nëse lihen anash disa nga poetët e shkrimtarët e shek. XVIII dhe XIX, kjo periudhë mbetet e përbërë nga shumë poetë që kanë shkruar poezi të pakripa.<sup>44</sup>

Në stilin e poezisë së vjetër përgjithësisht nuk shihet ndonjë zhvillim ndër shekuj. Edhe pse mund të vëresh disa poetë që të çojnë të mendosh për ndonjë zhvillim në këtë drejtim, prapëseprapë mund të gjesh shumë raste që dëshmojnë për një ngecje të përgjithshme. Secila periudhë cilësohet me disa gjeni dhe kjo njihet si periudha e tyre, kurse të tjerët shihen si margjina të asaj periudhe dhe nuk merren parasysh. Edhe pse kronikat e Latifiut, Kënallëzades, Salimit e Fatinit janë përplot emra poetësh, mirëpo shek. XVI është shekulli i Bakiut, shek. XVII është shekulli i Nefiut, shek. XVIII është shekulli i Nabiut, shek. XIX është shekulli i Shinasiut, Namik Kemalit dhe Zija Pashës.

Themelet e letërsisë së re janë hedhur nga Shinasiu dhe shokët e tij. Ata e shpëtojnë gjuhën tonë nga artificet e fjalës dhe i hapin rrugë shprehjes së thjeshtë, të bukur e të natyrshme. Kjo është një përmirësim dhe përparim, nuk është ndonjë ndryshim dhe risi rrënjësore. Ndryshimi dhe risia rrënjësore është realizuar në fillim të shek. XX. Ky stil i ri është përhapur dhe zhvilluar përtej masës së pritur. Edhe pse janë paraqitur poetë si Naxhiu që kanë dashur t'i zbulojnë gacat e shuara të Nabiut, Nefiut etj. e t'i tërheqin të rinjtë nga kjo anë, prapëseprapë ky shekull është shekulli i përtëritjes në fushën e poezisë dhe letërsisë, e nuk është ringjallje e stilit të vjetër. Paskëtaj nuk është rritur ndonjë poet i këtij stili. Edhe pse poezitë e poetëve të

■  
<sup>44</sup> Po ai, "Şiir ve Edebiyattaki Teceddüd-i Ahirimiz", *Yeni Türk Edebiyatı Antolojisi III*, (përgat. Mehmet Kapllan dhe të tjerët), Stamboll, 1979, f. 318.



kaluar meritojnë t'i paraqiten popullit si vepra të vjetra, nuk i shkon ndëmend dikujt që ato t'i marrë si mostër.<sup>45</sup>

Samiu thotë që në këto çështje ai e ndjek maturinë dhe se në diskutimet lidhur me letërsinë e vjetër e të re, i vetë-dijshëm se mund të shkaktojë pezëm me përçafimin kaq të ngushtë të stilit të ri në letërsi e poezi, ai shpreh mendimin dhe ndjenjat e tij për faktin se ky stili i ri nuk duhet kuptuar si një pranim i pakusht, por për më tepër si një nevojë për ta pëlqyer atë.<sup>46</sup>

Duhet ruajtur të mos e imitojmë qorrazi Perëndimin, mirëpo edhe nuk duhet qortuar marrja shembull prej tij. Kjo është e natyrshme dhe e domosdoshme. Të shkosh pas e t'i ndjekësh veprat e Perëndimit, i cili si në arsimim ashtu edhe në fushat e tjera të qytetërimit është shumë përpara nesh, a thua vetëm në lëmin e letërsisë është gjë e keqe? A thua vallë nuk i imitojmë ata në çdo punë?... Edhe në Perëndim ka kategori e shkolla të ndryshme nga njëra-tjetra. Secila prej tyre ka moralin, qëndrimin e saj të ndryshëm nga tjetra. Ndërkaq në lëmin e arsimimit e të qytetërimit janë një. Për një popull që dëshiron të qytetërohet e të përparojë nuk ka alternativë tjetër pos t'i bashkëngjitet kësaj "rruge të përbashkët".<sup>47</sup>

Nuk mund të mohohet bukuria e gjuhës sonë dhe lehtësimi i natyrshëm i saj në poezi. Të shpresojmë që tani e tutje letrarët e rinj të shkathët që po rriten ta braktisin imitimimin e poetëve iranianë e t'i drejtohen rrugës së re. Nga ana tjetër, do ta marrin parasysh këshillën e Zija Pashës që, duke e ndjekur më shumë natyrën sesa adetin, do

■  
<sup>45</sup> *Po aty*, f. 318-319.

<sup>46</sup> *Po aty*, f. 320.

<sup>47</sup> *Po aty*, f. 321.

ta zgjedhin rrugën e shkrimit të poezive të natyrshme e të lirshme, në vend të poezive të dhunshme.<sup>48</sup>

Siç mund të shihet, Shemseddin Samiu është një personalitet që është shquar në letërsinë turke me idetë e tij, po aq sa edhe me punimet e tij gjuhësore dhe krijimtarinë letrare. Shemseddin Samiu është bërë një personalitet me rëndësi që brenda jetës ideore të kohës së tij, në veçanti në jetën letrare turke e cila kishte filluar të ndryshonte si pasojë e ndikimit perëndimor, tërheq vëmendjen drejt rrënjëve kombëtare të letërsisë sonë, shtrihet deri te krijimet letrare të kohës së paraislamit dhe shquhet në këto fusha edhe me punimet e tij letrare po edhe me risitë ideore. Me këtë tipar që kishte, ai zinte pozicionin e një risie të moderuar brenda polarizimeve e re - e vjetër dhe brenda polemikave që zhvilloheshin përreth këtyre polarizimeve. Mirëpo, interesimi i tij për të reën nuk e ka penguar të mos lëshohet në rrënjët e letërsisë sonë.

### **Shemseddin Sami literary works and his ideas on literature**

The vast written heritage by Shemseddin Sami could be divided in two parts: his own works as an author, and the translations.

a) Sh. Sami wrote four fiction works, including three plays, and a novel.

1. *Taash-shuk-i Talat ve Fitnet* [The love between Talat and Fitnet] (1873) has a special place in the history of Turkish literature, because it is the first attempt to create

■  
<sup>48</sup> Şemseddin Sami, "Şarkta Şiir ve Şuara 3", *Hafta*, Stamboll, 5 Dhul-Ka'de 1298, vëll. I, nr. 7, f. 108.

in Turkish a novel, based on the elements of the Western style novel.

2. *Besa yahut Abde Vefa* [Pledge of Honor](1874), after the first success on Istanbul stages, was prohibited in 1875, and reappeared only in 1908. According to Niyazi Akı, the plot of the play remembers us the father killing his son in the story *Matteo Falcone* by Prosper Merimée.

3. *Seydi Yahya* (1875) is based on the events in Andalusia, Spain, during the ninth century, at the time of Arab conquests. As a novelty in the play could be quoted the choir having the same role as in ancient Greek tragedies. Traces of influence from *Comte de Monte Cristo* by Alexandre Dumas (père) also are to be noted.

4. *Gave* (1876) is a play with the subject borrowed from 'Şehname' by Firdevsi, a poem considered the national epic in Persian literature.

A common characteristic of dramatic plays by Sami is the struggle between tyranny and justice, with justice finally winning. These plays had an important place in the arts of the time. Two other his plays, *Subrab yahud Ferzendkuş* (Meditator) and *Mezalim-i Endülüs* (Andalusia Disasters) remained unpublished.

b. Translations by Sami from French:

1. *İhtiyar Onbaşı* [Old Corporal] (1873), a tragedy in five acts, is a work of Domanoir and Dennery. 2. *Galatée* (1873), a poetical drama with a mythological subject, written by Claris de Florian, was translated by Sami in the form of a story. 3. *Şeytanın Yadigarları* [Devil's Memories] (1878), an adventure novel by Frederic Soulie. 4. *Sefiller* [Les Misérables] (1880) by Victor Hugo. Sami translated only the half of the novel. 5. *Robinson* (1885) by Daniel de Foe. Sami translated a short version of it in French.

Shemseddin Sami translated a number of other works from Persian and Arab languages.

Parallel to literary works, Sami expressed a number of important ideas on literature and poetry. He represented a new trend in Turkish literary theory, which demanded the abandon of the old style. From this point of view he treated the Arab, Persian, and Turkish literatures, with special attention to their periods before and after the advent of Islam. The most splendid period of the Turkish literature was the time of Timur. Samarkand became the center of poetry. After the establishment of the Ottoman State, there were advances in Turkish language, and a vast Ottoman literature was developed. But already it was the time for a new direction in literary art.



*Akad. Gane Todorovski\**  
*(Maqedoni)*

**IDE TË UNIVERSALE**  
**NË VEPRËN E VËLLEZËRVE**  
**SAMI DHE NAIM FRASHËRI**

---

Të nderuar të pranishëm, e nderuara kryesi e punës,  
Kumtesa ime është titulluar “Idetë universale në veprën e vëllezërve Sami dhe Naim Frashëri”. Këtë para do kohe e kam bërë në një farë marrëveshjeje me organizatorin e këtij tubimi shkencor. Megjithatë që në fillim jam i detyruar t’ju them se unë nuk i takoj rrethit të orientalistëve dhe albanologëve. Përcaktimi im është në hapësirën e gjerë të shkencës, sillet në relacione të tjera. Megjithatë si maqedonist, sllavist dhe në një farë dore si ballkanolog, e kuptova se megjithatë vendi im është këtu, sepse në një mënyrë dhe përmes disa angazhimeve dhe formave të veçanta (personale) më modeste jam përzier në interpretimin e lidhjeve kulturore të popujve të Ballkanit, prandaj po paraqitem si një aktor episodal edhe në këtë ngjarje të madhe kulturore, e cila në situatën tonë kulturore maqedonase i jep, i përshkruan dhe i vë vulën e një nisme impresionuese, të çmuar dhe të rrallë jo aq në ndriçimin e të



\* Anëtar i ASHAM, Shkup

kaluarës, sa hap qasje të gjera racionale për të ardhmen. Jam njëri nga ata që në këtë hapësirë kulturore synojnë ta lëvizin dhe t'i japin kuptim konceptit të multikulturalitetit, andaj edhe idenë e pjesëmarrjes sime shikojeni në këtë plan. Megjithatë pa dyshim, se nuk është hiç keq të dihet se në tingujt e gjuhës maqedonase i kam përcjellë (me ndihmën e miqve, kolegëve dhe bashkëpunëtorëve të mi shqiptarë) bilurët e vargut shqip, që nga koha e rilindjes dhe më vonë, prandaj kam hyrë në këto obligime që t'i shpjegoj personalitetet, veprat, ngjarjet dhe proceset e së kaluarës kulturore maqedonase dhe shqiptare dhe t'i komentoj afërsitë e dallimet e specifikave të tyre.

Edhe diçka, sa për të thënë, ideja e kësaj përzierje timen ndërmjet jush, të dashur dhe të respektuar kolegë të shkencës dhe të artit, kuptojeni dhe pranojeni edhe si pjesë të aktivitetit tim (si lexues dhe përkthyes) që nga vitit 2004, në të cilën dy obligime më lidhën dhe më afruan deri të pranimit të konceptit literaturë shqiptare: angazhimi (bashkë me Luan Starovën) për përkthimin e poetëve shqiptarë për një shtëpi botuese nga Athina, e cila do t'i paraqesë poetët shqiptarë në një zgjedhje antologjike. Kam përkthyer edhe shumë vjersha nga Jeronim de Rada, Naim Frashëri (pikërisht nga ai), Gjergj Fishta, Fan Noli, Lasgush Poradeci, Migjeni, Martin Camaj, Fatos Arapi, Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Azem Shkreli, Ali Podrimja dhe Xhevahir Spahiu. Ky kontribut, kujtoj, se ma ka hapur rrugën që sot të jem në mesin tuaj: dhe, e dyta, me çka dua të lavdërohem, është mahnitja ime pas leximit të librit të mrekullueshëm të kolegut Ali Aliu "Don Kihot me|u albancite" (Shkup, botimi i shtëpisë botuese "Kultura", 2004) në të cilën përmes tetë kapitujve të ndarë radhiten përpjekjet e tetë emrave të krijuesve të letërsisë shqipe të shekujve XIX dhe XX (Jeronim de Rada, Naim Frashëri, Fan Noli, Faik Konica, Lasgush

Poradeci, Ismail Kadare, Ali Podrimja dhe Luan Starova). Me këtë më duket është e shpjegueshme nga pak prania ime këtu.

Mbase kjo hyrje imja ishte pak më e gjatë, më e gjatë, por sigurisht e pashmangshme...

Sipas kësaj, pa marrë parasysh sa janë të thella njohuritë e mia për proceset e letërsisë shqipe në dy shekujt e kaluar (XIX dhe XX), duke u bazuar në librat, të botuar në gjuhën maqedonase (Luan Starova – "Relacii" (*Relacione*) dhe Ali Aliu "Don Kihot me|u albancite" (*Don Kishoti te shqiptarët*)), jam inkurajuar që publikisht të shprehem për fenomenin e letërsisë shqipe jo aq si studiues i saj, si një super-studiues i saj, si një ekspert burimor i studimeve, por kryesisht si një respektues i saj, si një kureshtar i artit poetik dhe si një ndjekës i pasionuar i kulturologjisë, në rastin tonë në kontekst të asaj që e kanë dhënë vëllezërit Sami dhe Naim Frashëri. Meqë opusi i tyre shkencor dhe letrar është i lidhur me gjerësinë e ideve universale që e kanë lëvizur njerëzimin, prandaj në një mënyrë të veçantë, si një formular, si paradigmë, si nxitje specifike, reflektohen edhe në aktualitetin tonë mbi etapat dhe kahet zhvilluese të letërsisë maqedonase, e cila akoma ka implikime të afërta, të ngjashme dhe të barazuara.

Tre vëllezërit: Abdyl, Sami dhe Naim Frashëri, janë dalluar si emra të mëdhenj të rilindjes shqiptare, emra eminentë dhe kryesorë të politikës, shkencës dhe letërsisë, prijës të proceseve të rilindjes shqiptare. Specifika e rilindjes shqiptare aq më tepër është interesante për shpjegim edhe të logjikës së zhvillimit të vonshëm të lëvizjes së popullit maqedonas drejt lirisë, andaj më duket se me një ndriçim më të thelluar dhe sistematik të zanafillës së idesë nacionale në kushte të një trysnie të madhe të penguesve – faktorit politik turk dhe faktorit shpirtëror grek.



Nga kjo duket se ka vend që t'i krahasojmë, së paku në këtë çast solemn, tre vëllezërit Frashëri me kuptimin, madhështinë, kontributet e tre veprimtarëve të rilindjes maqedonase, vëllezërit struganë Milladinov – Dimitar, Naum dhe Konstantin, si shembuj për krahasim dhe ndjekje, pa marrë parasysh asinkroninë e paraqitjes së tyre. Drejt këtyre angazhimeve vepron edhe i nderuari Ali Aliu në librin e tij “Don Kishoti te shqiptarët”, sepse koncepti i rilindjes shqiptare promovon procese që edhe për zhvillimin e idesë nacionale maqedonase, siç thamë, është në një mënyrë specifike – e vonuar dhe e penguar me barriera të ngjashme politike dhe shpirtërore, njeh një lloj të specifik të aritmisë, diskontinuitetit, shtypjeve dhe trysnive.

Sigurisht nuk do të ishte huqje një studim krahasimtar i ngjashmërive në zhvillimin krijues të Naim Frashërit dhe Grigor Përliçevit (të dy janë përkthyes të Homerit në gjuhën shqipe, respektivisht në gjuhën maqedonase ose gjuhën pansllave). Me të drejtë do të konstatojë Ali Aliu në librin e tij “Don Kishoti te shqiptarët” (shih faqet 58-61) se koordinatat poetike të Naim Frashërit dalin nga Ballkani i ngushtë, duke u zgjeruar ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit të përvojës dhe mendimit njerëzor. Por, me këtë rast vlen të përmendet një diskualifikues i rëndësishëm në proceset e rilindjes maqedonase edhe te mendimtarët shumë të dalluar (D. Milladinov, Grigor Përliçev, R. Zhinzifov) – distanca nga prekja e frytshme me ndikimet e dukshme të letërsisë dhe gjuhës turke e persiane.

Studiuesit e nesërm të Naim Frashërit dhe Grigor Përliçevit nga radhët e albanologëve maqedonas dhe nga radhët e maqedonistëve shqiptarë, pasi t'i zbulojnë dimensionet ballkanike të të dy poetëve dhe veprimtarinë e tyre në më shumë qendra kulturore gjatë shekullit XIX – Konstantinopojë, Athinë, Bukuresht, Selanik, Tiranë, do ta kuptojnë se rilindja shqiptare i ka dhënë shtytje rilindjes



maqedonase jo vetëm me vite, vepra dhe autorë të shpërndarë nëpër hapësirat euro-aziatike, por edhe për nga kuptimi i tejkalimit të debatit për fenë dhe të ndarjes së faktorit gjuhë në sinonim të përcaktimit nacional. Ky formular, kjo paradigmë e përfshirjes së rilindjes shqiptare drejt universit, ky praktikum gjenerues i idesë nacionale, edhe shumë kohë do të mungojë nga koncepti maqedonas i rilindjes. Mjafton ta kujtojmë korigjimin e Misirkovit për Ilindenit, kah fundi i 1903-tës, i cili ideologëve të kryengritjes me urtësi ua tërhoqi vërejtjen se liria arrihet edhe me libër, e jo vetëm me pushkë!

Ne, maqedonasit, e dimë se edhe një tipar tjetër i ndërlihd cilësitë tipologjike të dy letërsive tona – shqiptares dhe maqedonases; fillimet e tyre, gjegjësisht të ashtuquajturat etapat rilindëse zhvillohet kryesisht jashtë shtetit amë. Këto qendra janë zhvendosur jashtë vatrave të vendlindjes. Kështu ndodh me vëllezërit Milladinov, me R.Zhinzifovin, G.Përliçevin, M.Cepenkovin, K.Shapkarevin dhe shumë të tjerë. Kështu ngjet edhe me Jeronim de Radën, Fan Nolin, Ndre Mjedën, Andon Zako Çajupin, Asdrenin, Migjenin, Poradecin. Megjithatë kjo është një ko incidencë e rastësishme e më shumë letërsive ballkanike. Por, tash, shembulli i vëllezërve Sami dhe Naim Frashëri na shpie drejt konstatimit se kjo specifikë e shpjegon barrën e fatit tjetër të tyre – ata vazhdimisht ishin në lëvizje, si thuhet, njerëz me dy ose tre vendbanime, që flet edhe për fenomenin e tyre dygjuhësor dhe tregjuhësor. Në rastin e vëllezërve Frashëri kjo është gjuha persiane dhe turke, ndërsa te rilindësit maqedonas – greqishtja, rusishtja, bullgarishtja dhe serbishtja. Prej Përliçevit deri te Racini kjo dysi te shkrimtarët maqedonas është një tipar i përbashkët. Autorët shqiptarë, mes tyre edhe Sami dhe Naim Frashëri, e praktikojnë bilinguizmin dhe polilinguizmin pozitiv dhe negativ.

Këto pikëpamje fillestare hapin rrugën ose qasjet e gjera drejt studimeve të nevojshme dhe sigurisht të pasura krahasimtare, përmes të cilave kombet fqinje duhet t'i shpje-gojnë normat e bashkëjetesës së tyre.

Ja ku është ideja e inkuadrimit tonë në temën bujare për veprën e Sami dhe Naim Frashërit. Do të përsëris: ia lejo-va vetes këtë guxim që të përzihem në mesin e dijetarëve, por vetëm në rolin e një konsumatori maqedonas të vlera-ve të veprës së tyre epokale, gjithnjë i vetëdijshëm se me këtë e përcaktoj pozitën time të njeriut që e do Ballkanin. Paraqitja ime ishte edhe një përpjekje që një thërrmijë të lavdërohem se e kam përcjellë mendimin e Naim Frashë-rit në gjuhën maqedonase. Do ta them edhe këtë, se kjo përpjekje nuk është për t'u nënçmuar, sepse të përcjella në tingullin maqedonas, vargjet e Naim Frashërit (të bo-tuara në librin tim "Neka se rodi -ovek" (Le të lindë njeriu), Shkup, 1993) e kanë ngritur në një nivel më të lartë artistik dhe në mbifuqi dhe prestigj të lakmueshëm qëndrueshmërinë e fjalës së lidhur ose të bukur maqedonase.

Fjala poetike e Naim Frashërit, e përshtatur në tingëlli-mën maqedonase, u imponua me gjithë elegancën e saj të mendimit modern dhe me shtrirjen e gamës së madhe të emocioneve si formë e kompensimit mbireal të asaj të pa-arriture të bukurisë mendore dhe emocionale, që njeriut të Ballkanit ia mihte plagë në kompleksin e prapambetjes, vonesës dhe letërsisë së demoduar popullore (bitova). Kjo si duket i ka shkuar për dore edhe Naim Frashërit, që për-mes gjuhës qumështore amtare, përmes shpirtit dhe zërit, t'ia hapë këtë shqiptarit, t'ia shqiptarizojë edhe gëzimin edhe pikëllimin, edhe vajin edhe frymëmarrjen dhe t'u japë aromë, ngjyrë dhe tingull shqisave nacionale. Pra, mund të themi se Naim Frashëri ia arriti që ta deshifrojë frymëmarrjen e shpirtit maqedonas, duke e shndërruar në

fjalë të kuptueshme. Dhe, pikërisht këtu është vendi ku duhet të shtohet mendimi – përfundimi: Sami dhe Naim Frashëri janë koncepte komplementare të një vepre historike, e pakalueshme për nga kuptimi.

Neve, maqedonase, kjo na duhet shumë që marrim mësim nga praktikumi i menduar dhe racional i rilindjes shqiptare. Prej kësaj do ta nxjerrim edhe pozitën tonë të stabilitetit nacional dhe do ta rregullojmë në nivel të lakmueshëm dijen e vetërespektit. Mos të harrojmë se në këso ide ftonte edhe Grigor Përliçevi. Neve na nevojitet respekt për shqiptarësinë.

### **Universal ideas in the work of Frasheri brothers Sami and Naim**

The literary and scientific works by brothers Frasheri are penetrated with universal ideas promoting humankind, and as a consequence in the form of a paradigm they also have a reflection on the trends of the development of the Macedonian literature. There are many similarities and common features to be noted. In this meaning there is place for a comparison with three Macedonian activists of the Macedonian Renaissance, Milladinov brothers - Dimitar, Naum, and Konstantin. It doesn't mean that we forget that we have to do with asynchronous phenomena.

Another meaningful comparison could be made between the creative development of Naim Frasheri and Grigor Perlichev, both translators of Homer in their respective languages. The Albanian Renaissance was a source of stimuli for the Macedonian Renaissance with the authors and works scattered in Euro-Asian spaces, and particularly with the overcoming of the debate on religion and language as a way to achieve the national identification. There is another common typological characteristic connecting the Albanian and

the Macedonian literatures. It is their development in the early stage of the Renaissance outside their homeland. Considering the rationale and the practice of the Albanian Renaissance, we could better understand our position of the national stability, and we could learn more on the self-respect. To this ideas called us Grigor Perlichev.



**Matteo Mandalà\***  
(Itali)

**STRUKTURAT E RRËFIMIT**  
**NË DRAMËN "BESA" TË SAMI FRASHËRIT**

---

**1.- Hyrje**

1.1.— E shkruar turqisht më 1874 dhe e botuar më 1875 në Stamboll, ku u shfaq për herë të parë më 25 mars 1875, drama *Besa ose mbajtja e fjalës së dhënë* e Sami Frashërit<sup>49</sup> është ndër të parat vepra të letërsisë shqipe, që trajton temën e *besës* në të gjitha aspektet e saj të ndërlikuara morale e psikologjike. *Besa* ose “mbajtja e fjalës së dhënë”, njihet sidomos si një nga institucionet më të rëndësishme juridike të përfshira në *Kanunin e Lekë Dukagjinit*, korpusi doktrinar i të cilit u mbledh nga Shtjefën Gjeçovi dhe u publikua prej tij më 1933, pas shumë vitesh kërkimi, në një botim që mbetet shembullor. Kohët e fundit ky material i pasuruar

■

\* "Universiteti i Palermos", Palermo

<sup>49</sup> Shih S. Frashëri, *Besa ose mbajtja e fjalës së dhënë*, Dramë me gjashtë pamje, Istanbul, 1292 (1875). Njihen botime të ndryshme të dramës në shqip: më 1901 u përkthye nga Abdyl Ypi, e më pas nga Vexhi Buharaja e nga Shaban Çollaku. Këtu do të mbajmë parasysh këtë version të fundit, sipas botimit që doli në S. Frashëri, *Vepra*, vëll. I, Tiranë, 1988, f. 19-95.

me plotësime të reja dhe me shënime të shumta shpjeguese doli me titullin *E drejta zakonore shqiptare*<sup>50</sup>.

1.2.— Me *besën* nuk janë marrë vetëm juristët, studimet e të cilëve mbeten themelore për të kuptuar vlerën e saktë juridike e morale të saj. Studiues të ndryshëm që kanë kryer kërkime të vlefshme në fushat e disiplinave përkatëse, duke filluar nga udhëtarët që patën mundësi të vizitonin Shqipërinë në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të kaluar, deri te gjuhëtarët, etnografët, historianët, specialistët e folklorit dhe, natyrisht, kritikët e letërsisë, kanë analizuar më tej aspektet dhe ndërlikimet e kësaj të drejte zakonore antike. Natyrisht *besa*, falë forcës së saj të madhe sugjestionuese si një normë e respektuar dhe e praktikuar rreptësisht dhe rrënjosjes së jashtëzakonshme shekullore që ka gjetur, dhe akoma gjen, ndër shqiptarët, veçanërisht ndër malësorët, është bërë një burim i pashtershëm frymëzimi për shumë shkrimtarë e poetë. Në fakt, të gjitha rrymat e letërsisë mbarëshqiptare, arbëreshe dhe shqiptare, të shekujve të kaluar dhe të sotme, janë përpjekur të mishërojnë një paraqitje letrare që në mënyra të ndryshme thellohet në domethënien dhe rolin që *besa*, njëlloj dhe ndoshta më shumë se zakonet e tjera të ngjashme, ka pasur në formimin e universit të ndërlikuar kulturor shqiptar.

■  
<sup>50</sup> Citimet tona janë nxjerrë nga *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, mbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefën K. Gjeçovi, Tiranë, 1989. Botimi i parë i Kanunit është i vitit 1933 (Sh. Gjeçov, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shkodër, 1933).

1.3.— Në një studim timin të mëparshëm<sup>51</sup>, jam përpjekur të thellohem në arsyet që kanë përcaktuar një interesim kaq të madh të poetëve, shkrimtarëve dhe dramaturgëve, duke u mbështetur në origjinën etimologjike të fjalës, duke analizuar vlerat e saj semantike në raport me ato të njohura në gjuhët e tjera, duke vënë në dukje faktet historikisht të vërtetuara në të cilat ajo është praktikuar, duke rikërkuar në veprat letrare qëllimet, format, pikëpamjet nëpërmjet të cilave ajo është paraqitur. Synimi kryesor i këtij punimi është të dallojë dhe të shpjegojë, duke nisur nga strukturimi i veçantë i raporteve të kundërtave të bashkëlidhura në konceptin e *besës*, mekanizmin e funksionimit të premisave rrëfyese të pranishme në veprat e ndryshme letrare që e ndërtonin fabulën e tyre pikërisht mbi “fjalën e dhënë”. Prej tij është shkëputur një pjesë që, në një kreshendo kushtesh të sakta e të ndërlikuara të rrëfimit, njihete në *Besën* e Sami Frashërit një nga veprat më të arrira në planin semiologjik. Megjithatë, në një pikë që lidhet me çështjen e gjinisë letrare, trajtuar me mprehtësi edhe nga vetë Frashëri në *Parathënien* e dramës së tij, nuk munda të thellohem, sepse do të kisha tejkaluar kufijtë dhe natyrën e këtij punimi tim të rinisë.

Është fjala për një aspekt që jo vetëm nuk është i dorës së dytë në raport me temën qendrore të motivit të *besës* në letërsinë shqipe, por i vështruar në optikën e një analize ndërtekstore, mund të ndihmojë shumë për të kuptuar zanafillën e formave dhe të gjinive letrare, si tregimi i shkur-



<sup>51</sup> M. Mandalà, “Sul motivo della besa nella letteratura albanese”, in *Gli Albanesi d’Italia e la “Rilindja” Albanese. Linguistica, letteratura, storia, folklore: Il contributo degli Albanesi d’Italia*, Atti del XVII Congresso Internazionale di Studi Albanesi, a cura di A. Guzzetta, Palermo, 1993, f. 151-189.



tër dhe romani, që historikisht nuk ishin afirmuar akoma në rrethin e letërsisë shqipe. Nga kjo pikëpamje, botimi i dramës së Frashërit shënon një vijëndarëse brenda historisë së gjinive të letërsisë shqipe dhe një pikënisje objektive për lindjen dhe zhvillimin e asaj gjinie letrare që bazohet mbi prozën e shkurtër (tregimin) dhe prozën e gjatë (romanin).

Nuk është e rastit që kush i ka kushtuar një vepër *besës, përpara* publikimit të dramës së Frashërit – letërsia gojore dhe Zef Skiroi, për shembull<sup>52</sup> –, ka shfrytëzuar gjinitë letrare në vargje; po kështu nuk është rastësi që kush u përqendrua përsëri mbi të njëjtin motiv *pas* vitit 1875 – paradigma të shkëlqyera rrëfyese janë novela *Gjaku* e Ernest Koliqit<sup>53</sup> dhe dy romanet *Kush e solli Doruntinën?* e *Prilli i thyer* të Ismail Kadaresë –, nuk ka mundur të mos e konsiderojë si një subjekt *topos* me ato ndryshime të gjendjes tipike për romanin, pikërisht të asaj gjinie letrare evropiane, origjinën e së cilës M. Bachtin<sup>54</sup>, në mënyrë gjeniale dhe

■

<sup>52</sup> Të vetmin përjashtim që njohim e përbën *Alessio Ducagino*, që shkrimtari arbëresh Francesco Antonio Santori e imagjinoi në formën e një melodrame. Megjithatë, edhe pse u krijua pas vitit 1855 e para vitit 1860, sipas hipotezës së ngritur nga Francesco Solano, melodrama santoriane mbeti e pabotuar, çka lejon ta përjashtojmë si fond të mundshëm ndikimi. Shih. F. Antonio Santori, *Alessio Ducagino, melodramma*, a cura di F. Solano, *Radhonjtë e Zjarrit*, Castrovillari, 1983.

<sup>53</sup> Shih E. Koliqi, "Gjaku" in *Hija e maleve*, Zara, 1929, f. 21-64.


<sup>54</sup> Shih M. Bachtin, "Formy vremeni i chronotopa v romane, in *Voprosy literatury i estetiki*, Izdatel'stvo «Chudožestevennaja literatura», Moskva, 1975 (tr. it. "Le forme del tempo e del cronotopo nel romanzo" in *Estetica e romanzo*, Einaudi, Torino, 1979, f. 231-405).



absolutisht novatore, e gjen në evoluimin e idilit familjar, ngjashmëria diexhetike e të cilit me teatrin është hulumtuar, në mënyrë jo më pak gjeniale, nga C. Segre-ja<sup>55</sup>.


## 2.– Tregim a teatër ? Zgjedhja e Sami Frashërit

2.1.– Të dy tipat e komunikimit letrar që u përgjigjen formave të teatrit dhe të romanit, paraqesin në mënyrë të qartë dallime të shumta, disa stilistiko-gjuhësore, të tjerat strukturore e formale. Në dy skemat e mëposhtme, të krijuara nga Segre-ja, e para



riprodhon strukturën diexhetike tipike të romanit, e dyta

■  
<sup>55</sup> Shih C. Segre, *Teatro e romanzo. Due tipi di comunicazione letteraria*, Einaudi, Torino, 1984, në veçanti kapitullin e dytë ("Narratologia e teatro", f. 15-26), të pestë ("Quello che Bachtin non ha detto. Le origini medievali del romanzo", f. 61-84), të gjashtë ("Punto di vista e polifonia nell'analisi narratologica", f. 85-102) dhe të shtatë ("Intertestualità e interdiscorsività nel romanzo e nella poesia", f. 103-118).



atë të teatrit. Dallimi është mjaft i dukshëm meqë në komunikimin teatror, shpjegon Segre-ja, eliminohet «ndërmjetësimi nga UNË treguesi o personazhi tregues. Teksti përbëhet kryesisht nga thëniet e personazheve të ndryshme, që mund të kuptohen në formë diexhetike, (AI i treguar), tregim i fakteve të jashtme për skenën. Pra UNË është vendosur mbi AI, ndërsa në tregim AI është vendosur mbi UNË. Raporti UNË dhënës e Ti marrës është fshehur, por është i mundur – kryesisht në prologët dhe epilogët, në koret dhe në *a parte* – një raport i drejtpërdrejtë midis UNË personazh e Ti marrës (publik)».

2.2.– Përfundimi i analizës së Segre-së është i pranueshëm po t'i shtojmë elementin e tretë, atë tredimensional, pamor, që në teatër ndërvepron nëpërmjet UNË e Ti dhe në roman i besohet tërësisht aftësisë së Ti për të përpunuar dhe, në një farë mase, për të rikrijuar mbi bazën e një ripasqyrimi fantastik, pra subjektiv, elementin që mungon. Kjo konsideratë e fundit, e studiuar nga teoritë semiotike të gjeneratës së re, mbështetet në faktin që *lexuesi* i romanit është thelbësisht i ndryshëm nga *lexuesi* i shfaqjeve audiovizive, është më pak i dukshëm se homologu i tij shfrytëzues i veprave kinematografike, televizive e pra edhe teatrale. Është për këtë arsye që horizonti i marrjes së të parit shfaq një hiat të dukshëm në momentin kur *lexuesi* i një teksti vihet përpara paraqitjes tridimensionale të të njëjtit tekst. Mund të thuhet se edhe *teksti* teatral, para

se të shfaqet, ruan forcën komunikuese të romanit, por me kohë paraqit, në sytë e *lexuesit*, të njëjtin kufizim komunikativ që herë herë dallohet në tekstin e romanit.

2.3.— Kjo hyrje është e rëndësishme për të kuptuar plotësisht arsyet që e shtynë Sami Frashërin të zgjidhte teatrin në disfavor të tregimit:

«Që kaq kohe ma pati pushtuar imagjinatën ideja që të shkruaja një pjesë teatrale, në të cilën të viheshin në pah disa virtyte e zakone të popullit shqiptar. Dhe kjo, jo sepse isha bir i këtij populli, por sepse të ky kisha vënë re disa virtyte burrërore e të larta, të denja për skenë, siç ishin dashuria për atdhe, shpirti i sakrificës, besa dhe fakti që ata nuk e kishin për gjë jetën. Mirëpo midis kërkesave për një pjesë teatrale dhe aftësisë sime, ishte një hendek shumë i gjerë. Prandaj njëherë pata vendosur që këtij qëllimi t'ia arrija nëpërmjet ndonjë tregimi. Mirëpo tregimi mbetet vetëm në mëndjen e lexuesve (dhe mbetet si diçka abstrakte). Prandaj mendova se, meqë pjesa teatrale ia paraqet të gjallë ngjarjen publikut, ndikimi i saj në çështjen e edukimit, që është qëllimi i vetëm i kaq e kaq veprave letrare, do të ishte më i fuqishëm se ai i tregimit. Sakaq, përballë paaftësisë sime vura diletantizmin e teatrit tonë dhe mora zemër, sepse pata parasysh se veprat që ishin shkruar për vlerat shpirtërore të popullit tonë numëroheshin me majat e gishtërinjve dhe se repertori i teatrit tonë kufizohej vetëm në disa përkthime veprash mbi zakonet e të huajve, të cilat deri diku ishin në kundërvështim me ato të popullit tonë dhe ngandonjëherë edhe të dëmshme. Dhe atëherë vendosa që të shkruaja një pjesë teatrale mbi virtytet dhe traditat e popullit shqiptar»<sup>56</sup>.

■


<sup>56</sup> S. Frashëri, "Parathënie", në *Besa*, cit., f. 21.

Motivimi i Frashërit është elokuent e shumë domethënës, sidomos po të kihet parasysh si fakt që paraprin një prej parimeve bazë të orientimeve aktuale të analizës semiologjike të modeleve më të përhapura të komunikimit letrar. Teatri, në sytë e një intelektualit të madh shqiptar të gjysmës së dytë të shekullit XIX, dukej më i efektshëm për perspektivën komunikative të dhënësit, sepse mesazhi i tij do të linte gjurmë më të thellë në përfytyrimin e marrësit. Është fjala për një intuitë të jashtëzakonshme që, ndër të tjera, nuk përlligjte zhvillimin e pamjaftueshëm të krijimeve teatrale, por edhe si rezultat i një refleksioni kritik të bërë me saktësi e, madje, jo pak të dhimbshëm. Paraqitja e një motivi që përmbledhonte «disa virtyte e zakone të popullit shqiptar» e, veçanërisht, ato që lidheshin me *besën*, nuk ishte një veprim që kufizohej vetëm në zgjedhjen e sistemit komunikativ, gjë që ishte e qartë për Sami Frashërin, sepse nga pikëpamja e modelit tregues të nënkuptuar në koceptin “shqiptar” të *fjalës së dhënë* ishte i nevojshëm, i domosdoshëm, i kushtëzuar zbatimi i një tipologjie diexhetike mjaft të saktë e, madje, mjaft të kodifikuar në planin logjiko-formal.



### 3.– Modeli tregues i *besës*: një rreth diexhetik i mbyllur

3.1.– Nga studimet etimologjike për fjalën *besa* dhe për vlerat e saj semantike dalin dy koncepte që mund t'i përmbledhim kështu: 1) është fjala për një akt në të cilin “premtimi” shoqërohet detyrimisht me “zbatimin konkret” të tij; 2) “detyrimi” është një kusht i nënkuptuar për subjektin e interesuar për rivendosjen e nderit të tij. Duke qenë normë zakonore, *besa*, si “fjalë e dhënë, premtim, besnikëri, armëpushim, marrëveshje”, hyn në një skemë logjike që udhëhiqet nga ligje të përcaktuara morale, të cilat kërkojnë gjithnjë një veprim të detyruar nga ana e subjektit të lidhur me *besë*. Ky karakter i detyruar i veprimit ka gjithnjë një zhvillim vertikal nëpërmjet një serie aktesh të njëpasnjëshme, që mund të arrijnë në dy përfundime: tek *nderja*, pra tek “nderi, tek prestigji shoqëror i rifituar”, kur pikësnyimi i *besës* arrin realizimin e tij konkret objektiv; tek një përfundim i kundërt me të parin, pra tek *pa-nderja*, tek “çnderimi, tek turpërimi shoqëror”, në rastin kur ky pikësnyim nuk arrihet. Procesi që shpie nga *besa* tek *nderja* ndahet nga një moment ndërmjetës që sanksionon realizimin efektiv të së parës dhe përlligj rinjohjen e së dytës: *burrisë*, që është shfaqje e “guximit, e vlerës shoqërore” të atij që, duke mbajtur *besën*, e meriton *nderjen*. Shfaqja e *burrisë* në përgjithësi përkon me një gjendje tjetër juridike, me *gjakmarrjen*, ose me “hakmarrjen”, që përben gjendjen e mungesës fillestare nga e cila buron *besa*. Duke transferuar këto koncepte nga sfera juridiko-morale në një model tregues të rregulluar nga struktura semiotike, është e mundur të skematizohet kështu mekanizmi diexhetik që *besa* vë në lëvizje:



funksionet aktanciale (a, b, c) ndërthuren reciprokisht, duke formuar një cikël tregues [A], që në vetvete është i përfunduar. Ndërkaq, struktura bërthamore e tregimit, bazuar në një seri sekuencash elementare që ndërlikohen logjikisht [nëse (a), atëherë (b), e nëse (b) atëherë (c)] nuk mund të shmanget nga vijimësitë vertikale, që e detyrojnë ligjërimin tregues të mos dalë jashtë skemës së përgjithshme logjike  $\alpha$ .

3.2.— Vlera e *marrëveshjes* që merr *besa* në raport me situatat tip të tregimit, supozon një gjendje mungese fillestare mbi të cilën bazohet i gjithë programi tregues: vijojnë në fakt *prova, kapërcimi* i saj e *arritja e qëllimit*, që mbyllin perspektivën rrëfyese të përcaktuar vërtet lirisht nga tregimtari për tregimin dhe për vepruesit e tij, por gjithnjë duke respektuar besnikërisht ndërlikimin logjik të përmendur më sipër. Një statut i programit tregues të qendëruar në motivin e besës do të karakterizohet në fakt nga një perspektivë e qartë treguese: të rivendoset ekuilibri fillimisht i prishur nga gjendja e mungesës nëpërmjet një procesi që, duke filluar nga një *përmirësim për t'u arritur* duhet të mbërijë në plotësimin e *përmirësimit të arritur*. Kështu që, kur tregimtari vendos të paraqitë *besën* si bërthamë treguese qendrore, mund të gëzojë një liri zgjedhjeje që ndikon vetëm mbi nivelin semantik sipërfaqësor, por jo mbi strukturat e thella që rregullojnë mekanizmat e dy vijimësive vertikale [1: (a) → (b) e 2: (b) → (c)]. Nga ky statut disiplinohen edhe sjelljet e vepruesve, që natyrisht do të lëvizin gjatë


një rrugë të përcaktuar treguese, e cila nuk parashikon ndonjë shmangie që lidhet me veprimet dhe sjelljet e kërkuesit nga cilido cikël tregues i *besës*.

3.2.1.— Zbatime koherente të këtij modeli tregues gjenden në letërsinë gojore: për shembull, në dy baladat *Kostandini i vogël* e *Kostandini dhe Doruntina*, struktura diexhetike e bazuar mbi një sekuencë të vetme, ndjek mekanikisht vijimësinë vertikale të parshikuar [(a) → (b) → (c)], duke mos e lejuar tregimtarin të ushtrojë lirinë e tij krijuese. Në të dyja baladat, heroi ndërmerret një veprim që nga (a) i lejon të arrijë në (c), por vetëm pas mënjanimit të pengesës së pranishme në (b). “Udhëtimi” i heroit (nga lufta në paqe; nga vdekja në jetë) përfaqëson provën që duhet kaluar për rivendosjen e ekuilibrit fillestar; kjo arrihet nëpërmjet realizimit të “premtimit” të heroit, pa të cilin i gjithë cikli tregues nuk do të kishte kuptim as logjik, as brendor. Tregimtari, o më mirë, këngëtar i popullor është këtu i kushtëzuar nga modeli tregues dhe nuk mund ta shtjellojë tregimin sipas një perspektive diexhetike të ndryshme nga ajo e parashikuar në skemë, çka mund të mos ndodhë natyrisht nëse *besa* nuk është motiv qendror i episodit tregues.

3.3.— Rasti i vetëm i shmangies jepet nga mungesa e mundshme e kalimit [(a) → (b)], i vetmi që orienton epilogun drejt një synimi të kundërt nga ai i parashikuar, duke lejuar kështu një lidhje të brendshme të ndryshme të sekuencës bërthamore. Kjo ndodh kur subjekti i lidhur me *besë* nuk e kalon *provën*, nuk e ushtron *burrinë*, që është momenti i aktualizimit të *besës*, duke mos lejuar realizimin e saj dhe duke shkaktuar mosnjohjen e *nderjes*, falë reagimit shoqëror që e damkos subjektin me “paburrëri, çnderim shoqëror”. Por ky rast i “lirisë treguese” (tregimtari mund të zgjedhë lirisht nëse do ta bëjë heroin ta kalojë apo jo *provën*), vë në diskutim vërtetësinë e vlerës morale të *besës*, e cila, duke qenë se duhet të paraqitet domos-



doshmërisht gjatë kalimit ndërmjetës që është *burria*, paraqit në (a) dykuptimësinë e mëposhtme:




ajo që në këtë sekuencë duket fillimisht si një përmirësim për t'u arritur i dalluar nga një shenjë pozitive, në të vërtetë nuk është e tillë, sepse, duke ndjekur vijimësinë vertikale, kalimi nga *besa* te *pa-nderja*, bashkëmbart, së pari, mundësinë e arritjes së *nderjes* dhe kalimin pasues drejt një përfundimi të kundërt nga ai që kërkohet prej zbatimit korrekt të *besës*; së dyti *pa-nderja*, si efekt i procesit që ndeshet me përmirësimin për t'u arritur, e drejton *besën* në një funksion të kundërt, pikërisht te *pa-besa*. Në të vërtetë, lidhjet horizontale janë të tilla që nuk lejojnë as barazi logjike, as brendore midis semave në kundërvënie, si *besa* vs. *pa-besa* e *nderja* vs. *pa-nderja*. Kështu, (a) duhet të ndiqet – në vijimësi vertikale domosdoshmërisht brenda [1] – nga (b) e (c); dhe, meqë vijimësia treguese në [1] nuk vertikalizohet, por pëson një devijim drejt semës së kundërt, që për lehtësi e kemi paraqitur me një kolonë të sajuar [2], përkatësisht me segmentin (b), kalimi pasues në [3] (c) shpjegon se si kalimi në [1] nga (a) në (b) fsheh në të vërtetë një mashtrim, një *escamotage* treguese, sikur fillimi i procesit diexhetik të jetë segmenti i fillimit i vendosur në [3] (a). Duket, ndër të tjera që [3] do të ishte tautologjike, dhe thelbësisht pa efekt, prania e [2] (b), meqë vijimësia e mundshme e [3] (a) në [2] (b) është tashmë e nënkuptuar në kundërvënien *besa* vs. *pa-besa*. [2] (b) pra është rrjedhim



i një vijimësie treguese vertikale, por e tërthortë ndaj asaj që analizohet në skemën  $\alpha$ . Kjo tregon që “liria treguese” fillestare nuk është vërtet e tillë dhe që, edhe në këtë rast, për tregimtarin nuk ka asnjë mundësi ndërhyrjeje: *besa* o mbahet o nuk mbahet dhe... *tertium non datur*.


3.3.1.— Shembuj të zbatimit të këtij modeli “devijues” në letërsinë shqipe gjenden në baladën *Kështjella e Rozafatit* dhe në melodramën *Alessio Dukagjini* të Santorit. Në të parën *besa* krijon një zhvillim tregues të dyfishtë: nga njëra anë, shihet si protagonist një veprues (vëllai i vogël) që arrin qëllimin duke treguar vlerën e vet dhe duke respektuar marrëveshjen; nga ana tjetër, përjashtohen vepruesit e tjerë (dy vëllëzërit e mëdhenj) nga arritja e qëllimit për shkak të paaftësisë së tyre për të përballuar provën e për të zbatuar kështu marrëveshjen. Në të dyja zhvillimet tregimtari duhet të respektojë strukturën formale të ilustruar në skemën  $\alpha$ , me variantin e studiuar në skemën  $\beta$ , pra të provës së pakaluar për shkak të pranisë së *pa-besës*. Një zhvillim të ngjashëm ndjek edhe sekuenca treguese e veprës santoriane, në të cilën kundërvënja *besa* vs. *pa-besa* zgjidhet në të mirë të semës së shënuar negativisht: vijimësia kryhet duke zhvendosur tërthorazi funksionet treguese [1]  $\rightarrow$  [2]  $\rightarrow$  [3]. Kjo tregon që, në fund të fundit, *besa* e Alessio-s ishte kështu një *pa-besë*, o më mirë, që realizimi i *besës* së tij ishte domosdoshmërisht i kushtëzuar nga mashtrimi. Kjo del qartë nga skema e mëposhtme



në të cilën paraqiten dy sekuenca treguese bërthamore, që zhvillohen paralelisht sipas një perspektive treguese, e cila i përplas dy vepruesit, duke ndjekur drejtime të ndryshme, njëri nga lart poshtë (Zaccaria), tjetri nga poshtë lart (Alessio). Me një fjalë, funksionet aktanciale ndjekin vijimësi treguese të ngurta, duke gjetur një kontakt domethënës vetëm në (b), që dallohet nga dy shenja në kundërvëniet (*pozitiv vs. negativ*), sepse kundërvëniet në (a) e (c) janë në të vërtetë lidhje kundërvënies, *besa* e njëjës përkon me poshtërimin dhe/o heqjen e *nderjes së tjetrës*. Por, ndërsa për heroin që ndjek rrugën treguese [1], pra Zaccaria-n, mbajtja e *besës* është një kusht vërtet i natyrshëm e pozitiv, për tjetrin, Alessio-n, që ndjek rrugën [2], është sigurisht i panatyrshëm e negativ, sidomos po të vështrohet nga perspektiva e tij treguese (Alessio duhet të hakmerret për “padrejtësinë” që i ka bërë Zaccaria, dhe për këtë, duhet të mashtrrojë), por edhe më i pasur në lidhjet e *fabulës*, meqë këtu hyn në lojë një kompleks i dy operacioneve të kombinuara, *shtirja* e *tinëzja*, të dyja me synimin për të ndërtuar një mekanizëm tregues të njohur si *kurth*. Nga njëra anë, heroi në [1] bëhet viktimë e heroit në [2], duke pranuar lidhje që bashkëmbart një agresion i frymëzuar nga mashtrimi; nga ana tjetër, heroi në [2] ndërton kurthin e tij duke simuluar situata paqësore, duke tradhtuar kështu marrëveshjen e arritur me viktimën e tij të ardhshme, por duke respektuar *besën* me të cilën ishte lidhur për të arritur *nderjen* e tij. Midis *besës* së dhënë në shenjë “paqeje” dhe *besës* së dhënë në shenjë ndreqjeje, heroi në [2] parapëlqen të parën: kjo, siç duket qartë, nuk e cenon vijimësinë e rreptë vertikale të rrënjësor te *besa*, ndoshta i ndërron drejtimin.

3.4.— Skemat e vështruara deri këtu përjashtojnë zhvillime treguese të tjera, sepse struktura e thellë e *besës* nuk parashikon zgjidhje që do të largoheshin nga vijimë-

sia vertikale e ilustruar në  $\alpha$ , që bashkëmbart një, dhe vetëm një, sekuencë bërthamore. Edhe në rastin e veprës santoriane shihet që sekuencat nuk e ndryshojnë vendosjen e skemës, duke u kufizuar të dyfishojnë të njëjtën strukturë treguese. Mundësia e vetme për të arritur një zhvillim më kompleks është të parashihet një bashkëlidhje sekuencash vijuese, në mënyrë të tillë, që çdo arritje e qëllimit të përputhet me një përmirësim të ri për t'u arritur, pra me një marrëveshje të re, që i kundërvihet së parës, sipas skemës së mëposhtme:



Sekuencat kanë gjithnjë strukturë të njëjtë (zhvillim vertikal, vijimësi dhe funksione), por pasurohen, duke shtuar



në varg sekuenca të reja (B në A, C në B, D në C, E në D, etj.). Pika më e lartë e lirisë së ndërhyrjes është përputhja e (a) e (c), në kuptimin se ajo që për [1x] është kalim i provës dhe arritje e qëllimit, për [2y], që përfaqëson kundërshtarin [1x], është krejtësisht e kundërta, pra nevoja për një marrëveshje të re, për kryerjen e provës, kalimin e saj dhe arritjen e qëllimit, e kështu më tej në një vazhdimësi rrुकullisjeje ridondante të së njëjtës sekuençë bërthamore. Ky është rasti i rapsodisë skiroiane, që, duke parashikuar të shkojë pas gjakmarrjeve midis vepruesve në raporte kundërshtuese, teorikisht mund të mos kishte kurrë fund. Në të vërtetë, nga pikëpamja e logjikës treguese, gjakmarrja mund të përcaktohet si një kundërparti që kreditori ia merr debitorit në të njëjtën masë me të cilën mund të quhet e shlyer kredia e hapur: duke marrë në konsideratë një çift brenda një lidhjeje dyshe,  $x$  do të kërkojë të marrë kundërparti nga  $y$ , i cili, nga ana e tij, do të përpiqet të marrë nga  $x$  kundërpartinë e tij, e kështu pambarim. Megjithatë, meqë shtrirja nuk ka të bëjë me cilësinë e strukturës treguese, por me numrin e sekuençave të futura në *fabul*, është e natyrshme që, në një farë pike, kjo seri e pafundme duhet të arrijë një përfundim. Dhe, meqë tregimtarit, siç e pamë në skemën  $\gamma$ , i njihet e drejta të ndërhyjë vetëm në aktin që mbyll sekuençën, ai mund të vendosë cila nga seritë paralele do të jetë e fundit.

3.5.— Zgjedhja natyrisht do të rishikojë mënyrat me të cilat do të përcaktohet epilogu, kurrë nuk do të interesohet për strukturën e sekuençës që përbën ciklin tregues elementar, i cili do të mbetet i njëjtë. Rapsodia e Skiroit, drama e Frashërit dhe novela e Koliqit i përkasin këtij lloji të strukturës treguese me bashkëlidhje shumëfishe. Asnjë nga shfaqjet e *besës* nuk tradhton sistemin formal të sekuençës elementare, me përjashtim të epilogut që paraqitet ndryshe në nivelin semantik sipërfaqësor, por krejtësisht i



njëjtë në strukturën e thellë. Në të vërtetë, në tri shfaqjet, me gjithë dallimin e tyre formal (e para në vargje, e dyta është një tekst teatral, e treta një tregim i shkurtër), ndërpritet papritur sepse, përkatësisht, Miloja çmendet, Fetahu vetëvritet, Doda i dorëzohet policisë, pra zhduket përfundimisht vepruesi që do ta kishte vazhduar rrugën treguese duke futur sekuenca të reja elementare. Ajo që është me interes të vërehet, nuk i përket mënyrës sesi realizohet zhdukja, por funksioni i njëjtë që ajo kryen në ekonominë e përgjithshme të veprës, së paku në ekonominë e aktit përfundimtar.

#### **4.– Intriga dhe fabula e dramës *Besa***

4.1.– Historia e treguar nga Frashëri është vendosur në Shqipërinë jugore, pikërisht midis fushave dhe fshatit Progonat, një fshat i vogël i krahinës së Kurveleshit në jug të Tepelenës. Protagonistët kryesorë janë dy të rinj, Merushja e Rexhepi, e para vajza e bariut Zyber dhe e Vahidesë, i dyti nipi i Zyberit. I mbetur jetim që në moshë të njomë, Rexhepi birësohet nga Zyberi, në shtëpinë e të cilit jeton së bashku me kushërirën e tij moshatare. Midis dy të rinjve zë fill një lidhje e thellë, që fillimisht e shpjegojnë me lidhjen farefisnore, por më pas zbulojnë se është një ndjenjë e vërtetë dashurie. Merushja, duke pasur frikë se i ati mund ta ndajë nga kushëriri i dashuruar, ia beson vetes të vërtetën e ndjenjave të saj, duke shpresuar se një mrekulli mund ta realizojë ëndrrën e saj të dashurisë. Por pikërisht kur bareshëza lutej për këtë, bie në kurthin e Selfos, birit të Fetah agait, një i ri shqiptar në shërbim të beut të Tepelenës, Demirit. Në një moment gjuetie, Selfoja, prej kohësh i dashuruar me Merushen, u tregon shokëve për dashurinë e tij të pandryshuar për vajzën. Vijon mes të dyve një bisedë e shkurtër, por Merush-

ja vendos menjëherë të largohet, duke e lënë kështu Selfon nën ironinë dhe mosmiratimin e shokëve (biri i një agai nuk mund të marotohej me vajzën e një bariu!). Kur vijnë i ati dhe Rexhepi, Merushja u tregon çfarë ndodhi dhe ata të dy alarmohen. Më pas, të mbetur vetëm, dy të rinjtë marrin guxim t'i pohojnë njëri-tjetrit ndjenjat e tyre. Duke dëgjuar, i fshehur bisedën e të rinjve, Zyberi vendos të plotësojë dëshirat e tyre dhe, duke kapërcyer pengesën e lidhjes së gjakut, jo vetëm i fejon, por edhe u premtun se do ta bindte edhe të shoqen, Vahidenë, për të dhënë miratimin e saj. Para se të kthehet në shtëpi, Merushja, që mbetet përsëri vetëm, kundërshton edhe një përpjekje tjetër të Selfos, të cilit i thotë se është fejuar me kushëririn Rexhep, duke e paralajmëruar se po të vazhdojë ta shqetësojë, do të ndeshet me të atin.

4.2.— Selfoja kthehet me shokët në Tepelenë dhe në një moment dëshpërimi, duke menduar për të atin Fetah aga, luftëtar trim që ishte nisur për në luftë dhe për më se njëzet vjet quhej i humbur, kërkon – falë edhe ndërhyrjes së shokëve – ndihmë nga Demiri. Beu përpiqet ta bindë të riun Selfo që zgjedhja e tij ishte e pavend dhe e papërshtatshme; se për rangun e tij shoqëror i takonte një grua nga një shtresë e lartë; se ai mund t'i jepte shumë vajza të tjera. Por përballë këmbënguljes së djaloshit, Demiri i premtun se do ta kënaqë dhe, duke qenë i lajmëruar se Zyberi gjendej në Tepelenë, dërgoi dikë ta sjellë pranë tij.

4.3.— Biseda që vijon midis të dyve është provë e krenarisë së shqiptarëve, që përballë fjalës së dhënë, refuzojnë çfarëdo kompromis, deri edhe ato propozime të një autoriteti si Beu. Zyberi nuk e pranon propozimin e Demirit për t'i dhënë dorën e vajzës Selfos, duke saktësuar se ajo tashmë ishte premtuar dhe se ai i kishte dhënë *besën* të fejuarit. Deklaroi se do të parapëlqente vdekjen më mirë se të mos mbante premtimin. Përballë këtij qëndrimi

të vendosur armiqësor të bariut, Demiri e kërcënon, vendos ta arrestojë, urdhëron trimat e tij ta rrëmbejnë Merushen e t'ia dorëzojnë Selfos. Por Zyberi arrin të ikë nga burgu dhe vihet në ndjekje të Selfos, e arrin pikërisht kur ishte duke rrëmbyer vajzën. Vijon një përleshje e ashpër, në të cilën Zyberi bie i plagosur për vdekje nga një goditje e armës së shkrehur nga Selfoja. Merushen e marrin; vjen me vrap e ëma, Vahideja, që sheh burrin duke vdekur. Edhe pse grua, duke marrë parasysh moshën e re të Rexhepit dhe duke mos pasur të afërm të tjerë meshkuj, ajo gjen forcë të japë *besën* e saj që të hakmerret për vdekjen e Zyberit dhe të shpëtojë vajzën e saj. Megjithëse fqinjët, që u grumbulluan ndërkaq përreth, përpiqen t'ia ndryshojnë mendjen, Vahideja nuk ndërron mendim, rrëmben armën e të shoqit dhe niset drejt Tepelenës. Arrin në një lirishtë dhe, e lodhur nga rruga, vendos të pushojë pas një shkëmbi. Në këtë moment, në një rrugë paralele, arrin në të njëjtin vend një luftëtar shqiptar, që shpejt bën të ditur se është Fetah agai, i ati i Selfos. Edhe ai, i lodhur, qëndron në anën e kundër të shkëmbit dhe, duke mos e parë gruan, bie në gjumë të rëndë. Arrin papritur Selman agai, armik i betuar i Fetahut, që e sheh kundërshtarin, e çarmatos dhe pastaj, duke e zgjuar, e fton në dyluftim. Fetahu, përballë epërsisë së armëve të Selmanit, nuk kërkon mëshirë, por tregon edhe një herë krenarinë dhe ndershmërinë e tij. Ndërhyn Vahideja dhe e vret Selmanin. Në këtë çast Fetahu e falënderon gruan, e cila më pas i rrëfen fatkeqësinë e saj tragjike. Duke mos kërkuar identitetin e vrasësit të Zyberit dhe rrëmbyesit të Merushes, Fetahu i jep besën e tij Vahidesë, duke e liruar atë nga detyrimi i marrë dhe duke u angazhuar të shpëtojë nderin e fyer të gruas.

4.4.— Në këtë pikë drama shkon drejt përfundimit: Fetahu merr vesh që është Selfoja, i biri, përgjegjës për tragjedinë, dhe megjithëse i munduar nga ndjenja të kun-



dërta (të vrasë të birin dhe të mbajë fjalën e dhënë, apo ta shpëtojë dhe të humbë nderin?), zgjedh atë që është sigurisht më e dhimbshme për një baba, por është edhe më e ndershme për një luftëtar e për të gjithë fisin. Fetahu e gjen Selfon në shtëpinë e tij, e vret dhe, duke ndjekur edhe ai rrugën e gjakmarrjes, vendos të vetëvritet, duke shkaktuar ngashërim dhe respekt tek të gjithë ata që ishin të pranishëm në epilogun tragjik të kësaj historie.

4.5.– Nuancat në të cilat gjendet *besa* në veprën e Frashërit përvijojnë variante të ndryshme të betimit, si kur është fjala për një marrëveshje pozitive, ashtu edhe kur është fjala për të kryer një gjakmarrje. Por ajo që ofron Sami Frashëri është paraqitja e një spiraleje që përzien personazhe të ndryshme, të cilët, gjatë fazave të tregimit, i kryejnë veprimet e paracaktuara mekanikisht, pa ndërprerje vazhdimësie, deri sa të arrihet një përfundim i papritur e paradoksal. Duke përmbledhur fazat në të cilat zhvillohen ngjarjet, dallohen pesë makrofjali treguese në të cilat shfaqet e realizohet *besa*:

I) Zyberi u premtonte të rinjve se do të martohen.

II) Demiri i premtonte Selfos t'i japë Merushen.

III) Vahideja vendos të marrë gjakun për vdekjen e të shoqit dhe të shpëtojë Merushen.

IV) Fetahu ofrohet të zëvendësojë Vahidenë, duke premtuar të hakmerret për nderin e saj si grua dhe si nënë;

V) Fetahu hakmerret për Vahidenë, duke vrarë birin e tij;


VI) Fetahu hakmerret për vdekjen e të birit, duke vrarë veten.

Dy të parat karakterizohen nga një marrëveshje pozitive: si Zyberi, ashtu edhe Demiri ofrojnë *besën* e tyre për të plotësuar, përkatësisht, dëshirat e Merushes, Rexhepit dhe Selfos. Nga ndeshja e këtyre dy marrëveshjeve të kundërta, rrjedhin pasoja treguese, të cilat u imponojnë tri formave të *besës* që mbeten, të ndjekin njëra tjetrën mekani-



kisht. Spiralja përfundon vetëm ngaqë në aktin e fundit të dramës *gjakmarja* dhe *besa* përqendrohen në një personazh të vetëm, Fetahun, tek i cili mbledhen të dyja veprimet diexhetike që janë në bazë të kësaj historie.

4.5.— Disa vërejtje përfundimtare janë të nevojshme për të komentuar dramën e Frashërit, sepse është një vepër që përmbledh në vetvete të gjitha kushtet treguese të kërkuara nga paraqitja e motivit të *besës*, të cilat janë formalizuar në skemën e mëposhtme:



Aparati tregues bazohet mbi dy situata fillestare në kundërvënie, [1] e [2], që përvijojnë perspektivat e po aq vepruesve dhe zhvillohet në tri faza pasuese A, B, C. *Besa* e dhënë nga *Zyberi* në A[1] u drejtohet dy të rinjve të dashuruar; asaj i kundërvihet ajo që *Demiri* i jep *Selfos* i cili ngarkohet me të njëjtën përgjegjësi që i takon mbrojtësit të tij, në momentin kur i premtun ndërhyrjen e tij të drejtpërdrejtë. Dhe, në të vërtetë, është *Selfoja* që, përballë

dështimit të parë të provës nga ana e Demirit (mosarrestimi i Zyberit), vë në vend *nderjen* e tij me rrëmbimin e vajzës së dëshiruar prej tij dhe me vdekjen e Zyberit. Kjo gjë shkakton reagimin e Vahidesë, e cila jep *besën* e saj, por pa e zbatuar [1]B. Në vend të saj, ndërhyt Fetahu, që shlyen fyerjen e pësuar nga Vahideja, duke vrarë vrasësin e Zyberit, domethënë Selfon, djalin e vet. Meqë edhe nderi i Fetahut u fye, ai jep *besën* kundër vetvetes, duke u vetëvrrarë. Faza treguese C sheh të përqendruara në një veprues të vetëm të dyja situatat fillestare, duke theksuar kështu karakterin e pashmangshmërisë që *besa*, me ngarkesën e saj të fortë morale, u imponon protagonistëve. Përfundimi tragjik i dramës, ku vepron protagonistin absolut i historisë, Fetahu fatkeq, bëhet simbol i respektimit të “fjalës së dhënë”, e cila, nga njëra anë, e detyron Fetahun të mbajë premtimin që i bëri Vahidesë dhe, nga ana tjetër, të shlyejë nëpërmjet “gjakmarrjes”, fyerjen e pësuar nga vrasja e Selfos. Dhe meqë për të dyja përgjegjës i vetëm është Fetahu, *besa* nënkupton vrasjen e tij. Ajo që ndodh me përpikëri, me gjithë kundërvënien e mprehtë midis dy ndjenjave kryesore të subjektit të lidhur me *besë* dhe të *babait* vrasës të të birit, kundërvënie që Frashëri zgjatet ta shpjegojë në *Parathënien* e tij, sikur, nga njëra anë, të ndiejë të nevojshme t’i shpjegojë një publiku joshqiptar domethënien e thellë të logjikës së hekurt e të pashmangshme të nënkuptuar në modelin tregues të *besës* dhe, nga ana tjetër, duke iu drejtuar lexuesit të ardhshëm, të mbulojë në fushën peritekstuale largësinë vërtet të skajshme që teksti teatral, pikërisht për shkak të përfitimit të tij të drejtpërdrejtë, nuk arrin ta mbulojë njësoj si teksti në prozë, qoftë ky roman apo tregim.

## Narrative structures in the play *Pledge of Honor* by Sami Frasheri

*Pledge of Honor*, an Albanian tragedy written by Sami Frasheri in 1874, and published in Istanbul in 1875, is one of the first literary works dealing with the subject of the given word from various complex moral and psychological aspects. As a very important juridical institution, *besa* is a fundamental part of the *Lek Dukagjini Canon*. The tragedy by Frasheri marks a dividing line in the genre history of the Albanian literature. In the Preface to the work the author explained that he was writing it to show virtues and traditions of the Albanian people. Theatre in the eyes of the distinguished Albanian intellectual during the second half of the 19<sup>th</sup> century was a more effective means in the communicative perspective of the receiver, it would impress deeper traces on the imagination of the receiver.

As it is represented in the play, the given word opens different variants of promising in case of a positive engagement or to fulfil the obligations imposed by blood feud. The author gives a spiral in which different characters are involved, carrying out their predestinate acts mechanically, without interrupting the continuity up to the unexpected and paradoxical conclusion.

The dramatist considered it necessary to explain to the non-Albanian public the deep significance of the iron logic and unavoidable implicit meaning of the narrative model of *besa*, and at the same time he addresses himself to the future reader because of the distance that a play cannot cover in the same way as it happens with prosa works.

*Dr. Sali Bashota\**  
(Kosovë)

**PËR ENCIKLOPEDINË, ROMANIN DHE  
DRAMËN E SAMI FRASHËRIT**

---

**Shëmbëlltyra krijuese**

Sami Frashëri është një nga mendjet më të ndritura dhe më të fuqishme krijuese të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, i njohur me veprën e tij letrare, diturore gjuhësore, enciklopedike, didaktike, etj., i çmuar si në kulturën shqiptare, po kështu edhe në kulturën turke.

Shëmbëlltyra e tij krijuese rrezaton shenjën emblematike të mendimtarit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Duke shkruar më shumë vepra sesa kohëzgjatja e jetës së tij (gjithsej 54 vjet jetë), Sami Frashëri me veprën e tij në përgjithësi, ka mbërritur shkallën më të lartë të vetëdijesimit krijues e dituror.

Sami Frashëri është personalitet shqiptar që u takon dy kulturave: shqiptare dhe turke.

Prandaj, vepra e tij i detyrohet dy qytetërimeve: si gjuhë, si komunikim, si krijimtari, si edukim, madje si vetëdije krijuese e politike.

■

\* "Universiteti i Prishtinës", Prishtinë



## Enciklopedia për personalitetet shqiptare

Çështja e parë e shqiptimit të esencës së kësaj vepre, qëndron pikërisht te zgjedhja e personaliteteve shqiptare. Çështja e dytë ka të bëjë me fenomenin kohë, pra me kohën kur është shkruar vepra, që është kohë e pjekurisë së tij krijuese, dhe çështja e tretë qëndron te argumenti fundamental se kjo vepër e bën Sami Frashërin dijetar me njohje ndërkombëtare. Pra "Personalitetet shqiptare në Kamus Al-a'lam" është një vepër e veçantë e botuar me një titull të ri, nxjerrë nga vepra kapitale e Sami Frashërit, shkruar në gjuhën turke, e cila është një enciklopedi voluminoze në vëllime të ndara që e ka edhe referencën e titullit në gjuhën frënge.

Duke iu referuar këtij botimi (zgjedhur dhe përthyer nga Dr. Mehdi Polisi), fillimisht, vepra çelet me trajtesën "Shqiptarët" ku Sami Frashëri shkruan për origjinën, gjuhën, kulturën e shqiptarëve, pastaj për doket, zakonet, moralin, krenarinë, besën etj., duke i dalluar edhe personalitetet e kombit. Gjithsesi, esenca kryesore e kësaj vepre qëndron tek paraqitja e afër 100 personaliteteve shqiptare në kohë dhe periudha të ndryshme. Formula ideore dhe shkrimore e Sami Frashërit mbështetet qartë e saktë tek biografia, portretizimi, karakterizimi i personaliteteve shqiptare në tërë hapësirën gjeografike të Shqipërisë Etnike. Referencat e tjera shoqërore-politike kanë të bëjnë me ndriçimin sa më objektiv të periudhave të caktuara të historisë sonë kombëtare.

Lexuesi shqiptar me përkthimin e kësaj vepre, njihet më për afër me personalitetet e historisë, diplomacisë, kulturës shqiptare; Skënderbeun, Abdyl Frashërin, Ali Pashë Tepelenën, pastaj Bogdanin, Elena Gjikhën, me ministra, kryeministra, intelektualë, pra me personalitetet më të rëndësishme të popullit shqiptar.

Koncepti, strukturimi dhe cilësia e shkrimeve të Sami Frashërit këtu, për afrohet me idetë substanciale si tek enciklopedia kombëtare " Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe çdo të bëhet". Pra, vlera qëndron pikërisht tek mënyra e qasjes dhe e argumentimit, por edhe tek specifika e mendimit politiko-shoqëror.

## **Romani i parë i letërsisë turke**

Romani "Dashuria e Talatit me Fitnetin", i shkruar më 1872 në gjuhën turke, është romani i parë në letërsinë turke, si dhe vepra e parë e Sami Frashërit. Deri më tash është botuar tri herë dhe ka dy versione. Në nivelin e shqiptimit të ideve të këtij romani motivit inicial i paraprin tema dhe ambienti. Fillimisht, si hyrje në rrëfim shkallëzohen peripecitë e jetës së personazheve. Diçka që ndër lidhet me intrigën kallëzimtare të dashurisë së pafat. Diçka tjetër që projektohet me intrigën e dashurisë së imponuar. Dhe zbërthimi funksional i dëshirës erotike mbaron me vetëvrasje, me vdekje.

Kështu shpaloset tema themelore e romanit në mënyrën e funksionalizimit të rrjedhës së veprimit, aty ku brenda përplasen ndjeshmëria romantike; ofshama dhe klithma. Pra, është një goditje në jetën njerëzore ku vetëvritet dashuria: ku ka më shumë karaktere dhe më pak personazhe. Më tutje në shtigjet e rrëfimit ikën incesti, aty ku kafyhet jeta me vdekjen dhe faktura e mirënjohur e romantizmit përthekohet me patetizmin si karakterizim; pastaj realiteti, mentaliteti, zakoni etj.

Në romanin e Sami Frashërit kundërvihet ngjarja me rrëfimin. Personazhet qëndrojnë në mes. Thashë më lart: janë karaktere. Kështu fuqizohet shtresa narrative deri tek domethënia letrare. Pra, temë-dilemat e Talatit për realizimin e dashurisë, maskimi i trupit, ndërrimi i emrit, pozi-

cioni i Fitnetit që lëkundet midis pasionit dhe arsyes. Pastaj vjen zbulesa e dashurisë, po ashtu e ndërlidhur me hollësitë e veprimit dhe me përshkrimin e gjendjeve shpirtërore të të dy bartësve të rrënimt. Dhe intriga e përfaqon kodin narrativ të romaneve sentimentale. Dalëngadalë shkallëzohen situatat dhe eliminohet konflikti.

Nga domethënia e roleve të vepruesve në roman, dramatizohet pozicioni i Ali Begut. Ndodh përfytyrimi dhe shpërfytyrimi, ndërsa struktura psikike e personazhit rikthehet nga lumturia në tragjedi, si tek tragjeditë greke. Rinjohja, e pastaj vetëvrasja. Një domethënie e ngjashme e botëpërjetimit tragjik të personazhit në relacionin atë-bijë, ku riciklohet formula e incestit, e hasim më vonë tek novela "Vjeshta e Xheladin beut" të shkrimtarit Mitrush Kuteli.

Romani "Dashuria e Talatit me Fitneten", i emëruar në mbarimin e tij dhe si "Libri i Fatkeqësisë", është roman i tablove sentimentale, që e shtreson tematikën zakonore të një ambienti dhe të një kohe, ku ndjenja ngadhënjën mbi arsyen. Këtu paraqiten dy koncepte të papajtueshme ndërmjet vetes: koncepti i dashurisë së vetëzgjedhur dhe koncepti i dashurisë së imponuar. Nëpër këtë teh të peripeive jetësore, lakohet fati dhe drama shpirtërore e njeriut, dhe trajtimin e temës së dashurisë e mund trajtimi i temës së vdekjes. Prandaj, përshkrim i dashurisë fatlume udhëhiqet nga motivimi psikologjik.

Në mes rri legjenda romantike për dashurinë, duke i ruajtur shenjat substanciale të virtytit e të nderit njerëzor. Procedim i ngjashëm i historisë erotike si te romani "Dashuria e Talatit me Fitneten" është shumë i pranishëm në letërsinë evropiane, por në periudhën pasuese dhe në letërsinë shqipe.



## **Drama *Besa***

Një përfytyrim magjepsës për shkrimtarin dhe për veprën e tij sjell edhe drama "Besa".

Në të gjitha nivelet e ligjërimit kritik dhe të domethënies letrare, drama "Besa" e Sami Frashërit e përfaqon një kod. Është kodi konvencional i artikulimit të moralitetit shqiptar, që e pushton erotizmin nëpër variantet e gjëllimit.

Sami Frashëri e kapërthur dramën në gjashtë pamje përbrenda njësisë së caktuar të veprimit. Fillimisht, një dashuri infantile që e prodhon incestin mbërrin kulmin e tragjicitetit.

Besa shqiptare në këtë dramë artikullohet nëpër variantet e dashurisë për të përmbushur konvencën morale: nga adhurimi, dashuria deri tek tragjika, vetëvrasja, vdekja.

Nëse krejt drama strukturoret në nivelin e veprimit se Fetahu e vret të birin për të mbajtur besën e dhënë, përse atëherë vetëvrasja e Fetahut është më shumë se heshtje e çuditshme, kur përmbushet një konvencë dhe pasioni ngadhënjën mbi arsyen.

Drama "Besa" me subjektin e saj, i vë në epiqendër të veprimit virtytet, traditat, zakonet e popullit shqiptar. Që në parathënien e shkruar vetë nga Sami Frashëri, ndër të tjera, shenjëzohen disa nga idetë supreme që kanë të bëjnë me disa nga karakteristikat e popullit shqiptar: dashuria për atdhe, shpirti i sakrificës, besa etj., kështu autori duke e trajtuar njërin prej këtyre dimensioneve të traditës shqiptare, pra besën, arrin të mbitheksojë sentimentalizmin si procedim krijues.

Këtu Sami Frashëri e artikulon temën e besës, në një anë dhe karakterologjinë e personazheve, në anën tjetër përbrenda ambientit rural, për të prodhuar efektin e dashurisë së Merushes me Rexhepin, nëpër peripecitë e një jete, e cila patjetër ndeshet me zakonet dhe moralin e



shqiptarëve. Këso mënyre, edhe pse pajtohen prindërit e të dashuruarës, ngjarja rrëshqet në një dimension tjetër, kur Selfoja, biri i Fetahut, i cili ishte i mërguar, e rrëmben Merushen dhe e vret babanë e saj.

Njohja e Fetahut me Vahidenë, e cila ia kishte shpëtuar jetën, është kulmi i kërkimit të esencës gjatë procesit të veprimit, meqë Fetahu ishte betuar për gjakmarrje. Edhe pse e kupton se vrasësi ishte djali tij Selfoja, ai e bën një veprim të këfillë dhe e vret djalin e vet, për të mbajtur premtimin dhe besën e dhënë, pastaj edhe bën vetëvrasje.

Pra, drama “Besa”, është dramë e ndërtuar sipas koncepteve të lidhura përbrenda kuadrit dhe situatave dhe veprimeve, ku projektohet jeta e lumtur, ngulfatet dashuria pasionante dhe shkallëzohet tragjiciteti, vdekja.

Sami Frashëri, problemin e besës dhe të fjalës së dhënë e situon dhe e funksionon si ndërgjegje, ku triumfon tragjika përballë dashurisë. Duke e tërhequr pikëshikimin midis ngjarjeve dhe ideve përbrenda kufijve të tragjicitetit, autori e rikrijon përfytyrimin e situatës në veprim të dhembshëm, trishtues, ndërsa burim i kontrastit, herë bëhet fjala e dhënë, herë përmasa e vdekjes. Natyrisht, çasti tragjik - kur babai e vret djalin e vet, detyrimisht e koncepton mitin apo legjendën për fjalën e dhënë. Më tutje, obsesioni i Fetahut shndërrohet në mision, secilit i paraprin ligji veprues i vdekjes.

Drama “Besa” i referohet një kohe dhe një ambienti, ku dashuria përmbysset përbrenda sfondit të tragjikes, flijimit, vdekjes....

## On Encyclopedia, the Novel and the Drama by Sami Frasheri

As an Albanian personality Sami Frasheri belongs to two cultures – Albanian and Turkish. His work owes to two civilizations from many points of view – as languages, communication, creation, education, even as political and creative consciousness.

From his well known *General Encyclopedia* dr. Mehdi Polisi selected and translated into Albanian all the items connected with Albania and Albanians. The Albanian edition opens with the large paper on Albanians, in which Sami Frasheri gives information on the origins, the language, the culture, and the history of Albanians, together with their customs, virtues, morality, and so on. There are more than 180 distinguished and historical figures of Albanians through centuries. The underlying structure and conception are very close to the substantial ideas of his major work *Albania – What it was, what it is and what will become of it*.

The novel *the love between Talat and Fitnet* written in Turkish in 1872 is the first novel in the Turkish literature. It was published three times. Under the subtitle ‘The Book of Misfortune’ it is a novel of sentimental pictures, unfolding the customs of a milieu and a given time, in which the feeling wins over the reason. Two irreconcilable concepts are represented – the love chosen willingly and the imposed love.

The drama *Pledge of Honor* is centered on Albanian virtues, traditions, and customs. In the ‘Preface’ to the work the author marks some of the supreme ideas as characteristics of the Albanian people – the love to fatherland, the spirit of sacrifice, the word of honor, and so on. The

creative procedure rests on sentimentalism. The issues of 'besa' and the promise, together with characters in a rural ambience, are in function of a consciousness, in which the tragic triumphs in front of love.

*Dr. Zeki Gyrel\**  
(Turqi)

**POZITA DHE RËNDËSIA  
E SAMI FRASHËRIT<sup>57</sup>  
NË LETËRSINË TURKE**

---

Fjalimin tim me rastin e 100-vjetorit të vdekjes së Sami Frashërit, këtij mendimtari, letrari, gramaticieni, enciklopedisti dhe botuesi të madh dua ta filloj duke kërkuar mëshirën hyjnore për të.

Dua t'ju përgëzoj edhe juve vëllezër shqiptarë, që po bëni përpjekje për t'i dalë zot, për ta jetësuar dhe për ta ngjallur këtë figurë madhështore.<sup>58</sup>

■

\* Universiteti "Abant Izzet Bajrall" Bolu.

<sup>57</sup> Në botën turke i njohur si Shemsettin Sami. (Shën. i përkth.)

<sup>58</sup> I përgëzoj vëllezërit shqiptarë të cilët bëjnë një punë të vërtetë duke i dalë zot historisë së tyre me plot vetëdije dhe shpreh pezmin tim lidhur me turqit e Maqedonisë.

Këtë vit (2004) mbushen 120 vjet të plota nga lindja e Jahja Kemalit, këtij poeti të madh turk, i lindur në Shkup dhe i shpërngulur në Stamboll në moshën 18-vjeçare, i cili në poezitë dhe shkrimet e tij e jetëson si Turqinë ashtu edhe Maqedoninë. Për fat të keq në Maqedoni lidhur me këtë datë të rëndësishme nuk u organizua asgjë, pos "Festës së poezisë nga Nexhati Zekerija te Jahja Kemal", të udhëhequr nga shoqata "Namik Efendi" nga Banjica e Epërme (Gostivar).



Më lejoni që të theksoj se jemi vonuar në njohjen dhe promovimin e Sami Frashërit, një vlerë kjo që i përbashkon bijtë e dy popujve vëllezër shqiptarë dhe turq. Për të mësuar më mirë rëndësinë e Samiut në kuadër të letërsisë turke, së pari duhet të ndalemi pak te jetëshkrimi i tij.

## Biografi e Samiut

Sami Frashëri ka lindur në vitin 1850 (h. 1266) në Frashër të Përmetit (Vilajeti i Janinës), të mërkurën e parë të qershorit. I ati i tij, Halit beu, ishte bej timari, kurse gjyshi i tij ka qenë Durmush beu. Nëna e tij, Emineja, është mbesë prej Mirahori dhe ka ndërruar jetë në vitin 1886. Ka pasur shtatë fëmijë me Halit beun, pesë djem dhe dy vajza. Samiu është fëmija i katërt i radhës nga kurora e Eminesë dhe Halitit.

Samiu, më 4 maj të vitit 1884 (1300), në moshën 34-vjeçare, martohet me Eminen, vajzën e Sadettin Efendiut, kazasker edremitas. Nga kjo martesë lindën katër fëmijë Samija, Ali Samiu (Jen), Sadija dhe Sadiu. Pas vdekjes së Emines në vitin 1893/1309, martohet me Belkis Hanëmin dhe me të iu lind një djalë, Skender Samiu.

Shkrim-leximin e ka mësuar nga një mik i të atit. Në moshën 14-vjeçare është regjistruar në gjimnazin grek Zosimea, ku i ka kaluar shtatë vite dhe në moshën 22 vjeçare, më 1871, ndahet nga kjo shkollë.

Samiu i ri, në këtë institucion, përveç shkencave pozitive, mëson edhe frëngjishten, italishten dhe greqishten e vjetër. Ndërkohë e ka vazhduar edhe medresenë, në të cilën e ka mësuar gjuhën arabe dhe persiane. Sami Frashëri, përveç gjuhës amtare, ka zotëruar, turqishten, arabishten, persishten, frëngjishten, italishten, greqishten e re dhe të vjetër.

Pas ndarjes prej shkollës një kohë të caktuar punoi si administrator në Vilajetin e Janinës. Në vitin 1872 (1288 h.) vjen në Stamboll dhe punësohet në sektorin e botimeve ku i kalon tre vite. Ndërkohë filloi që t'ia tërheqë vëmendjen opinionit me artikujt e botuar në gazetën *Sabah*, themelues i së cilës ishte vetë ai. Në vitin 1874 u internua në Tripoli, ku Sami Pasha (djali i Sezai Beut) e mori në mbrojtje dhe që të mund të mbijetonte, e nxiti të nxirrte gazetën *Tripoli* në gjuhën turke dhe arabe. Në këtë qytet kaloi një vit dhe me ndërhyrjen e Sami Pashës iu fal dënimi dhe u kthye në Stamboll. Më 1877 (1293), kaloi pesë muaj në Rodos si sekretar privat i Sava Pashës. Më vonë dha dorëheqje nga ky post dhe u kthye në Janinë, ku kreu detyrën e kryesekretarit të Komisionit për Mobilizim Usharak të themeluar nga Abidin Pasha. Më 1888 përsëri kthehet në Stamboll dhe sërish u fut në botën e botimit. Më 1880 (1297) është caktuar si sekretar i Komisionit për Hetime Usharake, kurse më 1893 (1309) si kryesekretar i këtij komisioni, detyrë kjo të cilën e ka kryer deri në vdekje.

Samii Frashëri, ndërroi jetë në Stamboll, më 1 korrik 1904 (1320 h.), ditën e shtunë, në moshën 54 vjeçare. Është varrosur në Erenkoj, në varrezat përballë xhamisë së lagjes Sahrajë Xhedid.<sup>59</sup>

■

<sup>59</sup> Lidhur me jetën e Sami Frashërit shih: Osman Fikri Sertkaya; "Şemseddin Sami ve Kamus-ı Türkî'si", *Türk Kültürü*, qershor 1967, nr.56; Şükran Kurdakul, *Şairler Ve Yazarlar Sözlüğü*, botimi i dytë, Ankara 1973, f. 357-358; Ağah Sırrı Levent, *Şemseddin Sami*, Ankara, 1967; Hikmet Turhan Dallıoğlu, *Şemseddin Sami Hayatı Ve Eserleri*, 1934; Şecaattin Tural, *Şemseddin Sami*, Stamboll, 1999. Sami Frashëri së pari është varrosur pranë gruas së vet, në varrezat e Erenkojit. Më vonë, më 1968, eshtrat e tij u bartën në varrezat familjare në Ferikoj. Në vitin

■

1959, qeveria shqiptare i ka kërkuar eshtrat e Samiut, por familja e tij nuk kanë lejuar një gjë të tillë. Atëbotë Pejami Safa, në gazetën *Tercüman* shkroi një artikull shumë kuptimplotë që titullohet "I kujt është varri i Sami Frashërit?" Po e japim në vazhdim:

"Qeveria shqiptare, duke i dalë zot autorit të veprave *Kamusu'l-a'lam* dhe *Kamus-i Turki*, kërkoj leje për bartjen e eshtrave të Samiut dhe premtoi se do të ndërtonte një varr madhështor. Arsyetimi i kërkesës bazohej në pohimin se Samiu paska qenë shqiptar.

Po, Samiu ka qenë shqiptar. Në Stamboll, për shkakë të ndryshme nuk ka varr të veçantë. Në Turqi nuk ekziston ndonjë muze si ai i Shqipërisë i pagëzuar "Muzeu i Sami Frashërit". Madje s'mund të themi se s'kanë të drejtë ata që pohojnë se në zemrën e fjalorshkruesit mjeshtër jetonte ideali për Shqipërinë. Samiu pati përgatitur një alfabet shqip dhe në *Kamus al-A'lam* madhorët turq si Kavallasi Mehmed Ali Pasha i pat paraqitur si shqiptarë.

Por, sikur sot të ishte gjallë, sigurisht se do të dëshironte që të vdiste dhe të varrosje në Turqi. Ishte i lidhur për kombin turk me një dashuri që e tejkalonte dobësinë racore të lidhjes ndaj Shqipërisë. Punimet e zellshme në sferën e gjuhës turke dhe veprat kolosale të lëna pas vetes, tregojnë se ai e donte turqishten dhe Turqinë më tepër edhe se turkofilet ekstremë. Por le të mos hidhërohemi me qeverinë shqiptare. "Muzeu i Sami Frashërit" në Tiranë dhe kërkesa për bartjen e eshtrave të Samiut në vendlindje përbëjnë një koncept të lartë të respektit ndaj kulturës dhe shkencës. Ne nuk duhet të hidhërohemi me të, por me vetveten që s'e kemi çmuar sa duhet deri më sot Samiun. Nusja e të ndjerit, zonja Fahrije informon se pas refuzimit të kërkesës insistuese të qeverisë shqiptare, do të pasojë ndërtimi i varrit nga vetë familja e Samiut. Varri i Samiut nuk është i shqiptarisë por i turqnisë. Kontributin e vet në ndërtimin e një përmendoreje të bronzte të Samiut duhet ta



## Bota ideore e Sami Frashërit

Koha në të cilën ka jetuar Samiu përbën shekullin në të cilin politika botërore është ribërë. Për shtetin osman ky shekull ishte kohë e dekadencës, e viteve të zbrapsjes së pandalshme.

Njëri prej letrarëve dhe burrështetasve të periudhës në fjalë, me të drejtë do të konstatojë:

Çdo i mençur vazhdimisht nga sprova përshkohet në këtë dynja,

Të mençur e të vyer që ka jetuar në rehati dikush a ka pa?

Ngjarjet dhe lëkundjet e kohës janë të lidhura ngushtë me identitetin e Samiut si mendimtar. Në këtë periudhë kohore, në krye të çështjeve që e preokuponin shtetin osman ishin kryengritjet nacionaliste në trojet ballkanike. E para prej tyre, në fakt s'ishte e re. Kjo çështje ishte hallka e fundit e zinxhirit të rebelimeve të filluara me Kryengritjen Greke në vitet 1800. Ndjenja nacionaliste, e ngjallur politikisht me Revolucionin Francez të vitit 1789, filloi t'i trondiste dhe t'i copëtonte dalngadalë strukturat shtetërore në formë të perandorive. Lëvizjet nacionaliste të lindura në Evropë dhe të nxitura nga perëndimorët, dallgë-dallgë arritën përmes Ballkanit deri në kufijtë e shtetit osman. Kjo i shtyu politikanët, mendimtarët dhe letrarët që t'i kërkojnë rrugët e ruajtjes së strukturës shumelementëshe të këtij shteti vigan. Ata e lypnin pikën e re të përbashkët mbi të

■

japë edhe Ministria e Arsimit. Nëse figurat tona gjigante s'i nderojmë, na i marrin të tjerët. Sepse jemi popull me shumë personalitet të larta që në gjakun e tyre bartin kromosome shqiptari, arabi, persiani, greku, armeni dhe bullgari. Kjo dukuri vërehet te çdo popull. Ata janë turq aq sa ne i nderojmë."

(Nevzat Köseoğlu, *Peyami Safa, Alternatif Yayınları*, Ankara, 2002, fq. 220.)



cilin do të rindërtohej struktura shumëgjuhëshe, shumëfeshë dhe shumëkombëshe e shoqërisë osmane.

Këtyre përpjekjeve që shkonin duke u përshpejtuar që nga koha e Mahmudit II iu bashkangjitën burrështetasit, dijetarët, mendimtarët dhe letrarët. Në këtë kontekst vend të veçantë zënë letrarët, të cilët në saje të ndjeshmërisë, ideve dhe dijes, shoqërinë në të cilën jetonin e njihnin më për së afërmi dhe thujtë e parandienin ardhmërinë e saj. Për këtë arsye, ata kanë qenë epiqendër e çdo përpjekjeje për shpëtimin e osmanllit çdo alternativë të ofruar, në çdo fazë historike, përmes veprave të tyre ia kanë rrëfyer dhe treguar në mënyrë më të qartë popullit. Me shpalljen e reformave pas Fermanit të Tanzimatit dhe të Meshrutijetit të Parë, me themelimin e bashkësisë së Osmanllinjve të Rinj, si pasoja të kërkimeve politike të kohës, thujtë në të gjitha ngjarjet e rëndësishme shoqërore vend të çmuar zënë edhe letrarët. Një prej letrarëve më me peshë të kohës së këtyre kërkimeve është edhe Sami Frashëri. Veçoria kryesore që atë e dallon nga bashkëkohasit e tij letrarë dhe mendimtarë, është fakti se ai me kohë e kishte kuptuar fuqinë e ndjenjës nacionaliste që me shpejtësi marramendëse po përhapej anekënd Evropës. Kjo veçori dhe akcesi i tij shkencor ndaj kësaj çështjeje e bëjnë Samiun njërin prej prijësve ideorë të nacionalizmës turke.

Në atë kohë debatet rreth rrugës politike që duhej të ndiqte shteti osman vërtiteshin rreth tre rrymave ideore: *osmanizmi*, *islamizmi* dhe *turkizmi*. Më vonë, në këto lëvizje ideore të emërtuara nga Jusuf Akçura si *Üç Tarz-ı Siyaset* (Tre forma të politikës)<sup>60</sup>, Sami Frashërin e gjejmë si një

■  
<sup>60</sup> Këtë vit (2004) shënohet 110 vjetori i *Tre forma të politikës*, artikull ky i gjatë i botuar për të parën herë në Kajro. (Yusuf Akçura, "Üç Tarz-ı Siyaset", *Türk Gazetesi*, 25 mars 1320/1904, nr. 24; 10 prill 1320, 1904, nr. 26; 22

nga liderët e lëvizjes turkiste. Në vitet e Tanzimatit, prijës të kësaj lëvizjeje na paraqiten tre emra: Ahmed Vefik Pasha (1823-1891), Sulejman Hysny Pasha (1838-1892) dhe Sami Frashëri (1850-1904). Për ta konstatuar pozitën e Samiut në kuadër të kësaj lëvizjeje duhet shqyrtuar një nga një këta tre figura.

Nacionalizmi turk i viteve të Tanzimatit nismën e ka me njohjen e lëvizjes turkologjike të Evropës. Në shekullin XVIII dhe XIX, në Evropë, nga njëra anë janë zhvilluar shkencat pozitive, nga ana tjetër ideja nacionaliste dhe dashuria ndaj historisë kombëtare u dha peshë të madhe studimeve historike. Historia u shndërrua në një fushë hulumtimi me rëndësi që s'e kishte pasur kurrë më parë. Kjo shkencë i ndriçoi marrëdhëniet e evropianëve me popujt aziatikë; syri i historianëve evropianë, që merreshin me të kaluarën e Evropës, me një interesim më të madh u përqëndrua nga Azia. Kjo prirej, historianëve të rinj u dha mundësinë që të njihen me historinë e vjetër të popullit turk, pozitën e tij në histori si njëri nga etnoset kryesore të Azisë. Disa dijetarë evropianë krijuan hulumtime serioze në sferën e gjuhës, historisë, letërsisë, etnografisë dhe folklorit të popujve turq. Veprat e pasura që dolën në shesh, që nxitnin kurajo, ndikuan në përshpejtimin e hovshëm të gjurmimeve turkologjike. Ishin veprat e hulumtuesve evropianë ato që nxorën në pah të vërtetën se turqit kanë themeluar qytetërime të begata para peiudhës osmane, se turqit janë një nga popujt më të vjetër dhe më të

■  
prill 1320/1904, nr. 27) Kjo vepër më vonë është botuar si libër në Kajro, Stamboll dhe Ankara. Për vlerësimin e kësaj vepre shih: Recep Duymaz, "Üç Tarz-ı Siyaset Yüz Yaşında", *Türk Kültürü Dergisi*, korrik-gusht 2004, nr. 495-496, fq. 647-652 (Ankara).

qytetëruar të botës. Në këto hulumtime morën pjesë shkencëtarë gjermanë, danezë, rusë, frangë etj.<sup>61</sup>

Dijetarët turq një kohë të gjatë nuk ishin përfshirë në këto hulumtime, kishin mbetur të huaj ndaj historisë së vet kombëtare. Por, nga mesi i shekullit XIX, Ahmed Vefik Pasha i cili shkollën e mesme e kreu në Francë, u njoh për së afërmi me hulumtimet turkologjike të realizuara në vendet evropiane. Ai tregoi një interesim të madh për to. Atë e ndoqën disa shkrimtarë të tjerë të periudhës së Tanzimatit si Sulejman Pasha, Ali Suavi, Sami Frashëri. Kësisoj, në pjesën e dytë të shekullit XIX, në shtetin osman u shfaq lëvizja e *turkizmit shkencor*.<sup>62</sup>

Ideja e osmanizmit dhe ajo e islamizmit, së pari janë trajtuar si qëndrime politike dhe mekanizëm mbrojtës që më vonë do t'i gjenerojnë ekzemplarët e vet letrarë. Nacionalizmi është formësuar në saje të gjurmimeve gjysma-

■  
<sup>61</sup> Shkenca që merret me turqit, me gjuhën turke dhe me dialektet e saj quhet turkologji. Do të ishte më mirë që në vend të këtij termi të përdorej shprehja "shkenca e turkizmit". Kjo shkencë, në Evropë ka një të kaluar që arrin deri në shekullin XIV. Por nëse e njëjta, në kuptimin e gjerë të fjalës, trajtohet si degë shkencore që jep njohuri për fiset turke, mund të thuhet se pararendësit e këtij lëmi janë autorët latinë dhe bizantinë. Prof. Dr. Hasan Eren ka përgatitur një libër në të cilin i ka përmbledhur emrat më të dalluar të dijetarëve që janë marrë me turkologji. Shih: Hasan Eren, *Türklük Bilimi Sözlüğü* (I. Yabancı Türkoloğlar), Ankara, 1998.

<sup>62</sup> Për vlerësimet e Nihad Sami Banarliut lidhur me këtë çështje shih: Nihad Sami Banarlı, *Metinlerle Türk ve Batı Edebiyatı-III*, Stamboll, 1981, fq. 357-361. Për njohuri më të gjera në lidhje me lindjen, zhvillimin dhe ndikimin e lëvizjes turkiste në letërsi dhe në lidhshpin shtetëror shih: Yusuf Sarınoy, *Türk Milliyetçiliğinin Tarihi Gelişimi Ve Türk Ocakları*, Stamboll, 1974.



kademike dhe veprave letrare që niseshin nga ideja e përkatësisë së përbashkët, e kërkimit të së kaluarës së largët të përbashkët, nga ideja për daljen zot periudhave madhështore të historisë, nga ndjenja për ta konsideruar veten përgjegjës për arsimi(mi)n dhe përparimin e popullit.

Botimi i gazetës *Ngulmi* (İkdam, 1869)<sup>63</sup> dhe përvojat e *Poezive turke* (Türk Şiirleri) dhe të revistës *Kopshti* (Bağca), botimi i *Gjuhës osmane* (Lehçe-i Osmani),<sup>64</sup> të Ahmed Ve-

■  
<sup>63</sup> Në fund të shekullit XIX në kryeqytetin e Shtetit Osman, Stamboll, u themelua një bashkësi që mbështeste idenë turkiste. Por kjo lëvizje kishte më tepër karakter shkencor sesa politik. Ka edhe të atillë që thonë se në themelimin e kësaj lëvizjeje rol ka pasur edhe mënyra se si turqit dhe gjermanët e kanë përkapur njëri-tjetrin. Sami Frashëri, Nexhip Asëmi, Veled Çelebiu dhe Hasan Tahsini kanë qenë anëtarë të kësaj shoqate që ka botuar edhe gazetën *İkdam*. Shkaku pse kjo shoqatë nuk është zhvilluar ishte se qeveria e kohës nuk e ka shikuar me sy të mirë.

<sup>64</sup> Ahmed Vefik Pasha është autor i parë i shkrimeve nacionaliste, që në vitet e Tanzimatit filloi si lëvizje shkencore. Vefik Pasha i cili kishte mësuar në Paris, në Liceun St. Louis, ka kryer funksione shtetërore si ambasador në Paris, guvernator i Edrenesë dhe Bursës, senator, mësimdhënës në Daru'l-funun, ministër i punëve të brendshme dhe kryeministër.

Ahmed Vefik Pasha, i cili tregoi interesim të madh për lëvizjet turkologjike, gjithherë me një këndvështrim nationalist, ka përpiluar vepra nga fusha e gjuhës, historisë dhe folklorit. Së pari, nga turqishtja çagataje në truqishten osmane përktheu *Shexhere-i Turki* (Etnogjeneza turke) të Ebulgazi Bahadır Hanit. Duke e promovuar historinë turko-mogole të Azisë së Mesme, të panjohur për osmanllinjtë, tregon se turqit edhe para osmanllinjve kanë pasur një histori të madhe. Më vonë ka përgatitur fjalorin e parë të



fik Pashës, i *Historisë turke* (Türk Tarihi) të Nexhip Asëmit, i *Gramatikës turke* (Sarf-i Turki),<sup>65</sup> polemika rreth *Tre*

turqishtes së Anadollit, *Lehçe-i Osmani* dhe në vëllimin e parë të saj, për herë të parë pas shumë shekujsh përmbledh fjalë turke. Kjo vepër, më vonë në studimet e gjuhës kombëtare turke është shndërruar në shembull, në burim të çmuar për hulumtimet e mëtutjeshme. Vefik Pasha në këtë vepër ka dhënë njohuri për dialektet e turqishtes, i ka fiksuar trevat e përhapjes së tyre në nënqiellin osman dhe atë të Turkistanit. Në po të njëjtën vepër, ka theksuar se historia turke ka filluar 5000 vjet para hixhretit, ka nënvizuar zinxhirin oguzët-selxhukët-osmanët dhe ka shtuar se oguzët janë dega më e ndershme e popullit turk.

Vepra e tretë e Ahmed Vefik Pashës, e shkruar gjithashtu në vijën nacionaliste, është përmbledhja e proverbave e titulluar *Atalar Sözü*. Ahmed Vefik Pasha, i cili ka edhe vepra të tjera lidhur me historinë e përgjithshme dhe historinë osmane, është përmendur me respekt nga nacionalistët turq të mëvonshëm.

<sup>65</sup> Emri i dytë i rëndësishëm i turkizmit shkencor të periudhës së kërkimit është heroi i Shipkës, Sulajman Hysny Pasha, ky luftëtar i madh dhe patriot i dijsëm. Kur kryente detyrën e drejtorit të shkollave ushtarake, përpigëj që në to të zhvillonte edukatën kombëtare-ushtarake, u dha një hov atyre, u shpërndau ekspertëve të lëmenjve gjegjës librat mësimorë që duheshin përkthyer dhe vetë e shkroi veprën *Sarf-i Turki* (Gramatika turke). Sulejman Pasha këtë libër të vetin nuk e titulloi siç ishte zakon atëherë të quheshin librat e kësaj fushe *Sarfi Osmani* ose *Kavaid-i Osmanijje*, por *Sarf-i Turki*. Me këtë ai tregon qëndrimin e drejtë dhe shkencor të tij se turqishtja është gjuhë e gjithë kombit turk.

Sulejman Pasha, në një letër që ia dërgoi Rexhaizade Ekremi, njërit prej themeluesve të rrymës letrare të *Servet-i Fununit*, thekson se togfjalëshi letërsi osmane është i gabuar, sikur që janë të gabuara edhe shprehjet gjuha osmane dhe

*formave të politikës* mes Jusuf Akçurës, Ali Kemalit dhe Ahmed Feridit, që është botuar në Kajro në gazetën *Türk* dhe shkrimet e botuara në Evropë në *Meshveret*, janë më tepër pasqyrime të kërkimit të një sfondi ideor sesa politik.

Lëvizja e kthimit të intelektualëve turq në vetvete u duk në tri sfera: 1. Veprimtaria akademike, 2. Themelimi i organizatave të ndryshme, dhe 3. politika.<sup>66</sup>

Nga koncepti i nacionalizmit akademik i kuptojmë humtimet me dimension më të ulët emocional në fushën e gjuhës, historisë dhe artit. Dijetarët e periudhës në fjalë, për të nxjerrë në pah përmasat shkencore dhe filozofike të nacionalizmit dhe të turkizmit, që përbën emrin e përveçëm të termit të parë, i kanë marrë nëpër duar burimet e vendit dhe ato të huajat.

Jam i mendimit se vendin e Sami Frashërit në historinë e mendimit dhe letërisës turke duhet ta shohim nën dritën e këtyre të dhënave.

Një personalitet i shquar nga shkrimtarët e Periudhës së Kërkimit në Letërsinë Turke<sup>67</sup>, që ka vepruar në vijën e nacionalizmit turk është Sami Frashëri.

■  
kombi osman. Sipas tij "shprehja "osman/e" është emër i shtetit, kurse kombi ynë quhet kombi turk. Për këtë arsye gjuha jonë duhet quajtur gjuha turke, kurse letërsia, letërsi turke. Vepra më e rëndësishme e Sulejman Pashës nga sfera e nacionalizmit shkencor turk është *Tarih-i Alem* (Historia e botës).

<sup>66</sup> Për njohuri më të hollësishme lidhur me studimet në këto tri fusha ku pasqyrohet turkizmi shih: Sadık Kemal Tural, "II. Meşrutiyet Döneminde Türk Edebiyatı", *Türk Dünyası El Kitabı*, botimi i dytë, Ankara, 1992, fq. 471-502; Sadık K. Tural, *Osmanlı İmparatorluğunun Son Yıllarında (1908-1920) Edebiyatımızda Türkçülük Akımı*, Ankara, 1978 (Universiteti Hacettepe, tezë e pabotuar doktorate).

Sami Frashëri, është një letrar i nivelit të mesëm, një përkthyes kompetent, një dijetar i madh i gjuhës. Me fjalorët e mëdhenj dhe me vlerë frëngjisht-turqisht dhe anasjelltas, ka përgatitur vepra të dobishme që kanë ndikuar në zhvillimin e marrëdhënieve turko-frënge. Fjalori i tij i frëngjishtes (*Kamus-i Fransevi*), është shndërruar në burim dhe shembull për të gjithë fjalorët e mëvonshëm turqisht-

■

<sup>67</sup> Në shekullin XIX në botën turke në përgjithësi dhe në nënqiellin osman në veçanti filluan të shfaqen **kërkime** kundër thesarit ekzistues në sferën ushtarake, politike, ekonomike, financiare, administrative, sociale dhe estetike. Këto kërkime u zhvilluan në fushën e të drejtave dhe lirive të individit dhe në atë të ripërtëritjes së strukturës politike, ushtarake, financiare, juridike dhe administrative të shtetit. Që nga fillimi i shekullit XIX, thuhet në të gjitha fushat vërehet një lëvizje, e cila në letërsi dhe në art quhet Letërsia turke e periudhës së kërkimit. Veprën e Keçexhizade Izet Mollës, *Mihmet-i Keshan* (Fatkeqësia e Keshanit) dhe stilin dhe logjikën e memorandumit të dorëzuar Sulltanit mund t'i quajmë si zanafillë të Letërsisë turke të periudhës së kërkimit, e cila sipas Sadik Kemal Turallit ndahet në disa faza: 1. Faza e ndarjes nga letërsia klasike. 2. Periudha e letërsisë për shoqërinë ose periudha e letërsisë edukative. 3. Periudha e Shoqatës Servet-i Funun dhe e bashkëkohasve të saj ose Periudha e vjeljes së arsimit perëndimor. 4. Periudha e ndërmjetme ose Periudha e daljes së lëvizjeve letrare jashtë Stambollit. 5. Periudha e Meshrutijetit të Dytë ose Periudha e individualizimit ose e letrarizimit të romantizmit kombëtar. 6. Periudha e luftës kombëtare. 7. Periudha e Ataturkut. 8. Periudha e çletrarizimit dhe e ideologjisë në botën letrare dhe 9. Periudha e politikës në letërsi.

Shih: Sadık K. Tural; "II. Meşrutiyet Döneminde Türk Edebiyatı", *Türk Dünyası El Kitabı*, vëll. 3, botimi i dytë, Ankara, 1992, fq. 471.



frëngjisht. Vepra e tij gjashtëvëllimëshe *Kamus al-A'lam*, përbën një enciklopedi të historisë, të gjeografisë dhe të njerëzve të famshëm.

Por përpjekjet më të vyeshme të këtij gjuhëtari punëtor, janë ato idealiste të pastrimit dhe nacionalizimit të gjuhës turke, duke pohuar se bëhet fjalë për një gjuhë të vjetër, të pasur, të bukur dhe të pavarur.

Autori që nga artikulli i vitit 1880 "Gjuha turke" (*Lisan-i Turki*), botuar në revistën *Hafta* si dhe nga artikulli "Gjuha dhe letërsia jonë" (*Lisan ve Edebiyatımız*) botuar në gazetën *Terxhuman-i Hakikat*, pikëpamjet e tij shkencore lidhur me gjuhën dhe letërsinë turke i shpreh me një dashuri të flaktë për një gjuhë kombëtare. Punën e tij të përkushtuar me vite të tëra me pikëpamje dhe mendime të këtilla, do ta kurorëzojë me fjalorin më të pasur të gjuhës turke *Kamus-i Turki* (1901).

Në artikullin e parë, autori është shprehur se fjalët e futura në gjuhën turke nga gjuhët e tjera mund të largohen, në artikullin e dytë fjalët e turqizuara i konsideron për turke dhe nënvizon se turqishtja është një nga gjuhët më të bukura.

Samiu thotë se „populli i cili e flet turqishten quhet populli turk dhe gjuha e tij s'mund të quhet osmane, por turke“ dhe për këtë arsye fjalorin e tij nuk e ka pagëzuar *Kamus-i Osmani* por *Kamus-i Turki*. Në artikullin *Lisan-i Turki* për fjalën turk do të pohojë: "Ky emër është emërtues i një bashkësie të madhe dhe përkatësia asaj është krenari" dhe me këtë do ta tregojë lidhshmërinë e tij për kombin turk.

Samiu, në *Kamus-i Turki* të cilin e përgatiti me këtë ndiesi, përveç fjalëve me origjinë të pastër turke është përpjekur t'i tubojë edhe fjalët arabe, persiane, greke, italiane dhe franceze. Libri është i formatit të madh dhe ka 1574 faqe.

Autori, i cili në parathënien e librit *Kamus-i Turki* turqishten e studion duke e ndarë në turqishte lindore dhe



perëndimore, do të shprehet se më autentike është turqishtja lindore, kurse më elegante, më e bukur dhe më harmonike është ajo perëndimore. Edhe përkundër kësaj, ai thekson se të dy turqishtet në fakt janë një gjuhë, se e pasurojnë atë, se në asnjë mënyrë nuk duhet shpërfilluar turqishtja lindore-çagatajase.

Këto mendime, ky emocionalitet dhe kjo veprimtari, Sami Frashërin e bën më të përthelluar në çështjen e gjuhës se Ahmed Vefik Pasha dhe Sulejman Pasha.

Punimet e tij në sferën e turkizmit nuk mbeten me kaq, në vitet e fundit të jetës, duke shfrytëzuar publikimin e Radloffit, ka përkthyer *Shkrimet e Orbunit* në turqishten e Turqisë. Përveç kësaj, duke përfituar nga publikimi i Vembery-t, bën shqyrtimin shkencor edhe të *Kutadgu Bilig-it*, veprës së parë islame të literaturës turke të periudhës së karahanëve.<sup>68</sup>

Shikuar nga këndi i turkologjisë, shohim qartë se Samiu është autor edhe i dy veprave me peshë: *Dhuratë finoke për gjuhën turke* (et-Tuhfetu'z-zekijje fi'l-lugati't-Turkijje) edhe *Dialekti turk në trevat egjiptiane* (Lehxhe-i Turkijje-i memalik-i Misir).

Në kuadër të veprave samijane vend të çmuar zë edhe *Kamus-i Turki*, që autorin e vë në një pedestal të lartë në kuadër të historisë turke të fjalorshkruarjes.<sup>69</sup>

■

<sup>68</sup> Këtë vlerësim për Samiun e bën historiani i letërsisë Nihad Sami Banarlli. Shih: *Po aty*, f.q. 360-361.

<sup>69</sup> Osman Fikri Sertkaja, në një shkrim me rastin 117 vjetorit të lindjes dhe 63 vjetorit të vdekjes së Sami Frashërit ka bërë vlerësimin e *Kamus-i Turki*. Pjesën që ka të bëjë me artikullin tonë po e japin në vijim: (...) "Në historinë tonë të leksikografisë, Sami Frashëri zë në një vend të lartë. *Kamus-i Turki* mban epitetin e fjalorit të turqishtes më të gjallë në kuadër të

■  
 fjalorëve të shkruar në shekullin e fundit. Edhe pse nga botimi i tij kanë kaluar 67 vite të plota, asnjë fjalor i turqishtes i botuar pas tij s'e ka arritur e jo më t'ia ketë tejkaluar atij. *Kamus-i Turki* para së gjithash na ka prurë një koncept të ri të fjalorit, gjë që vërehet qysh nga kujdesi i tij në përzgjedhjen e titullit të librit. Siç dihet ai i ka hedhur mënjane shprehjet e përdorura deri atëherë *Lugat-i osmani* ose *Kamus-i Osmani* (Fjalori osman) dhe në vend të tyre e ka përdorur termin turki (turk). Fakti se fjalori i Ahmed Vefik Pashës që ngërthente vetëm fjalë turke ishte pagëzuar si *Lehçe-i Osmani* (Gjuha osmane), edhe më tepër flet për kujdesin që Sami Frashëri ka treguar gjatë zgjedhjes së emrit të veprës së vet. Ai lidhur me këtë në Parathënien e *Kamus-u Turki* thotë: "Meqenëse tek ne është bërë traditë që të përdoren shprehjet "fjalor i arabishtes" dhe "fjalor i persishtes", ndoshta do të ketë të atillë që do ta kundërshtojnë emërtimin *Kamus-u turki*. Por gjuha jonë është gjuhë turke. Është absurde që fjalorëve të kësaj gjuhe t'u vihen emra të tjerë. Edhe pse në gjuhën tonë ka shumë fjalë të huazuara nga gjuhë të tjera, numri i tyre prapë-seprapë është i kufizuar". Risia e dytë të cilën e solli Sami Frashëri është e rëndësishme po aq sa e para. Fjalorët e botuar deri në atë kohë, në përgjithësi, përfshinin vetëm fjalët arabe dhe persiane që e përbënin turqishten osmane. Fjalët turke shiheshin me një sy përçmues, nuk merreshin në konsideratë duke u nisur nga ideja se "ajo është gjuha jonë, sikush e di atë". Madje shumica e këtyre fjalorëve, pa marrë parasysh janë përdorur ose jo në gjuhën osmane, meqë kanë qenë të mbushur me fjalë të panevojshme arabe dhe persiane dhe për pasojë shumë fjalë turke që s'kanë kaluar në gjuhë e shkrimi janë harruar: "Fjalorët e mbushur deri më 80 % me fjalë të papërdorshme janë quajtur Fjalor i osmanishtes, kurse fjalët turke janë konsideruar të mirënjohura dhe nuk janë përfshirë në to. Sikur të mos ishte kjo praktikë nuk do të kishte nevojë

■  
 të përdornim fjalorë komentues arabisht-arabisht, persisht-persisht, frëngjisht-frëngjisht, fjalorët e Larousse-it, ai Littre..." Samiu deri diku e ka penguar eliminimin e fjalëve turke. Sipas tij, një gjuhë e quajtur gjuhë osmane nuk ekziston. Gjuha jonë është gjuhë turke. Edhe pse një numër i caktuar i fjalëve që përdoren në turqishte janë të huaja, ato tanimë janë bërë pjesë e turqishtes, janë turqizuar. Ato s'mund të largohen prej turqishtes, s'ka nevojë dhe mundësi për një gjë të tillë. "Është e pakuptimtë të bëhen përpjekje për të larguar fjalët dhe terminologjinë me origjinë arabe dhe persiane, siç është e pakuptimtë që nga anglishtja të përjashtohen fjalën me prejardhje frënge, gjë të cilën s'mund ta paramendojë asnjë anglez". Sami Frashëri duke u nisur nga kjo ide i ka përfshirë në fjalorin e tij të gjitha fjalët e përdorshme, kurse ato ta përdorurat nuk i ka përfshirë bile edhe nëse janë me gjenezë turke. "Fjalori i kësaj gjuhe duhte t'i përmbledhë fjalët dhe terminologjinë turke si dhe të huazuarën nga gjuhët e tjera dhe t'i lërë mënjanë fjalët që s'hyjnë në përdorim". "Fjalori i çdo gjuhe duhet t'i mbërthejë në vete të gjitha fjalët që janë në përdorim dhe t'i përjashtojë ato që s'shfrytëzohen. Sipas kësaj mund të themi se s'është produkt i gjuhës tonë ai fjalor që i përmbledh në vete fjalët arabe dhe persiane të përdorshme dhe të papërdorshme dhe që s'përfshin në vete fjalët me origjinë turke. Gjithashtu s'mund ta trajtojmë si fjalor të përsosur të gjuhës tonë as atë që i përfshin vetëm fjalët turke dhe që i lë jashtë fjalët dhe termat arabe dhe persiane që janë të përdorshme". Këto qëndrime të Sami Frashërit na japin të kuptojmë për konceptin e tij të leksikologjisë. Sipas tij, fjalori i përsosur duhet t'i ketë këto veçori: "Sipas meje, që ky fjalor (Kamus-i Turki) të jetë i përsosur, duhet t'i përfshijë të gjitha fjalët me prejardhje turke. Ç'e do që deri tani shumë pak janë bërë përpjekje për tubimin e fjalëve të gjuhës sonë. Ndërsa te popujt e tjerë ka vëllime të tëra me



Siç dihet, që nga gjysma e dytë e shekullit XIX, te inteligjencia turke vërehet një proces i vetëdijshëm i kërkimit të identitetit. Këto përpjekje për caktimin e identitetit në vartësi të koncepteve të kombit, historisë, politikës, gjuhës dhe letërsisë, mbeten në rrafshin akademik. Për ndërtimin e identitetit nuk mjafton populizmi i ngushtë i Shinasit, pikëpamja për historinë dhe letërsinë e formuar nga karakteri i Namik Kemalit, e as poezia e Zija Pashës e

■  
*emrat dhe biografite e leksikografëve, tek ne askush nuk mendon të merret me këtë shkencë, fjalët kanë mbetur të pakodifikuara. Për të arritur një vepër të tillë nuk mjafton vjelja e të gjitha veprave të shkruara në gjuhën turke, duhet udhëtuar në të gjitha trojet ku flitet kjo gjuhë, duhet biseduar me njerëzit që e njohin mirë këtë gjuhë nga shtresat e ndryshme. Vetëm kështu mund të bëhet kodifikimi i gjuhës turke, duke i përmbledhur dhe regjistruar edhe fjalët më të rralla. Një gjë të tillë mund ta realizojë vetëm njeriu që tërë jetën ia kushton kësaj veprimtarie. Duhet ditur se me të parën herë s'mund të arrihet përkryerësia, një gjë të tillë, me kalimin e kohës, mund të arrijnë leksikologët duke dhënë maksimumin e tyre në përplotësimin e veprave të pararendësve". Intelektuali ynë i lartë synon ruajtjen e turqishtes me ndjenja nacionaliste të larta, qysh para 67 viteve e ka treguar rrugën më të drejtë në këtë lëmi. Për fat të keq, sot shënohet një shkarje nga kjo vijë. Sot shënohet një anarki e vërtetë e fjalëve. Fjalët e gjalla, për shkaqe të injorancës dhe ideologjike hidhen mënjanë, nga ana tjetër sugjerohen fjalë artificiale. Në këtë mënyrë, turqishtja ngulfatet dhe zëvendësohet me një gjuhë zogjsh. Për shkak të mosndjekjes së rrugës së Sami Frashërit, të treguar para gjysmë shekulli, sot gjuha ka rënë nën nivelin e kohës kur është shkruar Kamus-i Turki, i cili sot duhej të ishte tejkaluar. Me siguri se eshtrat e Samiut s'janë rehat për shkak të bastardimit të turqishtes.*



cila pasqyron tiparet e periudhës së tij të fëmijërisë. Kërki-  
mi i turkut në gjuhë, histori dhe letërsi, nivel akademik fi-  
ton me personalitetin e Ahmed Vefik Pashës, me atë të  
Ahmed Xhevdet Pashës, të Sulejman Pashës dhe të Sami  
Frashërit.<sup>70</sup>

## Veprat letrare të Samiut dhe pozita e tij në letërsinë turke

Sami Frashëri ka lënë pas vetes 54 vepra, prej të cilave  
42 janë botuar. *Dashuria e Talatit me Fitneten* (*Taşşuk-i Talat  
ve Fitnet*, 1871-1872) ka një rëndësi të madhe për letërsinë  
turke, sepse përbën romanin e parë në gjuhën turke.<sup>71</sup>

<sup>70</sup> Sadık Kemal Tural, *Şahsiyetler ve Eserler*,  
Ankara, 1993, fq. 49-50.

<sup>71</sup> Pas gazetës dhe teatrit, ndër format letrare  
perëndimore që janë futur në letërsinë turke janë  
edhe tregimi dhe romani. Në periudhën klasike të  
letërsisë turke (Letërsia e Divanit) nevoja për  
tregime dhe romane plotësohej në formë të  
mesnevive si *Lejla dhe Mexhnuni*, *Ferhatî dhe  
Shirini*, *Vamiku dhe Azra* etj. përmes rrëfimeve  
prozaike të shkruara që qarkullonin në popull si  
*Keremi dhe Asllë*, *Tahiri dhe Zyhreja*, *Trimëritë e  
Aliut* (r.a.), *Korroglu*, *Battallname*,  
*Salltukname*... Lloji rrëfimor sipas shembullit  
perëndimor fillet i ka në përkthimet. Rrëfimet e  
para në turqishte sipas modelit perëndimor i  
hasim te Ahmet Mit'hat Efendiu me serinë e  
veprave *Kissadan Hisse* dhe *Letaif-i Rivajat*, që  
filluan të botohen prej vitit 1870. Përpyekja e  
dytë në këtë drejtim është vepra *Shkresë për ar-  
gëtimin e mbrëmjes* (*Musameretname*) e Emin Nihat  
Beut, e shkruar mes viteve 1873-1875. Më tutje  
sipas radhës pasojnë *Dashuria e Talatit me  
Fitneten* (*Taşşuk-i Talat ve Fitnat*, 1875), *Gatimi*  
(*Intibah*, 1876), *Xhezmi i Namik Kemalit* (1880),  
*Aventura* (*Sergüzeşt*, 1887), e Sami Pashazade  
Sezai Beut, *Dashuria ndaj karrocës* (Araba

Studiuesi i letërsisë prof. Mehmet Kaplan për të bën këtë vlerësim:

“Shkrimtarët turq, pas gjysmës së dytë të shekullit XIX janë ndikuar nga letërsia perëndimore, kështu që filluan të shkruajnë drama dhe romane sipas yrneku perëndimor. Së pari filloi përkthimi i romaneve nga gjuhët evropiane. Jusuf Qamil Pasha, një burrështetas, me një gjuhë të vjetër dhe të bukur më 1862 përktheu në gjuhën turke romanin e shkrimtarit francez Fenelon të titulluar *Telemak*. Më vonë, në gazetën *Xheride-i Havadis* është përkthyer shkurtimisht romani i Viktor Ygosë, *Të mjerët*. Më pas vijuan përkthimet e romaneve të njohura si *Robinson Kruzo*, *Monte Kristo*, *Atala*, *Pol* dhe *Virginia*. Në vitin 1870 Ahmet Mit’hat Efendiu shkroi shembujt e parë të rrëfimit nën titullin *Pjesë nga rrëfimi* (Kıssadan Hisse) dhe *Përcjellje urtësish* (Letaif-i Rivajet). Në vitin 1875, Sami Frashëri e botoi romanin *Dashuria e Talatit me Fitneten*, kurse më 1876 e botoi romanin *Intibab* (Gatimi). Kësisoj, në letërsinë turke lindi një traditë e tregimit dhe e romanit në formën perëndimore që dallon shumë nga rrëfimet dhe poemat klasike turke”.<sup>72</sup>

Këto vepra të para që trajtojnë tema të dashurisë dhe të ngjarjeve historike, në të cilat rastësitë zënë një vend të çmuar, edhe përkundër ngathtësisë kundrejt veprave perëndimore, kanë rëndësinë e vet ngase e kanë përgatitur lexuesin e tregimit dhe të romanit, e kanë edukuar njeriun tonë, i kanë dhënë atij dituri dhe e kanë ngritur atë moralisht. S’mund të mohohet as roli që këto vepra e kanë

■

Sevdası, 1889) e Rexhai Zade Mahmud Ekremi, *Gjëra të imta* (*Küçük Şeyler*, 1890) e Sami Pashazade Sezai Beut), *Karabibik* (1890) dhe *Zehra* (1896) e Nabizade Nazimit.

<sup>72</sup> Mehmet Kaplan, *Edebiyat-2*, Stamboll, 1977, fq. 31-32.

luajtur në gjetjen vend të konceptit evropian në strukturën shoqërore dhe në letërsinë osmane.<sup>73</sup>

Dr. Gyndyz Akënshë, në parathënien e veprës së tij *Türk Romanında Köye Doğru*, duke dashur ta theksojë pozitën dhe vlerën e *Dashurisë së Talatit me Fitneten* në romanin turk do të thotë:

“Është bërë shprehi që të thuhet se romani i parë i periudhës së Tanzimatit është *Fantazmat e gjuhës (Hajalat-i Dil)* i Hasan Tevfikut, i botuar më 1868; kurse në fakt kjo është një vepër iluzioniste e letërsisë sonë. Ajo kalon në ëndrra, është përplot përralla. Ismail Hakki Danëshmend (gazeta *Cumhuriyet*, 25 nëntor 1942) gabon kur e paraqet si romanin e parë të letërsisë turke. Është shumë më e saktë të thuhet se romani i parë i kohës së Tanzimatit është vepra e Samiut *Dashuria e Talatit me Fitneten* (1872). (Këtu nuk do të ndalem te arsyeja, do të them vetëm se te ky gjykim më kanë shpënë mënyra e përpunimit të temës, gjallëria e personazheve kryesore dhe ndjenja e besueshmërisë që lë vepra).<sup>74</sup>

Në këtë roman, flitet për pozitën e gruas në shoqërinë tonë, për raportet martesore, për problemet që shkaktojnë martesat e pavend. Në të me një teknikë të thjeshtë të rrëfimit janë shfaqur pasojat e hidhura të martesës pa u

■

<sup>73</sup> *Türk Dünyası El Kitabı*, vëll. 3, fq. 390.

<sup>74</sup> Gündüz Akıncı, *Türk Romanında Köye Doğru*, Ankara, 1961, fq. 10. Më vonë edhe Sedit Jyksel, i cili e përgatiti për botim me shkronjat e reja veprën *Dashuria e Talatit me Fitneten*, e mbështeti qëndrimin e Akënshiut. Shih: *Taaşuk-ı Talat ve Fitnat*, përgatiti: Sedit Yüksel, botimi i dytë, Ankara, 1979, fq. IV.



parë djali e vajza, analizat e karakterit emocional janë shprehur me gjuhën e përditshme (me gjuhën vendore).<sup>75</sup>

Sami Frashëri përveç veprave origjinale ka bërë edhe përkthime të rëndësishme, të cilat kanë lënë gjurmë në atë kohë, si p.sh. *Tetari plak* (İhtiyar Onbaşı, 1874), *Robinson* (1884), *Sefiller* (Të mjerët, 1880).<sup>76</sup>

Xhemil Meriçi, duke e zbërthyer çështjen e përkthimit thotë:

“Përkthimi nuk duhet të jetë një fotografi e zbehtë, as imitim pa ngjyrë dhe pa gjallëri. Sipas meje, përkthimi është krijim... si poezia, si eseja, por shumë më i rëndë se ato. Letrarët diqysh mund të merren vesh rreth dhjetë poetëve më të mëdhenj, rreth dhjetë romanshkruesve ose dramëshkruesve më të mirë. Kush prej nesh mund t'i numërojë dhjetë përkthyes të mëdhenj?

Po, përkthimi është arti më i rëndë: Ringjallje në tokën tonë të mendimit që ka lindur në një klimë dhe në një

■

<sup>75</sup> Ky roman së pari është botuar vëllim pas vëllimi. Një e dhënë e tillë gjendet në gazetën *Basiret* të 18 nëntorit të vitit 1872.

<sup>76</sup> Në origjinal *Les misérables*, vepër e shkrimtarit të njohur frëng Viktor Hugoit, që ndërtohet mbi jetëshkrimin e Zhan Valzhanit. Në jetën shoqërore, pika kyç është shpëtimi nga jeta e shndërruar në ferr. Në këtë ngjarje me peshë parakalojnë tipa nga shtresat e ndryshme të jetës sociale që e kahëzojnë rrjedhën e ngjarjeve. Romani në fjalë, ka tërhequr vëmendjen si pasqyrim shumëdimensional i jetës së asokohshme në qytetin e Parisit. *Të mjerët*, për herë të parë në letërsinë turke është bartur përmes përkthimeve të pjesërishtme nga gjuha arabe, nën titullin *Mağdurîn Hikâyesi* (Rrëfimi i të shtypurve). Në gazetën *Xheride-i Havadis* janë botuar pjesë nga kjo vepër në formë të serisë. Ky roman, si i tërë, për herë të parë është botuar nga Sami Frashëri.



kohë tjetër. A thua ringjallje vetëm e mendimit? Në përkthim, nënshtrimi fjalës përbën tradhtinë më të madhe“.

Nuk ka dyshim se Samiu i ka njohur dhe zotëruar mirë gjuhët prej të cilave ka përkthyer. Ai ka qenë mjeshtër i përkthimit të mirë letrar.

Njëri prej penave më të mprehta të letërsisë turke të Servet-i Fununit,<sup>77</sup> Halit Zija Ushakllëgil në shkrimin e tij “Lëvdatë Shemsettin Samiut dhe pezëm ndaj Mual’lim Naxhiut“ shpreh elozhe për përkthimet e Samiut si *Të mjerët* dhe *Trashëgimitë e djallit* (Şeytanın Yadigarları).<sup>78</sup> Shi-

■

<sup>77</sup> Emri i revistës (botuar mes viteve 1896-1901) që ishte organ i lëvizjes së Letërsisë së Re (Edebiyat-i Cedide) që lindi pas Tanzimatit, si oponente e Letërsisë së Vjetër (Edebiyat-i Atika). (Shih: *Sabah Genel Kültür Ansiklopedisi*, 2, f. 604 - shën. i përkth.)

<sup>78</sup> “Duhej të isha vetëm novelist, duke dashur të jem i shumanshëm, ishte e pashmangshme të pësoja fatin e atyre që s’janë gjë. Tregimi!... Isha i prirur që jetën ta perceptoj si tregim dhe për këtë arsye edhe i mahnitur nga ky zhanër. Pasi arrita një nivel të caktuar në njohjen e frëngjishtes, me përjashtim të përkthimit të *Les misérables* të Sami Frashërit, s’kam lexuar më roman në gjuhën turke. Romani i parë që e kam lexuar në gjuhën frënge ka qenë *Dyluftim deri në vdekje* i Pierre Zaccon-it. Më pas lexova të gjitha tregimet e mëdha të kohës, të Eugen Sue, Paul Feval, Frederic Soulie etj... U ndala me Alexandre Dumas-në. U bëra i çmendur për të. Në saje tregimeve të tij historike u dashurova në historinë. A thua i kuptoja në fillim këto vepra? Natyrisht se jo. Por, nuk ndalesha në rreshtat që s’i kuptoja, madje s’i referohesha as fjalorit, lexoja në mënyrën si një kalë i shpejtë i kalon pamjet e ndryshme. Atyre që duan ta mësojnë ndonjë gjuhë të huaj ua sugjeroj këtë metodë. Jam i mendimit se mënyra më e mirë e njohjes së fjalëve të panjohura është që çdonjërin prej tyre

■

ta njohesh në genien dhe vendin e vet, në klimën e vet, pa iu kthyer fjalorit.

Më pas vijon përkthimi... këtu, pa dyshim se duhet referuar fjalorit. Atëbotë, në vijën frëngjisht-turqisht s'kishte fjalor tjetër pos atij të përdorshmit të Bianchit dhe fjalorit të xhepit të Kalfasë i cili thua jse s'të nevojitej fare. Mu në atë kohë në ndihmë erdhi fjalori i bukur i Sami Frashërit. U botua vëllim pas vëllimi. Çdo vëllim e pritja me padurim. Dallgët iluminuese të kësaj veprimtarie mbresëlënëse të Sami Frashërit, që diturisë së vendit i bëri një prej shërbimeve më të mëdha dhe që thua jse vetë formoi një bibliotekë me veprat *Kamus al-A'lam* dhe *Kamus-i Turki*, e ngjallën brezin tonë. Unë atë e njihja përmes përkthimit të *Trashëgimive të djallit*, të *Të mjerëve të Hygosë* dhe nga traktati i tij *Hafta* (Java). Nën mbikëqyerjen e Jabasë edhe vetë u futa në veprimtarinë e përkthimit. Me një frymë përktheva *Mbretëresha Margot* të Alexander Dumas-it dhe *Aventura e dashurisë të Scribe-së*. Kjo e dyta s'e di se si më ka humbur. (...) S'mori leje, por shënimet sm'i ktheu. Kjo mbeti një çështje e pazgjidhur. Ky ishte pasqyrimi i parë që më dha të kuptoj se prej këtij njeriu do të ndahem me një përshtypje jo të mirë.

Një kohë, përmes përkthimeve m'u shtuan orekset. Doja t'ia filloj përkthimit të një drame. Veprën e Jean Racinit, *La Thebadie*. E përktheva me njëfarë turqishteje dhe ca pjesë të saj një natë në javë ua lexoja miqve që tuboheshin në dhomën time. Ata e dëgjonin me pasion dhe mahnitje të madhe. Fëmijëria shumë shpejt na mahniste.

Ajo që fascinonte në fakt ishte trimëria ime për të përkthyer nga një gjuhë të cilën s'e zotëroja mirë në një gjuhë tjetër (turqishte) me të cilën s'mund të mburreja para të tjerëve, që më shtyri që t'u dërgoj shkrime disa revistave të Stambollit dhe gazetës zyrtare të vilajetit. Edhe më interesante ishte që këto shkrime ishin pranuar dhe botuar. Ja kjo ishte zanafilla e karrierës sime prej shkrimtari".

het qartë se Samiu ka ndikuar shumë që Halit Zija të merret me përkthime dhe ta zhvillojë frëngjishten e tij.

Ndikimi i Samiut nuk vërehet vetëm te lëvizja e Servet-i Funun-it, por në përgjithësi te rryma e letërsisë kombëtare turke.

Në një kohë kur të shkruarit në gjuhën turke, me rimën e rrokjeve ishte i përçmuar, kur ithtarët e Servet-i Funun-it nuk njihnin vepra të tjera për t'u lexuar pos atyre në gjuhën frënge, Samiu e mbështet shkrimin në gjuhën turke.

Njëri prej mbështetësve më të mëdhenj të veprës *Poezi turqisht* (Türkçe Şiirler, 1898) të Mehmed Emin Jurdakullit, i cili para Mehmed Akif Pejanit e ka merituar ta marrë titullin „poet kombëtar“, është pikërisht Sami Frashëri. Jurdakull duke kërkuar përgjigjen pyetjes „Çfarë poezie duam?“ në një varg do të thotë:

Mos harro! Një popull që s'ka poetë me zërin si bori  
i përngjan një jetimi, prindërit e të cilit janë bërë hi.

Disa rreshta poetikë të zgjedhur nga ky libër, mendoj se mjaftojnë për ta shpjeguar dhe për ta kuptuar Samiun:

Unë jam turk, feja dhe trupi im janë madhështorë  
(duke shkuar në luftë)

Ne jemi turq, me këtë emër e me këtë gjak jetojmë.  
(duke e kaluar kufirin grek)

Ky është libër të brendshmen e të jashtmen që ta mëson,  
që Krijuesin në qiell, n'tokë, n'trup e n'shpirt ta dëfton!  
(për Kur'anin Famëlartë)

S'ka burrë turku që lejon ta lidhin me litar,  
s'lejon turku që xhamisë dikush kryq t'i var!  
(duke kaluar kufirin grek)



Te kjo ngritje zëri të Mehmed Eminut vërejmë gjurmët e ndikimit të Samiut. Në këtë drejtim janë të rëndësishme vlerësimet e prof. Sadik Turallit.<sup>79</sup>

Omer Sejfettini, i cili me artikullin “Gjuha e re” (Yeni Lisan), të botuar në revistën *Lapsat e rinj* (Genç kalemler), që ishte vazhdimësi e revistës *Magjepsja dhe poezia* (Hüsn ve Şiir), shkroi manifestin e letërisë kombëtare turke dhe konsiderohet ndër klasikët e prozës në gjuhën turke, si-kurse dhe letrarët e tjerë, ka qenë në rrugën e Sami Frashërit, prej ithtarëve të tij.

Omer Sejfettini, i cili vetë e kishte përjetuar të vërtetën e Ballkanit, në luftërat ballkanike ka marrë pjesë si luftëtar, ka mbërritur deri në Kumanovë dhe ka rënë rob në duart e grekëve. Ai në ditarin e vet të Luftërave Ballkanike, rrëfen se si e përkujton Samiun:

15 Teshrinisani (28 nëntor)

Këtë mbrëmje rashë në çadër dhe ndiehem disi mirë. Dikran Efendi Farmacisti përgatiti makarona me kaurmë. Kjo më ngjalli.

Jemi në rrugën për në Frashër. Çdo shqiptar që e takojmë thotë se është „afër“. Koha s’është e keqe, një diell i zbehtë që e zbut kohën. Rrugës një copë të bukës së misrit e shesin dhjetë grosh.

Vërehet një skamje e madhe.

Vendet që po i kalojmë janë humnera. S’ka gjë tjetër pos përroskave dhe baltës. Ndonjëherë, në largësi shfaqen katundet shqiptare me ngjyrë guri. Qielli është me mjegulla shiu. Ushtria e dërrmuar qesin në ajër kot së koti. Gëzhojat ca herë bien shumë afër nesh.

■  
<sup>79</sup> Sadık Tural, “Bir Hayat Hikâyesinin Ana Çizgileri: Milli Şair”, *Şahsiyetler ve Eserler*, Ankara, 1993, fq. 43-61.



Frashër, 12:00.

Qe dy orë jemi këtu. Ky fshat që ka dhënë kaq njerëz mendjendritur, s'është gjë tjetër pos një copë shkëmbi. Në çdo anë gurë. Shtëpitë janë të mëdha dhe të sistemuar mirë. Në rrugë fola me disa shqiptarë. U fola për njerëzit e mëdhenj të këtij fshati, për Samiun, Abdylin dhe të tjerët. Më treguan për disa ndërtesa të gurit që gjendeshin në largësi dhe shtuan: Tani të gjitha janë të zbrazura! Treguan se njerëzit e atij vendbanimi kanë gjetur prehjen në kasaba dhe e kanë harruar këtë dhé. Me të vërtetë s'është vend për t'u jetuar. Bile edhe vetëm shikimi me sy të shqetëson".<sup>80</sup>

## Në vend të përmbylljes

Samii Frashëri, i cili lindi më 1850, në një pikë të gjeografisë kulturore osmane, në moshën 23 vjeçare shtegtoi në kryeqytet, në Stamboll dhe atje krijoi një qark të dalluar. Samiu, i cili në veçanti, me punimet e tij në fushën e gjuhës turke ka ndërtuar një famë që arrin deri në ditët tona, në kuadër të politikës tretrajtëshe (osmanizmi, islamizmi dhe turkizmi) të periudhës së kërkimit të letërsisë turke, mbështeti turkizmin, të cilin e mori si pikënisje të vepërimitarisë së vet. Qëndrimi i tij në këtë temë është më tepër akademik sesa politik. Ai në historinë e mendimit dhe të letërsisë turke, pas Ahmed Vefik Pashës dhe Sulejman Pashës, është personalitet që patjetër duhet përmendur.

Rryma e letërsisë kombëtare e formuar dhe e zhvilluar nga Zija Gokalp, Ali Khanip dhe Omer Sejfettin mbi bazamentin e vënë nga ai dhe shokët e tij, është nismëtare e



<sup>80</sup> Ömer Seyfeddin, *Bomba*, botimi i pestë, Erdem Yayınları, Stamboll, 2002, fq. 150.

luftës dhe ndërgjegjes kombëtare që e ndërtuan Turqinë e sotme bashkëkohore.

Sami Frashëri, si për nga pikëpamja ideore, për nga ajo linguistike, ashtu edhe për nga disiplina e punës dhe në veçanti për nga metoda dhe terminologjia e përdorur, do të përmendet si një figurë kyç. Përdorimi prej tij i termit turqishte në vend të termit osmanishte, si dje ashtu edhe sot, si në aspektin thellësinor (historia) ashtu edhe në atë gjerësinor (gjeografia) hap horizonte të reja.<sup>81</sup>

Samiu veprat e tij i ka shkruar në gjuhën turke të shumëdashur prej tij. Ai e pati fatin që në periudhën e kërkimit të letërsisë turke të shkruajë dhe të botojë romanin e parë. Në këtë drejtim, ai është një pishtar. Ai, me *Kamus-i Turki* dhe *Kamus al-A'lam* është ndër prijësit edhe në fushën e leksikografisë.

Ndodh që përkufizimi më i shkurtër dhe më i drejtë i letërsisë të jetë ky: „Arti që lëndën e vet ia imponon gjuhës“. Shikuar nga ky këndvështrim mund të thuhet se Sami Frashëri është një nga figurat më të dalluara letrare turke.<sup>82</sup> Pasurimi i letërsisë dhe gjuhës në saje të përkthi-

■  
<sup>81</sup> Dilema nëse duhet të përdoret togfjalëshi “gjuhë osmane” ose ai “gjuhë turke” ekziston që nga Sami Frashëri. Në këtë çështje edhe Omer Sejfettini e ka mendimin e njëjtë me atë të Samiut: “Një komb që do të quhej kombi osman s’ekziston. Gjuha gjithsesi duhet t’i takojë një populli. Por shteti osman ekziston. Gjuhët ndërlidhen me kombet e jo me vendet. Gjuhës që flitet në Amerikën Veriore i themi gjuhë angleze e jo gjuhë amerikane”.

Për njohuri më të gjera lidhur me Omer Sejfettinin shih: Zeki Gürel, *Ömer Seyfeddin*, Alternatif Yayınları, Ankara, 2002.

<sup>82</sup> Sadik Turall, termin letërsi e përkufizon në këtë mënyrë: “Letërsia është tërësi e reflekseve të shkakut të krijimit të njeriut që shfaqen në nivelin mendimor, fryt i kërkimit të më të

mit të veprave të tij është një punë që duhet përshëndetur dhe çmuar.

Nëse ujin e Vardarit e mbushni në shishe dhe e shpërdani në të katër anët, a thua mund ta mohoni faktin se burimi i tij gjendet në Vrutok? E vërteta që Sami Frashëri ka shkruar në gjuhën turke ose në ndonjë gjuhë tjetër, nuk e ndryshon të vërtetën tjetër se ai ka lindur në Frashër.

Ne sot duhet të bashkohemi rreth vlerave si Samiu, të priremi nga shkenca dhe nga e vërteta, të ecim vëllezërisht në rrugën e hapur nga ai.

Siç duket ky organizim do të ndihmojë që kjo vëllezëri të vihet mbi themele të shëndosha. Sipas meje, hapi i parë duhet të jetë përpilimi i një fjalori të mirëfilltë turqisht-shqip/shqip-turqisht<sup>83</sup> duke ndjekur vijën e Sami Frashëri si gjuhëtar, letrar, mendimtar dhe njeri i kulturës.

Ju falënderoj për kujdesin dhe shpreh nderimet e mia më të thella!

## **Position and Importance of Sami Frasheri in the Turkish Literature**

After a short survey on the biography of Sami Frasheri, the paper first concentrates on the world of the ideas of

■  
pëlqyerës, më të bukurës, më sublimes, i kompozimit të tyre duke shfrytëzuar aftësitë e veçanta të gjuhës me një qasje emocionale". Sipas tij personat që bëjnë kompozime gjuhësore quhen letrarë. Shih: Zeki Gürel, *Türkistan Yazıları*, Berikan Yayınları, Ankara, 2004, fq. 174.

<sup>83</sup> Me sa kam arritur të vërej ekzistojnë tre fjalorë turqisht-shqip: Sami Neziri, *Türkçe-Arnautça Sözlük*, Tiranë, 2003; Rian Dişçi, *Arnavutça Konuşma Kılavuzu - Türkçe-Arnautça/Arnavutça-Türkçe Sözlük*, Fono Yayınları, Stamboll, 2000; Hysen Voci, *Fjalor Turqisht-Shqip*, Tiranë, 2002.



Sami. He lived in the period of re-making of world politics, while for the Ottoman Empire it was the century of decadence. Sami differs from many of his contemporaries with his understanding of the patriotic sentiment dramatically progressing over the whole Europe. Together with his scientific approach Sami became one of the ideological leaders of the Turkish nationalism. He was a common man of literature, a competent translator, and a great scientist of language. With his French-Turkish and Turkish-French dictionaries he contributed to the development of the Turkish-French relations. On the other hand, his lexicographical works influenced all dictionaries of the later periods. His six volumes of *Kamus al-A'lam* represent a rich encyclopedia of history, geography, and famous people.

Sami Frasheri belongs to the authors of the research period in the Turkish literature, but his most precious contributions are in the field of the nationalist spirit and purification of the Turkish language. He appraised it as an ancient, rich, beautiful and independent language. Beginning in 1880 with the paper "Turkish language" (*Lisan-i Turki*), published in *Hafta* magazine, and following with the other paper "Our language and literature" (*Lisan ve Edebiyatımız*) published in *Tercuman-i Hakikat*, he expressed with great love his scientific considerations on the Turkish literature and language. He crowned his dedicated work with the richest dictionary of the Turkish language *Kamus-i Turki* (1901).

Sami Frasheri compiled 54 books, from which 42 were published. Among others, he was the author of the first novel in Turkish (*Taşuk-i Talat ve Fitnet*, 1871-1872). He created in a period when three important trends were delineated in the political and cultural thinking on the future of Ottoman Empire – Osmanism, Islamism, and Turkism.



He joined Turkism, which remained as the guide of his activity in all the cases. His approach was more academic than political. As a linguist, Sami insisted on the clear distinction between the Ottoman language and the Turkish language, based on the long history of the Turkish nation.

Sami Frasheri's contribution to the field of linguistics

If we look on the work of Sami Frasheri even limiting ourselves in one field like linguistics, we once more note the encyclopedic dimension of his activity. He paid due attention to issues from simple orthography up to the nature and the origin of the language. Therefore it is impossible in a short paper to consider his voluminous lexicographical contributions, his Turkish dictionaries, as well as school textbooks and grammars of a number of languages. Apart from them three types of his work could be traced: 1) theoretical approaches, 2) descriptive works, and 3) language codification.

It was expected than in his book *The Man* (1879) Sami would also mention the language as the first distinctive sign of the human beings. Seven years later (1886) he published a separate booklet under the title *The Language*. We can consider it as a to-day textbook on elementary linguistics, adapted from French. Even some terms are in French, because for the Turkish language of the time they were quite new words. Sami followed the contemporary linguistic thinking, adding to this the data from the Oriental languages.

*Shkronjëtorë e gjuhësë shqip* (Albanian Grammar) is considered the first grammar of our language published in Albanian, with Albanian terminology and aimed at Albanian schools. It should be placed in the wider context of his works on Turkish and Arab grammars, and it is compiled following the method in describing the European languages. Once more we see at the end of the book a linguistic glossary including French terms. In this way we have an

explanation for the high level of the definitions and systematic description of the grammatical categories in this work. Another dimension is added to the competence of Sami in linguistics calling him a grammarian.

In general, in linguistic work of Sami we find the major conceptions of the Albanian Renaissance men concerning the Albanian language. For them this was a very ancient language. Sami accepts the thesis on the Illyrian origin of Albanian language. It is listed as a separate branch in the Indo-European family of languages. He considers it a beautiful tongue. Moreover, it was a perfect language, an opinion generally common for the Romanticism. In the Albanian language could be expressed all the domains of science and culture, and could be created artistic literature. If this language would be purified from unnecessary borrowings, it would be enriched with words from its inner means. The language is the mark of the nationality, and the Renaissance people put the language in the centre of their concern for the future of the nation.

The contribution of Sami Frasheri was directed to the codification of the language norm as well as to the codification of its status. His Grammar aimed the normativization of the use. His work on the Albanian language was part of his general scientific activity in the description and the codification of several languages.

*Prof. Dr. Xhevat Lloshi\**  
(*Shqipëri*)

**NDIHMESA E SAMI FRASHËRIT  
NË FUSHËN E GJUHËSISË**

---

Po të vështrohet puna e Sami Frashërit qoftë edhe në një fushë të vetme, siç është gjuhësia, përsëri do të dalë në pah përmasa enciklopedike e veprimtarisë së tij. Ajo përfshin trajtesa që nga rregullat e pikësimit e deri te natyra dhe prejardhja e gjuhës si dukuri njerëzore. Për këtë arsye në një kumtesë të shkurtër nuk do të mbetet vend të prekeshin vëllimet e tij leksikografike, domethënë fjalorët (i turqishtes dhe dygjuhësh: frëngjisht-turqisht, turqisht-frëngjisht, arabisht-turqisht) dhe dorëshkrimi i fjalorit të shqipes, e gjithashtu tekstet mësimore, si gramatika e sintaksa e turqishtes, për arabishten sintaksa, lakimet, ushtrimet dhe një gramatikë.<sup>84</sup>

Ndihmesa e Samiut atëherë mund të gjurmohet përmbledhtazi në tre drejtime të ndërlidhura: 1) trajtimi teorik, 2) përshkrimi dhe 3) kodifikimi gjuhësor.

■

\* "Universiteti i Tiranës", Tiranë

<sup>84</sup> Për të dhënat bibliografike shih paraqitjen e zgjeruar nga Zymber Hasan Bakiu, në: Sami Frashëri, *Vepra 8*, Rilindja, Prishtinë, 1984, dhe Agâh Sirri Levend, *Sami Frashëri*, DITURIA, Tiranë 2004, f. 130-133.



1. Ishte e natyrshme që në broshurën *Njeriu* (1879)<sup>85</sup> Samiu do të cekte edhe gjuhën. Sipas tij, të folurit ka qenë shenja dalluese fillestare e qenieve njerëzore. Të folurit ka nisur me disa tinguj e shenja, me fjalë njërrrokëshe, e më vonë u shtuan fjalët e trajtat. Në shfaqjen e tyre të parë gjuhët kanë qenë të ndryshme e të llojlojshme. Po të mbajmë parasysh lexuesin e Perandorisë Osmane të asaj kohe, këto ide që vinin nga gjuhësia bashkëkohore europiane, i trondisnin besimet për prejardhjen jonjerëzore të gjuhës. Nga njohja konkrete e përhapjes së arabishtes, e cila kishte ngadhënjyer mbi gjuhët e tjera prej Egjiptit e deri në Persi, autori shtjellon po me atë mënyrë proceset e kontakteve dhe të përzierjeve të gjuhëve, si edhe të ndarjes së tyre, duke shpjeguar burimin e lidhjeve ndër-gjuhësore. Ndërsa lindjen e shkrimit e lidh me shfaqjen e pushtetit shtetëror e të fesë, duke nisur me të kohët historike, pohime këto që mbeten të drejta edhe sot.

Shtatë vjet më pas (1886) Sami Frashëri botoi një broshurë më vete me titullin *Gjuha*.<sup>86</sup> Është përgatitur sipas tipit të teksteve që kemi sot për *hyrjen në gjuhësi* dhe ka shumë mundësi që të ketë ndjekur një libër frëngjisht të kohës, siç e dëshmojnë disa terma të lënë frëngjisht në tekst, meqë ndërtoheshin për herë të parë për vetë turqishten. Në thelb kemi vijimin e trajtimit të nisur te broshura e mëparshme; kështu p.sh., shtjellohet më tej lindja e fjalëve nga tingullimitet e nga përdorimet e rastit të bashkimeve tingullore, por këtu flitet hollësisht për vetë natyrën e gjuhës si mjet komunikimi, për zanafillën dhe jetën e saj. Jepet tipologjia e gjuhëve dhe përshkruhen tre grupet kryesore: gjuhët njërrrokëshe, përngjitëse dhe eptuese. Autori e shpreh drejtpërdrejt se gjuhësia është një

■

<sup>85</sup> Sami Frashëri, *Njeriu*, Logos-A, Shkup 2004.

<sup>86</sup> Sami Frashëri, *Gjuha*, Logos-A, Shkup 2004.



shkencë ende e panjohur në Perandorinë Osmane. Ndonëse kështu ai bënte hapin e parë në dijet turke të atij shekulli, vepra ka ide tepër largvajtëse për mjedisin përkatës, të cilit i drejtohej. Po përmend vetëm një shembull: Samiu e quan një mendim të çuditshëm atë, sipas të cilit gjuha ka ekzistuar para shfaqjes së racës njerëzore, kurse vetë pranon evoluimin shkallë-shkallë deri në gjendjen e sotme. Tërthorazi kjo është mospranim i thënies biblike, se në krye të herës ka qenë fjala; përkundrazi, autori pohon se gjuha lidhet me përparimin mendor të njeriut.

Shkurt, në qasjen teorike, Samiu është në vijën e mendimit bashkëkohor europian, duke e mbështetur me të dhënat nga njohja e tij e thelluar e gjuhëve të rëndësishme lindore. Është e vërtetë, se shkrime të tilla nuk ishin shqip, por kjo nuk e përjashtonte që intelektualët shqiptarë, të shkolluar në Perandorinë Osmane, të njiheshin me ato ide. Me këtë rast dëshiroj të shtoj këtë përmasë të re për perceptimin e krijimtarisë së Sami Frashërit. Deri më sot janë quajtur si diçka pa lidhje me shqiptarët vëllimet e tij turqisht, por harrohet se gjuha sunduese e shtetit dhe e kulturës për disa shekuj ishte edhe për shqiptarët turqishtja e kohës, rrjedhimisht, edhe ata e shfrytëzonin literaturën në atë gjuhë. Samiu lexohej nga shqiptarët e shkolluar edhe turqisht. Këto janë dukuri të zakonshme në rrethanat e dygjuhësisë, siç do ta tregonte paralelizmi me rusishten për popujt e tjerë në ish Bashkimin Sovjetik, ose me serbishten për shqiptarët nën sundimin e ish Jugosllavisë.

2. *Shkronjëtoe e gjuhësë shqip*<sup>87</sup> është quajtur e para gramatikë e gjuhës sonë, e botuar shqip dhe me terminologji shqipe, e para gramatikë për shkollat shqiptare dhe nga më të mirat ndër gramatikat e dala për shqipen në shekullin



<sup>87</sup> Sami Frashëri, *Shkronjëtoe e gjuhësë shqip*, DRITA, Bukuresht 1886.

XIX.<sup>88</sup> Është e vërtetë që në synimin e parë ky ishte një libër mësimor për shkollat shqipe të sapohapura, por në atë periudhë me gjithë punën e rëndësishme të paraardhësve, si të Kristoforidhit, mund të pohohet se përshkrimi i strukturës gramatikore të shqipes ishte në zanafillë, prandaj vepëra e Samiut ishte edhe një ndihmesë në paraqitjen e një gjuhe të re për qarkullimin në fushën e gjuhësisë. Kristoforidhi, gjithashtu, e kishte konceptuar si të tillë në një drejtim gramatikën e tij: për t'u sjellë dobi albanologëve. Në atë shekull ishte me vlerë çdo përshkrim për një gjuhë të ndryshme nga rrethi i zakonshëm i pak gjuhëve europiane me traditë të gjatë përshkrimi shkencor.

Nga ana tjetër, kjo vepër duhet vendosur në kontekstin e gjerë të punës së Samiut për përshkrimin e gjuhëve. Që më 1884 ai shënonte<sup>89</sup> se kishte hartuar tashmë librat për rregullat e gramatikës arabe, rregullat e sintaksës arabe, lakimet arabe, ushtrime të gjuhës arabe dhe rregullat e pikësimit e të radhitjes. Ndërsa më pas (më 1890) ka botuar një abetare dhe një gramatikë të turqishtes me një metodë të re, si dhe ka lënë dorëshkrim një sintaksë të turqishtes sipas metodës së re. E quaj të rëndësishme të theksoj

■  
<sup>88</sup> Shih për vlerësimet kryesore: Jup Kastrati, *Gramatikat e shqipes, II*, në: Buletin Shkencor i Institutit Pedagogjik Dyvjeçar të Shkodrës, 1964, nr. i posaçëm, f. 258-261; Shaban Demiraj, *Ndihmesa e Sami Frashërit në lëvrimin e gjuhës shqipe*, në: Studime filologjike, 1979, nr. 3, f. 3-12; Fatmir Agalliu, "Shkronjëto e gjuhësë shqip" e Sami Frashërit - vepër e rëndësishme e gramatologjisë shqiptare, në: Studime filologjike, 1979, nr. 3, f. 13-29; Rexhep Ismajli, *Gramatika e Sami Frashërit*, Fjala, 1980, nr. 1.

<sup>89</sup> Në *Bibliografinë*, të cilën S. Frashëri e ka shtuar në fund të librit *Përpyjekjet e heronjve në përhapjen e Islamit*, Stamboll 1884, botuar shqip nga Logos-A, Shkup 2003.

ngulmimin e autorit disa herë për “metodën e re”. Nga përmbajtja e teksteve më duket se del e qartë, që metoda e re e përshkrimit do të thoshte sipas mënyrës së përshkrimit të gjuhëve të reja europiane, e konkretisht të frëngjishtes. Jo rastësisht për terminologjinë e dhënë në fund, krahas neologjizmave për shqipen, autori ka shënuar menjëherë fjalët e frëngjishtes. Për këtë arsye e shoh të nevojshme të vë në dukje diçka që nuk përmendet lidhur me gramatikën e tij të shqipes: Samiu ka ndjekur edhe për shqipen një metodë të re, domethënë modelin e gramatikave të frëngjishtes. Me këtë shpjegohet niveli i lartë i përkufizimeve të nocioneve e kategorive gramatiko-re dhe sistematika e paraqitjes së eptimeve.<sup>90</sup>

Përmasa tjetër e re që i shtohet kështu perceptimit të krijimtarisë së Samiut është se ai nuk ka qenë thjesht hartues i një gramatike të shqipes, qoftë dhe me meritat e përmendura më lart, por ka qenë gramatolog përgjithësisht. Në këtë vështrim del e nevojshme që të njihemi edhe me tekstet për turqishten e arabishten, për të dhënë një gjykim më të plotë për vlerën e punës së tij dhe për rrishtë që ka sjellë në këtë drejtim. Do të shtoja këtu, se nga një shqyrtim i shpejtë i *Abetares* së tij,<sup>91</sup> del se për togjet e tingujve (mësimet 10 deri 21) janë ndjekur zgjidhjet për gjuhët orientale.

3. Në trajtimin e shqipes përgjithësisht Samiut gjuhëtar i bashkohet edhe Samiu atdhetar. Duke sintetizuar koncep-

<sup>90</sup> Rrjedhimisht, nuk qëndron pohimi i F. Agalliut, *vep. e cit.*, f. 14: “Të marrim punën që ka bërë Samiu me përkufizimet, ku meritat e tij janë të mëdha”. Këto përkufizime janë përkthyer nga tekste për gramatikën e një gjuhe europiane, që ishin më të mirat për kohën. Meritën e Samiut e përbën orientimi drejt fjalës së fundit të dijeve dhe shqipërimi me kompetencë e mjeshtëri.

<sup>91</sup> Sami Frashëri, *Abetare e gjuhësë shqip*, DRITA, Bukuresht 1886; *Küçük Elifba* (Abetare e vogël), Stamboll 1882.



timin e rilindësve për shqipen si pjesë thelbësore e qenies kombëtare, ose sipas thënies së tij “Prandaj më parë nga të gjitha do të mbahetë gjuha”, si dhe për nevojën e lëvrimin të saj për të qenë mjeti i zgjimit të ndërgjegjes kombëtare, Sami Frashëri dashurinë për gjuhën amtare e mbështeste edhe te bindja për vlerat e saj të veçanta. Për rilindësit shqipja duhej të ishte gjuhë e rëndësishme në rrafsh historik europian dhe shkencor, e jo thjesht gjuha e atdheut të tyre. Teza e parë ishte lashtësia e shqipes. Te zëri *Shqiptarët* në enciklopedinë e tij<sup>92</sup> duket qartë, se është mbështetur në studimet më të fundit për gjuhët indoeuropiane dhe pranon mendimin e prejardhjes ilire të shqipes, ndërsa në një shkrim të vitit 1878 e quante si të vështirë të provohej, se pellazgjishtja e vjetër ka qenë e njëjtë me shqipen e sotme.<sup>93</sup> Teza e dytë ishte se shqipja përbente një degë më vete, që vinte drejtpërdrejt nga familja e vjetër indoeuropiane. Teza e tretë ishte bukuria e shqipes. Bashkë me të tjerat kjo tingëllon gjithandej në manifestin e tij politik *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë*. Teza e katërt ishte se shqipja madje shfaqej si gjuhë më e mirë e më e përsosur sesa mjaft të tjera. Teza e pestë ishte se në shqipen mund të shpreheshin të gjitha fushat e dijes e të kulturës dhe të krijohej letërsi e bukur. Teza e gjashtë ishte se shqipja, po të lëvrohej, do të bëhej e pasur dhe e pastruar nga huazimet e panevojshme. Teza e shtatë përmbledhëse ishte se gjuha përbën shenjën e kombësisë.

■

<sup>92</sup> Shih te përmbledhja e zërave përkatës të përkthyer shqip në: Sami Frashëri, *Personalitetet shqiptare në Kamus al-a’lâm*, Logos-A, Shkup, 2004.

<sup>93</sup> Sami Frashëri, *Duke provuar të vërtetën*, Terxhumani Shark, 4 korrik 1878, në: Sami Frashëri, *Vepra I*, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë 1988, f. 137.



Këto ishin përbërëset e mitologjisë rilindëse për shqipen, porse pa këtë nuk do të kishte qenë ai frymëzim i pasionuar për ta lëvruar shqipen.

Në këtë vështrim, puna kodifikuese e Samiut na del në të dy rrafshet: edhe për kodifikimin e normës, edhe për kodifikimin e statusit. Për ta shpëtuar shqipen nga rreziku që të humbiste në rrethanat e kohëve moderne,<sup>94</sup> atdhetarët e tjerë dhe Samiu i hynë punës për alfabetin e qëndrueshëm, hartimit të abetares, pasurimit të shqipes nga gurra popullore e me neologjizma dhe pastrimit nga huazimet e tepërta, përcaktimit të drejtshkrimit deri në një farë mase dhe normativizimit gramatikor. Nga kjo pikëpamje, Gramatika e tij është me prirje normativizuese.

Lidhur me kodifikimin e statusit, natyrisht, problemi qendror ishte ndarja dialektore. Janë tashmë gjerësisht të njohura fjalët e tij për një shqipe të pandame e të njëjtë, se shumë gjuhë e dialekte sjellin ndarje e mërgim.<sup>95</sup> Para së gjithash, ai e shihte të mundshme arritjen e këtij synimi, sepse dialektet nuk i vështronte me dallime të mëdha, ndërsa një pjesë e pasurive të shqipes jetonte e shpërndarë ndër dialektet, madje edhe në të folmet e kolonive. Si rrugë të nevojshme për të arritur te një gjuhë e shkruar në funksionin kombëtar, te varianti standard siç do ta quanim sot, ai quante bashkimin e përzierjen e dialekteve. Besoj se jemi përsëri te mendimi i tij, i mbështetur te për-

■

<sup>94</sup> "Komb'i shqiptarëve, nga të mos shkruarët e gjuhës së vet, ka humburë gjer më sot më të shumët e njerëzet, po në ka humburë aqë në kaqë mijë vjet, ata që kanë mbeturë do t'i humpnjë në fort pakë kohë, se kol'e sotme nukë ngjan me kohërat e vjetëra". Sami Frashëri, *Alfabetare e gjuhësë shqip*, Stamboll 1879.

<sup>95</sup> Sami Frashëri, *Letër drejtuar Jeronim de Radës*, 20 shkurt 1881, në: Sami Frashëri, *Vepra 2*, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë, 1988, f. 373-377.

voja e gjuhëve orientale, në veçanti arabishtes e osmanishtes, se një proces i tillë njihet nga historia. Ndërkaq, e vlen të vihet në dukje diçka te thënia e tij e mësipërme, që nuk është prekur më parë. Samiu ishte edhe kundër pranisë së shumë gjuhëve në statusin e gjuhëve kombëtare për shqiptarët. Realisht në trojet shqiptare të katër vilajeteve kishte dukuri të përhapura të dygjuhësisë e mund të imponoheshin edhe gjuhë të tjera të shkruara, pa përmendur osmanishten sunduese. Së fundi, fjalët e kësaj letre lidheshin me projektin e një gazete shqipe për gjithë Shqipërinë. Një gazetë të tillë Samiu e shihte si pikën e takimit për të gjithë shqiptarët dhe si mjetin më të dobishëm për të arritur te një gjuhë letare e bashkuar.

Do të përsërisim këtu, se çështjeve të kodifikimit të shqipes Samiu gjithashtu nuk u qasej në mënyrë të shkëputur. Me të drejtë Hasan Kaleshi e ka lidhur këtë me formimin e gjuhës letrare turke.<sup>96</sup> Duke shkruar për jetën e veprën e Sami Frashërit,<sup>97</sup> edhe Rexhep Qosja e rimerr këtë lidhje të ngushtë dhe nxjerr në pah që sa i përket reformës së gjuhës turke, Samiu bëri përpjekje për modernizimin e alfabetit, të drejtshkrimit dhe të turqishtes letrare përgjithësisht, duke u mbështetur te gjuha popullore, duke e pastruar turqishten prej arabizmave e persizmave, në mënyrë që në statusin e gjuhës standard të ngrihej gjuha turke në vend të gjuhës osmane. Ndonëse ishin gjuhë të ndryshme dhe në kontekste të dalluara, përsëri Samiu edhe problemet e shqipes i shihte kështu me një këndvështrim të gjerë dijetari e veprimtari.

■

<sup>96</sup> Hasan Kaleshi, *Le rôle de Shemseddin Sami Frachery dans la formation de deux langues littéraires turc et albanais*, në: *Balkanica*, I, 1970, f. 197-216.

<sup>97</sup> Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe. Romantizmi*, III, Tiranë, 2000, f. 354-357.

Si përfundim, dëshiroj të vë në dukje se Sami Frashëri ka qenë një gjuhëtar shqiptar në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, domethënë një dijetar, që e jep ndihmesën e tij pavarësisht në cilën gjuhë i shkruan punimet, madje pavarësisht se për cilën gjuhë shkruan. Rrjedhimisht, puna e tij për shqipen është pjesë e pandarë e tërësisë së veprimtarisë së tij shkencore dhe ne do ta nderojmë si të parin gjuhëtar shqiptar, që ka dhënë ndihmesa edhe për përshkrimin e për kodifikimin e gjuhëve të popujve të tjerë.

## Sami Frasheri's contribution to the field of linguistics

If we look on the work of Sami Frasheri even limiting ourselves in one field like linguistics, we once more note the encyclopedic dimension of his activity. He paid due attention to issues from simple orthography up to the nature and the origin of the language. Therefore it is impossible in a short paper to consider his voluminous lexicographical contributions, his Turkish dictionaries, as well as school textbooks and grammars of a number of languages. Apart from them three types of his work could be traced: 1) theoretical approaches, 2) descriptive works, and 3) language codification.

It was expected than in his book *The Man* (1879) Sami would also mention the language as the first distinctive sign of the human beings. Seven years later (1886) he published a separate booklet under the title *The Language*. We can consider it as a to-day textbook on elementary linguistics, adapted from French. Even some terms are in French, because for the Turkish language of the time they were quite new words. Sami followed the contemporary linguistic thinking, adding to this the data from the Oriental languages.

*Shkronjëto e gjuhësë shqip* (Albanian Grammar) is considered the first grammar of our language published in Albanian, with Albanian terminology and aimed at Albanian schools. It should be placed in the wider context of his works on Turkish and Arab grammars, and it is compiled following the method in describing the European languages. Once more we see at the end of the book a linguistic glossary including French terms. In this way we have an explanation for the high level of the definitions and syste-



matic description of the grammatical categories in this work. Another dimension is added to the competence of Sami in linguistics calling him a grammarian.

In general, in linguistic work of Sami we find the major conceptions of the Albanian Renaissance men concerning the Albanian language. For them this was a very ancient language. Sami accepts the thesis on the Illyrian origin of Albanian language. It is listed as a separate branch in the Indo-European family of languages. He considers it a beautiful tongue. Moreover, it was a perfect language, an opinion generally common for the Romanticism. In the Albanian language could be expressed all the domains of science and culture, and could be created artistic literature. If this language would be purified from unnecessary borrowings, it would be enriched with words from its inner means. The language is the mark of the nationality, and the Renaissance people put the language in the centre of their concern for the future of the nation.

The contribution of Sami Frasheri was directed to the codification of the language norm as well as to the codification of its status. His Grammar aimed the normativization of the use. His work on the Albanian language was part of his general scientific activity in the description and the codification of several languages.

*Akad. Jorgo Bulo\**  
(*Shqipëri*)

**SAMI FRASHËRI**  
**DHE KODIFIKIMI I SHQIPES**

---

Kodifikimi i një gjuhe, siç dihet, nis njëherazi me shkrimin e saj. Në këtë kuptim, duke nisur me Buzukun e duke vazhduar me Bogdanin, i cili formuloi shprehimisht idenë se gjuha e shkruar duhej ndrequr sipas një modeli, për të vazhduar me autorë të tjerë shqiptarë dhe të huaj që hartuan gramatika e fjalorë, standardizimi i shqipes deri në shekullin e Rilindjes rrodhi më shumë si një proces spontan i diktuar nga nevoja e shkrimit të saj. Rilindja solli një koncept të ri dhe nevoja e kodifikimit të shqipes u bë pjesë e një politike kulturore kombëtare dhe e një projekti gjuhësor që synonte lëvrimin e shqipes në nivelin e një gjuhe kulture, gjuhën e shkollës kombëtare dhe të shtetit të ardhshëm të shqiptarëve. Në ballë të këtyre përpjekjeve për realizimin e këtij projekti ambicioz, qëndron Sami Frashëri, një nga figurat qendrore të Rilindjes Kombëtare, ideolog i saj dhe autori i veprave të para kodifikuese ose i akteve të para kodifikuese, siç janë alfabeti, abetarja dhe gramatika. Me komisionin për alfabetin e shqipes, ku bënte pjesë Samiu dhe, me pranimin prej këtij komisioni të alfabetit të paraqitur prej tij, që njihet me emrin "Alfabeti i Stambollit", nis për së mbari kodifikimi i shqipes në shkallë kombëtare dhe i hapet rruga një procesi të

■

\* Anëtar i ASHSH, Tiranë

gjatë të përpunimit, të përgjithësimit e të ngulitjes së normës gjuhësore.

Pas "Alfabetares së gjuhësë shqipe" (1879) ku parashtroi kërkesën për alfabetin latin të shqipes dhe pas "Abetares së gjuhësë shqipe" (1886) ku e sendërtoi këtë kërkesë, po atë vit, S. Frashëri botoi "Shkronjëto e gjuhësë shqip", e para gramatikë shqip e shqipes, një nga veprat më të mira jo vetëm të shekullit kur u shkrua, por dhe një nga veprat që shërben si pikë referimi për historinë e gramatologjisë shqipe. Vlera e kësaj vepre nuk qëndron vetëm në faktin se është një gramatikë e shkruar shqip, për të mësuar shqipen shqiptarët, ndryshe nga veprat para saj, duke përfshirë këtu edhe gramatikën e Kristoforidhit, as se ka paraqitur strukturën gramatikore të shqipes, ligjet e saj të brendshme mbi bazën e një metode shkencore e të njohjeje të thellë të pasurisë, të bukurisë e të shpirtit të saj, e të një intuete të rrallë gjuhësore, por edhe se ka në vetvete një prirje kodifikuese e një synim për të ngritur në normë forma sa më të përgjithshme, edhe pse mbështetet në lëndën gjuhësore të koinesë letrare jugore. Një synim i tillë ishte shprehje e vetëdijes së shkencëtarit dhe atdhetarit Sami Frashëri për rolin e njësisë gjuhësore për ngjizjen e njësisë së kombit, për formimin e kulturës e të literaturës kombëtare, siç i shkruan ai De Radës më 1881, "nukë me gjuhëra shumë po vetëm në gjuhët shqip, të pandame e të njëjtë, ... se shumë gjuh' e shumë djalekta sjellin ndarje e mërgim" .

Duke çelur nga të parët brazdën e studimeve në një fushë të palëvruar të dijes shqiptare, Samiut iu desh të krijojë me mjetet e shqipes edhe sistemin terminologjik përkatës. Ai ka krijuar 114 terma, prej të cilëve gati gjysma i kanë qëndruar kohës dhe kanë shërbyer si model për të ndërtuar e kodifikuar këtë sistem në gramatologjinë shqiptare.



Pas hartimit të abetares e të gramatikës prej Samiut, do të pritej në mënyrë krejt të natyrshme edhe hartimi i një fjalori të shqipes. Do të ishte paradoksale që ky atdhetar dhe intelektual i madh, të cilit leksikografia turke i detyron, si dihet, vepra kapitale, të mos kishte menduar e punuar për një fjalor të gjuhës së mëmës; do të ishte paradoksale që të mbetej jashtë projektit të tij gjuhësor hartimi i një fjalori të shqipes me të cilin ai do të plotësonte korpusin e veprave themelore për qenien, mësimin, lëvrimin dhe kodifikimin e një gjuhe, për të dëshmuar me plot gojën se shqipja u bë, si i shkruante bashkë me Naimin, më 1898, Murat Toptanit. Tanimë nuk ka asnjë dyshim se Samiu e pati njëmendësuar dhe këtë pjesë të projektit të tij gjuhësor, pra se e pati hartuar fjalorin e shqipes.

Këtë e dëshmon J. Vretoja në një letër dërguar Th. Mitkos më 23.11.1885, letër që kemi pasur rastin ta gjejmë në arkivin e Mitkos në Aleksandri. Në këtë letër Vretoja i shkruan, midis të tjerave, Mitkos: "Fjalëtore ka zën' e bën edhe Sami beu, dhe unë vetë ja numërova mbi gjashtë mijë fjalë rrënjë që me të dalat të pakënë bënenë dy a tri herë aqë". Nga ky pohim i një dëshmitari okular dhe të besueshëm, siç është Vretoja, i cili e ka pasur në dorë fjalorin e Samiut, provohet se mendimi për një fjalor të shqipes nuk kishte mbetur thjesht një projekt por dhe se ishte realizuar dhe se ai fjalor kishte të paktën 12-18000 fjalë. Pikëpyetjet që mbeten pas kësaj dëshmie kanë të bëjnë me fatin e fjalorit, me faktin pse s'u botua dhe me tipin e tij.

Naimi, në një letër të vitit 1896, që ia drejton me sa duket V. Terpos në Bukuresht, i premtonte se do t'ua dërgojnë për shtyp fjalorin, pasi të botohen veprat e tjera që kanë zënë radhën në shtypshkronjën e Bukureshtit. Por, si dihet, vepra nuk u botua ndonjëherë dhe pas këtij njoftimi askush nuk bën më fjalë për të. Mos vallë për shkak të sëmundjes e të punëve të tjera, Samiu ka hequr dorë



nga botimi, ndoshta i pakënaqur nga puna e tij? Por ai nuk ishte nga ata që i linin punët në mes. Në parathënien e fjalorit të turqishtes (Kamus-i-turki) ai shkruan se në punën e tij ndjek fjalën e urtë arabe që thotë: "Po nuk i arrite të gjitha, mos i lër të gjitha" .

Mundësia më e madhe është që ai të mos ketë arritur t'i japë veprës dorën e fundit për shkak të sëmundjes e të vdekjes së parakohshme, pra, që fjalori të ketë mbetur dorëshkrim, gati i përfunduar, sepse që nga viti 1885 kur e ka parë Vretoja fjalorin dhe deri më 1896 kanë kaluar 11 vjet dhe në këta 11 vjet nuk mund të mos jetë punuar mbi të.

Pyetjes se i ç'loji ka qenë ky fjalor, ka qenë një fjalor shpjegues i shqipes po përmes shqipes apo një fjalor i tipit shqip-gjuhë e huaj e anasjelltas, sipas modelit të mëparshëm në fushë të leksikografisë shqipe, model që e ndoqën Kristoforidhi e Mitkoja dhe vetë Samiu për fjalorët dygjuhësh të turqishtes, sot për sot është vështirë t'i jepet një përgjigje e sigurtë. Por, po të nisemi nga fakti se Samiu hartoi një gramatikë shqip të shqipes, ndryshe nga Kristoforidhi, edhe fjalori i tij, si pjesë e projektit për veprat themelore të shqipes, duhet të jetë një fjalor i tipit shpjegues shqip-shqip, po ndryshe nga fjalori i Kristoforidhit, i cili fjalën shqip e shpjegon përmes greqishtes. Fakti që dorëshkrimi i këtij fjalori nuk është gjetur deri më sot dhe që për të nuk ka bërë fjalë askush, as Mithat Frashëri, që pati trashëguar arkivin e frashërllinjve, lë të dyshohet se ai edhe mund të jetë zhdukur enkas, prej të njëjtave motive që shtyjnë edhe sot disa studiues turq të mohojnë autorësinë e një vepre tjetër shqip të Samiut, siç është "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë?" Megjithatë, këto dyshime nuk duhet të dekurajojnë kërkimet e mëtejshme të cilat mund të çonin në një zbulim të madh të një vepre, me të cilën Samiu ka dashur të fiksojë visarin dhe normën leksikore të shqipes. Me zbulimin e saj do të

plotësohej njohja shkencore e kontributit të këtij eruditi dhe atdhetari rilindës për zhvillimin e shqipes dhe të gjuhësisë shqiptare.

### **Sami Frasheri and the codification of the Albanian language**

One of the major goals of the Albanian National Movement in the 19th century was the elaboration of the Albanian to the level of a language of the culture, the national school, and the future Albanian State. On the head of these ambitious efforts stood Sami Frasheri, one of the central figures of the Albanian Renaissance. He not only was its ideologist, but at the same time he was the author of the first works on the codification of the language, like the alphabet, the primer, and the grammar. With the adoption by the Istanbul Society for the publication of the Albanian writing in 1879 of the alphabet, known as Istanbul Alphabet, the codification of the language starts in national level. Sami was at the head of all this work. The way for the long process of the cultivation, generalization, and implementation of the language norm was opened. Sami worked for the necessary means of this process, including the establishment of the respective terminology. After the primer and the Albanian grammar, the next step would be the Albanian dictionary.

Today there is no doubt that S. Frasheri started the compilation of this book. In a letter written by J. Vreto to Th. Mitko, in November 1885, the author mentions that Sami is working on the dictionary, and Vreto himself counted six thousands root words, from which with derivatives would be two or three times more. We can conclude that there would be a dictionary of about 18,000 words. It is true that we have no concrete traces of that

work; nevertheless, this ought not to discourage us in the future researches to find it. The discovery of Sami Frasheri manuscript of the *Albanian Dictionary* would complete the scientific knowledge about the contributions of this erudite and patriot to the development of the Albanian language and linguistics.

**Akad. Luan Starova\***

**(Maqedoni)**

**BËRTHAMAT ENCIKLOPEDIKE**

**TE SAMI FRASHËRI E FAIK KONICA**

**-Kamus al-A'lam e Albania-**

---

Kur bëhet fjalë për përpjekjet e para enciklopedike të turqit dhe shqiptarët, menjëherë imponohen bërthamat enciklopedike në Fjalorin e përgjithshëm të historisë dhe gjeografisë, ose Kamus -al- A'lam (1889-1898) i Sami Frashërit dhe revista enciklopedike franko-shqipe *Albania* e Faik Konicës.

Në kohën kur tundeshin themelet e Perandorisë Osmane, Samiu dhe Faiku duke kaluar nëpër purgatorin e një egzili gjithëjetësorë, si Sizifë të vërtetë të fjalës, ata secili prej horizontit të vet, njëri nga lindja tjetri nga perëndimi, u ngarkuan me misionin historik në atë kohë: "Si të plotësonin boshllëqet dhe mosvazhdimësinë në evoluimin drejt qytetërimit me një sintezë enciklopedike sipas modeleve të njohura evropiane të Volterit dhe Dideroit në shekullin XVIII?"

Por problemi kryesor që i imponohej këtij misioni nuk ishte vetëm "plotësimi i së humburës", por ishte një lloj përpjekjeje për të mbijetuar mes dy gjuhëve dhe dy strukturave të identitetit të ndryshëm, mes shqipes dhe frëngjishtes në

■

\* Anëtar i ASHAM, Shkup.



rastin e Faik Konicës dhe mes shqipes dhe turqishtes në rastin e Sami Frashërit. Të dy ishin plotësisht të vetëdijshëm se duhej të flijonin diçka në identitetin e tyre amë, që më vonë të gjenin kompensimin apo plotësinë e këtij identiteti me gjuhën shqipe të kodifikuar dhe unifikuar.

Veprat enciklopedike të tyre, dhe jo vetëm ato, në gjuhë të huaj duket sikur e përmbanin në përpjekjet e tyre sintagmën paradigmatiche të një lloji *mea culpa* dhe *ars poetica*. Si *mea culpa* ndoshta mund të shihet si një lloj flijimi në gjuhën e të tjerëve edhe në përmasa enciklopedike. Por duke iu flijuar nevojave të një Rilindjeje universale dhe kombëtare, ato mbeten pa *ars poetikën* e tyre. Dhe ashtu duke flijuar në dy aspekte, mes dy gjuhëve, ata krijuan monumente enciklopedike të shprehjeve të të dy popujve. Por nuk duhet harruar fakti se Samiu dhe Konica "enciklopeditë e tyre" i hartojnë në një periudhë historike me plot paradokse dhe antagonizma, me të cilat ishte gërshe-tuar fati i tyre dhe i popullit, kur 90 % e popullit shqiptar ishte analfabet dhe gjuha shqipe ishte e ndaluar.

Në misionet enciklopedike të Sami Frashërit dhe Faik Konicës mund të konstatohet një lloj vazhdimësie. Samiu, *Kamus al-'lam* (Fjalorin e përgjithshëm të historisë dhe gjeografisë), e boton që nga viti 1889 deri më vitin 1898 në Stamboll në gjuhën turke në 6 vëllime, me karakter dhe bërtham enciklopedike. Në këtë enciklopedi mund të zbulohet edhe një enciklopedi e vogël e vërtetë kushtuar Shqipërisë dhe shqiptarëve. Pra Samiu mund të konsiderohet si paraardhës ose paralajmëtar i një fjalori enciklopedik shqiptar. Bërthamat plotësuese të një projekti enciklopedik të shqiptarëve, krahas me enciklopedinë e Samiut, të frymëzuar prej koncepteve enciklopedike të iluministëve francezë, siç ishin Volteri, Didëroi dhe të tjerë, gjenden si bërthama enciklopedike edhe në shembujt e rilindasve të shquar shqiptarë, siç ishte revista e Jeronim

De Radës "L'Albanese d'Italia" (Shqiptari i Italisë), në gjuhën italiane, dhe të Anastas Kulluriotit i cili botoi I Fontis Albanias (Zëri i Shqipërisë). Por një qasje të veçantë besojmë se meriton rasti i Faik Konicës, i cili në moshën 21-vjeçare më 1897 (kur Samiu e kryen botimin e enciklopedisë Kamus al-A'lam) fillon botimin e revistës enciklopedike "Albania" në gjuhën shqipe dhe frënge që doli për 12 vjet me radhë, së pari në Bruksel, deri më 1902, e pastaj në Londër. Sipas vlerësimit të historianit Kristo Frashëri, "Albania" e Faik Konicës "mbetet një thesar enciklopedik i Rilindjes kombëtare shqiptare". Edhe se të shkruajtura turqisht dhe frëngjisht, enciklopeditë, ose më mirë thënë bërthamat enciklopedike si "Kamus al-A'lam" e Samiut dhe "Albania" e Konicës luajtën një rol të madh në njohjen dhe internacionalizimin e çështjes shqiptare në një periudhë vendimtare për historinë e Shqiptarëve. Mund të themi se idetë Rilindase shqiptare hynë në një lloj osmoze dhe ndërveprimi plotësues me këto dy vepra enciklopedike. Në enciklopedinë e Samiut, si dhe në Albaninë të Faik Konicës, janë të pranishme dhe plotësohen idetë më të rëndësishme të Rilindjes Kombëtare, në një kohë kur agonia e gjatë e Perandorisë Osmane i afrohej fundit dhe kur "vulosej" fati i popullit shqiptar. Zërat janë zgjedhur, janë përkthyer dhe janë shkruar prej Samiut dhe Faikut jo vetëm sipas frymës dhe kriterëve enciklopedike evropiane, por edhe sipas kërkesave dhe momentit aktual politik dhe Rilindjes kombëtare shqiptare. Konturet e një enciklopedie shqiptare, ose një enciklopedie në enciklopedi, janë të qarta në veprën e Samiut. Për shembull, ai në enciklopedi i vendos gati të gjitha qytetet më të mëdha të Shqipërisë dhe gati të gjithë njerëzit më të shquar të trojeve shqiptare, idetë kryesore, kategoritë fundamentale të përbashkëta. Këto enciklopedi i përcaktojnë edhe koordinatat shpirtërore të shqiptarëve në një relief balkanik

mendor prej kohërave më të lashta deri në ditët tona. Gati të gjitha bërthamat enciklopedike shqiptare siç janë revista enciklopedike "L'Albanese d'Italia" e Jeronim De Radës, "Albania" e Faik Konicës dhe Kamus al-'lam e Sami Frashërit, e kanë të përbashkët misionin historik ta njoftojnë opinionin e huaj se shqiptarët kanë pasur një të kaluar të lavdishme dhe se ata pa përjashtim mbronin dhe argumentonin të vërtetën për lashtësinë e popullit shqiptar. Të gjithë ata sikur përcjellin një marrëveshje jashtë kohërave në të cilat jetonin, duke kërkuar modele dhe module enciklopedike të bindshme për të kompletuar mozaikun e një Shqipërie të bashkuar. Këto tek Shqiptarët kishin edhe një mision të veçantë - plotësimin e institucioneve të memories popullore. Për shembull, Sami Frashëri në zërat e Enciklopedisë si "Pellazgët", "Shqipëria", "Shqiptarët", "Iliria" shfaq argumente gjuhësore se "Shqiptarët janë populli më i vjetër në gadishullin Ballkanik, kurse në krahinat dhe qytetet ku ata shtrihen sot, ata janë autoktonë që në kohërat më të lashta". Preokupimi kryesor si i Sami Frashërit në enciklopedinë e vet ashtu edhe Konica në "Albania" dhe në revista të tjera shqiptare theksojnë fatin e gjuhës shqipe si komponente kryesore e identitetit shqiptar. Samiu, Konica, De Rada në kronikat e tyre enciklopedike jo vetëm që e madhëronin vlerën e gjuhës shqipe si kryesimbol i identitetit kombëtar të shqiptarëve, por edhe si *conditio sine qua non* i bashkimit të tyre. "Një gjuhë shqipe e pandame dhe e njëjtë" i shkruante Sami Frashëri De Radës, "sepse shumë gjuhë dhe dialekte sjellin ndarje dhe mërgim". Në faqet e enciklopedisë të Samiut si dhe në ato të revistës së Faik Konicës, dhe jo vetëm aty, shihet qartë një kronikë e vërtetë e kërkimit në kontekstin shqiptar dhe atë evropian, të një gjuhe të përbashkët shqipe, që do të eliminonte ndarjet dialektore. Samiu dhe Faik Konica në faqet enciklopedike, por edhe në



veprat e tyre të tjera, vite me radhë do t'i theksojnë rrugët e realizimit të këtij procesi. Në këtë tribunë të fuqishme enciklopedike, Samiu mbron dhe ilustron tezën se gjuha shqipe është gjuha e gjithë shqiptarëve kudo që janë. Krijimin e gjuhës shqipe Samiu ia atribuon procesit të natyrshëm, të evoluimit të pandërprerë të kësaj gjuhe të lashtë, si një organizëm i gjallë. Preokupime gati identike dhe plotësuese në lidhje me evoluimin e natyrshëm të gjuhës shqipe kanë edhe Jeronim De Rada dhe Faik Konica dhe të njëjtat i parashtrojnë në fletoret e tyre me karakter enciklopedik. "Gjuha shqipe - i shkruante Samiu De Radës - do të bëhet e begatë, e gjërë dhe do të shpëtoj nga të pasurit nevojë me fjalë të huaja, dhe dialektet do të gjenden të gjitha të bashkuara e të përziera". Faik Konica me sens dhe intuitë historike vazhdon t'i përkrahë dhe u jep kuptim edhe më të gjerë tezave të Samiut rreth evoluimit natyror të gjuhëve, duke patur shqipen parasysh në kontekst lokal dhe universal.

Vazhdimësinë në këto teza do ta kërkojë Faik Konica vite me radhë së pari në revistën javore L'Europeen, të viteve të para të shekullit XX, kur ai, me pseudonime të njohura, u kundërvihet tezave të esperantistëve në një polemikë ndërkombëtare, duke i mbrojtur tezat për përkrahjen e gjuhëve natyrore dhe të drejtën e tyre për evoluim të pandërprerë, duke marrë parasysh edhe fatin e gjuhës shqipe, në kohën kur Faik Konica, në Albania vazhdonte luftën enciklopedike të Samiut. Duke polemizuar gati një vjet me linguistët e njohur evropianë të kohës, me pseudonimin që përdorte në "Albania", Thrank Spirobeg, dhe duke patur përkrahjen e Gijom Apolinerit dhe Remi de Gourmonit (krye-esteti i simbolizmit), Faik Konica si dihet nën pseudonimin Pyrus Bardhyli shkruan librin *Essai pour les langues naturelles et artificielles* (Ese mbi gjuhët natyrore dhe gjuhët artificiale) në vitin 1904 në Bruksel, për të dhënë



"grushtin e fundit esperantistëve" kundërshtarëve të teza-ve të Samiut dhe Konicës për evoluimin e gjuhëve. Përkundër faktit se ky libër kishte një qëllim të caktuar në polemikën kundër esperantistëve, teza kryesore e Konicës ishte se favorizimi i një gjuhe të përbashkët internacionale dhe artificiale do të vononte dhe marginalizonte procesin e zhvillimit dhe konsolidimit të gjuhëve natyrore, me kontinuitet mijëvjeçar, siç ishte për shembull shqipja, për të cilën me siguri Konica e kishte fjalën por pa e përmendur. Sipas Remi de Gurmonit, Konicës "tërsisht i shkoi dorësh të dëshmojë se gjuhët natyrore mund të krahasohen me organizmat e gjallë, kurse gjuhët artificiale nuk duhet më të rivalorizohen me to". Sikur të imponoheshin gjuhët artificiale, sipas Apolinerit dhe De Gurmonit, në favor të ideve të Konicës, ato do ta kishin ngadalësuar procesin e "evolucionit të dialekteve, të idiomave natyrore". Si për Sami Frashërin ashtu edhe për Faik Konicën, mbrojtja e gjuhës do të thoshte edhe mbrojtje e identiteti shqiptar në kohërat vendimtare për të. Një pjesë e rëndësishme e veprimtarive të tyre në suaza enciklopedike dhe jashtë tyre, i janë kushtuar në kontekst të hapur apo të fshehur, edhe fazave të evolucionit të gjuhës shqipe sidomos në periudhën e Rilindjes. Sami Frashëri në zërat e enciklopedisë kujtonte se "gjuha shqipe është shkruar prej disa shekujsh përpara", duke i paralajmëruar asaj një të ardhme të ndritur, duke e parë evolucionin e saj të vazhdueshëm si gjuhë e natyrshe, larg klisheve artificiale, kundër të cilave luftonte Faik Konica me mjete të tjera.

Mbetet mahnitëse edhe sot se si Sami Frashëri, Jeronim De Rada, Faik Konica dhe Rilindasit e tjerë, si për shembull, dhe Pashko Vasa i cili gati të gjitha veprat i botoi në gjuhën italiane dhe frënge, me një hov enciklopedik, i vunë vetes një mision të përbashkët dhe gati të harmonizuar nga një fuqi e brendshme koherente, edhe pse në

gjuhët e të tjerëve, ta njihnin Evropën me gjuhën shqipe dhe t'i fusin shqiptarët në rrjedhat e qytetërimit evropian, pjesë e të cilit ka qenë dhe është qytetërimi shqiptar. Misioni i tyre ishte mjaft i ndërlikuar, në çaste gati donkishotesk dhe i pamundshëm, në pëpjekjet ta shndërrojnë shqipen nga një gjuhë pothuajse e vdekur, në një gjuhë të gjallë kombëtare të një populli, siç thoshte Robert Escarpi "i ngjallëm më gjuhën e vet - gjuhë më e vjetër se gjuha e Homerit, e lindur dhe e shënuar prej gjuhëve të të gjithë pushtuesve të saj, por e paprekur në strukturat e veta".

Sami Frashëri dhe Faik Konica si pasardhës të vërtetë të iluministëve evropianë, Deni Didëroi dhe Volteri me vonesë prej një shekulli, vazhdonin misionin e tyre enciklopedik edhe në këto vise të Evropës jug-lindore me gjërsi dhe tolerancë evropiane, sidomos në përdorjen e "gjuhëve të të tjerëve". Në këtë drejtim kontributi i Sami Frashërit mbetet i veçantë dhe i pazëvendësueshëm. Vepra madhore e Samiut, Enciklopedia "Kamus al-A'lam" në gjuhën turke është ndoshta rasti i vetëm në botë ku në një vepër enciklopedike kryqëzohen botëra, qytetërime, popuj, kultura. Samiu në këtë vepër i jep një vend të veçantë dhe të dukshëm botës shqiptare dhe figurave më të rëndësishme të popullit shqiptar gjatë historisë së tij. Sami Frashëri ose Shemsetin Samiu siç e quajnë Turqit ("dhe që përkthehet si Samiu i ndritur si diell"), gjatë jetës së tij 54-vjeçare ka hartuar dhe botuar 54 vepra letrare, gjuhësore, kulturore në turqisht dhe në shqip. Me gjithë se ka kaluar më se një shekull, vepra e Samiut jo vetëm që e ruan karakterin e saj shkencor por edhe bart një vlerë të theksuar aktuale. Ajo mbetet si një urë bashkimi mes turqve dhe shqiptarëve, mes Evropës dhe Ballkanit, mes lindjes dhe perëndimit.

Ashtu siç ka hulumtuar vite me radhë Samiu në arkivat e perandorisë osmane, duke përpunuar një sërë dokumen-

tesh origjinale, ashtu dhe Faik Konica, sikur me ndonjë marrëveshje të brendshme, ka gjurmuar nëpër arkivat dhe institucionet perëndimore, në British Museum, në arkivat francezë, për ta plotësuar të vërtetën shqiptare në përmasa enciklopedike. Na duket sikur ka ardhur koha të dekodohet ëndrra e përbashkët e enciklopedistëve dhe rilindasve tanë, ku kontributi i Samiut dhe i Konicës zë vend të posaçëm në këtë drejtim. Samiu dhe Konica, me enciklopeditë e tyre komunikojnë me Evropën dhe institucionet e saja, shumë dekada para institucioneve të vendeve të tyre. Samiu siç hodhi themelet e Albanologjisë,<sup>98</sup> ai tashmë pranohet në historinë turke si turkologu i parë në Turqi dhe Ataturku kur shpalli Republikën Turke në vitin 1923, reformat gjuhësore i realizoi sipas projekteve të hartuara nga Sami Frashëri. Krijimtaria e tij në gjuhën shqipe, në mbështetje të Rilindjes shqiptare, për nevojat e shkollave të para shqipe na bënë t'i kuptojmë akoma më mirë dimensionet e misionit të tij universal në kërkim të një dialogu plot tolerancë dhe mirëkuptim mes popujve dhe civilizimeve, dialog i cili vazhdon edhe sot.

Vepra madhështore e Sami Frashërit, si dhe ajo e Faik Konicës por edhe e rilindasve tanë që shkruanin në gjuhë të huaja, duke kërkuar shqipen e vërtetë dhe të merituar, të kristalizuara dhe të kulluara si lotët e nënës, janë më tepër pjesë të një veprë të vetme, komponentë të një identiteti të harmonizuar. Sot ne shqiptarët si dhe turqit, por edhe popujt e tjerë fqinjë, mund të mburremi me veprën enciklopedike të Sami Frashërit, "Fjalori i përgjithshëm i histo-

■

<sup>98</sup> Krijimtaria e Samiut në gjuhën shqipe është në funksion të Rilindjes, Për shkollat e para shqipe Samiu botoi veprat: *Abetare e gjuhës shqipe* (1886), *Shkronjetore e gjuhës shqipe* (1886), *Dheshkronja* (1888). Hartoi edhe një fjalor të gjuhës shqipe të cilit nuk i dihet fati.



risë dhe gjeografisë", ose me veprën enciklopedike siç është "Albania". Para një viti me rastin e njëqindvjetorit të vdekjes së Jeronim De Radës në Kalabri, albanologu i shquar Franko Altimari e shpalli botimin e veprave të Jeronim De Radës në 12 vëllime, si botim më i plotë deri tani. Ne sot me rastin e 100-vjetorit të vdekjes së Sami Frashërit kremtojmë botimin e veprave të tija në 20 vëllime, të shkruara shqip dhe të përkthyer nga turqishtja. Për një kohë relativisht të shkurtër, realizohen me vonesë prej një shekulli ëndrrat e dy rilindasve tanë të pavdekshëm si Jeronim De Rada dhe Faik Konica.

### **Encyclopedic core in the works of Sami Frasheri and Faik Konica – *Kamus al-A'lam* and *Albania***

When we speak about the first encyclopedic attempts among Turks and Albanians first of all we mention the encyclopedic works *Kamus al-A'lam* (The general Encyclopedia, 1889-1898) by Sami Frasheri, and the encyclopedic journal *Albania* by Faik Konica. Both of them were aware that they would sacrifice something from their identity to find a compensation or the fulfillment of this identity in the unified Albanian language. There is continuity in their activity. To Sami it took ten years to accomplish the voluminous edition in Turkish, in which we can perceive another smaller encyclopedia of Albania and Albanians. He was the forerunner of the Albanian encyclopedic dictionary.

Faik Konica started in 1897 (just in time when S. Frasheri was concluding his 6 volumes of *Kamus al-A'lam*) with the encyclopedic journal "Albania" in Albanian, a magazine that was published in successive 12 years first in Brussels, and afterwards in London. It is considered an encyclopedic treasure of the Albanian National Renais-



sance. Both authors played a distinguished role in making the Albanian question known on the international arena in a decisive period of the history of Albania. We may consider an osmotic process between their two works. Sami selected and prepared the representative items concerning Albania and Albanians, following the demands of the National Movement and at the same time the encyclopedic criteria of the European tradition. The same applies to the materials published by F. Konica. They saw as their historical mission the obligation to inform the foreign opinion about the long history of the Albanian people. On the other hand, they made serious efforts to integrate the Albanians into the trends of the European civilization. This is why they in a large part wrote their works in foreign languages, a practice followed by many other Renaissance people.

It took long years to Sami to make researches in the archives of Ottoman Empire in search of historical documentation for the items in his Encyclopedia. The same search was made by F. Konica in the Western archives, in British Museum particularly, to complete the truth on Albania. There was a common dream of both of them, which gives them a special role in the communication with European institutions a number of decades before specialized institutions were established in their country.

*Prof. Dr. Ömer Faruk Akün\**  
(Turqi)

**SHEMSEDDIN SAMIU**  
**DHE KAMUS-I TURKI**

---

Shemseddin Samiu, me punimet dhe shërbimet e tij shumëdimensionale dhe tejet aktuale në jetën e mendimit dhe botimit turk, na paraqitet si një figurë që brenda një jete shumë të shkurtër ka arritur të ngërthejë aq shumë punë, sa që sot madje duket e pamundur që një njeri t'i ketë arritur të gjitha këto i vetëm.

Ne sot e përkujtojmë me nderime atë si një personalitet që, krahas shërbimeve të tij në rrafshin e sjelljes së temave të reja e të ndryshme për arsimimin e vendit, është përpjekur që gjuha turke ta fitojë identitetin e vet, që te intelektualët tanë (turq) të zgjohet ndjeshmëria ndaj gjuhës amtare, që duke filluar qysh nga mosha 31-vjeçare e deri në 23 vitet e fundit të jetës së tij, përmes përkushtimit të tij sidomos ndaj punimeve gjuhësore e leksikografike, ka dashur që breznive të reja t'u sjellë përgjigje të përshtatshme ndaj nevojave të tyre në këtë fushë dhe është një personalitet që me veprën *Kamus-i Türki* ka përpiluar fjalorin kryesor të gjuhës turke, fjalor ky që mbi 90 vjet nuk bie nga dora e lexuesit dhe studiuesit turk.

■

\* "Universiteti i Stambollit", Stamboll.

Lindi më 22 rrexheb 1266 (1 qershor 1850) në Frashër, që ishte qendër e nahijes së Malësisë së kazasë Përmet në vilajetin e Janinës. Babai Halid beu dhe gjyshi Durmush beu, prejardhjen e kanë nga bejlerët timariotë të shpërngulur nga Berati në Frashër. Nga ana e nënës na del te subashi Iljas beu që ishte burrë shteti në kohën e Sulltan Fatihut dhe Bajazitit II. Kur ky i mbush nëntë vjet i vdes babai, dy vjet më vonë i vdes edhe e ëma, me ç'rast kujdesin ndaj tij dhe vëllezërve të tjerë e merr përsipër vëllai më i madh Abdyl beu. Shemseddin Samiu pasi e kryen shkollën fillore në Frashër, për të vazhduar shkollimin e mëtejshëm vëllai i madh Abdyli e merr tërë familjen në vitin 1861 dhe i bart në qendër të vilajetit të Janinës, ku Samiu bashkë me vëllanë më të madh Naim Frashërin vazhdojnë shkollimin në gjimnazin grek Zosimeia Skoli, i cili ishte tetëvjeçar por Samiu e mbaron për shtatë vjet, në vitin 1868. (Meqë diploma bart datën 14 korrik 1868, kjo na jep mundësinë për ndryshimin e atyre datave që Samiu na jep në biografinë e tij lidhur me shpërnguljen familjare të tij në Janinë në vitin 1281=1864 dhe lidhur me mbarimin e këtij gjimnazi në vitin 1288=1871, kurse shkuarja e tij në Stamboll nuk ndodh shpejt mbas kësaj kohe, porse pasi të kenë kaluar shumë vjet prej mbarimit të shkollimit të tij në Janinë). Samiu, në këtë shkollë që kishte një program mësimor bashkëkohor, përveç greqishtes, greqishtes së vjetër, frëngjishtes e italishtes, me ndihmën e mësuesve të veçantë jo vetëm që e përkryen gjuhën frënge, por nga myderrizët e njohur që kishte kjo shkollë mëson mjaft mirë edhe arabishten e persishten. Pas mbarimit të shkollës për një kohë punon si sekretar i përgjithshëm (mektubi kalemi) në vilajetin e Janinës (sipas një njoftimi tjetër, punon si një nëpunës i ulët në Goricë), kurse në vitin 1288 (1872) vjen në Stamboll dhe bashkë me të vëllanë, Naimin hyjnë në Zyrën e Shtypit (Matbuat Kalemi). Jeta e



shkrimeve dhe botimeve të Samiut fillon mu këtu. Në po të njëjtin vit kur punësohet në këtë sektor, në verën e vitit 1289 (1872), ai e botoi librin e parë të tij, përkthimin e veprës *Tarih-i Mücmel-i Fransa*, por me këtë rast mundi të shtypej vetëm pjesa e parë e kësaj vepre. Menjëherë pas kësaj filloi të botojë pjesë-pjesë veprën e tij origjinale, romanin *Taaşuk-ı Tal'at ve Fitnat*. (1289 -1290 = 1872 nëntor – 1873). Samiu vijoi t'i përkushtohej veprimtarisë botuese, me këtë rast shkruan tragjedinë *Sübrab-yahud-Ferzendenkuş* dhe dy romanet *İskat-ı Cenin-yahud-İkisi Ölmiş*, *İkisi Çıldırmuş* dhe *Rekabet*, të cilat nuk i boton pasi nuk i pëlqen fort.

Edhe pse nuk dihet mirë se kur ka filluar të angazhohet në gazetari, që përbën një anë shumë të rëndësishme të veprimtarisë së tij botuese, ekziston mundësia që ai të ketë filluar hapat e tij të parë në këtë profesion në gazetën **Hadika (Kopshti)**, e cila kishte filluar të botohej në një formë të re në nëntor të vitit 1872 nën administrimin e Ebuzzija Tefikut. Edhe pas kohës kur për dy muaj rresht mbyllet gazeta **Hadika** dhe kur sërish nga ana e Ebuzzija-ut, aty kah marsi i vitit 1873, fillon të botohet gazeta **Sirac**, Samiun e shohim të punojë këtu si përkthyes dhe ndihmës në zyrën e shtypit (Ebüzziya Tefik, “Yeni Osmanlılar Tarihi”, Yeni Tasvir-i Efkarö nr. 351, 11 shtator 1910). Gjatë kohës derisa botohej gazeta **Sirac**, gazetës së parë **Hadika** i përfundon afati i dënimit dymujor dhe fillon të ribotohet, por kësaj radhe si gazetë javore e jo ditore (nr. 57, 2 muharrem 1290 – 28 mars 1873). Mirëpo kësaj radhe më 6 prill 1873 mbyllet gazeta **Sirac** për shkak të ngjarjes dramatike *Vatan-yahud-Silistre* të botuar në **Sirac**. Pasi e paraburgosin dhe syrgjynosin Ebuzzijaun, Samiut i mbetet drejtimi i punëve të gazetës **Hadika**, por edhe ky për shkak të një shkrimi ku e kritikonte ashpër ambasadorin rus Ignatief, për ta penguar rrezikun e shfu-



qizimit të koncesionit (patentës) vetvetiu i jep fund botimit të gazetës **Hadika** (nr. 64, 21 safer 1290 – 19 prill 1873). Më vonë e merr me qira gazetën prej koncesorit të saj dhe pas një muaji fillon ta botojë sërish nën drejtimi e vet (nr. 1, 22 rebiul-evvel 1290 – 19 maj 1873). Pasi kishin kaluar pesë javë, deklaroi se është i zënë me punë të tjera dhe se nuk ka ndihmës për punët e shtypit. Gazetës ia zvogëlon formatin dhe ia ul çmimin aq sa bëhet gazeta më e lirë e kohës, me çka ai vetë e mbyll përfundimisht këtë gazetë pa i mbushur akoma dy muaj nga drejtimi i tij në këtë gazetë (nr. 42, 20 xhemadijel-ula 1290 – 15 korrik 1873). Shemseddin Samiu, i cili për një kohë e braktis veprimtarinë e gazetarit, nga njëra anë vazhdon punën e tij në Zyrën për Shtyp, kurse nga ana tjetër nuk e pakëson angazhimin e tij në fushën e letërsisë. Kështu në vitin 1290=1873 ai boton dy përkthime, tregimet **Galatee** dhe tragjedinë **İhtiyar Onbaşı (Dhjetari plak)**. Me shfaqjet e tragjedisë **İhtiyar Onbaşı** që tërhoqi pasionues të shumtë – nga fillimi i janarit 1874, me fillimin e sezonit të teatrit dhe pas saj – emri i tij u rrit edhe më shumë. Duke e pasuar modën e teatrit të atyre viteve, Samiu e shkruan tragjedinë **Besa**, e cila po ashtu që nga prilli i vitit 1874 fillon të luhet në teatrin Gedikpasha. Me kërkesën që bëhet nga Tripoli (i Libisë) për një editor që do ta drejtonte gazetën e vilajetit, Samiu emërohet për në këtë vend me pëlqimin e drejtorisë së Shtypit. Niset për në detyrën e re, duke kaluar nëpër Janinë. Prej atje pastaj kalon në Brindizi e nëpër Napoli kalon në Meshine dhe Maltë, çka i jep rastin e volitshëm për ta vizituar një pjesë të Evropës. Pasi i kalon nëntë muaj rresht në Tripoli si kryeredaktor i gazetës turko-arabe **Trablusgarb** (nr. 256, 4 xhemadijel-evvel 1291 = 18 qershor 1874 - nr. 271, 26 muharrem 1292 = 4 mars 1875), sipas disa thënieve në të njëjtën kohë ka shërbyer edhe si ndihmëssekretar dhe drejtor i

shtypshkronjës së vilajetit (të Tripolit), ai kthehet në Stamboll. Thua jse të gjithë autorët që flasin për Shemseddin Samiun thonë se ai, që në fakt në kohën e Abdulazizit në Tripoli ka shkuar me punë, ka qenë i syrgjynosur nga ana e Sulltan Abdulhamidit II. Kjo nuk është e vërtetë, siç nuk është e vërtetë edhe thënia e disave se Abdulhamidi e ka burgosur atë në burgjet e Tripolit (p.sh. Albert Ghika, **L'Albanie et la question d'Orient**, Paris, 1908, f. 278). Këto janë vetëm sajime paragjykuese e fiktive. Pas kthimit nga Tripoli Samiu thotë se ka punuar për një kohë në disa gazeta, e në ndërkohë në shtypshkronjën Tasvir-i Efkar, pronësia e së cilës kishte kaluar në duart e Namik Kemalit dhe Ebuzzijaut, krijon serinë e librave ku i boton dy vep- rat teatrale **Besa** (1292 = nëntor 1875) dhe **Seydi Yahya** (1292 = fundi i dhjetorit 1875).

Pos kësaj në të njëjtën shtypshkronjë që nga janari i vitit 1876 filloi të merrej me drejtimin e botimit të revistës **Muharrir**, të cilën e botonte në emër të Ebuzzijaut i cili gjendej i syrgjynosur në Rodos. Gjatë kësaj kohe mësojm se ai është përpjekur t'i pajtojë Namik Kemalin me Ebuz- zijaun që ishin ndarë me kohë dhe mësojme se për këtë i ka shkruar edhe Namik Kemalit. (Ebüzziya, "Yeni Os- manlılar Tarihi", Tasvir-i Efkar, nr. 457, 31 dhjetor 1910). Me shkarkimin nga fronti të Abdulazizit dhe deri me kthi- min e Ebuzzijaut nga Rodosi në Stamboll, katër numrat e parë të revistës **Muharrir**, që botohej nën drejtimin e tij, në kapakët e tyre bartnin vulën Shemseddin Samiut. Sa- miu bashkë me Mihran Efendiun, i cili e kishte marrë me qira shtypshkronjën Tasvir-i Efkar, më 12 safer 1293 (8 mars 1876) fillojnë ta botojnë gazetën **Sabah**, koncesioni i së cilës ishte në duart e një greku të quajtur Papadopu- los. Kjo gazetë, që me seriozitetin dhe përmbajtjen e saj shkaktonte një interesim jashtëzakonisht të madh, për shkak të një thashethemeje që botohet në të mbyllet për

një kohë (Basiret, nr. 1916, 6 ramazan 1293) kurse Samiu, në botimin e shkrimeve dhe pjesëve të tij që dilnin të censuruara, vendet e censuruara nuk i mbushte me shkrime të tjera porse i linte bardhë, të zbrazëta, me çka na del si një shkrimtar i parë në veprimtarinë botuese që me shkathtësinë e tij metodike ndërhyr në ekspozimin e politikës censuruese (shih Ebuzzijau, po aty). Se çfarë pozite të lartë kishte kjo gazetë që botohej nën drejtimin e Samiut, na tregojnë edhe gazetarët e shkrimtarët e tjerë të kohës. (Abdërrahman Şeref, *Tarih Musahabeleri*, Stamboll, 1339, f. 339, po ashtu shih, “Terakkiyat-ı Matbuat-ı Osmaniyye ve Sabah Gazetesi”, Sabah, nr. 2668, 22 dhul-ka’deh 1314). Samiu i cili gjatë gjithë kësaj kohe nuk e pakëson aktivitetin e tij letrar, menjëherë pas shkarkimit nga froni të Abdulazizit kësaj radhe e boton dramën e tij **Gave** (1293 = qershor 1876). Me rastin e kryengritjes së Hercegovinës dhe luftërave të Malit të Zi e Serbisë, që në botën politike evropiane për pasojë pati nxjerrjen në plan të parë të Çështjes së Lindjes, Sh. Samiun e shohim si një gazetar dhe analist mjaft të shkëlqyer të kohës i cili, në shtypin e kohës, përballë kësaj politike e mbronte me shkathtësi e mençuri të dalluar pozitën dhe të drejtën e Turqisë mbi tokat e Rumelisë. Ai në gazetën e tij, me këmbëngulësi e trajton këtë çështje, deri në kohën që përkon me fillimin e Konferencës së Stambollit. Për dhjetë muaj me radhë, deri në numrin 256 të saj (17 dhul-hixheh 1293 = 3 janar 1877), Samiun e shohim si kryeredaktor të kësaj gazete, mirëpo paskëta nuk e shohim më emrin e tij në këtë gazetë, pasi ai e braktis atë dhe shkon në Rodos me detyrën e myhyrdarit (sekretar privat) të Sava Pashës i cili në shkurt të vitit 1877 ishte emëruar për vali i Cezair-i Bahr-i Sefidit /Ujdhësat e Arkipelagut të Egjeut/ (Ceride-i Havadis, nr. 3307, 19 muharrem 1294 = 3 shkurt 1877). Me fillimin e luftës turko-ruse në pranverë të këtij viti dhe



me shtrirjen e vazhdueshme të trupave ruse drejt Ballkanit, Samiu jep dorëheqje nga detyra që e ushtroi pesë muaj dhe po në atë verë kthehet në Janinë, ku për disa muaj me radhë shërben si kryesekretar i komisionit për dërgimin e trupave ushtarake që shërbenin nën komandën e Abidin Pashait. Në të njëjtin vit kthehet në Stamboll dhe e merr përsipër kryeredakturën e gazetës **Tercüman-ı Şark** të cilën më 7 rebiul-ahir 1295 (10 prill 1878) kishte filluar ta nxirrte Mihrani, radhitësi i gazetës **Sabah**. Për shkak të anekdotave që kishte filluar t'i botonte më herët në gazetën **Sabah** e që vazhdonte t'i botonte edhe këtu nën titullin "**Şundan-bundan**", një kohë Samiun nisën ta quajnë "shundan-bundanxhi". Edhe pse këto anekdota këtu botoheshin edhe më herët, emri i Samiut fillon të shihet që nga numri 74 (21 xhemadijel-ahir 1295 = 22 qershor 1878). Në artikujt politikë që i ka shtjelluar në këtë gazetë vërehet se ai është interesuar shumë për së afërmi me çështjen e Rumelisë e të Ballkanit sidomos gjatë Kongresit të Berlinit (1878) dhe në periudhën pas kësaj. Vëllai i Samiut, Abdyl beu (Abdullah Husniu) luante rolin kryesor në lëvizjen "Arnavut İttihadi" ("Lidhja Shqiptare"), që ishte themeluar si reagim kundër vendimeve të marra me marrëveshjen e Shën Stefanit (sot Yeşilköy afër Stambollit-përkth.), sipas së cilës parashihej që disa pjesë të tokave shqiptare t'u mbeteshin vendeve fqinjë. Kjo lëvizje u zhvillua edhe më tej pas vendimeve të marra në Kongresin e Berlinit. Gjatë kësaj veprimtarie politike që dita-ditës sa vinte e forcohej, edhe Samiu në shtypin e Stambollit shkruante artikuj kundër disa analizave që i akuzonin shqiptarët lidhur me çështjen shqiptare duke tentuar ta mbronte kauzën shqiptare dhe duke u munduar të sqaronte se shqiptarët nuk kishin ndërmend të ndaheshin nga shteti osman. Kësokohe Samiu tërhiqet nga gazeta (fundi i tetorit 1878). Botimi i një shkrimi në



**Tercüman-ı Hakikat** (nr. 144, 22 dhul-hixheh 1295 = 17 dhjetor 1878), ku thuhej se shqiptarët pretendonin pavarësinë (prej shtetit osman), e detyron Samiun të shkruajë një përgënjeshtim (**Tercüman-ı Hakikat**, nr. 150, 29 dhul-hixheh 1295). Të njëjtën gjë detyrohet ta bëjë (**Tercüman-ı Hakikat**, nr. 167-168, 19-20 muharrem 1296) edhe ndaj një shkrimi të një gazete greke të quajtur **Neologos** e cila në mënyrë shumë akuzuese e kishte komentuar artikullin e Samiut “Arnavudluğun Amali” (Shpresat e Shqipërisë) të botuar në **Tercüman-ı Hakikat** (nr. 159, 9 muharrem 1296). Këto shkrimet e fundit të tij vijnë në kohën kur bëheshin përgatitjet për Konferencën e Prevezës që duhej të mbahej në janar 1879 nga “komisioni turko-grek për caktimin e kufijve” për të diskutuar rreth çështjes së lënies së Janinës e disa tokave shqiptare në duar të Greqisë. Lidhur me idetë politike të Samiut ndaj vendlindjes së tij për të cilën ishte shumë i interesuar, thuhet se ka shkruar një vepër e cila në fillim botohet në vitin 1899 në shqip pa emër autori, pastaj botohet në gjuhën frënge me titull **“L’Albanie – le passe, le present et l’avenir”**, kurse më 1904 botohet në Sofje nga ana e Shahin Kolonjës me titullin *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë* (**Arnavutluk Ne idi, Nedir, Ne Olacak**), në krye të së cilës qëndronte emri i Samiut dhe ku shënohej se ishte “një përkthim i fjalëpërfjalshëm nga shqipja”, por që ishte një botim larg originalit dhe në të cilin ishin futur mjaft elemente të pabaza, kështu përkatësia dhe përmbajtja e veprës është bërë lëndë diskutimesh e polemikash të vazhdueshme. Si një shembull tipik për trajtimin e thjeshtë politik e të njëanshëm të Samiut, mund të përmendim këtë shkrim: Kristo Frashëri, “Shemseddin Sami Frashëri – Ideologue du mouvement national Albanais”, *Studia Albanica*, nr. 1, 1966, Tiranë, f. 95-110 = “Shemseddin Sami Frashëri – Ideolog i lëvizjes kom-

bëtare shqiptare”, Studime Historike, 2/1967, f. 79-93. Përkundër shkrimtarëve turq të cilët nuk e pranojnë këtë si vepër të Samiut, në të cilën ushqehet një kauzë e rëndë shqiptare, përpos asaj që me këmbëngulësi theksohet nga ana e autorëve shqiptarë se kjo është një vepër e Samiut me anë të së cilës ata kanë dashur që kësaj veprë t’ia ngrenë namin duke e përdorur emrin dhe autoritetin e Samiut, edhe kohëve të fundit madje është futur në kompletin e veprave të tij, në të cilin bëjnë pjesë edhe veprat e tjera të tij të përkthyer nga turqishtja, ku kjo është botuar si vepra e dytë e kësaj serie: *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë, Veptra II*, Tiranë, 1988. Ky libër, përpos turqishtes e frëngjishtes, është përkthyer edhe në gjermanishte, italishte e greqishte dhe në shkallë të gjerë është përdorur si material për propagandë politike. Në botimet ku figuron emri i Samiut si autor i kësaj veprë, bie në sy se të gjitha këto botime janë bërë nga viti 1904 e kanë vazhduar edhe pas vdekjes së tij. Kjo vepër, që i përshkruhet Samiut dhe ku mbrohet teza se shpëtimi i Shqipërisë nga imperializmi shekullor i shtetit osman mund të bëhet vetëm me vullnetin dhe marrjen në dorë të pushtetit të saj nga ana e vetë shqiptarëve e jo më me administrimin e Turqisë, e cila edhe ashtu është duke i numëruar ditët e fundit të saj në kontinentin evropian, dhe ku kundër turqve përdoren fjalë e gjykime shumë nënçmuese, sikur të ishte vepër vërtet e Samiut, kjo para së gjithash do të ishte një refuzim dhe kundërshtim i Samiut me vetveten pas krejt atyre thënieve mburrëse me elementin turk, që i pati shprehur deri më atëherë e që do t’i shprehë edhe pas vitit 1899, e në veçanti do të ishte një mohim apo përgënjeshttrim i tërësishtëm nga ana e tij e të gjitha mendimeve që ai kishte shprehur ndaj çështjes turke. Në të vërtetë gjithnjë e më shumë po del në shesh se këtë vepër nuk e ka shkruar Samiu, por vëllai i tij Naim Frashëri, i cili edhe pse një pjesë

të konsiderueshme të jetës së tij e ka kaluar në Turqi dhe ku është ngjitur në poste të larta zyrtare, prapë se prapë nuk ka mundur të ngrohet me turqit dhe me turqinë. Në mesin e personaliteteve të tjera, si Abdyl Beu, Vasa Efen-  
 diu, Jani Vretoja etj., të cilët më 30 shtator 1879 në Stamboll themeluan “Arnavud Cemiyet-i Ilmiyyesi” (Shoqata shkencore shqiptare) duke e marrë pëlqimin prej Abdulhamidit II, i cili në fillim ishte i mendimit se lëvizja e paraqitur në Shqipëri duhej zgjidhur e menaxhuar me rrugë politike, bënte pjesë edhe vetë Shemseddin Samiu. Samiu vetëm brenda disa muajsh në emër të kësaj shoqate e përpiloi abetaren e gjuhës shqipe që për bazë e kishte shkrimin latin. Kjo abetare pastaj do të njihet si “Abetarja e Shoqërisë së Stambollit” ose “Abetarja e Stambollit”. Përpos kësaj abetareje (Abetarja e gjuhës shqipe) që në fillim u botua në Stamboll më 1879 e pastaj edhe në Bukuresht më 1886, Samiu shkroi edhe gramatikën e parë të gjuhës shqipe (Shkronjëtoje e gjuhës shqip) e cila u botua në Bukuresht më 1886 nga ana e shoqërive botuese shqiptare. Në botimet e para të të dyja këtyre veprave në vend që të shkruhej emri i plotë i tij, vërehej të ishte shënuar forma e shkurtuar e emrit të tij me simbolet S.M.F. Në vitin 1880 (1297) me kërkesë të vetë Abdulhamidit II, Samiu merret në saraj dhe emërohet si sekretar i Komisionit Ushtarak për Inspektim (Teftiş-i Askeri Komisyonu) që ishte formuar në ndërkohë (Tercüman-ı Hakikat, 29 dhjetor 1880). Kjo detyrë, të cilën e ka ruajtur deri në fund të jetës së tij pas shumë ngjitjesh nëpër poste të ndryshme (shih Tahsin Paşa, *Abdülhamid ve Yıldız Hatıraları*, Stamboll, 1931, f. 21), Shemseddin Samiut i ka dhënë një rast shumë të volitshëm për t’iu kushtuar punës së vazhdueshme librat dhe përgatitjes së veprave voluminoze nga ana e tij. Veprat më të mëdha të tij, ku e shpreh pastaj edhe identitetin e tij të mirëfilltë, fillon t’i shkruajë pasi hipi në



këtë post. Në krye të punimeve të kësaj periudhe vjen vepra **Sefiller (Idiotët)**, që njëkohësisht është edhe përkthimi më i madh i tij. Samiu, i cili në fillim nxori revistën **Aile (Familja)** (1880) e pastaj edhe **Hafta (Java)** (1881/1882), mes viteve 1882-1883 (1299-1300) pjesë-pjesë e botoi veprën e tij të parë voluminoze, fjalorin frëngjisht-turqisht **Kamus-i Fransevi**. Me këtë, në veprimtarinë botuese të Samiut fillon periudha e leksikografisë së tij, e cila në botën e mendimit turk atij i siguron një pozitë të lartë e të dalluar. Po në këtë periudhë rasis edhe martesë dhe formimi i familjes së tij (1884). Në vitin 1302 (1885), në fund të një angazhimi të vazhdueshëm dyvjeçar, ai e përfundon edhe pjesën tjetër turqisht-frëngjisht të fjalorit **Kamus-i Fransevi**. Si shpërblim për këtë angazhim të tijin Sulltan Abdulhamidi II i dha gradën “ûlâ sınıf-ı sâni” dhe dekretin “İftihar”. Mbas kësaj, brenda një periudhe disavjeçare kur ai fiton një farë lirie (mosangazhimi) relative, Samiu nuk rri bosh por i përfundon edhe librat e tjerë të serisë “Cep Kütüphanesi” (Biblioteka e xhepit), krahas disa përkthimeve e veprave të vogla origjinale, boton edhe fjalorin e vogël frëngjisht-turqisht, por të përgatitur më me kujdes sesa ai i madhi, të quajtur **Küçük Kamus-ı Fransevi** (1304=1886) dhe i përvishet punës së madhe për përpilimin dhe botimin (në mes viteve 1305-1316=1888-1899) e një enciklopedie të përgatitur fillikatisht nga ai të quajtur **Kamus al-A’lam**, për të cilën ai thotë se ia ka marrë 12 vjet të jetës së tij. Nga njëra anë në vitin 1309 (1892) ai ngrihet në postin e sekretarit të përgjithshëm të Komisionit Ushtarak për Inspektim, në vitin 1311 (1894) i ndahet grada “ûlâ sınıf-ı evvel”, kurse nga ana tjetër në vitin 1892 i vdes gruaja e parë e më 1894 martohet sërish, me çka përjeton disa ndryshime në jetën e tij, pa përfunduar akoma kjo veprimtari e madhe autoriale, në mes viteve 1313-1314 = prill 1896-prill 1897 me



një vrull të mahnitshëm fillon përpilimin dhe botimin e një fjalori të madh të quajtur **Kamus-ı Arabi**. Në vitin 1315 (1898) e riboton **Kamus-i Fransevi** me një redaktim e zgjerim të konsiderueshëm sikur ta kishte përpiluar për së dyti. Në mesin e këtyre ai nuk ngurron të shkruajë edhe vepra të tjera për mësimin e gjuhës, e kur i afrohet vëllimit të fundit të enciklopedisë **Kamus al-A'lam** (1316=1898/1899), ai fillon në mënyrë të vazhdueshme të shkruajë nëpër gazeta edhe për çështjen e Përmirësimit të gjuhës turke. Ky njeri i palodhshëm menjëherë pasi e përfundon përpilimin e **Kamus al-A'lamit**, shtatë-tetë muaj më pas, në vitin 1899, i përvishet fjalorit turqisht-turqisht **Kamus-ı Türki**. Samiu, para se të fillojë me botimin e kësaj vepre të re madhështore, përmes një artikulli e njofton opinionin turk për këtë nismë të re të tijën ("Kamus-ı Türki ve Kamus-ı Arabi", Servet-i Funun, XVIII, nr. 462, 6 janar 1315, f. 306-308). Këtu ai e njofton publikun edhe me lajmin se bashkë me Kamus-ı Türki për çdo javë nga një pjesë do ta botonte edhe Kamus-ı Arabi, shtypjen e të cilit për një kohë e kishte lënë mënjanë.

Meqë nuk mund t'i duronte më shpërdorimet e botuesit të tij Mihranit, dhe meqë as botuesit e tjerë nuk tregonin gatishmërinë për ta botuar veprën Kamus-ı Türki bashkë me veprat e fundit të tij, Samiu fillon që këto botime t'i bëjë vetë në një pjesë të marrë me qera në Portën e Lartë. Në vitin 1899 e nisi serinë e botimeve "Kütübhanë-i Müntehabat", me ç'rast në vitin 1317 (1899) e botoi veprën **Baki'nin Eş'ar-ı Müntahabesi** kurse një vit pas, 1318 (1900), veprën **Ali bin Ebi Talib Efendimiz'in Eş'ar-ı Müntahabesi**. Kah fundi i vitit 1901 e përfundon fjalorin **Kamus-ı Türki** dhe deri në fund të jetës së tij jepet tërësisht pas kërkimeve të gjuhës dhe letërsisë turke, me ç'rast në vitin 1902 e përkthen veprën **Kutadgu Bilig**, më 1903 **Orhun Abideleri** dhe **Tuhfetü'z-zekiy-**

**ye fi lugati't-Türkiyye** dhe më 1904 e përgatit fjalorin e turqishtes kipçake me titull **Lehce-i Türkiyye-i Memalik-i Mısır**. Fatkeqësisht, për shkak të mungesës së të hollave nga njëra anë dhe për shkak të sëmundjeve që vuan-te nga ana tjetër, nuk arriti t'i botonte këto vepra të fundit e me peshë të jashtëzakonshme. Autori, që tanimë dukej sikur të ishte në moshë shumë të thyer, si rezultat i angazhimeve të mëdha e të lodhshme gjatë jetës së tij, ndërron jetë në moshën 54 vjeçare, respektivisht më 18 qershor 1904 (4 rebiu'l-ahir 1322). Vdekja e tij që shkaktoi një keqardhje të gjerë, u reflektua gjerë e gjatë edhe në shtypin e kohës (shih p.sh. "Bir haber-i Elim, Şemseddin Sami Bey'in İrtihali", İkdam, nr. 3595, 3596, 5-6 rebi'ul-ahir 1322; "Ziya-i Azim", Sabah, nr. 5-6 rebiul-ahir 1322; Ahmed Ihsan, "Ziya-i Elim, Merhum Şemseddin Sami Bey", Servet-i Fünun, XXVII, nr. 687, 10 qershor 1320, f. 162-164). Edhe në revistat e gazetatat që botoheshin nga rrethi i xhon turqve jashta vendit, të cilët ushqenin respekt e simpati të thellë ndaj të ndjerit, zunë vend mjaft shkrime lidhur me punimet dhe largpamësinë e tij (Abdullah Cevdet, İctihad, Gjenevë, nr. 2, 5 janar 1905, f. 7, 10-12; "Bir Ziya-i Azim", Türk, Kajro, nr. 35-36, 23 rebiul-ahir 1322). Varri i Shemseddin Samiut, që për një kohë të gjatë nuk ka patur gur varri, ka qenë në varrezat përballë Xhamisë Sahra-yi Cedid në Erenköy, kurse në vitin 1968 transferohet pranë varrit të djalit të tij Ali Sami Yen në Feriköy.

*Personaliteti dhe veprat e tij.* Në mesin e figurave më krijuese në botën e gjuhës dhe letërsisë turke të shek. XIX, Shemseddin Samiu na paraqitet si një shkrimtar që ka shkruar vepra në lëmi shumë të ndryshme. Veprimtaria e tij e shkrimit ka filluar me gazetarinë, për të vazhduar më pas me veprat letrare, me përkthimet, me revistat dhe enciklopeditë e për të përfunduar me punimet gjuhësore e leksikografike. Prej këtyre, kah fundi i jetës së tij nuk i

është kthyer më kurrë gazetarisë, romanit, teatrit dhe revistave. Lidhjet e tij me gazetarinë, më pas i ka vazhduar vetëm me artikujt nga fusha e mendimit dhe gjuhës, kurdo që gjente kohë prej punimeve të tij voluminoze.

*Veprat letrare.* Vepra e parë e tij në fushën e letërsisë **Taşşuk-i Tal'at ve Fitnat (Dashuria e Talatit me Fitneten)** është një roman që, duke ndjekur prirjen e drama-ve të kohës, shtjellon çështjen e fatkeqësive që i sjell me vete martesë e padëshirueshme e dy të rinjve. Ka mendimtarë që këtë roman, të cilin autori filloi ta botojë në vitin 1872 (Hadika, nr. 5, 13 ramazan 1289) dhe e përfundoi në verën e vitit 1873, e shohin si romanin e parë të stilit evropian në letërsinë turke. Në këtë vepër të vogël, ku autori nuk e zotëron mirë gjuhën turke, krahas ngjarjeve romantike vërehet edhe një ndjeshmëri e stërmadhuar me disa vrojtime të vogla realiste. (Kjo vepër është shtypur edhe me shkronja latine: bot. Sedid Yüksel, Ankarë, 1964). Edhe pse autori ka dhënë lajmin se ka për të botuar edhe dy romane të tjera me titujt **İskat-ı Cenin – yahud - İkisi Ölmüş, İkisi Çıldırmiş (Aborti – ose të dytë të vdekur, të dy të çmendur)** dhe **Rekabet (Konkurrenca)**, si roman i botuar i mbetet vetëm ky, pas të cilit veprimtarinë e tij letrare e drejton kah fusha e teatrit që ishte prirje kohe. Ai edhe më herët kishte provuar të shkruante një tragjedi të titulluar **Suhrab-yahud-Ferzendkuş**, ndëkaq mes viteve 1874-1876 ai shkruan edhe tri vepra teatrale, të cilat edhe u botuan. Në këto vepra teatrale Samiu, në vend që ta trajtonte vetëm dashurinë dhe ngjarjet e zakonta që ndodhnin brenda kornizës së jetës së përditshme e që kishin të bënin me problemet e shkaktuara nga martesë me personin e padëshirueshëm, ai kishte idenë dhe prirjen të shkruante për temat që ai i quante “kombëtare” dhe që mbështeteshin në historinë ose në traditat morale të një populli. Edhe Ebdulhak Hamidi në



po të njëjtat vite e mbështet të njëjtën ide dhe veprën **Besa** të Samiut e paraqet si shembull të dramës kombëtare (Duhter-i Hindu, Stamboll, 1292, "Hatime", f. 2). Vepra **Besa – yahud – Ahde Vefa**, e shkruar me këtë ide nga ana e Samiut, është një dramë e cila e trajton zakonin e betimit që ushtrohej në vendlindjen e autorit, e që quhej "besë/a". Në këtë vepër bëhet fjalë për Tahir again se si ai ia jep fjalën (besën) një zonje, e cila i shpëton kokën nga dora e një katundari kur po kthehej në vendlindje, se ai do ta marrë hakun për vrasjen e burrit të saj Zubejrit dhe për grabitjen e vajzës nga ana e katundarit. Mirëpo, pasi ai e merr vesh se personi që duhej mbytur ishte djali i tij, për të mos e thyer besën, e vret të birin, por nga keqardhja e kësaj që ndodh ai më në fund e vret edhe vetveten.

Ndërkaq veprat **Seydi Yahya** dhe **Gave**, që janë rezultat i të njëjtit botëkuptim teatror, temat i kanë të marra nga historia dhe mitologjia. **Seydi Yahya** është një vepër e cila, pak më parë se Abdulhak Hamidi, letërsinë teatrore turke e hap ndaj temave të marra nga historia e Andaluzisë. Ashtu si në dramën e parë **Suhrab-yahud-Ferzendkuş**, edhe vepra **Gave** temën e merr nga Shahnameja duke u frymëzuar sidomos nga legjenda e Dahhakut, ndaj dhe këtu trajtohet tregimi i farkëtarit Gave, i cili ngritet kundër padrejtësive të Dahhakut. Edhe pse Samiu njoftonte se pas disa ditësh do të botohej kjo vepër (Sabah, nr. 1, 12 safer 1293 = 8 mars 1876), në fakt ajo ka mundur të botohet vetëm pas shkarkimit të Abdulazizit dhe në ditët e para të hipjes në fron të Muradit V (Sabah, nr. 109, 8 xhemadijel-ahir 1293 = 30 qershor 1876). Këto shënime që i dhamë më lart, nga çdo aspekt e përgënjeshtrojnë pretendimin e Kramersit (Encyclopedie de l'Islam, IV, 1928, f. 140-141) kinse shfaqja e kësaj drame është bërë shkak për internimin e Samiut në Tripoli. Këto drama të Samiut, edhe pse kanë qenë shumë të natyrshme si



për nga kujdesi ndaj kërkesave të skenës, renditjes profesionale të ngjarjeve, përshtatshmërisë me gjuhën e skenës, figurave që ishin larg çdo stërmadhimi, ashtu edhe për nga suksesshmëria më e madhe krahasuar me veprat e tjera që kishin fituar famë teatrore në atë kohë, prapë se prapë nuk arritën të afirmohen aq shumë. Në këtë mund të ketë ndikuar edhe ngritja e autoritetit të autorit me veprat e tjera më të mëdha e më voluminoze, që më vonë i shkruan në fushat e tjera.

Ndërsa ishte gjallë autori i botua një libër i vogël që drejtpërdrejt studionte dhe analizonte veprat teatrale të tij (İsmail Hakkı, *On Dördüncü Asrın Türk Mubarrirleri – Şemseddin Sami Bey*, Stamboll, 1311 = 1895). Në këtë libër është trajtuar vetëm drama **Besa**, duke u lënë mënjanë, si pasojë e censurës, pjesët ku ishin dramat **Seydi Yahya** dhe **Gave. Besa**, e cila ishte drama më e famshme dhe më shumë e shfaqur se dramat e tjera, pas Meshrutijetit të Dytë (Periudhës së dytë kushtetutore 1908-1918 – përkth.) është vënë në skenë shumë dhe shpesh në vise të ndryshme të vendit. Përveç këtyre, autori pati shkruar edhe dy vepra të tjera në fushën e teatrit. Njëra është drama pesëperdëshe **Mezalim-i Endülüs (Mynxyrat e Andaluzisë)**, për të cilën në fillim nuk kishte folur fare, por në vitin 1885 e përmend në mesin e veprave të tij, pa qenë botuar, me emrin “Facia”, si dhe drama e pabotuar triperdëshe **Vicdan (Ndërgjegjja)**, që po ashtu temën e kishte të marrë nga historia e Andaluzisë.

*Përkthimet.* Sidomos në periudhën dymbëdhjetëvjeçare të jetës së tij si autor, vend të veçantë zë veprimtaria e tij përkthyesë. Përkthimet që i pati bërë ai, më tepër janë të njohura e të rëndësishme për shkak të reagimeve që i kanë shkaktuar ato dhe për ndikimin që kanë patur në ndryshimin e prozës turke. Përkthimet që ai i ka bërë nga letërsia evropiane dhe që për nga numri i tejkalojnë veprat

e tij origjinale nga fusha e letërsisë, gjithsejt janë 6 e të bëra deri në vitin 1885. Të gjitha këto janë përkthime të bëra nga gjuha frënge dhe, ashtu si përkthimet e të tjerëve, edhe këto kanë qenë zgjedhur nga lloji i atyre veprave që më tepër pëlqeshin nga populli, sesa nga ato që kanë patur vlera të mirëfillta letrare. Nga veprat më të rëndësishme të literaturës perëndimore të përkthyer në gjuhën turke janë vetëm veprat **Sefiller** e Victor Hugo-s dhe **Robinson Cruso** e Daniel de Foë-s. Përkthimi i veprës **Sefiller**, ka mbetur në gjysmë, sipas një njoftimi për shkak të ndalimit të saj (p.sh. shih: *İçtihad*, Gjenevë, nr. 2, 5 janar 1905, f. 7; Ismail Habib, *Avrupa Edebiyatı ve Biz*, Stamboll, 1941, II, 233), kurse sipas Halid Zijaut për shkak se nuk ka mund të shitet (shih Halid Ziya, *Kırk Yıl*, Stamboll, 1936, III, 144). Edhe pse në fillim drejtorja për censurë e lejon botimin e këtij përkthimi, me ç'rast prej fillimit të vitit 1882 botohet pjesë-pjesë thujse 2/3 e veprës, gjithsejt 644 faqe (lajmi për këtë, në: *Hafta Mecmuası*, nr. 20, 21 safer 1299, f. 321), më vonë e ndalon këtë botim, pjesa tjetër e mbetur prej faqes 645 pëfundohet pas vdekjes së Samiut nga ana e Hasan Bedreddinit. (Ky përkthim është shtypur edhe me shkronja latine). Vepra **Robinson** ndërkaq nuk është përkthyer nga teksti origjinal në anglisht, por nga versioni i shkurtuar për fëmijë në frëngjishte dhe synonte të shërbente si udhëzues për ata që e mësojnë gjuhën frënge. Vepra **Şeytanın Yadigarları (Përkujtimet e djallit)** ishte përkthimi më voluminoz para përkthimit të **Sefiller**, që Samiu e mori nga Frederic Soulie, mirëpo ishte një roman aventurash që nuk kishte ndonjë vlerë të veçantë letrare. Novela **Galatee** të cilën ai e kishte përkthyer nga Floriani, nuk zgjoi ndonjë interesim të madh në atë kohë, përkundër kësaj, përkthimi i tragjedisë **İhtiyar Onbaşı** të Dumanoir dhe Dennery, është vënë shumë herë në skenë. Nuk gjejmë ndonjë shënim që

Samiu, i cili e njihte mirë edhe greqishten e vjetër e italishten, të kishte përkthyer ndonjë vepër nga letërsia e këtyre gjuhëve. Përkthimi i Samiut që merrte për bazë të qëndruarit besnik fjalë për fjalë ndaj tekstit, ka shkaktuar kritika e polemika të ashpra në kohën e tij. Atë e kanë fajësuar për vështirësimin e rendit të fjalisë, të bërë shprehje në gjuhën e prozës, gjë të cilën Samiu e bënte me qëllim që ta ruante, sa të ishte e mundur, strukturën e fjalisë në gjuhën origjinale prej së cilës përkthente; e kanë fajësuar edhe për moslëshimin pe nga teksti origjinal, të cilën ai e bënte vetëm e vetëm për t'i ruajtur kërkesat e stilit, me çka, sipas tyre, ai e prishte shprehjen idiomatike të gjuhës turke. Në këtë drejtim, sidomos përkthimi i veprës **Sefiller** ka tërhequr pas vete shumë kritika. Këto kritika kundër tij fillojnë qysh kur ai nisi ta botojë veprën pjesë-pjesë. Samiu, me rastin e një kritike të rëndë drejtuar atij (**Vakit**, nr. 1598, 19 rebiul-ahir 1297 = 30 mars 1880), në po të njëjtën gazetë e ndjen veten të detyruar t'i përgjigjet asaj (**Vakit**, nr. 1601, 22 rebiul-ahir 1297). Me vazhdimin e sulmeve ndaj Samiut, edhe Ahmed Mid'hat Efendiu i bashkëngjitet polemikës me ç'rast e mbron Samiun (**Tercüman-ı Hakikat**, nr. 572, 1 xhemadijel-ahir 1297). Edhe gjatë gjithë kohës derisa botohej pjesë-pjesë vepra, kritikant dhe polemikant në këtë drejtim s'kishin të ndalur. Shumë më vonë përkthimin e veprës **Sefiller** do ta kritikojë ashpër edhe Süleyman Nazifi ("Sully Prudhomme", *Servet-i Fünun*, v. 56, nr. 1481, 11 rebiul-evvel 1338, f. 92; shih edhe shënimin e autorit të Abdülhak Hamid, *Mektublar*, Stamboll, 1334, v. I, f. 26). Shemseddin Samiu për t'u dhënë një përgjigje përfundimtare këtyre kritikave, në veprën e fundit të përkthyer nga letërsia perëndimore, **Robinson**, në kapakun e këtij libri menjëherë nën titullin e veprës me qëllim e vë shënimin "përkthim i fjalëpërfjalshëm", kurse në hyrjen e saj edhe një herë i shpreh bin-



djet e tij në këtë drejtim, duke theksuar se nuk duhet frikuar nga përkthimet që u qëndrojnë besnike teksteve origjinale se mos po sjellin ndonjë humbje dialekti apo elementi të rëndësishëm gjuhësor, porse me këtë do t'i ndihmohet përmirësimit dhe zhvillimit të gjuhës sonë. Ky stil përkthimesh do ta ndryshojë strukturën komplekse të fjalisë të bërë shprehi në letërsi dhe me nxjerrjen e shprehjes nga stili i shkruar në atë të folur të popullit, gjuhës turke do t'i shtohet edhe më tepër thjeshtësia dhe bukuria e saj. Mendimi i Samiut se idetë e reja nuk mund të shprehen mirë me gjuhën e vjetër prozaike, është shumë me rëndësi për ta theksuar nevojën për një prozë të re. Kjo ide e tij, në letërsinë e Servet-i Fünunit do të gjejë vend me shprehjen “një gjuhë e re për ndjenjat dhe konceptet e reja”. Halid Zijau e përmend stilin e ri gramatikor në përkthimin e veprës **Sefiller** dhe na tregon se si më pas njerëzit fillojnë të mësohen me këtë stil (*Kırk Yıl*, IV, f. 89 e më tej). Kjo strukturë e ndryshme fjalië në përkthimet që botoheshin gjatë kohës së zhvillimit e rritjes së Servet-i Fununistëve, përbën njërin prej ndikimeve më me peshë në përgatitjen e terrenit për stilin evropian të prozës, të cilin më vonë do ta zhvillojë shoqata e Servet-i Fununit.

Pas botimit të **Robinsonit** më 1885, edhe pse interesi i Samiut në veprimtarinë përkthyesë orientohet kah veprat e lindjes, prapë se prapë nuk gjejmë ndonjë rezultat të madh, përveç dy veprave të vogla, njëra është përmbledhje poezish të zgjedhura nga kujtimet biografike të poetëve persianë të cilën ai, duke e marrë si shembull veprën **Hurdefuruş** të Muallim Naxhiut (1302=1885), e titullon me emrin **Hurdeçin** (1302=1885); kurse tjetra është një përmbledhje e pjesëve të përzgjedhura e të komentuara nga divani që i përshkruhet Ali bin Ebi Talibit. Merret vesh se me të njëjtën ide përkthimi e botimi i ka



përgatitur dhe shumëzuar edhe veprat **el-Muallakatü's-Seb'a** dhe **Zübde-i Şahname**.

Në vitet e fundit të jetës së tij, që karakterizohen me mbizotërimin gjithnjë e më të madh të punimeve turkologjike mbi jetën e tij ideore, veprimtaria përkthyesce e tij merr një kahje tjetër krejt të re, gjatë së cilës ai është munduar që lexuesit turk t'i ofrojë përkthimet në gjuhën e sotme të veprave **Orhun Abideleri** dhe **Kutadgu Bilig**.

*Veprat shkencore.* Ideja e tij për të qenë i dobishëm për popullin në lëmi të ndryshme e të larmishme si dhe për t'ia mësuar atij sendet më të reja, e shtyn Samiun që krahas veprave letrare, të shkruajë edhe vepra për intelektualët e mesëm e për popullin e thjeshtë. Me përfundimin e veprimtarisë gazetareske si dhe me shpëtimin nga barra e mbushjes së faqeve të gazetave të tij me lapsin e tij të vetmuar, gjen rastin të shkruajë vepra me tema të ndryshme nga lëmia e shkencës. Puna që bënte ishte e njëjtë dhe vazhdimësi më solide e punës që e bënte edhe Mid'had Efendiu. Dallimi midis tyre ishte se Samiu temat e tij i trajtonte me një kulturë të fituar nga njohja më e mirë dhe më e begatë e gjuhës dhe se ai merrej edhe me fushën e linguistikës, me të cilën Mid'had Efendiu merrej fare pak. Përkundër kësaj, punimet nga fusha e historisë e Ahmed Mid'had Efendiut nuk i gjen dot te Samiu. Edhe pse synimi i të dyve në këtë fushë ishte i njëjtë, prapë se prapë dallimi nivelor midis tyre vinte nga arsimimi shumë cilësor të cilin Samiu e kishte fituar në gjimnaz (Zosimea në Janinë-përkth.). Ç'është e vërteta, po këtu duhen kërkuar edhe disa anë progresive të Samiut që ai i kishte mbi shkrimtarët e tjerë të kohës.

Shemseddin Samiu i cili dëshironte që, masës së gjerë të mesme të kohës së tij t'ia paraqiste e mësonte disa degë shkencore sipas zhvillimeve më të reja që i kishin arritur në Evropë (shih p.sh. "Terakki ve Maarif", **Hafta**, nr. 2,

1298, f. 2-6; “Ta’ mim-i Maarifin Esbab u Usulü”, nr. 4, f. 49-52; “Okuyup Yazmak”, nr. 5, 65-69), angazhimin e tij në këtë drejtim e fillon me serinë “Cep Kütüphanesi” që përbëhej nga libra me format të vogël, të lirë në çmim e të shkruar me një gjuhë të thjeshtë, kurse nga ana tjetër këtë dëshiron ta vazhdojë me nxjerrjen e njëpasnjëshme të dy revistave të tij. Nga gjithsejt 32 libra të kësaj serie, në të cilën me veprat e tyre kanë marrë pjesë edhe shkrimtarë të tjerë si Ebuzzijau, Beshir Fuadi, Ahmed Rasimi etj. (1296-1302 = 1879-1886), 11 vepra 15 vëllimëshe qenë shkruar nga vetë Samiu. Prej këtyre, vepra **Gök (Qielli)** (1296=1879) ka të bëjë me astronominë, vepra **Yer (Toka)** (1296=1879) ka të bëjë me gjeologjinë, kurse veprat **Insan (Njeriu)** (1296) dhe **Yine Insan (Përsëri njeriu)** (1303=1886) kanë të bëjnë me antropologjinë. Në veprën **Medeniyyet-i Islamiyye (Qytetërimi islam)** (1296=1879) në mënyrë të thukët, sidomos duke e patur parasysh çështjen e ndikimit mbi qytetërimin evropian, flitet për nivelin e lartë që qytetërimi islam në mesjetë e kishte arritur përmes shkencave të ndryshme, llojeve të artit e përmes institucioneve shoqërore. Vepra **Kadınlar (Gratë)** (1296=1879) është një vepër sociologjike që e trajton pozitën e gruas në shoqëri. Afërsisht gjysmën e kësaj vepre e përbën pjesa ku flitet për vlerën që Islami ia ka dhënë gruas dhe përgjigjet që Samiu i jep kundër përshkrimeve e dyshimeve të ndryshme lidhur me këtë temë. Turkologu rus Gordlevski, i cili prej veprave të Samiut më së shumti është marrë me këtë vepër, i çmon lartë idetë progresive të ngërthyera në të. Tri veprat e tjera të serisë, ndërkaq, janë vepra që botën tonë ideore e hapin ndaj fushave të reja të shkencës. Vepra **Esatir (Legjendat)** (1296=1879) është vepra e parë në gjuhën turke që në mënyrë të përmbledhur na jep njohuri për mitologjitë e ndryshme të popujve të Lindjes e Perëndimit. Vepra **Li-**

san (**Gjuha**) (1303=1886) është vepra e parë te ne që në mënyrë të pavarur merret me linguistikën. Edhe vepra **Usul-i Tenkit ve Tertib (Metodologjia e pikësimit dhe renditjes)** (1303=1886) bart emrin e veprës së parë që i përcakton rregullat dhe shenjat e pikësimit në gjuhën turke. Këtu në sy bie edhe dëshira e tij për të treguar rregullat e kompozitave. (Për shkak të interesimit të madh që ngjallën te lexuesit, këto vepra janë botuar edhe nga një herë: **Medeniyyet-i Islamiyye** (1296, 1302), **Esatir** (1296, 1311) dhe **Kadınlr** (1296, 1311). Vepra **Letaif (Anekdota)** (1300=1883, 2 libra) që përmban tregime e anekdota të ndryshme si dhe vepra **Emsal (Fjalë të urta)** (4 libra, 1296-1297=1879-1880), që përmbledh në vete shumë fjalë të urta e tregime të pasura dhe e shkruar në stilin e veprës së Rochefoucauld-it, janë dy vepra të shkruara për argëtim. Përpos kësaj serie Samiu ka shkruar edhe një libër të vogël në gjuhën arabe **Himmetü'l-himam fi neshri'l-Islam (Përpjekja e heronjve në përhapjen e Islamit)** (1302=1885), ku ai flet për përhapjen e Islamit në tri kontinentet e botës, për popujt dhe shtetet që kanë luajtur rol në këtë drejtim, si dhe për ndikimet qytetërimore të kësaj përhapjeje. Këtë vepër e përkthen në gjuhën turke Giridli Mustafa Nuriu dhe e boton në Hanya në vitin 1887 (1305).

*Revistat e Samiut.* Revistat Samiu i shihte si një ndër mjetet më të rëndësishme për bartjen dhe përcjelljen e njohurive më të reja të nivelit evropian te populli dhe, para se t'i hyjë punës së fjalorëve, ai mundohet ta realizojë këtë ide me nismën e tij për nxjerrjen e dy revistave. Përvoja e tij e parë në këtë fushë fillon në vitin 1876 në revistën **Muharrir (Shkrimtari)**. Pas revistës **Aile (Familja)**, të cilën filloi ta botonte në vitin 1880 për të trajtuar problemet e grave dhe e cila pas tre numrash nuk del dot më (nr. 1-3, 17 xhemadijel-ahir 1297 – 2 rexheb 1297), veprimtarinë e



tij më origjinale e më të frytshme në këtë fushë e paraqet në revistën **Hafta (Java)**, të cilën ai nisi ta botojë në vitin 1881 dhe që ishte njëra ndër revistat më serioze të kohës. Në këtë revistë, që dilte një herë në javë dhe ku të gjitha shkrimet ishin të tijat, Samiu na paraqitet me një karakter enciklopedisti të vërtetë duke trajtuar tema të llojllojshme që nga shkencat e ndryshme e deri te gjuha, problemet e përgjithshme letrare, morali e arti. Revista **Hafta** mbyllet pesë muaj pas fillimit të botimit të saj (nr. 1-20, 22 ramanzan 1298 – 21 safer 1299), ku Samiu, ndër të tjera, ankohej edhe për jovazhdimësinë e revistave në jetën tonë ideore. Në këtë revistë Samiu, si një admirues i dijes ashtu sikurse edhe Hoxha Tasini ndaj të cilit kishte respekt të veçantë, bie në sy sidomos insistimi i tij për shtrirjen e njohurive shkencore te masat e gjera të popullit dhe për çështjen e ecjes përpara në mënyrë të qytetëruar. Më e rëndësishmja mbi të gjitha është se ai në këtë revistë sjell shkrime, në të cilat problemeve të gjuhës e të letërsisë u qaset si një turkolog i vërtetë.

*Veprat mbi gramatikën.* Dëshira për mësim që kishte zënë vend qendror në personalitetin e Samiut, e shtyn atë që të shkruajë edhe disa libra të vegjël praktikë nga fusha e gjuhësisë. Veç asaj që ai në shumë shkrime të tij ka shprehur mospajtimin e tij me metodën e vjetër të mësimin të gjuhës dhe ku ai i ka theksuar idetë e tij lidhur me lehtësimin e procedurës së mësimin të alfabetit e të gjuhës, ai edhe ka shkruar libra gjuhe në stilin e ri. Vepra e botuar shumë herë **Küçük Elifba (Abetarja e vogël)** (1300; bot. i katërt 1311), të cilën ai e kishte shkruar për të siguruar mësimin më të kollajshëm të shkronjave të vjetra arabe, pas saj vepra **Yeni Usul Elifba-i Türki (Metoda e re e abetares turke)** (1308) si dhe vepra **Nev-usul Sarf-ı Türki (Metoda e re në gramatikën turke)** (1309), ku ai provonte një metodë gramatikore shumë të ndryshme, janë



vepra që kanë lindur si rezultat i këtij të menduari të Samiut. Ai nuk arrin ta botojë veprën **Kıraat-i Türkiyye ve Nev-usul Nahv-i Türki (Leximi turqisht dhe metoda e re në sintaksën turke)**, të cilën e kishte përpiluar për të njëjtin qëllim. Edhe në veprat që i kishte shkruar për gjuhën arabe, si **Tasrifat-ı Arabiyye (1304=1887)**, **Usul-i Cedid-i Kavaid-i Arabiyye (1317)** dhe **Tatbikat-ı Arabiyye (1318)**, ai tenton të sjellë një metodologji të re.

*Fjalorët dhe enciklopeditë.* Shemseddin Samiu, personalitetin e tij të vërtetë dhe pozitën e tij të mirëfilltë në historinë tonë mendore e gjenë në fushën e leksikografisë e të trajtimit të çështjeve të gjuhës turke. Njëzet e tri vitet e fundit të jetës së tij që i përshkojnë punimet në fushën e përgatitjes së fjalorëve dhe enciklopedive, atë e bëjnë figurën më të dalluar e më të frytshme në leksikografinë turke. Edhe pse nga shkrimtarët e famshëm të kohës ndiehej nevoja e madhe për përpilimin e fjalorëve, asnjëri prej tyre nuk i hynte vetë kësaj pune. Këtë e merr përsipër Samiu dhe e vazhdon deri në fund të jetës së tij. Në fillim, për t'iu përgjigjur kërkesës së madhe të kohës, kësaj pune i rreket me hartimin e fjalorit frëngjisht-turqisht, kurse më në fund këtë e përfundon me hartimin e fjalorit turqisht-turqisht, fjalorit më të respektueshëm e më të përdorshëm nga shumë breza nxënësish e studiuesish turq. Fjalori i parë i tij **Kamus-ı Fransevi**, përveç asaj se është fjalori më i përkryer frëngjisht-turqisht që ishte hartuar deri më atëherë, por bartte privilegjin të ishte edhe lajmëtar i kalimit të kësaj fushe nga monopoli i autorëve të huaj apo të pakicave që jetonin në vend dhe të cilët deri më atëherë ishin të vetmit që merreshin me këtë, në duart e autorëve turq. Edhe pse në të njëjtën kohë është botuar edhe një vepër tjetër e titulluar **Gunyetü'l-hıgat**, njëri prej autorëve të saj ishte nga radhët e pakicave. Botimi i fjalorit **Kamus-ı Fransevi** u prit me shkrime të ngrohta urimi e

falënderimi (p.sh. Vehbi, "Üdebamızdan İzzetlu Sami Bey Efendi'ye", Tercüman-ı Hakikat, nr. 1397, 29 rebiul-ahir 1300) dhe ishte një fjalor që mbi një gjysmë shekulli e më tepër ishte më i kërkuari dhe që i plotësonte nevojat e brezave të njëpasnjëshëm dhe në fakt ishte një vepër që pastaj do të shërbejë si një nxitje e mirë për hartimin e fjalorëve të tjerë ng autorët e tjerë turq.

Në këtë vepër, për të cilën autori thoshte se ishte më e përkryer e më e pasur se edhe fjalorët Larousse dhe Chapsal, si pasojë e hartimit të saj brenda një kohe njëvjeçare, haseshin disa lëshime termash e konceptesh, të cilat ai, duke e shfrytëzuar edhe ndihmën anësore të autorëve të tjerë, i mënjanon me botimin e dytë të veprës. Ky fjalor, derisa ishte gjallë autori është botuar gjithsejt tri herë brenda 18 vitesh, gjithnjë duke e përsosur edhe më tej (1299-1300=1882-1883; 1315=1898 dhe 1318=1901).

Me interesimin e madh e të vazhdueshëm që e shkaktoi Samiu në fushën e leksikografisë, menjëherë pas kësaj brenda dy vitesh (1883-1885) e përgatit edhe fjalorin 1208 faqësh **Dictionnaire Türç-Français**, me çka e mbushi edhe një zbrazëtirë të madhe në këtë drejtim.

Pas hartimit të këtyre dy fjalorëve të mëdhenj, për qëllime praktike e harton edhe një fjalor frëngjisht-turqisht më vëllim më të vogël se i pari, të titulluar **Küçük Kamus-ı Fransevi**, por më i zhvilluar se ai si pasojë e përvojës që ai kishte fituar te fjalori i parë. Një arsye tjetër për këtë përparësi të këtij fjalori të vogël ishte edhe kontrollimi që atij ia kishin bërë njerëzit kompetentë të kësaj fushe si Beshir Fuadi etj.

Sa i përket **Kamus al-A'lamit**, kjo është një enciklopedi e përgjithshme mbi historinë, gjeografinë dhe njerëzit e famshëm, kurse për shkak të lëndëve të shumta mbi Lindjen islame ka shërbyer edhe si një enciklopedi islame. Qysh në vitin 1876 në revistën që e nxirrte autori doli një

artikull që ka shumë të ngjarë të jetë shkruar nga vetë autori ("Lügat Tarzında Kitab Yazmak", **Muharrir**, nr. 4, 1 rebiul-ahir 1293, f. 123-124), ku theksohej se kjo vepër është përpiluar duke e marrë për model veprën e Bouilletit **Dictionnaire Universel d'histoire et de geographie**, për të cilën ekzistonte një dëshirë e flaktë për t'u përkthyer në gjuhën turke. Meqë kjo vepër është një fjalor emrash të përveçëm nga Lindja e Perëndimi, në të nuk hasen dot terma ose shprehje historike, fetare apo shkencore. Edhe pse Samiu ka menduar të përpilojë edhe një vepër tjetër të titulluar **Kamusü'l-ulum** ku do t'i përfshinte edhe termat e shprehjet e këtilla, ai s'arriti ta bënte dot për shkak të mungesës së dëshirës së botuesve dhe për shkak të lodhjes së vetë autorit.

Meqë enciklopeditë perëndimore i kishin shpërfillur lëndët që kanë të bëjnë me Lindjen islame dhe me botën osmane, Samiu për këto u është qasur drejtpërdrejt burimeve lindore. Edhe njohja e gjuhës arabe dhe persiane ishte një arsye plus që ai të mbërrinte e t'i shfrytëzonte botimet e vjetra e të njohura të Lindjes, biografite, enciklopeditë, përmbledhjet poetike, librat e gjeografisë etj. Ai vetë thotë se sa herë që ka gjetur kohë e mundësi i ka përdorur edhe veprat në dorëshkrim që gjendeshin në bibliotekat e Stambollit. Samiu nuk kishte ndonjë përgatitje apo bagazh të madh historik, sa u përket personaliteteve të njohura osmane, ai u qaset në mënyrë të përciptë duke i dhënë vetëm disa njohuri të caktuara biografike të tyre.

Kjo vepër, që nga njëra anë hartohet e nga ana tjetër menjëherë botohet, në fillim ishte menduar të ishte dyvëllimëshe, mirëpo ajo mundi të përfundonte me gjashtë vëllime. Për lëndët që i kishte kaluar pa i përmendur apo që kishin mbetur të mangëta, autori thotë se do të botojë edhe një shtojcë njëvëllimëshe për ta t'i mënjanuar këto mangësi. Mirëpo ai nuk arrinë ta realizonte këtë. Botimi i



kësaj vepre, duke filluar nga viti 1888 (1305) e deri kah mesi i janarit të vitit 1899, për çdo 15 ditë është botuar nga një pjesë me çka përfundon vetëm pas njëmbëdhjetë vitesh. Kjo ngjarje e madhe u reflektua edhe në shtypin e kohës dhe u pranua me shkrime urimi e lavdërimi (p.sh. shih Abdullah Zühdü, 'Kamus a'l-A'lamın Huzurunda', Sabah, nr. 3331, 18 shevval 1316; Ahmed Mid'hat, "Kamus al-A'lam", nr. 4758, 21 dhul-ka'de 1316).

Në këtë vepër, që në një farë lloji ishte një enciklopedi islame, kur ishte fjala për termat e lëndët islame autori shkon aq larg, saqë p.sh. vetëm listës së veprave të el-Kindiut ia ndan plotë katër faqe, listës së Raziut dy faqe e gjysmë etj.

**Kamus-ı Arabi**, është një fjalor i rëndësishëm arabisht-turqisht që e pati përgatitur Samiu, por që botimi i së cilës mbeti në gjysmë. Me këtë vepër Samiu dëshironte të ofronte një fjalor të madh të arabishtes të përgatitur në stilin evropian. Ai na njofton se këtë fjalor e ka përgatitur duke i shfrytëzuar të gjithë fjalorët e Lindjes dhe Perëndimit që kishin të bënin me arabishten dhe se ky do të ishte një fjalor edhe një herë e gjysmë më i madh se **Kamusi** i Firuzabadit. Ky fjalor parashihej të përbëhej prej dy vëllimesh me mbi nga 2000 faqe secili, mirëpo arrinë të botohet vetëm pjesa prej 504 faqesh deri te shkronja "xhim – xhëja arabe" (1313-1314 = 1896-1897).

Vepra më e rëndësishme e Samiut që vlerën e saj e ruan edhe sot e kësaj dite dhe me të cilën ai ka dashur ta mbushë një zbrazëtirë shekullore në fushën e gjuhës turke, pa dyshim ka qenë fjalori turqisht-turqisht **Kamus-ı Türki**. Ky fjalor del në kohën kur të gjithë fjalorët e botuar deri në shek. XIX ishin përgatitur me një mentalitet që nuk e shihte të nevojshme përcaktimin e fjalëve të gjuhës amtare dhe që për bazë kishin vetëm gjuhët arabe dhe persiane, përveç fjalorëve të Es'ad Efendiut **Lehçetü'l-Lugat**



(1733) dhe të Ahmed Vefik Pashait **Lehce-i Osmani** (1876, 1891, 1892).

**Kamus-ı Türki**, duke filluar që nga titulli i tij, që nga pjesa hyrëse ku përcaktohet pozita e përgjithshme e shtrirjes historike e gjeografike të gjuhës turke e deri te mendësia e re që e përshkon përmbajtjen dhe renditjen e veprës, përbën një fazë të re në leksikografinë turke. Në një kohë kur turqishtes i thuhej osmanlisht e që konsiderohej si një gjuhë e përbërë nga tri gjuhë të tjera, Samiu e shtron gabueshmërinë e këtij emërtimi 18 vjet përpara se ta botonte këtë fjalor. Po edhe me botimin e këtij fjalori ku qartas ai e vendon emrin “turk” (pra **Fjalor i turqishtes**-përkth.), shënon një hap të ri e guximtar në këtë drejtim, gjë që këtë, me gjithë mendësinë e tij turqiste, nuk kishte mund ta bënte as edhe Ahmed Vefik Pashai. Samiu thoshte se sado fjalë të huaja që të kishte, përsëri ky fjalor nuk mund të quhej ndryshe pos si fjalor i gjuhës turke.

Pas këtij fjalori, për të cilin autori thotë se është munduar t'i japë një përsosuri që nuk do të linte hapësirë për të kërkuar ndonjë fjalor tjetër, qëndron një seri e tërë fjalorësh lindorë e perëndimorë prej te Redhouse e deri te fjalori i Ahmed Vefik Pashait. Samiu me përvojën e tij njëzetvjeçare të derdhur në këtë fjalor i ka përmbledhur fjalët e pranishme të turqishtes së Turqisë që gjendeshin në fjalorët vendas e sidomos në ato të huaj.

Si rezultat i një kohe dyvjeçare sa iu deshën Samiut për ta përgatitur këtë fjalor, natyrisht kanë ndodhur disa lëshime në përcaktimin e kuptimit të hollë e të thellë të disa fjalëve. Gjatë botimit të tij, në një revistë botohet pa nënshkrim një seri shkrimesh i mbetur në gjysmë, ku jepej një listë e fjalëve të papërfshira në fjalor dhe e fjalëve që nuk u është dhënë kuptimi adekuat (“Kamus-ı Türki Hakkında Mütaleat”, Mecmua-i Edebiyye, nr. 5-8, 29 rexheb-20 shaban 1318). Një pjesë prej këtyre në të vërtetë janë fjalë

që mund t'i hasësh te **Redhousi** dhe te **Lehce-i Osmani** e Ahmed Vefikut. Velid Çelebiu, i cili veprën **Kamus-ı Türki** e sheh si një përshtatje të bërë nga **Lehce-i Osmani**, në mënyrë të stërmadhuar thotë se Samiu, duke marrë Vefik Pashanë, nga arsyeja se nuk i ka dhënë fort rëndësi kontrollimit, nuk ka mund t'i kuptojë as edhe gabimet e renditësit të fjalorit të tij (Kunoş, Türk Halk Edebiyatı, "mukaddime", Stamboll, 1925, f. 6).

*Idetë kombëtare të tij lidhur me gjuhën dhe letërsinë turke.*

Punimet e Samiut, që në mënyrë të vazhdueshme e të vetëdijshme gjuhën turke dhe çështjet e saj i trajtojnë nga një qasje kombëtare, bënë të njihet si njëra ndër figurat që i ka sjellë shërbime të mëdha e të rëndësishme lëvizjes turqiste. Samiu, në një kohë kur gjuha dhe letërsia turke studioheshin vetëm brenda kornizës së osmanlishtes, na paraqitet si një mendimtar që gjuhën dhe letërsinë turke i kërkon në rrënjët e mirëfillta të turqnisë së Azisë së Mesme.

Autori qysh në vitin 1881 në shkrimin e tij të titulluar "Lisan-ı Türki 'Osmani'", duke i refuzuar shprehjet "osmanisht" dhe "çagatajisht", thotë se në të vërtetë këto nuk janë gjëra të tjera pos nga një degë e gjuhës turke që është e shtrirë në një zonë të gjerë gjeografike (**Hafta**, nr. 12, 10 dhul-hixhe 1298, f. 177-181). Ky artikull i rëndësishëm përbën qelizën e ideve turqiste të Samiut, të shprehur në pjesën hyrëse të veprës **Kamus-ı Türki** e në shkrime të tjera të tij. Në këtë artikull Samiu e qartëson edhe më tej idenë e hasur edhe më herët te Ali Suavi e te Sylejman Pashai, sipas së cilës gjuhës turke nuk duhej thënë gjuhë osmane. Në këtë artikull, që ka një karakter si të deklaratës së turqizmit në gjuhë, ai gjithashtu thekson se titulli që i është dhënë shtetit për shkak të themeluesit të saj nuk mund t'i jepet edhe gjuhës, sepse kjo gjuhë dhe ky popull kanë jetuar edhe para Osman Gaziut (në bazë të të cilit e merr edhe emrin shteti – përkth.) dhe thekson se në

vend të shprehjes “gjuhë osmane/osmanlisht” ose “gjuhë çagataje” duhet të përdoret shprehja “gjuhë turke”. Ai me ngulm thotë se më mirë është të përdoret shprehja “turqishte perëndimore” sesa “osmanlisht”, dhe “turqishte lindore” sesa “çagatajisht”.

Çështja që Samiun më së tepërmi e mundon lidhur me gjuhën turke, ka qenë ideja e pastrimit dhe çlirimit të gjuhës dhe letërsisë turke nga sundimi i fjalëve dhe rregullave të gjuhës arabe dhe persiane. Me ngulm është munduar të sqarojë se gjuha turke nuk është gjuhë osmane e përbërë nga tri gjuhë, sepse kjo në fakt nuk do të mund të ishte një gjuhë e vetme dhe se kjo gjuhë turke assesi nuk mund t’u nënshtrohet rregullave të gjuhës arabe dhe persiane, porse duhet të ketë gramatikën e saj të veçantë. Motoja e tij e shprehur në forma të ndryshme nëpër shumë shkrime të tij qysh nga viti 1897 e këndeje, ka qenë: “Pa mos shikuar djathtas e majtas, pa mos shikuar hatër të dikujt, nuk do të mërzitemi e nuk do të reshtim së bërtituri: ‘Ta pastrojmë gjuhën tonë! Ta turqizojmë gjuhën tonë!’” (‘Edebiyat-ı Müstakbelimiz’, Sabah, nr. 3343, 30 shevval 1316). I kësaj kohe është edhe propozimi i tij që turqishtja e Stambollit të jetë gjuha e letërsisë dhe shkrimit turk për gjithë botën turke. Samiu, për të mos u treguar si një ekstremist i pamatur, nuk është i mendimit që me rastin e këtij pastrimi të dëshirueshëm të gjuhës turke, të fshihen nga përdorimi të gjitha fjalët me prejardhje të huaj. Atë që ka dashur ky ka qenë pastrimi dhe largimi i atyre fjalëve të huaja që e kanë ekuivalentin e tyre turk dhe të atyre që nuk përdoren fort në gjuhën e popullit. Ato fjalë të huaja që janë ngulitur në gjuhën e popullit Samiu i merr për fjalë turke të cilat s’largohen dot. Këto ide të Samiut më vonë, sidomos pas Periudhës II Kushtetuese, do të përkrahen e do të merren si model nga shumë dijetarë e shoqata, siç ishte Ömer Sejjeddini, Ali Kemali etj.



Shemseddin Samiu gjithnjë kishte ide të reja dhe shumë herë ato e tejkalonin nivelin mendor të kohës së tij. Ky aspekt i mendimit të tij vërehet më qartë në pikat në vazhdim: Samiu ishte i pari që me anë të penës i mbronte Servet-i Fununistët nga sulmet e bashkëkohasve të tij, edhe pse nuk i miratonte qëndrimet e tyre lidhur me gjuhën turke. Ka treguar prirje për pranimin e shkronjave latine dhe e ka theksuar nevojën e themelimit të një institucioni, që do të merrej me mësimin e gjuhëve të ndryshme lindore, e sidomos të arabishtes e persishtes, sipas metodologjisë moderne. Çështjen e librave për fëmijë Samiu e ka trajtuar si një temë më vete. E mbrojti veprën **Ta'lim-i Edebiyyat** të Rexhaizade Ekremi për animin e tij të plotë kah të rejat në letërsinë turke, duke theksuar se ky ishte një libër retorike i shkruar në stilin evropian. Në shkrimet e tij të mëvonshme ai thekson se letërsia turke ka ndryshuar shumë dhe ngulmon në përpilimin e rregullave dhe metodave të reja në vend të atyre të vjetrave në letërsi, si dhe në përgatitjen e librave të rinj të retorikës sipas një mendësie krejt të re nga ajo e moçmja.

Kështu na shfaqet në vija të përgjithshme jeta dhe veprimtaria e Shemseddin Samiut, i cili ishte një njeri punëtor me ide e laps të ngjeshur, autor i një enciklopedie 4830 faqesh, i një fjalori frëngjisht prej 2240 faqesh, i një tjetri turqisht prej 1575 faqesh dhe i afro 50 veprash të formatit të broshurave.

### **Şemseddin Sami** **The life, the works, contribution** **to Turkish, and Kamus-i Turki -**

Starting its activity in Istanbul as a journalist, Sami Frasheri continued with literary works, with translations, and finally compiled great encyclopedic and lexicographic



works. In 1872 he published the first translation, and immediately after that produced the novel *Tarih-i Taassuk-ı Tal'at ve Fitnat*. He continued with the tragedy *Sührab-yahud-Ferzendkuş*, and with two other novels *İskat-ı Cenin-yahud-İkisi Ölmüş*, *İkisi Çıldırılmış* and *Rekabet*, with which he was not very contented, and decided not to give them to be printed. The first steps in journalism he made with the newspaper *Hadika* directed by Ebuzzija Tevfik. The next newspaper was *Sirac*. Two following translations were the story *Galatee* and the tragedy *İhtiyar Onbaşı*. The tragedy was welcomed, and the author wrote his own drama *Besa*, on an Albanian subject. For nine months in 1874-1875 he directed the newspaper *Trablusgarb* in Tripoli, and returning to Istanbul published the two plays – *Besa* and *Seydi Yahya* (1875). Together with Mihran, Sami published the magazine *Muharrir* and the newspaper *Sabah*. His most important contribution as a journalist was to the newspaper *Tercüman-ı Şark*. He was appointed secretary of the Military Committee (Teftiş-i Askeri Komisyonu), a post in which he worked all the life.

He prepared the most important works during the following period. His major translation was the novel by Victor Hugo *Sefiller*. With *Kamus-i Fransevi* (French Dictionary) starts his vast lexicographical work, continued with the Turkish-French counterpart. The success of the editions gave him the award “ûlâ sınıf-ı sâni”, and the decree “İftihar”. A special place Sami reserved to the series “Cep Kütüphanesi” (Pocket Library). After the small but very careful prepared *Küçük Kamus-ı Fransevi* (1886), he engaged himself in the great encyclopedia in six volumes *Kamus al-A'lam*, dedicating to it 12 years of his life. Another his masterpiece was the Turkish Dictionary, *Kamus-ı Türki*, completed in 1901. With great difficulties Sami also pre-

pared an Arab Dictionary, *Kamus-ı Arabi*, and at the same time published a revised edition of the French Dictionary.

In 1899 he opened the series “Kütübhan-e-i Müntehabat”, in which in 1899 was published *Baki'nin Eş'ar-ı Müntababesi*, followed the next year by *Ali bin Ebi Talib Efendimiz'in Eş'ar-ı Müntababesi*.

The last part of his life Sami dedicated to Turkish language and literature. In 1902 he translated *Kutadgu Bilig*, in 1903 he wrote *Orhun Abideleri*, and *Tuhfetü'z-zekiyye fi lugati't-Türkiyye*, while in 1904 prepared the Dictionary of Kipchak Turkish, *Lehce-i Türkiyye-i Memalik-i Mısır*.

Among the scientific works of Sami Frasheri should be mentioned his contributions to the series “Pocket Library”, 11 books altogether. *Gök* (Sky) 1879 speaks about astronomy, *Yer* (Earth) 1879 is dedicated to geology, *İnsan* (The man) and *Yine İnsan* (Again the Man) 1886 treat the anthropology, while *Medeniyyet-i İslamiyye* (Islamic Civilization) 1879 gives a truthful picture of the Islamic civilization in the Middle Ages. *Kadınlar* (Women) 1879 is a book on the position of women in society, expressing the most advanced progressive ideas of his time. *Esatir* (Mythologies) 1879 is the first book in Turkish on the mythology, including data from Eastern peoples. Another first book of its kind in Turkish is *Lisan* (Gjuha) 1886 dealing with general linguistics, and the classification of the languages. *Usul-i Tenkit ve Tertib* (Punctuation and type-set rules) 1886 was the first practical book on this practice. After many years of publishing in various newspapers, aphorisms and maxims were collected in the volume *Emsal* 1880, in which a part was created by the author himself. A small book *Himmatü'l-himam fi neshri'l-İslam*, published in 1885 speaks about the peaceful spread of Islam in many countries.

The journals were seen by Sami as one of the most important means in conveying to common reader scientific knowledge. *Muharrir*, *Aile*, *Hafta* were among the major journals of the time. Text-books were the other important way to give to the readers the information about their language. It is sufficient to only mention the titles of his books: *Küçük Elifba* published four times, *Yeni Usul Elifba-i Türki*, *Nev-usul Sarf-ı Türki*, while he didn't succeed in publishing *Kıraat-i Türkiyye ve Nev-usul Nahv-i Türki*. A special place Sami reserved to Arabic language with books *Tasrifat-ı Arabiyye* 1897, *Usul-i Cedid-i Kavaid-i Arabiyye*, and *Tatbikat-ı Arabiyye*, and every time he tried to introduce new methods in language learning.

The works that made famous the name of Sami Frasherri in his time, and which continue to our days to be useful, are his lexicographical works, including various dictionaries and the Great Encyclopedia *Kamus al-A'lam*, following the model of Bouillet's *Dictionnaire universel d'histoire et de geographie*. The most important contribution to the Turkish culture by Sami Frasherri were his successful efforts to revive Turkish language as the language of the nation in the modern period.

*Yumi Ishimareu\**  
(Japoni)

***SHEMSEDIN SAMI FRASHËRI - PËRÇUES  
I IDEVE ETNIKE NË SHOQËRINË OSMANE  
NGA "SABAH" TE "HAFTA"***

---

## 1. Hyrje

Kur diskutohen idetë lidhur me nacionalizmin, kurdoherë ka dalë e nevojshme të përcaktohen termat. As Perandoria Osmane nuk bën përjashtim dhe ka pasur një varg termash, që lidhen me grupet shoqërore, fetare dhe etnike. Mirëpo kuptimi i këtyre termave ka pasur ndryshime si nga njëri autor te tjetri, ashtu edhe sipas kontekstit, në të cilin kanë shkruar. Nuk është e mundur dhe nuk e vlen të jepet kuptimi i përgjithshëm për një term të tillë. Por do të kishim disa fjalë të rëndësishme kyç gjatë përkufizimit të termave, që i kanë përdorur autorët, ose do të hulumtonim se si t'i përdornim termat për të kuptuar mendimet e tyre.

Qëllimi kryesor i kësaj kumtese është që, duke u përqendruar te termat e përdorur nga Shemsedin Samiu nga viti 1876 deri më 1882, të hedhim dritë mbi karakterin e tij si përçues të ideve etnike në shoqërinë osmane. Më 1876 Samiu punoi për gazetën "Sabah" dhe pesë vjet më

■

\* Studiuuese e veprës së S. Frashërit nga Tokio.



vonë botoi gazetën “Hafta”, e cila është vlerësuar lart në turkologji, sepse aty ai zbulonte karakterim turk të osmanlijës (turqishtes osmane). Është e mundur të gjurmohet shndërrimi i mendimeve të tij, duke shqyrtuar termat që ka përdorur në “Sabah” dhe në “Hafta”.

## **2. Vatani (atdheu) dhe ummet (kombi)**

### **2-1. Shemsedin Samiu si osmanli (pjesëtar i kombit osman)**

Në vitin 1876 Samiu botoi në Stamboll gazetën e përditshme “Sabah”. Në atë kohë Perandoria Osmane ishte e ngatërruar në Çështjen Lindore, sidomos në problemin e Bosnjë-Hercegovinës. Prandaj gazeta “Sabah” i ka kushuar mjaft hapësirë edhe kësaj çështjeje. Meqë ishte i bindur se Fuqitë e Mëdha ishin ato, të cilat i shkaktonin turbullirat fetare në Perandorinë Osmane dhe kishin krijuar Çështjen e Lindjes, Samiu, i cili vetë e shihte këtë gjendje si krizë të vatanit (të Perandorisë Osmane), në fillim pohonte se osmanlinjtë (kombi osman) përfshinin ata njerëz, të cilët, duke i kapërcyer dallimet fetare (të dinit) dhe etnike (të milletit), jetonin në Hapësirën Osmane. Dhe vijonte: “Ne, osmanlinjtë, përpiqemi të mbrojmë të drejtat e vatanit tonë të përbashkët, që mbulon fenë tonë, dhe prandaj nuk mund të ketë çështje fetare ose etnike mes nesh”. Si shembull jepte vullnetarët rumë ose armenë në ushtrinë osmane. Samiu e ndiente krizën e vatanit, prandaj theksonte solidaritetin e vatanit (atdheut) e të umetit (kombit osman), duke mohuar çështjen fetare dhe etnike, të cilën Fuqitë e Mëdha e kishin kthyer në një pretekst për të ndërhyrë në Perandorinë Osmane.

Më tej, Samiu e trajtonte çështjen e vatanit (të atdheut) e të umetit (kombit = kombit osman) me qëndrim të fortë kritik kundrejt despotizmit të sulltanit, i cili, sipas

mendimit të Samiut, përbënte njërën nga arsyet për rënien e perandorisë. Në ato ligjërata ai e paraqiste umetin (kombin) si atë tërësi, që qeverisej prej një trupi politik, kurse vatanin (atdheun) si tërësinë që mbahej e përbashkët nga umeti (kombi).

Kjo do të thotë se në kundërshtim me trazirat e brendshme dhe me kërcënimet e jashtme, Samiu paraqiste idealin e osmanizmit, domethënë që gjithë subjektet e perandorisë, pavarësisht nga feja dhe etnia, ishin pjesëtarë të umetit (kombit osman) dhe Perandoria Osmane ishte vatanin (atdheu) i përbashkët për pjesëtarët e umetit (kombit osman). Kështu solidariteti i vatanit dhe i umetit mund ta siguronte perandorinë nga ndikimi i Perëndimit.

## **2-2. Shemsedin Samiu si iluminist në shoqërinë osmane**

Rreth vitit 1876 Samiu e pa të nevojshëm iluminizmin në shoqërinë osmane. Por ai ishte i vetëdijshëm për rrezikun që qytetërimi të merrej rastësisht. Ai ka shkruar në *Sabati*:

*Ka një ndryshim të madh nga marrja e qytetërimit nëpërmjet pranimit të dijes nga Europa me anë të përpjekjeve të veta, dhe të qytetëroresh kundër vullnetit, duke qenë i sunduar politikisht prej të tjerëve (Europës), që e kanë arritur atë qytetërim.*

Dhe vijonte, se disa vende europiane nuk nuk kishin si qëllim të përhapnin qytetërimin e tyre në Azi (duke përfshirë Perandorinë Osmane), por synonin ta pushtonin atë. Do të vinte çështja shqiptare në vitin 1878, e cila ndjenjën e tij lidhur me krizën do ta kthente në realitet. Samiu, i cili e kuptonte prapambetjen e shoqërisë osmane, e quante të nevojshme të qytetërohej Perandoria Osmane jo nëpërmjet dijes Perëndimore, por nëpërmjet përpjekjeve të veta. Ai ka thënë:

*Përparimi dhe qytetërimi ynë mund të arrihen duke futur dhe përhapur qytetërimin Perëndimor në shoqërinë tonë dhe duke ndjekur atë rrugë, që e kanë përshkuar europianët.*

Pasi të arrihej kjo, sipas mendimit të tij, Perandoria Osmane fare mirë mund të renditej ndërmjet vendeve europiane.

Atëherë Samiu, i cili kërkonte ndriçimin e shoqërisë osmane nëpërmjet forcave të veta, theksonte rëndësinë e gjuhës kur të përcillej dija europiane në shoqërinë osmane. Kjo do të thoshte se kërkoheshin një gjuhë jo e ngatërruar dhe e kapshme për njerëzit e zakonshëm, si dhe gazeta e revista të shkruara në një gjuhë të tillë, kur shoqëria të ndriçohej duke përçuar dijen Perëndimore. Rrjedhimisht, këto kanë qenë bindjet e tij kur botoi *Haftan* më 1881.

### **3. Idetë etnike të paraqitura në *Hafta***

Për Samiun nuk ishte vetëm gjuha mjeti për ta përçuar qytetërimin Perëndimor, por edhe kriteri i identitetit etnik. Ai e vërente rrezikun po të futej rastësisht qytetërimi Perëndimor në shoqërinë osmane, atëherë kur identiteti i vetvetes nuk ishte i diferencuar etnikisht, gjithashtu ishte i bindur se kishte nevojë të ndërtohej identiteti i vetvetes mbi bazën e gjuhës, në mënyrë që të mos bihej nën zgjedhën e Europës.

Samiu, vetëdija etnike e të cilit ndoshta po dilte gjithnjë e më tepër në pah ndërsa po përjetonte çështjen shqiptare, i hyri zbulimit të ideve etnike të veta kundrejt shoqërisë osmane pas daljes së çështjes shqiptare (1878). Kjo shfaqet në ndryshimin e përkufizimit të osmanlinjve (kombit osman) në *Hafta*. Ai ka shkruar:

*Gjithë grupet etnike, të cilat kanë shtetësinë e Perandorisë Osmane, mund të quhen osmanlinjtë (kombi osman).*



[Më parë ai kishte dhënë përkufizimin se osmanlinjtë (kombi osman) ishin ata që duke kapërcyer dallimet fetare (të dinit) dhe etnike (të milletit), jetonin në Hapësirën Osmane].

Gjithsesi, idetë e veta etnike ai i ka shprehur me disa terma në *Hafta* dhe, me sa duket, i ka përhapur idetë e veta në një shoqëri, të cilat idetë etnike ishin të kufizuara në fushën shkencore dhe nuk pranoheshin përgjithësisht, sepse tradicionalisht vijat ndarëse ndërmjet njerëzve ishin fetare dhe identifikimi i njerëzve në radhë të parë bëhej sipas fesë.

Këtu dëshiroj të kaloj te termat në *Hafta*, të cilët shënojnë grupet e njerëzve si më poshtë.

### 3.1. Umeti

Së pari, umeti, fjalë e ardhur nga arabishtja ‘umma’, përgjithësisht do të thotë një grup njerëzish në përgjithësi. Ka qenë i lidhur posaçërisht me idenë e një bashkësie të përsëritshme për mendjet e myslimanëve. Ky term me rast përdorej për popujt që të dalloheshin nga gjuha, për shembull, umma arab dhe umma persian. Porse për myslimanët në këtë term koncepti fetar doli përpara gjithë të tjerëve.

Në *Hafta* nuk ndeshet ndonjë shembull, kur umeti të përdoret për bashkësinë e përsëritshme. Samiu, i cili më përpara në *Sabah* e kishte përkufizuar termin ‘umet’ si tërësinë e qeverisur nga një trupë politike e vetme, tashti këtu jepte një përkufizim tjetër të termit. Së pari, në përkufizim ai nënvizonte marrëdhënien ndërmjet umetit e gjuhës. Përcaktonte edhe faktorin, i cili shërbente si kufiri ndërmjet umetit (umeteve). Kjo ishte gjuha. Ai ka thënë se nuk kishte tjetër kufi, që të përcaktonte umetin, përveç gjuhës. Me një fjalë, e përkufizonte umetin si një grup njerëzish, të cilët flisnin të njëjtën gjuhë. Pastaj vazhdonte:



*Gjithë grupet etnike që ia kushtojnë patriotizmin e vet Perandorisë Osmane, mund të quhen osmanlinjtë (kombi osman), kurse emri i umetit më të madh është turqit, të cilët jetojnë në hapësirën e gjerë nga Deti Adriatik deri në Kinë.*

Me fjalë të tjera, përfytyrimi i tij për umetin nga çka përcaktohej prej territorit të dalluar, ka ndryshuar te çka përcaktohej prej faktorëve kulturorë, sidomos prej gjuhës.

### **3.2. Kavim**

Së dyti, kavimi, fjalë me prejardhje nga arabishtja 'kawm' (pjesëtar fisi), është termi më i përdorshëm për të shënuar një grup njerëzish, të cilët flasin të njëjtën gjuhë (domethënë, 'grupi etnik') në shoqërinë osmane. Samiu e ka përdorur termin me të njëjtin kuptim. Ai edhe e ka shpjeguar dallimin ndërmjet umetit e kavimit si dallim në përmasat e grupit (popullsisë), ose sidomos të nivelit të qytetërimit, që ka arritur. Kështu, njerëzit që përbënin një popullsi më të madhe dhe kishin arritur një qytetërim më të lartë, mund të quheshin umet. Por ai ka shkruar, se kavimi, që ishte i prapambetur nga ana e qytetërimit, mund të ishte umet. Në këtë rast pika përcaktuese dilte gjuha. Ai ka thënë:

*Popujt mund të përparojnë në rrugën e qytetërimit vetëm po të nisin të shkruajnë e të lexojnë gjuhën e vet. Kavimi që ka letërsinë (gjuhën) e vet dhe historinë e vet mund të jetë një umet i madh.*

Duke përmendur myslimanët indianë, të cilët vështroshin si njëri ndër kavimet islamike (akvam-i Islamiye), ai ka thënë se ata mund të ishin një umet i madh islamik, sepse kishin nisur të shkruanin e të lexonin gjuhën e vet (gjuhën e folur).

Për më tepër, Samiu, i cili e vështronte gjuhën si kriter për kavimin, ashtu si kishte bërë në përkufizimin për umetin, paralajmëronte rreth zhdukjes së kavimijetit (ky

është një emër abstrakt i prejardhur nga kavimi) nëse përdornin gjuhën e të tjerëve. Ai vërente:

*Ibn Sina, Farabi dhe Razi janë quajtur se i përkasin umetit arab dhe jo umetit turk e as persian, sepse ata librat i kanë shkruar arabisht.*

Kjo do të thotë se Samiu, i cili e kishte përfytyrimin për kavimin si diçka që përcaktohet nga gjuha, nuk bënte ndonjë dallim të dukshëm ndërmjet kavimit dhe umetit.

### 3.3. Xhinsi dhe mileti

Së treti, Samiu ka përdorur edhe termin 'xhins', për atë që e shënonte si grup etnik. Termi xhins vjen nga arabishtja 'djins', që në zanafillë ka pasur kuptimin 'lloj ose klasë', por pastaj mori kuptimin e 'racës' në shoqërinë osmane. Kur përdorte këtë term, Samiu e thoshte me kuptimin e një grupi njerëzish të bashkuar nga gjuha. Gjithashtu ai është marrë me xhinsijetin (emri abstrakt nga xhinsi) si paralele me kavimijetin dhe ka nënvizuar rëndësinë e gjuhës për xhinsijetin. Ai ka shkruar:

*Baza e kavimijetit dhe e xhinsijetit janë gjuhët ... Cilido kavim ka nevojë ta reformojë gjuhën e vet dhe të përpiqet të zhvillojë letërsinë e vet.*

Te *Hafta* ai ka përdorur gjithashtu termin 'milet'. Termi milet në Perandorinë Osmane përdorej për të treguar grupet fetare, si mileti mysliman dhe mileti ortodoks e kështu më tej. Tashmë ai shënonte një bashkësi politike dhe kishte kuptim të ri. Por këtu te *Hafta* Samiu e ka përdorur termin vetëm për atë çka përputhet me kavimin.

Për Samiun, i cili nënvizonte marrëdhënien ndërmjet gjuhës dhe grupeve etnike (me fjalë të tjera, ai kishte bindjen se gjuha i përkiste grupit etnik), ishte e arsyeshme që secila gjuhë duhej të quhej me emrin e grupit etnik, i cili e fliste.

Duke pasur këtë bindje të patundur, Samiu me sa duket, ka deklaruar te *Hafta* që gjuha osmane ishte një ndër gjuhët turkike, kështu që duhej të quhej turqishtja perëndimore. Dhe kjo ka qenë arsyeja përse *Hafta* është vlerësuar lart në turkologji.

### 3.4. Grupet etnike në Islam

Samiu ka përmendur grupet etnike brenda Islamit. Ai ka thënë:

*Kur xhinsijeti arab me Islamin e përhapi ndikimin e vet mbi Azi e Afrikë, akvami (shumësi i kavimit) dhe umemi (shumësi i umetit), ato pothuaj u nënshtruan nga xhinsijeti arab dhe u shuan xhinsijetet e gjuhët e tyre.*

Porse ka pasur disa akvame, që arritën t'i mbanin xhinsijetet e tyre, pavarësisht se pranuan Islamin. Arsyen përse ato qenë në gjendje t'i mbanin xhinsijetet e tyre Samiu e ka shpjeguar me përpjekjet e tyre për të ruajtur gjuhën e vet. Me fjalë të tjera, ka qenë pranimi i gjuhëve të huaja dhe jo pranimi i Islamit, që solli shuarjen e ekzistencës së kavimit dhe të umetit. Kështu, ai mendonte se grupet etnike (kavim dhe umet) mund ta tregojnë ekzistencën e vet pa u varrosur nën Islamin, nëse do ta ruanin gjuhën e vet. Për më tepër, ai ishte i bindur se bota islamike si tërësi mund të zhvillohej pasi secili grup etnik brenda Islamit të ndriçohej me anë të gjuhës së vet. Natyrisht, bota islame në këtë rast për Samiun përputhej me Perandorinë Osmane.



## 4. Përfundim

Për Samiun, gjuha ishte jo vetëm një mjet për ta futur qytetërimin Perëndimor, por edhe një kriter i identitetit etnik.

Së pari, Samiu, i cili e kuptonte prapambetjen e shoqërisë osmane, ishte në kërkim të zgjidhjes dhe e gjeti atë te përcimi i qytetërimit Perëndimor. Do të ishte gjuha jo e ndërlikuar për njerëzit e zakonshëm, që kërkohej, kur shoqëria osmane do të përfitonte nga qytetërimi Perëndimor dhe do të arrinte nivelin e vendeve Perëndimore në fushat e shkencës e të teknologjisë. Për shoqërinë osmane, e cila përbëhej nga grupe etnike, Samiu mendonte se gjuhët që mund të bëheshin mjetet të iluminizmit ishin jo vetëm turqishtja osmane, por edhe gjuhët etnike. Kjo ka qenë arsyeja përse Samiu u jepte rëndësi gjuhëve që i flisnin grupet etnike dhe për Samiun, secila gjuhë në shoqërinë osmane ishte e barabartë nga rëndësia.

Së dyti, siç shihet nga ndryshimi i përkufizimit për osmanlinjtë dhe umetin, duke kaluar përmes çështjes shqiptare, Samiu, i cili e përfytyronte shoqërinë osmane si pluraliste, me fjalë të tjera si të përbërë prej grupesh etnike, pohonte rëndësinë e vetëdijes etnike të mbështetur te gjuha me qëllim që të mos nënshtroheshin nën zgjedhën e Europës nga ana politike dhe kulturore. Gjithashtu ai u përpoq të përçonte vetëdijen etnike në një shoqëri, ku idetë etnike nuk ishin të zakonshme dhe kufizoheshin në fushën shkencore, si dhe kishte bindjen që popujt në shoqërinë osmane duhej të ndërtonin identitetin e vet me vetëdije etnike. Në këtë rast pikë kryesore ishte gjithashtu gjuha.

Pikërisht te *Hafta* Samiu është përpjekur ta informojë shoqërinë osmane për rëndësinë e vetëdijes etnike, të mbësh-



tetur te gjuha, dhe i ka përhapur idetë e veta në atë shoqëri me disa terma të ndryshëm, të cilët shënonin grupet etnike. Për më tepër, arsyeja përse Samiu është përpjekur të përçojë idetë e veta etnike në shoqërinë osmane ka qenë se ai ishte i bindur, që shoqëria osmane, e përbërë prej grupesh etnike, mund të zhvillohej dhe fare mirë mund të renditej mes vendeve europiane, në qoftë se secili grup etnik në shoqëri do të ndriçohej nëpërmjet gjuhës së vet.

Nga kjo pikëpamje, ne nuk mund ta vështrojmë atë as si nacionalist turk, as si nacionalist shqiptar.

Mund të themi se ai ka qenë një tip osmanisti, i cili dëshironte dhe ëndërronte riintegrimin dhe solidaritetin e Perandorisë Osmane të asaj kohe.

### **Şemseddin Sami Frashëri as a carrier of Ethnic ideas into the Ottoman society**

The main purpose of this paper is, by focusing on the terms which Şemseddin Sami used from 1876 to 1882, to throw a light on his character as a carrier of ethnic ideas

into the Ottoman society. In 1876, Sami worked for a newspaper *Sabah* and five years later he published *Hafta*, which would be highly estimated in Turkology because he revealed the Turkish character of Osmanlica (Ottoman Turkish) there. It would be possible to trace the transformation of his thoughts by examining the terms which he used in *Sabah* and in *Hafta*.

Against the domestic troubles and external threats, Sami presented the ideal of Ottomanism that all subjects of the empire, regardless of religion and ethnicity, were members of ummet (the Ottoman nation) and the Ottoman Empire was the common vatan (the Fatherland) for the members of ummet (the Ottoman nation). So it was

the solidarity of vatan and ummet that could secure the empire from the Western impact.

Sami, who desired the enlightenment of the Ottoman society by its own efforts, stressed the importance of language when Western knowledge was introduced into the Ottoman society. Anyway he expressed his ethnic ideas with several terms in *Hafta* and seemed to spread his ideas into a society where ethnic ideas were restricted to the scientific field and were not generally accepted, because the dividing lines among peoples were traditionally religious, and self-identification of peoples was primarily made by religion.

In other words, his image of ummet had changed from what was determined by distinct territory to what was determined by cultural factors, especially the language. For Sami, who had an image of *kavim* as what was determined by language, there was no prominent difference between *ummet* and *kavim*. Sami emphasized the relationship between language and ethnic groups (in other words he had a conviction that language belonged to the ethnic group), for him it was reasonable that each language should be called with the name of ethnic group who spoke it.

It was on this firm conviction that Sami apparently declared in *Hafta* that Ottoman language was one of the Turkic languages so that it should be called Western Turkish. And this was the reason why *Hafta* was highly estimated in Turkology. He thought that ethnic groups (*kavim* and *ummet*) could indicate their existence without being buried in Islam if they retained their own language. Moreover, he was convinced, that Islamic world as a whole could develop after each ethnic group within Islam was enlightened by its own language. Of course, Islamic world here would be compatible with the Ottoman Empire

It was in *Hafta* that Sami tried to inform the Ottoman society with the importance of ethnic consciousness based on language, and spread his ethnic ideas to the society through several terms which denoted ethnic groups. Moreover, the reason why Sami tried to introduce his ethnic ideas into the Ottoman society was that he was convinced that the Ottoman society composed of ethnic groups could develop and could be well ranked among European countries if each ethnic group in the society was enlightened by their own language. In this respect, we can regard him neither as Turkish Nationalist nor as Albanian Nationalist. We might say that he was a kind of Ottomaniist who desired and dreamed the re-integration and solidarity of the Ottoman Empire in those days.

*Akad. Jashar Rexhepagiq\**  
(Kosovë)

**VEÇORITË THELBËSORE DHE RËNDËSIA E  
VEPRËS SË SAMI FRASHËRIT**

---

Gjatë punës intelektuale të Samiut dhe në veçanti të veprimtarisë së tij shkencore - kërkimore, me të cilën ai është marrë rreth 33 vjet, mund të dallojmë këto veçori thelbësore:

**E para,** se Samiu ishte gjurmues i fushave të shumta të shkencës dhe të kulturës (të historisë, gjeografisë, të shkencave moderne, të gjuhës dhe letërsisë shqipe, turke, arabe, të gjuhës greke, frënge e persiane, të shkencave politike, enciklopedike, futurologjike, të filozofisë, etikës, të pedagogjisë, dhe si islamolog, leksikograf, gramatolog, publicist dhe përkthyes). Do të ishte, pra, veprim i shtrembër në punë që shkencëtarin Sami ta kufizosh në një fushëveprimi shkencor e artistik, sepse ai të gjithë sferat e jetës i shikonte si elementet e një tërësie të pandarë.

**E dyta,** asnjë çështje Samiu nuk e shpjegonte në mënyrë sipërfaqësore dhe pa u bazuar në të dhënat e sigurta dhe të mjaftueshme, gjë që dëshmojnë studimet e tij të llojllojshme, p.sh. për femrën, njeriun, arsimin, shkollën, civilizimin, kombin, gjuhën, kulturën etj. Është interesante dhe jo pa vlerë, sidomos për metodologjinë e punës

■

\* Anëtar i ASHAK, Prishtinë



kërkimore-shkencore, pyetja sesi ky krijues serioz shkencor, në atë kohë kur mungonin shumë mjete teknike vinte deri te shënimet e shumta e të vërtetuara për vendet më të largëta në botë, për fenomenet e rralla, për ndonjë ngjarje nga historia e lashtë, etj.

**Veçori e tretë** janë dituritë e sakta dhe të sistematizuara mirë që i kishte fituar Samiu edhe gjatë të mësuarit në gjimnazin e njohur grek "Zosimea" në Janinë dhe më vonë në mënyrë të plotësimit dhe intensifikimit të njohurive shkencore dhe në formë të vetarsimit të tij. Nga arsyeja shkencore e arsimore pedagogu Sami insistonte "ta mbushimë mëmëdhenë tënë me shkolla shqip; djemtë tanë në pak kohë të mësojnë të këndojn'e të shkruajnë gjuhën e tyre edhe dituritë q'u duhenë". (Sipas: Kristo Frashëri, *Tre vëllezër pishtarë*, Tiranë, 1978, në fq. 82).

**E katërta**, nga tërë veprimtaria e Sami Frashërit rrjedh se ai edhe në teori, edhe në jetën shoqërore dhe në veprime konkrete ishte bartës i veprimtarisë krijuese, shkencore, letrare e arsimore, e cila që një punë dinamike dhe shumë progresive. Në bazë të këtij parimi themelor - lidhjes së ngushtë të qëndrimeve teorike me veprimtarinë praktike mund të kuptohen shumë ide të sakta, shkencërisht të drejta dhe në aspektin shoqëror që çojnë përpara, si p.sh. ato mbi rolin e gjuhës, kombësisë, mëmëdheut, diturisë shoqërore, arsimit të fëmijëve, të të rriturve e të tjera.

Në letrën e Sami Frashërit dhe të Naimit drejtuar skulptorit dhe poetit shqiptar, atdhetarit Murat Toptani, më 8 janar 1899, me një qëndrim aktiv përshkruhen rezultatet e mbërrime në fushën e gjuhës. Sipas këtij shkrimi "shqipja u shkrua. U krijua alfabeti i saj. U hartua gramatika. U shtypën libra të shkencës. U përkthyen poezi të bukura nga çdo gjuhë. Me një fjalë, u kuptua se ç'gjuhë e përsosur dhe e rregulltë është. Thonin se shkrimet tona nuk i pranon askush. Por panë se shqiptarët myslimanë, katolikë

dhe ortodokës, të gjithë i pranuan. Shqipja filloi të shkruhet e të lexohet në çdo vend të Shqipërisë. Shkrimet e saj u përhapën. U çelën shkolla". Nga përmbajtja e tekstit mund të vërehet se sa bukur, me të vërtetë artistikisht dhe në mënyrë të bindëse këta dy rilindës kanë hartuar edhe letrat e zakonshme. Në këto momente është normale të thellohemi për fatin e *Fjalorit të gjuhës shqipe* të Sami Frashërit, i cili, sipas pohimeve të Vretos, kishte rreth 15-20 mijë fjalë. Mjerisht, ky fjalor aq i pasur dhe i vlefshëm nuk arriti ta shohë dritën.

**E pesta**, do të përmendim së pari tekstet mësimore të Samiut e ato janë sidomos me përmbajtje shkencore dhe pedagogjike-andragogjike. Dallohen këta libra shkollorë që i shkroi ai:

1. Abetare e gjuhësë shqip, Bukuresht, 1886,
2. *Shkronjëto* (gramatikë), Bukuresht, 1886,
3. Dheshkronjë (gjeografi), Bukuresht, 1888,
4. *Alfabetare e gjuhësë shqip*, Konstandinopojë, 1879 (Në këtë punë kolektive janë dy punime të Samiut, me titull "*Gjuha shqipe*" dhe "*Dheshkronjë*").

Me dy tekste të para rreth 30 vjet punuan mësonjëtoret e para shqipe - deri më 1909.

Burimet arkivore dëshmojnë se sidomos gjatë vitit 1908, lidhur me hapjen e shkollave të reja kombëtare, qendra të ndryshme si Elbasani, Tirana, Durrësi, Korça, Pogradeci, Vlora, etj. vazhdimisht kanë kërkuar për qindra e mijëra libra shqip, ato të Samiut, të Naimit, të Vretos, etj. (Sipas: Hysni Myzyri, *Arsimi kombëtar shqiptar 1908-1912*, Prishtinë, 1996, fq. 45).

Gjithashtu libri i tij, përndryshe kryesor në gjuhën shqipe *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë* (Bukuresht, 1899), pos çështjeve politike, historike, ekonomike etj., u shërbente nevojave shkollore dhe si burim i rëndësishëm i arsimit, sidomos rreth projektimit të arsi-

mit dhe të sistemit shkollor në Shqipëri, në kaptinën XIII, me titull: *Ditura*. (Shihni: Sami Frashëri, *Vepra* 2, Tiranë, 1988, fq. 76-77).

Edhe në *Emsalet* (Istanbul, 1879) Samiu përfaqësoi me shumë fjalë të urta rolin dhe funksionin e shkollës, rëndësinë e mësimin, organizimin e arsimit, edukatën morale etj.

Vepra më madhore e Samiut në gjuhën turke është *Enciklopedia e historisë dhe e gjeografisë "Kdmus al-A'lam*, botuar në Stamboll gjatë viteve 1889-1898. Në këtë enciklopedi gjashtëvëllimëshe ka mjaft të dhëna për arsimin dhe kulturën e shqiptarëve dhe popujve të tjerë në këto treva të Ballkanit dhe më gjerë - në Evropë dhe jashtë saj. Samiu pas *Kamusu l-a' lam* ishte i mendimit të hartonte edhe një *endiklopedi shkencore (Kamusu l'Funun)*. Pos rëndësisë të saj në gaz. *Sabah* (më 1897) theksoi edhe vështirësitë për të realizuar këtë ide.

Po ashtu Samiu është autor i teksteve shkollore në ndonjë gjuhë orientale, sidomos në turqisht. Ai botoi abetarët, gramatikat, fjalorët, aforizmat etj.

Të gjitha ato tekste, si dhe disa antologji në gjuhë orientale, me përmbajtje nga letërsia botërore, dorëshkrimet e tij kryesisht nga gjuhësia dhe letërsia kanë vlerë të madhe didaktike e metodike, disa nga të cilat nuk kanë humbur aktualitetin as në ditët tona. Nuk është, pra, rastësi pse ato tekste, e në veçanti "Shkronjëto e gjuhësë shqipe", edhe në dekada të para të shekullit njëzet ishin në përdorim. Do të ishte me interes të veçantë pedagogjik e shkencor po qe se ndokush prej gjurmuesve të shquar dhe njohësve të këtyre fushave, do të merrej me analizën shkencore, didaktiko-metodike, psikologjike, estetiko-letrare, gjuhësore e tjera të secilit tekst shkollor të tij.

**E gjashta**, pos Samiut edhe rilindas të tjerë të mëvonshëm jo vetëm që kanë hartuar ndonjë libër shkollor dhe u orvatën për hapjen e shkollave shqipe, por ata, njëkohë-



sisht u munduan shumë që tekstet mësimore të tyre dhe të rilindësve të tjerë t'u dërgohen falas nxënësve dhe shkollave në Korçë, Pogradec, Kolonjë, Selenicë, Luaras, Prizren, Pejë, Elbasan etj., dhe në shumë katunde për të rritur që dëshironin të mësonin shqip. (Më gjerë shih në artikullin tonë: *Naimi dhe Samiu në pedagogjinë e Rilindjes Kombëtare*, Koha ditore, 28 tetor 2000).

Libri i Naimit *Dituritë për mësonjëtoret të para* p.sh. është një tekst përmbledhës që ka aritmetikën me elemente të gjeografisë, fizikën, kiminë, gjeografinë dhe biologjinë. (Sipas: Shefik Osmani, *Fjalor i pedagogjisë*, Tiranë, 1983, fq. 211).

Për tekstologjinë shqiptare të viteve tetëdhjetë të shek. XIX merita më e madhe, me siguri, i takon Naimit dhe Samiut, ndërsa si qendra e botimeve të këtilla u dallua Bukureshti.

**E shtata**, Samiu, njohës i disa gjuhëve: të nënës, turke, arabe, persiane, greke e vjetër dhe e re, frënge, pjesërisht italiane dhe latine botoi tekste shkollore dhe vepra shkencore, letrare, politiko-historike, linguistike dhe publicistike; bashkëpunoi në periodikun e asaj kohe dhe ishte kryeredaktor i gazetës *Terxhuman-i Shark* (Interpeti i Lindjes). Nga kjo gazetë turke u përkthyen shqip 81 shkrime të Samiut në veprën e tij publicistike me titull: *Kush e prish paqen në Ballkan* (Përktheu nga turqishtja Abdullah Hamiti, Pejë, Dukagjini, 2000).

Samiu organizoi edhe *Bibliotekën e xhepit* (**Cep kütüphanesi**) e cila përbëhej prej 32 librave, ndër ato gati gjysma e tyre ishte nga vetë Samiu. Në këtë bibliotekë Samiu, për popullarizimin e diturive shkencore që nga viti 1879 shkroi e botoi 13 broshura, siç janë: 1. **Medeniyeti Islamiyye** (Qytetërimi islam, Ist., 1885), 2. **Esatir** (Mitologji), 1893/94), 3. **Kadinlar** (Gratë, Ist., 1879), 4. **Gök** (Qielli, Ist., 1879), 5. **Yer** (Toka, Ist., 1879), 6. **Insan** (Njeriu, Ist.,



1880?), 7. **Emsal** (Fjalë të urta, 4 vëllime, Istanbul, 1879), 8. **Letaif** (Anekdota, Istanbul, 1882/83, 2 vëllime), 9. **Lisan** (Gjuha, Ist., 1885/6), 10. **Yine Insan** (Përsëri njeriu, Ist., 1885/86).

Sidomos Biblioteka e xhepit meriton një studim të posaçëm. Disa nga librat e xhepit të Samiut në kohën e re u përkthyen dhe u botuan në gjuhën shqipe. Kështu veprën e Samiut "Lisan" (Gjuha), të cilën ky dijetar i madh e botoi turqisht më 1303/1886, në gjuhën shqipe e përktheu Dr. Mehdi Polisi dhe u botua nga Shtëpia botuese "Logos-A" e Shkupit. në vitin 2002. Në këtë libër Samiu do të paraqiste pikëpamjet e tij për gjuhën; për rëndësinë e njohjes dhe mësimin të gjuhëve të huaja; për përdorimin e drejt të termave gjuhësore; për lidhjet e ngushta të gjuhësisë me gjeologjinë dhe antropologjinë; për ndarjen e gjuhëve nga aspekti tipologjik (njërrokëshe, përngjitëse dhe eptimore); për përparimin shkallë-shkallë të tyre; për grupimin dhe degëzimin e gjuhëve etj. Pa dyshim se librat e Samiut, siç është "Gjuha", do të jenë një ndihmesë për të gjithë ata që merren me gjuhësi ose me ndonjë fushë tjetër të studimit.

**E teta**, është kultura e lartë letraro-estetike e Sami Frashërit. Atë ai e kultivoi në çdo vepër si dhe në çdo punim të tij, pra edhe në artikuj të ndryshëm, në recensione dhe shkrime të tjera të tij. Sidomos dallohen veprat letrare të Samiut, siç është romani i parë i tij, i shkruar me metodën evropiane në gjuhën turke (më 1872), me titull "Dashuria e Talatit me Fitnetin", pastaj më 1875 paraqitja me dramën "Besa", si dhe dramat "Sejid Jahja" dhe "Kave".

**E nënta**, Samiu është autor i një varg veprash nga fusha të shumta të dijes, e disa ndër ato me tematikë shqiptare. Para së gjithash kemi parasysh këto vepra të tij: 1. Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë? (Bukuresht, 1899), që pos çështjeve politike, ekonomike e historiko-shoqëro-

re merret edhe me platformën e zhvillimit të arsimit në Shqipëri, 2. Shkronjëto e gjuhësë shqip (Bukuresht, 1886, i pari tekst shkollor i gramatikës shqipe), 3. Abetare e gjuhësë shqip (Bukuresht, 1886), 4. Dheshkronjë (Bukuresht, 1888).

Në fondin e Samiut gjendet një dorëshkrim me shënime: "Sh. (Shemsedin -J.R.) Sami Frashëri, *Mbledhje këngëve shqip të vjetra e të ra*. Në Konstandinopojë më 4 të qershorit 1882". Fjala është për një fletore 19 fletëshe e shkruar me alfabetin e Stambollit. Ky dokument i pabotuar edhe më shumë dëshmon për veprimtarinë shkencore e patriotike të Sami Frashërit.

Veprat e Samiut në shqip dhe në disa gjuhë të tjera, sidomos enciklopedia e tij ("Kamus al-A'lam") kanë vlerë të madhe shkencore dhe janë dëshmi për kontributin e tij në zhvillimin e arsimit humanistik, laik e demokratik, si dhe për kulturën islame dhe të asaj iluministe perëndimore.

Në veçanti analiza e pëmbajtjes arsimore të veprave të Samiut do të tregojë së pari, se sa shumë ide progresive na i dha Samiu. Së dyti, se me ato ide dhe botëkuptime, p.sh. për arsimin fillor, arsimin kombëtar, arsimin e qytetërimit islam, arsimin e përgjithshëm, vetarsimitin etj., e në veçanti me tekstet e para shkollore shqipe, ai kontribuoi dhe zuri vendin e posaçëm në historikun e mendimit pedagogjik shqiptar.

**E dhjeta**, edhe nga shënimet biografike të Samiut mund të nxirren disa qëndrime për të kuptuar më plotë konceptionet e tij. Sidomos dallohen këto momente:

- e para, se mësimet e para Samiu i mori në vendlindje - në Frashër, në çerdhen e teqesë së njohur bektashiane, në të cilën u dallua Baba Alushi dhe te myderrizi Mahmut Efendi Tetova, në shkollën fillore në të cilën i mori dituritë e para.

- Momenti i dytë ishte vendosja e familjes Frashëri në Janinë, në vitin 1861, kur Samiu së bashku me vëllanë Naimin u regjistrua në Gjimnazin Zosimea dhe këtë për shtatë vjet e mbaroi më 1868. Këtu Samiu ra në kontakt me iluminizmin frëng dhe me kulturën moderne e racionale të Evropës. Pos shkencave natyrore, matematikore, historisë e gjeografisë etj., në këtë shkollë përparimtare dhe kryesisht laike, ai si dhe disa nxënës të tjerë shqiptarë mësoi greqishten, frëngjishten, italishten e latinishten, ndërsa turqishten, arabishten dhe persishten, po ashtu në Janinë, te myderrizi Jakup Efendiu. Me një fjalë, ngritja dhe të mësuarit e Samiut ishte tejet e rëndësishme në formimin e tij arsimor e kulturor.

- Momenti i tretë mund të ndahet puna e pandërprerë krijuese 34-vjeçare e Samiut në Stamboll. Këtu ai, së bashku me rilindësit që jetonin dhe vepronin në këtë kryeqendër të Perandorisë Osmane, mori pjesë aktive në lëvizjen përparimtare shoqërore dhe në zhvillimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare (Shoqëria e Stambollit, Kanonizma e Shoqërisë, dokument i botuar më 1879 etj.), dhe bashkëpunoi me intelektualë progresivë dhe më të njohur turk të asaj kohe.

- Momenti i katërt është vepra e tij e pasur, kolosale dhe nga fusha të ndryshme të shkencës. Pos veprave letrare, filologjike, linguistike, dialektologjike, islamologjike dhe leksikologjike, Samiu shkroi edhe vepra historike, gjeografike, nga sociologjia, enciklopedike, publicistike, pedagogjike, shkollore e metodike. Samiu nuk u kufizua në fushat albanologjike dhe të turkologjisë, por u afirmua edhe më gjerë - si shkencëtar i çmuar në suaza ndërkombëtare. Ishte adhurues i librit dhe kishte një bibliotekë personale me rreth 20 mijë ekzemplarë.

Duke marrë parasysh se Samiu gjurmoi dhe përpunoi shumë tema dhe nga lëmi të ndryshme të shkencës, nuk



do të jetë ekzagjerim nëse do të themi se Samiu meriton studime si gjuhëtar, shkrimtar, historian, mendimtar, pedagog, gjeograf, metodicient po ashtu enciklopedist, përkthyes, themelues i disa gazetave, revistave etj.

Librat, broshurat, artikujt, dorëshkrimet e pabotuara, por edhe korrespondenca e tij me rilindas dhe dijetarë të tjerë zhvillojnë intelektin, njohuritë shkencore, aftësitë e shumëllojshme dhe kulturën universale. Veprat e Samiut, të botuara gati kryekëput në Stamboll dhe Bukuresht, kurse në kohën e re në Tiranë, Prishtinë, Shkup e vende të tjera, janë të frymëzuara nga idetë dhe lëvizjet përparimtare shoqërore, kulturore, shkencore e arsimore të Evropës dhe botës lindore, e sidomos nga Rilindja Kombëtare, Lidhja e Prizrenit dhe nga aspiratat shekullore të popullit shqiptar që të jetojë në liri, i arsimuar dhe i bashkuar.

Përmbajtja e teksteve dhe tërësia e veprës së Samiut ka shumë vlera dhe rëndësi. Dallohen sidomos këto:

- **Rëndësia historike**, gjë që e dëshmojnë, pos traktatit "Shqipëria ç'ka qenë..." dhe librave të shumta, edhe artikujt dhe shkrimet e vogla të tij, sidomos ato të botuara në gazeta dhe revista në gjuhën turke (osmane) dhe arabe. Aspekti historik njëkohësisht do të thotë se vepra e tij ka një vlerë të përhershme, e cila edhe në kohën e tanishme nuk e ka humbur aktualitetin e vet.

- **Vlera social-politike** e veprës së Samiut mund të ilustruhet me idetë, konceptionet dhe sugjerimet largpamëse të tij në çdo vepër, e posaçërisht në ato historike, teorike, analitiko-sintetike që janë në të shumtën edhe reprezentative dhe që kanë vlerën primare edhe për pedagogjinë. Për ngjarjet politike pos librave të tjera sidomos meriton gjurmime vepra e Samiut: *Kush e prish paqen në Ballkan* (Pejë, 2000, libri ka 356 fq.).

- **Rëndësinë arsimore** e dëshmon çdo punim i tij, sepse ai në to që mbrojtës i njohurive të sigurta, të vërtetuara



dhe më pak të njohura, si dhe diturive që mund të zbatohen në praktikë. Analiza e cilitdo tekst mësimor (p.sh. Gramatikës ose Dheshkronjës) të Samiut tregon qartë anën arsimore të librave të tij.

- **Rëndësinë teorike** të veprës së Samiut e ilustron fakti se çdo vit u botua ndonjë libër i tij dhe se ato vepra edhe sot nxisin përsiatje teorike. Përmbajtjen teoriko-shkencore e vërtetojnë sidomos fjalorët e tij, enciklopedia historiko-gjeografike, shumë tekste shkollore, antologjitë etj.

- **Vlera konkrete praktike** e veprës dhe e kontributit të Samiut po ashtu është e pamohueshme. Ai gjithnjë është përpjekur që të përcjellë realitetin, edhe atë që ishte më i vrazhdë. Nga shembujt konkretë nxirrte qëndrime të sakta dhe të dobishme për shkencën edhe për popullin e vet, për popullin mysliman kudo që gjendej dhe për të tjerët.

- **Rëndësia filozofike-universale** shihet në shumë libra të Sami Frashërit, në veçanti në veprën e tij monumentale dhe më voluminoze Kamus al-A'lam. Deri në fund të jetës ai preferonte ide të shëndosha, iluministe, ndërnjerëzore dhe kështu tejkaloi suazën e përcaktimit të popullit të vet.

- **Rëndësia kombëtare dhe patriotike** e veprës së Samiut është padyshim e madhe. Edhe në këtë pikëpamje mendimtari Sami na la në amanet shumë udhëzime të urta dhe arriti rezultate të reja të shkencës, sidomos duke përmbledhur fjalë të urta popullore, këngë popullore shqipe e tjera, duke përpunuar disa tekste shkollore në gjuhën shqipe për nevojën e shkollave të para kombëtare, si dhe duke u thelluar për fatin dhe perspektivën e Shqipërisë dhe shqiptarëve. Rreth 60 vepra të tij të shkruara turqisht, shqip, arabisht e në gjuhë të tjera, dhe me qindra artikuj të ndryshëm, janë të gërshtuara me synime të tij kombëtare e patriotike.

- **Veçoritë etike** mund t'i vërejmë gati në çdo tekst të Samiut, e posaçërisht në *Emsal* dhe *Anekdotat* të tij. Në to çmohen shumë virtytet morale të larta, ato që vlejnë për të gjitha gjeneratat dhe kohërat. Një broshurë e Samiut në shqip: *Dheu është flori* (Prishtinë, 2004), ka gjithsej 30 faqe, por aty gjejmë "grusht përrallëzash, rrëfimesh e fjalësh të urta", që sidomos janë të dobishme për fëmijë.

- **Përmbajtja shkencore e kulturore** e ideve dhe qëndrimeve teorike të Sami Frashërit na lehtëson për të njohur më të plotë begatinë e veprës madhore të tij. Kur të botohen shqip të gjithë librat e Samiut, p.sh. ato të Bibliotekës së xhepit, disa vepra të botuara arabisht dhe persisht e të tjera, po ato vepra me siguri do të jenë edhe më motivuese për gjurmime të reja shkencore, historike, etnopsikologjike, morale, pedagogjike, komparative, gjuhësore, letrare e tjera. Ato vlerësime mbi veprimtarinë dhe personalitetin e Sami Frashërit do të jenë edhe më të plota dhe më objektive. Me emrin e këtij pedagogu rilindës dhe dijetari të madh krenohen edhe institucionet tona arsimore e kulturore, e në veçanti shkollat që mbajnë emrin e tij, siç janë: Gjimnazi "Sami Frashëri" në Prishtinë, Shkolla e Mesme "Sami Frashëri" në Tiranë, Shkolla Normale "Sami Frashëri" e Prishtinës në vitet 1941-1944 dhe disa shkolla fillore dhe të mesme të tjera.

Vepra e Samiut ka një rëndësi të veçantë **për parashikimin e institucioneve të ndryshme** (shkencore, arsimore, kulturore) **dhe shtetit shqiptar në të ardhmen**. Rrugën dhe perspektivën e zhvillimit të tyre ai e trasoï sidomos në librin: "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?". Shumë nga ato ide dhe propozime janë të mbështetura në fakte, pa dyshim edhe tani vizionare dhe rezultat i përsiatjeve të tija.

Lidhur me perspektivën e afërme të Shqipërisë ai, po në veprën e cituar, do të thotë: "Mëmëdheu yn' i dashuri

nukë ron dot edhe shumë kohë kështu si është sot, a do të humbasë për jetë e nukë do të mbesë as shqiptarë as Shqipëri, a do të shpëtonjë e të ndërtohetë me një mëndyrë që të mos ketë shëmbëllë në jetët e t'i kenë zili gjithë kombet e dheut. **Të shpëtuarët a të humburit e Shqipërisë është në dorët të shqipëtarëve.** (Sami Frashëri, Vepra 2, Tiranë, 1988, fq. 64. Nënvizoi J.R.).

Këtu shprehen qartë ndjenjat patriotike dhe realizmi i S. Frashërit.

Në fund do theksuar edhe fakti se roli dhe rëndësia e veprës së Samiut shihet edhe në ndikimin e shumëfuqishëm të tij në gjeneratat e historianëve, letrarëve, filozofëve dhe shkencëtarëve të fushave të tjera, po ashtu të bartësve të jetës arsimore e kulturore etj., gjë që dëshmon se trashëgimia e tij shpirtërore është e pasur, e pashterur dhe shumë e çmueshme.

- Samiu ishte shtylla e Rilindjes Kombëtare dhe personaliteti i tij **shembulli pozitiv**, para së gjithash si punëtor i palodhur, njeri me kulturë të gjerë klasike e moderne - evropiane dhe nga bota lindore, intelektual i aftë, shkencëtar i dalluar, një talent i rrallë, kritik objektiv, njohës solid i gjuhës shqipe, poliglot, metodolog i ngritur, p.sh. se si të punohet duke përballuar edhe kushte më të vështira të jetës. Edhe si prindër dhe edukator i fëmijëve të vet Samiu kishte takt, durim, mirësjellje, dashamirësi dhe autoritet të madh.

Duke u thelluar në opusin dhe rolin e veprës së Samiut, përndryshe shkencëtarit më të madh të kombit shqiptar në gjysmën e shek. XIX, nuk do të jetë e tepërt nëse do të themi mendimin se me veprën madhështore të këtij mendimtari, gjuhëtari, dijetari të madh, publicisti, patrioti të dalluar dhe veprimtari të palodhur për shkollën, arsimin dhe për mendimin pedagogjik shqiptar, do të krenoheshin edhe popujt më të mëdhenj dhe më të ngritur në aspektin



arsimor e kulturor. Autori i veprës: *Gjuha dhe letërsia persiane në zonën e ndikimit osman* (Teheran, 1369/1990) dr. Mohamed Emin Rijahi për shkencën dhe letërsinë turke çmon jashtëzakonisht Sami Frashërin dhe që nga fillimi thekson se "dijetari më i madh i Perandorisë Osmane dhe më i njohuri nga vendet evropiane është Shemsedin Samiu". Po aty autori vazhdon: "Samiu ishte, pa dyshim, një nga gjenitë e epokës së tij". (Sipas: Gazmend Shpuza, *Vëllezërit Frashëri në një botim iranian*, Perla, Tiranë, nr. 1/1996, fq. 103).

### **Essential features and the importance of Sami Frasheri work**

To characterize the intellectual activity of Sami Frasheri we would like to mention a number of essential features of his work. First of all, he was a researcher in a number of fields of science and culture, not limited in one or two of them. There was no issue to be treated by him in a superficial way. His varied studies testimony that he every time tried to find sufficient and trustful data. On the other hand, his was an accurate and systematized knowledge, acquired already from the school years. In every case he sought to closely link the theoretical approaches with the practical activity. Sami was engaged in a scientific, creative, literary, and educational activity through a dynamic and very progressive work. With his text books on Albanian language - *Abetare e gjuhësë shqip* (1886), *Shkronjëtove* (1886), *Dheshkronjë* (1888), and *Alfabetare e gjuhësë shqip* (1879) the Albanian school worked for about thirty years, until 1909. Even more, he and the other Renaissance activists make great efforts to send the books free to the hand of the pupils. Apart from Albanian, Sami knew a number of languages – Turkish, Arabic, Persian,



Greek, French, and partly Italian and his contributions were written in a number of languages too. Every time the content of the writing was expressed with a high literary and aesthetic culture. An important place have the works by Sami compiled in Albanian language, and some of them on Albanian subjects. His library was a collection of more than twenty thousands books. As Turkologist he was internationally renowned.

As a conclusion, his work is important from many aspects – historical, socio-political, educational, theoretical, practical, philosophical universal and patriotic national. Sami Frasheri's influence is still felt by the generations of the historians, linguists, and at the same time he pave the way for a number of State and educational institutions.

*Prof. Dr. Mehdi Polisi\**  
(Kosovë)

**SAMI FRASHËRI – NJERIU QË SHKELI  
NË SHUMË FUSHA TË DITURISË**

---

Mendimtari, shkencëtari, iluministi, patrioti, publicisti, poliglotti dhe eruditi i kombit tonë, Sami Frashëri, autor i mbi 60 veprave të fushave të ndryshme, i ka bërë borxh brezat pas tij që t'i kthehen vazhdimisht veprës së tij. Jemi krenarë dhe të privilegjuar, do të thosha, që i ka rënë hise edhe brezit tonë të nderojë figurën poliedrike të Sami Frashërit në këtë Konferencë Shkencore që po e organizon Shtëpia Botuese Logos-A në Shkup, me rastin e Jubileut të madh, të 100 vjetorit të vdekjes së tij.

Samiu lindi në Frashër më 1850, ku e kaloi fëmijërinë. Në Janinë kreu gjimnazin e njohur Zosimea, ku u pajis me njohuri e dituri të shumta. Stambolli ndërkaq, u bë vendqëndrimi i tij i përhershëm, ku veproi për 33 vjet me radhë. Vdiq në Stamboll më 18 qershor 1904.

Njohja e shkëlqyeshme e gjithë atyre gjuhëve dhe diturive që i mësoi në Frashër e në Janinë: turqishtes, arabishtes, persishtes, greqishtes klasike dhe të resë, latinishtes, frëngjishtes, italishtes dhe, natyrisht të shqipes si gjuhë amtare, i mundësuan Sami Frashërit, këtij dijetari të madh shqiptar të shekullit 19, të njohë burimisht dhe gjerësisht

■

\* "Universiteti i Prishtinës", Prishtinë.

kulturat dhe të arriturat shkencore të dy botëve: të Lindjes, nga njëra anë, dhe të Perëndimit, nga ana tjetër.

I pajisur thellësisht me njohuri të shumta e të shuman-shme, Samiu i vuri vetes detyrë të shkruajë Enciklopedinë madhore historike-gjeografike *Kamus al-A'lamin* (I-VI), që shtrihet në 4830 faqe; e shkruar imët dhe ngjeshur, me material shumë të pasur<sup>99</sup>; të hartojë disa fjalorë njëgjuhësh dhe dygjuhësh, të gjithë së bashku me mbi 6000 (gjashtë mijë) faqe<sup>100</sup>, gjithnjë të nevojshëm e të domosdoshëm për leksikografë, orientalistë, filologë, gjuhëtarë etj.; të shkruajë vepra letrare, gjuhësore, filologjike, dialektologjike, didaktike, islamologjike, historike, astronomike, gjeologjike, antropologjike; të hartojë alfabetin e gjuhës shqipe (madje, të kërkojë që atëherë një alfabet të njësuar), me të cilin u shkruan e u botuan shumë vepra; të shkruajë tekste shkollore, të shkruajë gramatikën e gjuhës shqipe për nevojat shkollore; të shkruajë “Fjalë të urta” dhe “Anekdota”, përmes së cilave do të shprehë mendime të larta filozofike, arsimore, edukative etj.; të shkruajë veprën monumentale “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë?”; të shkruajë artikuj të panumërt polemizues nëpër faqet e periodikut të kohës për mbrojtjen e të drejtave dhe zgjidhjen e çështjes së pazgjidhur shqiptare etj.

Kur e shohim veprën e tij, vetvetiu del përgjigjja se kush ka qenë Sami Frashëri, sa dijetar i madh ka qenë ai, çfarë kontributi ka dhënë ai për shkencën, për kulturën, me një fjalë për dituritë përgjithësisht, në çfarë mase kanë qenë përpjekjet e tij për zgjidhjen e çështjes shqiptare, në çfarë përmasash, sa këmbëngulëse dhe sa të zëshme kanë qenë

■  
<sup>99</sup> Më gjerësisht shih: Mehdi Polisi, *Kamus al-A'lami i Sami Frashërit vepër me përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare*, në: “Jeta e Re” 1-2, Prishtinë, 2005, f. 177-188.

<sup>100</sup> Po aty, shënimi 2.

idetë e tij në frymëzimin e Lëvizjes Çlirimtare Kombëtare. Njeri mendjemprehtë! Njeri largpamës!

Ky bir i madh i popullit shqiptar, ky dijetar dhe shkencëtar, jo vetëm kombëtar, por edhe ndërkombëtar, ka shkruar shumë. Po të shprehemi me numra e shifra, ai ka shkruar mbi 60 vepra (disa prej tyre në më shumë vëllime) që shtrihen në rreth 20 mijë faqe (duke mos i numëruar nëntëmbëdhjetë veprat e pabotuara). Energji e papërshkruar! Energjia e tij për punë pra ka qenë e madhe. Kjo dëshmohet me shtatë veprat e para të serisë së veprave të Bibliotekës së Xhepit: Medeniyyet- İslamiyye “Qytetërimi islam”; Esatir “Mitologjitë”, Kadınlar “Gratë”, Gök “Qielli”, Yer “Toka”, Emsal “Fjalë të urta”, Letaif “Anekdota”, të cilat i shkroi dhe i botoi brenda një viti, më 1879.<sup>101</sup> Po në këtë vit ai botoi edhe veprën “Alfabetare e gjuhës shqip”, revistën “Aile” (Familja) dhe shkrime të tjera. Ose, ç’të themi për energjinë e tij kur të na shkojë mendja te Kamus al-A’lami, dy vëllimet e para të të cilit shtrihen në 1600 faqe të përmasës së madhe e që i botoi për një vit (1889)? Çdo koment është i tepërt dhe i pakuptimtë.

Duke mbajtur parasysh faktin se vepra e Samiut është e shumanshme, shumëdimensionale, e mbi të gjitha cilësore, i jap vetes të drejtë, dhe sigurisht nuk gabohem, që Samiun ta vlerësojmë figurë poliedrike dhe si njeriu që shke-li e lëvroi në shumë fusha të diturisë.

■

<sup>101</sup> Të gjitha këto vepra dhe shumë prej atyre që u përmendën më lart, pra gjithsej 20 sosh janë botuar në kuadër të veprës së Sami Frashërit me rastin e 100 vjetorit të vdekjes së tij, më 2004, nga Shtëpia Botuese Logos-A, Shkup. Për përgatitjen cilësore të veprës dhe gjithsesi për guximin për t’i hyrë një projekti kaq të madh përgëzojmë përzemërsisht drejtorin e saj Mr. Adnan Ismailin dhe bashkëpunëtorët e tij.



Në fakt kjo është vetëm njëra anë e veprës së tij. Ajo ka edhe anën tjetër, do të thosha shumë më të rëndësishme. Është ana cilësore e saj. Mendimet e tij të shprehura në atë mal veprash nuk e kanë humbur cilësinë dhe vlerën e tyre as sot e kësaj dite. Ato janë aktuale dhe të freskëta. Nuk dimë se cilën prej tyre ta marrim si shembull. Është vështirë t'i ndash, sepse vazhdimësia dhe lidhshmëria e mendimeve, e koncepteve dhe e ideve të tij është e qartë, si në veprimtarin e tij të shkruar në shqip, ashtu edhe në atë turqisht, në të cilën shkroi më së shumti. Le t'i përmendim shkurtimisht dy prej tyre: "Kamus al-A'lami" dhe "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhetë"? E para e shkruar në turqisht, ndërsa e dyta në shqip, por që të dyja kanë një pikëtakim: Afirmimin e Botës Shqiptare.

Në enciklopedinë *Kamus al-A'lam*, Samiu përfshin me mijëra njësi të veçanta historike, gjeografike me karakteristika të hollësishme, pastaj personalitete botërore të fushave të ndryshme nga të gjitha kohët dhe nga të gjitha vendet e rruzullit tokësor. Natyrisht, një material shumë i pasur do të përfshihet edhe për Botën Shqiptare: për kufijtë dhe territoret e Shqipërisë (në kuptimin e atëherëshëm): qytete, kasaba, male, fusha, liqene, lumenj etj., pastaj, për shqiptarët: lashtësinë e tij, trimërinë, krenarinë, moralin, besnikërinë e femrës shqiptare etj., e për t'ia dashur të mirën popullit të vet ndalet edhe tek disa gjëra të mbrapshta: ndarjet, përçarjet etj. që duhet t'i shmangë gjithsesi, duke shkruar për të gjitha këto hollësisht dhe me krenari.

Jemi thellë të bindur se këto shënime të hollësishme që i shkroi Samiu, në gjuhën turke, nuk i shkroi sa për të treguar erudicionin e tij, njohuritë e tij, por, pa dyshim, me pjekurinë më të madhe, me vetëdije shumë të lartë, që në këtë mënyrë t'i tregojë edhe botës tjetër se shqiptarët janë të zotët të vetvetes, janë një popull i lashtë, që duhet të

çmohet e të vlerësohet si i tillë. Kjo enciklopedi madhore, të cilën Samiu e punoi për 11-12 vjet me radhë, sipas vlerësimeve të dijetarëve nuk e ka humbur vlerën dhe cilësinë e saj edhe sot e kësaj dite. Janë vlerësimet e përgjithshme se kjo vepër e ka lodhur më së shumti Samiun, porse, pa mëdyshje, edhe e ngriti atë në radhën e shkencëtarëve dhe enciklopedistëve ndërkombëtarë dhe e bëri të pavdekshëm përjetë.

Vepra tjetër monumentale, që vlerësohet si kryevepra e veprave shqip të Samiut është *“Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë?”*. Nga vetë titulli i saj shihet se kjo vepër nuk është gjë tjetër veçse një program i qartë kombëtar, ku Samiu do t’i përfaqësojë idetë dhe pikëpamjet e tij rreth problemeve që më së shumti ia kishin zënë frymën gjatë tërë jetës – Ardhmëria e Shqipërisë dhe e popullit shqiptar. Ç’është e vërteta, ai shkruan artikuj të panumërt nëpër gazetatat e kohës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve, për padrejtësitë që bëheshin ndaj tyre etj., por, me mendjen e tij të ndritur dhe me largpamësinë që kishte, mendonte se duhej bërë ende më tepër. Prandaj, në një letër që ia kishte drejtuar De Radës, Samiu, shumë i shqetësuar, i shkruante se ngjarjet po lëviznin me aq shpejtësi të madhe (sepse ishte fundshekulli 19, me shumë kthesa të mëdha, kur të gjitha shtetet ballkanike përpiqeshin të kapnin sa më shumë territore në dëm të njëri-tjetrit, sidomos në dëm të Shqipërisë) sa që kërkohej një program, një platformë politike e qartë, e sistemuar dhe e argumentuar mirë. Dhe vërtet, këtë premtim të dhënë, Samiu e realizoi nja katër a pesë vjet para vdekjes (1899), domethënë, pikërisht në fazën e pjekurisë së tij shkencore, kulturore, politike dhe patriotike, duke shkruar pra veprën *“Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë?”*. Mendimet dhe konceptet e tij lidhur me zgjidhjen e çështjes shqiptare të përfaqësuara në enciklopedinë *Kamus al-A’lam* dhe nëpër

periodikun e kohës, Samiu do t'i elaborojë në këtë vepër një nga një, në mënyrë shumë të sistemuar, duke punuar në dy rrafshë: në rrafshin shkencor dhe në rrafshin politik, tamam ashtu siç vepron një enciklopedist. Dhe, mendoj, mu kjo është arsyeja që Samiu do ta ndajë veprën në tri pjesë.

Në pjesën e parë "*Ç'ka qenë Shqipëria?*" Samiu hedh dritë për historikun e Shqipërisë dhe të shqiptarëve, për shtrirjen e gjerë të tyre në ato kohë të lashta, për luftrat e tyre që kishin bërë për mbrojtjen e territoreve të tyre, për heroizmin e Skënderbeut, por shpreh dhe shqetësimet e veta, se shqiptarët nuk kishin punuar sa duhet për vete "... *Shqiptarëtë – thotë Samiu – gjithmonë janë vrar' e përpjekurë e kanë çpërkaturë të tërë faqen' e dheut me gjak të tyre; po nga gjaku i shqiptarëve të tjerë kanë fituarë...*"<sup>102</sup>. Shqetësimet e Samiut janë mjaft domethënëse, sepse edhe në këtë mënyrë ai ngacmon ndjenjat e bashkëkombësve të tij që të mendojnë më shumë për vete se për të tjerët.

Në pjesën e dytë "*Ç'është Shqipëria?*", Samiu përqendrohet në një realitet të ri të krijuar. Ai, duke qenë dhe vetë dëshmitar i këtij realiteti, i këtyre lëvizjeve të mëdha, i këtyre kthesave të papritura, i rreziqeve nga armiqtë e brendshëm e të jashtëm, vë në shërbim tërë qenien e vet për të mirën e atdheut. Samiu, me shpirtin e intelektualit dhe të patriotit të mirëfilltë thotë se "*Shqipëria është një nga më të bukurat e vëndeve t'Europësë*", për të thënë më poshtë se është e pasur me male, fusha, pyje, lumenj, limane, miniera, kënetë (liqene) etj. Ndërkaq, për të trimëruar dhe frymëzuar popullin shqiptar, ai thotë: "*Shqiptari s'është vetëm i fortë e trim, po edhe i xgjuarë...*" Luftën për ruajtjen e kombit dhe interesave kombëtare, Samiu e krahason me lojën: "*Në kombëri – thotë Samiu – s'ka miqësi, si s'ka në*

■

<sup>102</sup> Të gjitha citatet janë nxjerr nga vepra.



*lodrët; cilido vështron të fitojë vetë e të hajë shoknë. Kombetë janë si peshqitë, që hanë njëri-tjatrinë.*” Samiu ka qenë shumë largpamës dhe i mprehtë në mendje. Ai, duke nuhatur fare mirë se cilat do të jenë qendrat e vendosjes për fatin e kombeve dhe të shteteve të tjera, do të thotë se shqiptarët, përveç shumë armiqve, kanë dhe shumë miq. “... *me gjithë këtë – thotë Samiu – s’munt dhe s’dubetë të themi që gjithë bota janë armikët e Shqipëtarëve. Jo – vazhdon Samiu – kemi edhe miq, jan’ edhe shumë që na duanë edhe munt të na ndihinë, po të duam vetë...*” Duke parë rrezikun që po i kanosej Shqipërisë, Samiu ngutet të japë “*Mendime për shpëtim të mëmëdheut nga rëziket që e kanë rethuarë*”.<sup>103</sup>

Pyetjeve: A mund të qëndrojë Shqipëria kështu si është? A janë shqiptarët të zotët të mbajnë e të ruajnë veten? A është shpëtimi a humbja e Shqipërisë në dorë të shqiptarëve? etj., Samiu do t’u përgjigjet në pjesën e tretë “*Ç’do të bëhet Shqipëria?*” në mënyrë të argumentuar shkencërisht e politikisht. Samiu në tërë pjesën e tretë të veprës jep mendime të larta se ç’duhet të bëjnë shqiptarët për ta ruajtur dhe për ta bërë më të fortë mëmëdheun e tyre. Shqiptarët, thotë Samiu në radhë të parë duhet të jenë të bashkuar e jo të përçarë. “*Ay shqipëtar që le vëllezërit’ e ti e ndabetë nga shqipëtarët, për të bashkuarë me armikët’ e Shqipërisë, duke bequrë bese ay është tradhtor, është armik i kombit e i mëmëdheut. Të këtillë shqipëtarë – thotë Samiu - më mirë të mos jenë se të jenë*”. Për organizimin e shtetit, për organet që do ta udhëheqin atë, për arsimin, për hapjen e shkollave të të gjitha niveleve , për hapjen e shkollave profesionale, për institute të ndryshme, për shtëpi botuese etj., Samiu, me konceptet e tij të qarta, do t’i shprehë në vazhdim të veprës. Ai, që atëherë kishte menduar për dy apo tre, siç thotë ai, Gjithëmësime (Universitete), që duhej të hapeshin në kry-

■  
<sup>103</sup> Ky citat është vënë në ballë të librit.



eqendrat e Shqipërisë. E pra, si mos të quhet kjo vepër program kombëtar?

Nga kjo që u tha, qoftë në veprat e tjera, qoftë në këtë vepër, mund të nxirret përfundimi se Samiu u është drejtuar dy opinioneve:

1. Opinionit botëror, pra opinionit të jashtëm, me qëllim që ta bindte atë se Shqipëria i plotësonte të gjitha kushtet e parapara ndërkombëtarisht që të bëhej shtet i pavarur dhe se shqiptarët janë të zotët ta udhëheqin vetë atë dhe,

2. Opinionit të brendshëm, pra shqiptarëve, duke i frymëzuar ata që ta duan shtetin e tyre, t'i bindë ata t'i respektojnë normat e shtetit të tyre, të jenë punëtorë të zellshëm, të mësojnë e të fitojnë dituri, të respektojnë njëritjetrin, të fitojnë sa më shumë miq, të jenë të ashpër ndaj armiqve, sepse vetëm kështu do të bëhen të lumtur, se vetëm kështu *“Shqipëria në pak kohë – thotë Samiu – do të bëhet një nga më të bukuritë vënde t’Evropësë e të gjithë dheut.”*

Kjo vepër pra, mund të them me plot gojën, do të mbetet domethënëse përjetë. Është një manual që duhet ta ketë në dorë çdo shqiptar, nga qytetari i rëndomtë deri te qeveritari.

Duke mbajtur parasysh veprën e madhe dhe cilësore të Sami Frashërit, idetë e tij përparimtare e iluministe, porositë e tij për brezat e ardhshëm, me një fjalë dobitë që sjell vepra e tij për shoqërinë njerëzore përgjithësisht, këtë punim mund ta përfundojmë me bindjen se Sami Frashëri do respektuar e nderuar gjithnjë. Duke respektuar njerëzit e mëdhenj të kombit, ne respektojmë veten dhe kombin. Respekti dhe nderimi ndaj tyre bëhet vetëm atëherë kur mendimet, idetë dhe porositë e tyre jetësohen, vihen në veprim.

## **Sami Frasheri – a contributor to many scientific spheres**

Sami Frasheri was a prolific author; he published more than 60 books, some of them in many volumes, including about 20,000 pages. There even remained 19 unpublished manuscripts. Within the range of little more than a year he compiled seven books in the series “Pocket Library” – Medeniyyet-İslamiyye “Islamic Civilization”; Esatir “Mythologies”, Kadınlar “Women”, Gök “Sky”, Yer “Earth”, Emsal “Proverbs”, Letaif “Anecdotes”. In the same year 1879 he published the Albanian Primer, directed the magazine “Aile” (Family), not mentioning various other articles. His enormous energies are best represented by the six volumes of the encyclopedia “Kamus al-A'lam”, from which two first volumes of 1600 pages were published within one year 1889. Sami was a multidimensional and polymath author. The most important aspect of his work is its quality. It could be even testified if we are only limited with two his works.

“Kamus al-A'lam” was compiled in Turkish. There are included thousands of geographical and historical items, together with the names of most renowned personalities from various periods and countries all around the world. A special place is given to the entries dedicated to Albanian world and Albanian distinguished figures.

The masterpiece of Sami is considered *Albania – What it was, what it is and what will become of it*. From the very title it is clearly seen that this is a full national program, expressing his ideas and views on the actual and future solution of the problems of his country. His work was addressed to two audiences – the international opinion, from which he asks the attention to the major request of the

Albanians for their independent country, and to the internal opinion, to inspire Albanians in their struggle for an independent state, in which they would live and work, learn and progress, to make it a developed and respected European country.

**Nexhat S. Ibrahimimi\***  
(Kosovë)

**ASPEKTE TË KONTRIBUTIT TË SAMI  
FRASHËRIT NË ISLAMOLOGJI**  
*- Periodizimi, origjinaliteti dhe  
emërtimi*  
*i kulturës e qytetërimit islam -*

---

**“Besimi se popujt joperëndimorë  
duhet të përvetësojnë vlerat,  
institucionet dhe kulturën perëndimore  
është i pamoralshëm në pasojat e tij”.**<sup>104</sup>

## **I. Hyrje**

Është folur dhe është shkruar shumë herë se Sami Frashëri bën pjesë në mesin e dijetarëve më të njohur shqiptarë dhe ndërkombëtarë. Po ashtu, është thënë dhe është shkruar se Sami Frashëri ka shkruar shumë vepra, mbi 60, në shumë fusha (gjuhësi, leksikografi, histori, kulturë, dramë, islamologji etj.) dhe në shumë gjuhë (shqip, turqisht,

■

\* Islamolog, Bashkësia islame - Prizren.

<sup>104</sup> Samuel Huntington, *The West: Unique, not Univeirsal*, sipas: Murad Wilfried Hofmann, *Islam u 3 Mileniju*, Sarajevë, 2004/1425 h., fq. 11 dhe 175.



arabisht, persisht, greqisht, frëngjisht etj.), mirëpo këto pohime nuk janë përcjellë gjithnjë me studime të mirëfillta, sistematike dhe të specializuara.

Duke marrë parasysh faktin se veprimtaria e shkruar e Sami Frashërit ende nuk është e njohur në tërësi (si për shkak të vonesës së përkthimit të shkrimeve të tij në gjuhën shqipe, ashtu dhe për shkak se disa vepra të tij ende janë në dorëshkrim), si në pikëpamjen cilësore ashtu edhe sasiore, megjithatë, në bazë të rezultateve të deritashme, nuk do të gabohet nëse Samiun e cilësojmë si: shkencëtar, mendimtar, filolog, leksikograf, letrar, islamolog, historian, politolog dhe me shumë cilësime të tjera<sup>105</sup>, të cilat, dëshirojam apo jo, i imponon vetë vepra e shkruar dhe aktiviteti shkencor, intelektual e politik i Sami Frashërit, respektivisht siç e shpreh këtë intelektual Milazim Krasniqi, se **“Sami Frashëri është simbol i një simbioze kulturore turko-shqiptare, të bazuar në shtratin e qytetërimit islam.”**<sup>106</sup> Këtë pohim të M. Krasniqit synon ta vërtetojë pjesërisht edhe ky shkrim.sjhumw

■

<sup>105</sup> Shih: Hasan Kaleshi, *Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame*, Prizren, 1411 h./1991, fq. 74, 77-78, 86 etj. Historiani i letërsisë, Mahmud Hysa, e quan Samiun ndër më të lartët në kulturën dhe letërsinë shqiptare sidomos për tri arsye: është njëkohësisht shkrimtar dhe shkencëtar, është shkrimtar që më tepër i ka dhënë kulturës së huaj sesa asaj kombëtare dhe është ndër shkrimtarët më produktivë. Në mos edhe më produktivi në kulturën tonë në përgjithësi. Sipas: Mahmud Hysa, *Alamiada shqiptare I*, Shkup, 2000, fq. 247.

<sup>106</sup> Milazim Krasniqi, *Shtresimet e identitetit kulturor e kombëtar shqiptar: po më tutje?*, në: *Shtresimet e identitetit kulturor shqiptare*, Prishtinë, 2003, fq. 57.

## II. Kontributi i Sami Frashërit në islamologji

Hulumtimi dhe studimi i kontributit të Sami Frashërit në fushën e islamistikës është detyrë shumë komplekse, e vështirë dhe shumëpërmasore. Fakti se vepra e Samiut është ende e panjohur për qarqet shkencore shqiptare por edhe botërore, kufizon synimin që të jepet një vlerësim gjithëpërfshirës për të. Për këtë arsye, për shkak të këtij 'handikapi', do të kufizohemi vetëm në ato vepra dhe probleme në të cilat kemi qasje.<sup>107</sup>

Është i paqëndrueshëm dhe i nxituar mendimi se vetëm vepra **Medenijeti islamijeti** (Qytetërimi islam) dhe **Himmet'ul-himam fi neshr'il-islam** (Përpjekja e heronjve në përhapjen e islamit) janë vepra islamistike. Elementi islam dhe fryma islame është e pranishme thuajse në çdo shkrim të Samiut, si në veprat tërësore që janë në gjuhën shqipe, ashtu edhe nëpër artikuj të gazetave e revistave, e të cilat janë analizuar apo janë cituar nëpër shkrime të ndryshme. Enciklopedia historiko-gjeografike **Kamus al-A'lam** është temë në vete dhe vetëm ata që kanë pasur rast t'i lexojnë së paku pjesët e botuara në gjuhën shqipe, do të binden se Samiu është madhështor, gjeni, kolos i shkencës dhe diturive intelektuale, në veçanti të atyre gjeografiko-historike. Leximi i vëmendshëm i personaliteteve dhe i vendbanimeve të shtruarra në **Kamus al-A'lam** dëshmon pretendimin tonë se Samiu ishte islamolog i mirëfilltë, që mund të krahasohet me mendimtarët më seriozë e më me famë ndër shqiptarët që kanë

■

<sup>107</sup> Ismail Ahmedi, *Parathënie*, në: Sami Frashëri, *Përpjekja e heronjve në përhapjen e Islamit*, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2003, fq. 9.

ekzistuar deri në këtë kohë.<sup>108</sup> Madje, elementi islam në veprat e Samiut është i pranishëm edhe në veprat **Qielli, Njeriu, Përsëri njeriu, Toka, Gratë** e të tjera, në **fjalorët** e Samiut, me rastin e shpjegimeve të fjalëve apo nocioneve të ndryshme. Mendoj se mendimet shtrembëruese kundrejt besimit islam të Samiut, qoftë edhe duke e heshtur idenë dhe veprën e tij, më tepër kanë qenë ndikim dhe reflektim i klimës antifetare përgjithësisht dhe antiislame veçanërisht lidhur me studimet rreth Samiut. Sepse, studimet **për** dhe **mbi** Samiun lëre që janë të pamjaftueshme si sasi, por ato përshkohen me subjektivitet të theksuar dhe ngjyrim ideologjik. Ndërsa disa studime për Samiun neglizhojnë dhe heshtin disa aspekte të veprës së tij<sup>109</sup>, disa të tjera marrin guxim që veprën e Samiut ta shtrembërojnë dhe falsifikojnë deri në atë masë, sa ta shpallin Samiun jo më pak se pabesimtar, si jomysliman. Do të citojmë për ilustrim një fragment nga botimi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me titull **Historia e letërsisë shqiptare**, i cili Samiun e përshkruan si **“idealiste objektiv në pikëpamjet filozofike, racionalist, iluminist i pajisur me kulturë të gjerë, Samiu godiste fort misticizmin e obskurantizmin oriental ...”**<sup>110</sup>. Edhe fragmenti vijues nga monografia kushtuar Samiut,

■

<sup>108</sup> Sami Frashëri, *Vepra 7*, Prishtinë, 1984; Sami Frashëri, *Vepra 9*, Shkup, 2004.

<sup>109</sup> Hasan Kaleshi, *Sami Frashëri në letërsinë dhe filologjinë turke*, Gjurmime albanologjike, I, 1968, Prishtinë, fq. 85. Khs.: Mehdi Polisi, *Sami Frashëri në fushën e islamistikës*, në: Sami Frashëri, *Vepra 10*, Prishtinë, 1999, fq. 11-12.

<sup>110</sup> Razi Brahimi, Sami Frashëri, në: *Historia e Letërsisë Shqiptare*, Prishtinë, 1989, fq. 166. Qëndrimi negativ ndaj Samiut është i dukshëm edhe me vetë vëllimin e faqeve që zë Samiu në këtë vepër monumentale (sic).



nga autori i mirënjohur shqiptar, Zija Xholi, shtron mjaft vrazhdë dhe në mënyrë të paqëndrueshme pikëpamjet e Samiut rreth Islamit, kur pohon **“në gjithë studimin e tij për kulturën arabe Samiu nuk e zë në gojë fare Islamit dhe Kuranin, provë tjetër që flet për drejtimin e mendimit të Samiut, një drejtim iluminist dhe antiklerikal”**.<sup>111</sup> Vlerësime kuturu e të paqëndrueshme, shtron edhe akad. R. Qosja, kur pohon se Rilindja Kombëtare Shqiptare, në fazën e saj të vonshme, **karakterizohet me antiklerikalizëm**, duke nënkuptuar edhe Samiun. Qosja, duke i parë këto çështje vetëm bardhë e zi, nuk bën dallimin ndërmjet qëndrimit të Samiut ndaj fesë islame (apo feve të tjera) dhe qëndrimit të Samiut ndaj Perandorisë Osmane.<sup>112</sup> Angazhimi i Samiut për pavarësinë e tokave shqiptare nuk është edhe luftë kundër fesë islame, por është luftë kundër një sistemi të caktuar politik turk të shekullit XIX, sepse sa i përket fesë islame, Samiu deklarohej qartë: *“Falënderimi i qoftë Zotit që ka thënë: “Te Zoti fe e vërtetë dhe e pranuar është vetëm Islami.”* (El-Kur’an, Ali Imran, 19).<sup>113</sup>

Nuk vlen të shqyrtohet më hollësisht arsyeshmëria dhe qëndrueshmëria e këtyre pohimeve dhe tezave të Akademisë, të Zija Xholit dhe të tjerëve, por është bren-gosëse se këto vepra mësohen ende nëpër programe shkollore dhe qarkullojnë nëpër biblioteka e lexues, nëpër kokat e një numri të madh të intelektualëve dhe në vazh-

■

<sup>111</sup> Shih: Zija Xholi, *Sami Frashëri - Monografi, Vepra IV*, Prishtinë, 1978, fq. 49.

<sup>112</sup> Shih: Rexhep Qosja, *Prej tipologjisë deri në periodizim*, Prishtinë, 1979, fq. 114 - 117 etj.

<sup>113</sup> Sami Frashëri, *Përpyjekja e heronjve në përhapjen e Islamit*, Shkup, 2003, fq. 17.



dimësi të lexuesit mbjellin qëndrim negativ e keqësues ndaj Islamit.<sup>114</sup>

Pajtohem me mendimin e M. Krasniqit se një ndër arsye kryesore për sulmet e rrepta ndaj Islamit të shqiptarët është me qëllim që duke ua **“prerë rrënjët lidhjeve të gjata shqiptaro-turke, mund të dobësohet dhe eventualisht, të mposhtet Islami ndër shqiptarë”**.<sup>115</sup>

Mirëpo, gjendja në studimet e Samiut po ndryshon dhe viteve të fundit kemi një preokupim më serioz rreth jetës, veprës dhe ideve të Samiut. Hasan Kaleshi, Zymer Hasan Baku, Feti Mehdiu, Miftar Ajdini, Mehdi Polisi, Gazmend Shpuza, Shaban Çollaku, Jashar Rexhepagiqi, Ismail Ahmedi, Abdullah Hamiti dhe shumë të tjerë kanë dhënë kontribut të çmueshëm në prezantimin e veprës së tij. Mendoj se edhe ky tubim shkencor ndërkombëtar është një ndihmesë e madhe dhe një rrugë se si të ndriçohet trashëgimia dhe se si të mësojmë sa më shumë nga njëri-tjetri si për Samiun ashtu edhe për çështjet e tjera.

Në pamundësi që të merremi me shumë aspekte të Samiut, në vazhdim do të trajtojmë disa ide shumë interesante të Samiut, të cilat kanë qenë objekt trajtimi të shumë dijetarëve edhe më herët dhe aktualisht në botën islame por edhe perëndimore. Ato probleme janë:

1. A ekziston kulturë dhe qytetërim botëror **para** kulturës dhe qytetërimit grek;

2. A ishin myslimanët **vetëm** përshkrues, interpretues dhe transmetues të kulturës e qytetërimit grek të popujt myslimanë dhe më vonë në Europë etj. dhe;

■

<sup>114</sup> Mehdi Polisi, *Sami Frashëri në fushën e islamistikës*, në: Sami Frashëri, *Vepra* 10, Prishtinë, 1999, fq. 11.

<sup>115</sup> Për këtë dhe arsye të tjera shih gjerësisht: Milazim Krasniqi, *Shtresimet..*, op. cit., fq. 60-61.

3. **Si të emërtohet** tërë ajo trashëgimi që është krijuar dhe që po krijohet në botë ndër myslimanët: kultura dhe qytetërimi islam, arab apo arabo-islam.

### **III. Kulturat dhe qytetërimet botërore para grekëve**

Në historitë e shkruara të kulturës dhe qytetërimit në Europë në shekujt e fundit, krahas përparimit në hulumtime, vërehen edhe dobësi të konsiderueshme, si injorimi i ekzistimit të kulturës dhe qytetërimit botëror para grekëve.<sup>116</sup> Samiu cek se jo vetëm evropianët e mëvonshëm, por edhe vetë **“grekët, të cilët ishin më të qytetëruarit e popujve të lashtë, të gjithë të tjerët jogrekë, i nënçmonin dhe i quanin si barbarë, domethënë të egër, primitivë”**<sup>117</sup>, dhe si të tillë i mohonin si paraprijës dhe mësues të njerëzimit. Kulturat e vjetra si ajo kineze, iraniane, induse, egjiptiane, kaldejase, asiriane, babilonase janë injoruar si të tilla.<sup>118</sup> Edhe filozofi i madh evropian, B. Rasell, nuk i ka shpëtuar frymës eurocentriste, duke pohuar se **“filozofia dhe dituria fillojnë me Talesin e Miletit në fillim të shekullit VI para e.r.”** dhe se **“Qy-**

■

<sup>116</sup> M. M. Sharif, *Historija Islamske Filozofije*, I, Zagreb, 1988, fq. 33. Miodrag Cekiq, *Pasqyrë e historisë së filozofisë*, Prishtinë, 1977, fq. 13.

<sup>117</sup> Sipas: Sami Frashëri, *Gjuha*, Shkup, 2002, fq. 19-20.

<sup>118</sup> Edhe filozofitë më të reja (shih: Zhane Hersh, *Habia filozofike*, Tiranë; Samuel Enoch Stumpf, *Filozofia*, Tiranë; Milan Damjanović, *Istorija kulture*, Gradina, 1977 etj.) janë nën ndikimin eurocentrist dhe me dinakëri i shmangen pranimit se ekzistojnë edhe filozofi e kultura me plot kuptim edhe jashta asaj greke.

**tetërimi perëndimor, i cili ka rrjedhur nga burimet greke, zë fill në traditën filozofike dhe shkencore të filluar në Milet para dymijë e pesëqind viteve.”<sup>119</sup>**

Kulturat dhe qytetërimet para grekëve janë pranuar nga evropianët vetëm si fazë përgatitore për kulturën dhe qytetërimin e mirëfilltë.<sup>120</sup> Evropianët neglizhojnë faktin se edhe kulturat dhe qytetërimet jashtë/joeuropiane kanë periudhat e veta të vjetra, të mesme dhe moderne, të cilat edhe pse nuk pajtohen në kohë, përmbajtje e formë, megjithatë kanë substancën e tyre fizike dhe shpirtërore, kanë gjuhën e tyre, idetë e tyre, emocionet dhe pasionet e tyre, traditat dhe shprehjet e tyre, synimet dhe rrjedhat e tyre që, natyrisht, dallojnë nga ajo greke.<sup>121</sup>

■

<sup>119</sup> Bertrand Russell, *Mudrost Zapada*, botimi II, Zagreb, 1977, fq. 10 dhe 13.

<sup>120</sup> Me periodizimin etnik nënkuptojmë ndarjen e proceseve historike në pjesë kronologjike të cilat ndërmjet veti janë të ndara me momente vendimtare. Këto momente mund të jenë të karakterit juridik, shoqëror, ligjet, kryengritjet, rebelimet etj. Me periodizimin racional nënkuptojmë përcjelljen e proceseve të tërësishme të zhvillimit të shkencës së caktuar, përcaktimit të stadeve të caktuara të zhvillimit në bazë të lëvizjeve ideore me peshë intelektuale, shoqërore. Sipas: Fikret Karčić, *Historija šerijatskog prava*, Sarajevë, 1987, fq. 13.

<sup>121</sup> Henry Corbin nuk pajtohet me periodizimin e filozofisë në përgjithësi dhe të kulturës evropiane në veçanti, sepse mendon se ajo nuk përkon me zhvillimet e përgjithshme botërore. Ai të kaluarën islame e ndanë në tri periudha kryesore:

1. **Periudha e parë** shtrihet prej shekullit VII deri në shekullin XII.

2. **Periudha e dytë** fillon prej shekullit XIII-XVI dhe quhet periudha e metafizikës sufiste;



Samiu nuk pajtohet me qëndrimet europiane se kultura dhe qytetërimi fillojnë me grekët. Ai pohon se **“qytetërimi janë paraqitur në rruzullin tokësor që nga kohët e lashta, kanë bërë që pak a shumë t’i shkruajnë historitë e veta”**, dhe vazhdon për të pohuar se **“kur i shohim këto histori, kuptojmë se, që nga paraqitja e qytetërimit të parë e deri në shuarjen e qytetërimit të grekëve, ai ka qenë i pranishëm herë te një e herë te disa popuj, dhe kështu rruzulli tokësor thuhet nuk ka mbetur asnjëherë pa të.”**<sup>122</sup>

Një gabim të tillë europerëndimor në vazhdimësi e kanë përsëritur deri në ditën e sotshme edhe qarqet shkencore-intelektuale shqiptare, të cilat për fat të keq, ende lëngojnë nga mungesa e identitetit vetjak shkencor, kulturor e intelektual, në pajtim me të kaluarën e tyre gjuhësore, territoriale e fetare dhe nën ndikimin e trashëgimisë europocentriste, nuk mund ta kuptojnë se **“progresi europian i kulturës dhe qytetërimit europian nuk mund të jetë model dhe kriter për zhvillimin e gjithëmbarshtëm njerëzor.”**<sup>123</sup> Shkenca, kultura dhe qytetërimi shqiptar, kryesisht ka vepruar dhe vepron varësisht nga përcaktimi ideologjik i hulumtuesit apo i institucionit ku vepron hulumtuesi, nga ndikimi i rrethit kulturor-historik kristian (katolik dhe ortodoks), duke ofruar vlerat e tyre, e jo rea-

■  
3. **Periudha e tretë** fillon prej shekullit XVI me safavidët për të vazhduar deri sot. Sipas: H. Corbin, *Historia e filozofisë islame*, I-II, Shkup, 1997, fq. 8-9 dhe 283-291. Ekzistojnë edhe ndarje të tjera.

<sup>122</sup> Sami Frashëri, *Vepra 10*, op. cit., fq. 28.

<sup>123</sup> M. M. Sharif, *Historija Islamske Filozofije*, I, Zagreb, 1988, fq. 34. Krhs.: Ali Bullaç, *Historia, shoqëria dhe tradita*, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2003.



litetin, duke i vënë të vërtetat historike në shërbim të synimeve ideologjiko-politike.<sup>124</sup>

Sami Frashëri, ndonëse ka jetuar dhe vepruar në një atmosferë të ngarkuar shoqërore-politike-ideologjike në fund të shekullit XIX, gjatë hulumtimeve dhe studimeve të thella e të specializuara, në gjuhë të ndryshme perëndimore e lindore, ka vërejtur këtë lajthitje të shkencëtarëve europianë. Ai nuk pajtohet me këto paragjykime apo studime të pjesërishtme dhe në bazë të provave historike, kulturore, filozofike, sociologjike, linguistike, antropologjike dhe provave të tjera ofron tezat e tij në disa drejtime:

Samiu vë në spikamë pretendimet e europianëve se kultura greke nuk arriti në Evropë nëpërmjet përkthimeve të veprave greke, pastaj glosave e superglosave dhe veprave origjinale të myslimanëve dhe e kundërshtoi këtë tezë. Europeanët mendojnë se kultura greke në Evropë arriti nëpërmjet dijetarëve grekë, të cilët, pas keqësimit të gjendjes politike, ekonomike dhe shoqërore në Greqi, ikën dhe kaluan në Itali dhe vendet e tjera europiane pas pushtimit të Stambollit. Mirëpo, duke i marrë parasysh datat dhe provat e tjera, periudhën shumëshekullore prej largimit të dijetarëve nga Greqia e deri në pushtimin e Kon-

■  
<sup>124</sup> Trimërojnë shkrimet e fundit më objektive, edhe të shqiptarët. I. Sulo dhe Ll. Filo në veprën e tyre cekin një citat nga vepra "Civilization Past & Present" ku thuhet: "Arritjet e myslimanëve në fushën intelektuale dhe artistike mund t'u atribuohen jo vetëm arabëve, por edhe popujve të tjerë, që e përfaqëuan Islamin në Persi, Siri, Egjipt, në Afrikën e Veriut dhe Spanjë. U përfitua shumë nga aftësia e Islamit për të absorbuar kulturat e tjera, si dhe prej gjenive të vetë popujve islamikë." Sipas: Ilira N. Sulo - Llambro Filo, *Ngritja dhe rënia e civilizimeve*, Tiranë, 2002, fq.141.

stantinopolit më 1453, është i paqëndrueshëm mendimi i tyre se Europa ishte pa qytetërim dhe kulturë mbi tetë shekuj.<sup>125</sup> Lidhur me këtë Sami Frashëri në frymën e shkencëtarit të vërtetë, në mënyrë të qartë, logjike por edhe argumentuese, pohon se **“kur t’u qasemi me vëmendje rrethanave dhe historive të shekujve, që nga fillimi i rënies së qytetërimit të grekëve dhe fillimet e zgjimit të Evropës, do të vëmë re se këta shekuj nuk do të jenë pa qytetërim, respektivisht nuk do të jenë të zhveshur nga qytetërimi. Përkundrazi, do të kuptojmë se kanë qenë të stolisur me një qytetërim më të plotë dhe më të përsosur se ata të mëparshmit. Ky qytetërim është qytetërimi islam.”**<sup>126</sup>

Samiu, duke përdorur metodat historiko-krahasuese dhe analitike vazhdon trajtimin rreth tezës së tij për të theksuar se “... ashtu siç është më i përsosur qytetërimi grek se qytetërimi egjiptas, e fenikasi se qytetërimi i popujve të tjerë të Azisë, edhe qytetërimi islam, s’ka farë dyshimi, është më i plotë dhe më i përsosur se qytetërimi grek.”<sup>127</sup>

Po ashtu, Samiu qysh moti tërheq vërejtjen se për osmanlinjtë nuk bën të flitet *a priori* në mënyrë keqësuese. Ndonëse ai harton programe politike për formimin e shtetit shqiptar, megjithatë nuk i lejon vetes të falsifikojë historinë dhe të japë gënjeshtër. Pra, përkundër aktivitetit politik të tij kundër shtetit turk të asaj kohe, ai nuk ngurron të pohojë se **“Shqipëria në kohët e tyrqet u bë m’e pasurë e m’e begatë se kurdo; se shqipëtarëtë sulëshinë bashkë me tyrqitë nëpër gjith’ anët të botës edhe këtheheshinë ngarkuarë me ar e me ergjënt,**

■  
<sup>125</sup> Sami Frashëri, *Vepra 10*, op. cit., fq. 26-27.

<sup>126</sup> Sami Frashëri, *Vepra 10*, op. cit., fq. 28.

<sup>127</sup> Sami Frashëri, *Vepra 10*, op. cit., fq. 28-29.

**me armë të vjejtura e me kuaj të bukurë t'Arabisë, t'Egjyptësë, të Qyrdistanit, t'Ungrisë etj....**"<sup>128</sup>

Dhe ndërsa studimet islame në Europë ditë-ditë po përparojnë, si në cilësi ashtu edhe në sasi, dhe aktualisht çdo shkencëtar serioz europëerëndimor pohon se humanizmi dhe Rilindja europiane drejtpërdrejt është e ndikuar nga Islami, e kështu ka menduar edhe vetë Sami Frashëri se **"qytetërimi europian ka lindur drejtpërdrejt nga qytetërimi islam"**<sup>129</sup>, qarqe shkencore shqiptare, veçanërisht në Kosovë, lëre që mohojnë këtë meritë dhe këtë të vërtetë, por e injorojnë në tërësi këtë problem apo kalojnë mbi të në mënyrë të heshtur.

Edhe pse trashëgimia greke që ruajtur dhe kultivuar në gjuhën greke, siriane dhe persiane, në tri gjuhë, në tri tradita, në tri nënqiej dhe me specifika të shumënduarta, kjo trashëgimi nën nënqiellin islam, duke u përkthyer arabisht, si gjuhë e përbashkët për të gjithë popujt, sektet dhe fetë, gjen kushte më të favorshme të zhvillimit të mëtejshëm. Me këtë ndërmarrje, trashëgimia greke filloi të përkthehet kryesisht në kohën e abasitëve në fillim të shekullit 2 hixhrij/ 8 gregorian dhe zgjati deri në shekullin X me intensitet më të ulët deri në shekullin XII. Kultura dhe qytetërimi grek, në këtë mënyrë, nuk ishte më trashëgimi e copëtuar në disa fe, kultura e gjuhë, dhe me përkthimin e saj në arabishte fitoi një forcë të re, një jetë të re dhe shpëtoi përgjithmonë nga harresa dhe zhdukja e tërësishme. Mirëpo, fakti se myslimanët e përkthyen, e komentuan dhe e vlerësuan kulturën dhe qytetërimin grek askujt nuk i jep të drejtë të pohojë se kultura islame është

■

<sup>128</sup> Sami Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë?*, Prishtinë, 1999, fq. 35.

<sup>129</sup> Shih: Sami Frashëri, *Vepra 10*, op. cit., fq. 29.



po ajo greke, respektivisht vazhdim i asaj greke me frymë të re, por është kulturë origjinale islame.<sup>130</sup> Sepse origjinaliteti nuk përjashton mundësinë dhe dëshirën e myslimanëve për mësim nga të tjerët dhe përvetësim nga përvojat, nga kulturat e hershme. Këtë nuk e bën për shkak të nxitjes heleniste, por **“për shkak të nevojës dhe synimeve religjioze”**.<sup>131</sup> Kjo për më tepër, sepse kultura dhe qytetërimi islam, dituritë intelektuale dhe eksperimentale, krahas formës religjioze, zotëronin edhe përmbajtjen dhe motivimin religjioz, disiplinën religjioze dhe orientimin etik drejt Zotit.<sup>132</sup>

Samiu nuk flet hollësisht për faktorët të cilët ndikuan që Europa ta njohë dhe ta pranojë me vonesë meritën e kulturës dhe qytetërimit islam në zhvillimin e ngritjen shoqërore, intelektuale dhe shkencore europiane, por thekson se mosnjohja e kontributit mysliman nga ana e europianëve nuk duhet të jetë produkt i **“fanatizmit të tyre”**<sup>133</sup>, por produkt i mosshtrirjes së veprave të myslimanëve në mesin e popujve europianë, që për pasojë pati mosnjohjen e veprave myslimane të shtresat e gjera. Qëndron edhe konstatimi të cilin e thekson Samiu me këtë rast, mirëpo, mendojmë se arsyeja kryesore e injorimit të Islamit ishte platforma e përgjithshme e botës kristiane ndaj botës myslimane e ajo është mosnjohja e Islamit si fe qiellore prej fillimit e deri sot nga ana e tyre dhe si pasojë e kësaj mosnjohjeje kemi inkuizicionin famëkeq<sup>134</sup>, luftërat

■

<sup>130</sup> Salih H. Alić, *op. cit.*, fq. 115.

<sup>131</sup> Nerkez Smailagić, *Klasična Kultura Islama*, libri 1, botimi II, Zagreb, 1976, fq. 108.

<sup>132</sup> Nerkez Smailagić, *op. cit.*, fq. 110-111.

<sup>133</sup> Sami Frashëri, *Vepra 10*, *op. cit.*, fq. 29.

<sup>134</sup> Samiu kështu e përshkruan inkuizicionin në një vepër tjetër: “Ata (europianët, N.I.) nuk u kënaqën me rënien e qeverisë (islame) në Spanjë,



kryqtare<sup>135</sup> dhe kolonializmin, modernizmin dhe postmodernizmin deri në ditët tona.<sup>136</sup>

Samiu, po ashtu, duke analizuar faktorët e distancës kohore dhe mosnjohjes së vlerave joeuropiane nga europianët, mendon se injorimi i kulturave dhe qytetërimeve joeuropiane nga europianët është pasojë mungesës së **“veprave që do të vlerësonin punën e popujve të qytetëruar të Azisë së vjetër”**.<sup>137</sup> Mirëpo, zbulimet dhe hulumtimet edhe në kohën e vetë Samiut tregojnë të kundërtën. Deri në kohën kur Samiu i shkruan këto qëndrime të tij, në Europë kemi disa përkthime të Kur’anit në gjuhë të

■

por shkuan aq larg saqë fretërit e tyre themeluan gjyqe, nga të cilat dilte djalli. Filluan të djegin myslimanët e devotshëm. Një numër jo i vogël i tyre, ndonëse u kthyen në të krishterë për të shpëtuar veten, përsëri u dogjën dhe u mbytën me urdhrin e fretërve. Kështu, në tërë Spanjën e atëhershme nuk mbeti asnjë mysliman.” Sipas: Sami Frashëri, *Përpyjekja e heronjve në përhapjen e Islamit*, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2003, fq. 22.

<sup>135</sup> Samiu për kryqëzatat thotë: “Europianët nuk u mjaftuan me këto mizori tragjike (inkuizicionin, N.I.), por u mbledhën nga të gjitha anët e Europës nën simbolin e kryqit (kryqëzatat, N.I.) dhe i sulmuan disa herë vendet islame. Ata nuk arritën asgjë nga pikëpamja morale me këto sulme në Azi dhe Afrikë, mirëpo ia dolën që t’i dëbojnë myslimanët nga Europa. Kjo veprë e tyre do të mbetet turp i madh, të cilin s’do ta harrojë kurrë historia, deri në ditën e kiametit.” Sipas: Sami Frashëri, *Përpyjekja e heronjve...*, op. cit., fq. 22. Shih për kryqëzatat edhe dramën e Samiut: *Sejdi Jahja*, Prizren, 2004.

<sup>136</sup> Shih: Edward Said, *Orientalizam*, Sarajevë, 1999. Lexo edhe: Bernard Lewis, *Kulture u konfliktu*, Sarajevë, 2002; Akbar S. Ahmed, *Islam pod opsadom*, Sarajevë, 2004/1425 h.

<sup>137</sup> Sami Frashëri, *Vepra 10*, op. cit., fq. 30.

ndryshme europiane<sup>138</sup>, shumë vepra filozofike dhe mjekësore, astronomike, matematikore, algjebrike etj. Në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX Europa e ka njohur shumicën e veprave të kulturës dhe qytetërimit të Lindjes së largët, të mesme dhe të afërt dhe vlerën e tyre<sup>139</sup> dhe kjo 'mosnjohje' nuk mund të arsyetohet me mosnjohje të Islamit dhe të myslimanëve nga ana e tyre.

■

<sup>138</sup> Nexhat S. Ibrahim, *Dimensine kur'anore*, Shkup, 2004, fq. 63 - 68.

<sup>139</sup> Shih një literaturë të pasur për temat e sipërme: Xhon L. Esposito, *Oksfordska istorija islama*, Beograd, 2002; M. M. Sharif, *Historija islamske filozofije*, pjesa 1-2, Zagreb, 1988; Umer Ferruh, *Tarih'ul-fikr'il-arabijji ila ejjami Ibni Haldun*, botimi IV, Bejrut, 1983; Muhammed Husejn Hejkal, *Hajatu Muhammed*, botimi XIV, Kairo, 1977; Francesko Gabrieli, *Historija arapske književnosti*, Sarajevë, 1985; Muhammed Hamidullah, *Muhammed a. s.*, botimi I, I-II, Sarajevë, 1977; C. Veljačić - Rada Iveković, *Indijska i iranska etika*, Sarajevë, 1980; Michel Hulin, *Skriveno lice vremena*, Zagreb, 1989; Lazar Milin, *Naučno opravdanje religije - Istorija religije*, libri 2, Beograd, 1977; Henry Corbin, *Islam u Iranu - Duhovni i filozofski obzirí*, I-IV, Sarajevë, 2000; Ćedomil Veljačić, *Razmedja azijskih filozofija*, I-II, Zagreb, 1978; Rada Iveković, *Rana buddhistička misao*, Sarajevë, 1977; G. M. Bongard-Levin, *Stara indijska civilizacija*, Beograd, 1983; Ahmed Fuad El-Ehwani, *Filozofia islame*, Prizren, 2002; Abd'ul-halim Mahmud, *Et-Tefkir'ul-felsefijji fi'l-islam*, botimi II, Kairo, 1989; Jëllmaz Ozakpënar, *Kultura dhe qytetërimi*, Shkup, 2003 etj.

#### IV. Myslimanët si përkthyes, interpretues dhe krijues origjinalë të kulturës dhe qytetërimit

Samiu vëren e shtron edhe një problem tjetër, e ai është se a ekziston kulturë dhe qytetërim i mirëfilltë islam, apo, sikurse pretendojnë qarqe të caktuara europiane, ajo është vetëm një kopjim, përshkrim dhe komentim i kulturës e qytetërimit grek dhe asgjë më tepër, respektivisht, si e shpreh këtë filozofi S. H. Nasr, se kultura dhe qytetërimi islam shikuar nga **“pikëvështrimi i traditës intelektuale perëndimore paraqitet thjesht si filozofi greko-aleksandrite në petkun arab”**.<sup>140</sup>

Edhe në fillim të shekullit XX dominonte mendimi i filozofit e orientalistit holandez T. J. de Boer, se e a.q. **“filozofia arabe mezi përmbante diç më tepër se përfolje të mendimit grek, e cila shpesh është e gabuar.”**<sup>141</sup> Kjo e shtyu orientalistin tjetër, Maks Horten të pohojë se kjo është dëshmi e **“mosdijes sonë të plotë të kulturës lindore... . Ne sot i afrohem Lindjes me vetëdije, që duhet t’ia shpaguajmë borxhin e rëndë.”**<sup>142</sup>

Mendimin e M. Horten do ta argumentojmë edhe me pohimin e shkencëtarit të madh Cahen, se merita e kulturës dhe qytetërimit islam është ajo që **“Europa mundi**

■  
<sup>140</sup> Sayyid Husejn Nasr, *The History of Islamic Philosophy*, 1996, London-NewYork, vëll. I, fq. 27-39, sipas: Glasnik Rijaseti IZ BiH, Sarajevë, nr. 1-2/1997, fq. 1165.

<sup>141</sup> T. J. de Boer, *Geschichte der Philosophie im Islam*, 1901, sipas: Cedomil Veljacic, *Filozofija Istocnih Naroda*, pjesa II, botimi III, Zagreb, 1982, fq. 39-40.

<sup>142</sup> Max Horten, *Geschichte der Philosophie in Einzeldarstellungen*, fq. 17 dhe 21, sipas: Cedomil Veljačić, *Filozofija Istočnih Naroda*, op. cit., fq. 40.



sërisht të zbulohet dhe rishtazi ta rilindë trashëgiminë antike”<sup>143</sup>, që flet qartë për rolin dhe rëndësinë e kulturës dhe qytetërimit islam në kontributin e kulturës dhe qytetërimit botëror.

Mirëpo, përveç rolit të kulturës dhe qytetërimit islam, vlen të theksohet edhe fakti se kultura dhe qytetërimi islam luajti rol të rëndësishëm në formimin e filozofisë skolastike dhe në Rilindjen në Europë.<sup>144</sup> Këtë fakt e ka vërejtur shkëlqyeshëm edhe Samiu, për të pohuar se “...realistët europianë këtë qytetërim (islam, NI) nuk e mohojnë, por vërtetojnë dhe pohojnë se qytetërimi europian ka lindur drejtpërdrejt nga qytetërimi islam. Është gabim që është menduar deri më tash se qytetërimi europian ka lindur drejtpërdrejt nga qytetërimi grek.”<sup>145</sup>

Këtë Samiu e pohon edhe në artikullin e tij Qytetëri e grekëvet, kur flet për zhvillimin e kulturës antike greke: “Kjo qytetëri është far’ e qytetërisë së Arapëvet, në kohëra të mesme edhe e asaj s’Europianëve të sotmë.”<sup>146</sup>

Por, edhe filozofët dhe kulturologët e tjerë të Rilindjes europiane, qoftë ata që e përkrahnin kulturën dhe qytetërimin islam, qoftë ata në konflikt me kulturën dhe qytetërimin islam, pranojnë vendin autokton të mendimtarëve myslimanë. Në këtë pikëpamje, Pico della Mirandola, dijetar i njohur, duke analizuar rolin e kulturës dhe qytetërimit islam, pohon: “Çfarë është dobia nëse studiohet

■

<sup>143</sup> C. Cahen, *Der Islam*, I, fq. 128, sipas: Salih H. Alić, *op. cit.*, 128.

<sup>144</sup> Salih H. Alić, *op. cit.*, fq. 122-123. Khs.: Čedomil Veljačić, *Filozofija Istočnih Naroda*, *op. cit.*, fq. 40, *op. cit.*, fq. 109-111.

<sup>145</sup> Sami Frashëri, *Vepra 10*, *op. cit.*, fq. 29.

<sup>146</sup> Drita, fl. 3, viti 1884, fq. 40, sipas: Sami Frashëri, *Vepra 8*, Prishtinë, 1984, fq. 23.



**filozofia e autorëve latinë, e Albertit, Skotit, Egidiusit, Thomasit, Frensisit dhe Henrit, e nëse lëshohen filozofët grekë dhe arabë.”<sup>147</sup>**

Samiu çështjen e përhapjes së kulturës islame e trajton edhe në një artikull tjetër: “Me të hapurit të diturisë së Grekëve nëpër Arabët, zunë të delninë njerës të ditur e me një mendje të tepërt të cilët diturin e grekërvet të vjetërë e shpunë shumë përpara ...”<sup>148</sup>

Do ta theksojmë një rrëfim, i cili në mënyrë ilustrative flet për rëndësinë e Islamit dhe kontributit të tij kulturës dhe qytetërimit botëror. Kështu, në veprën e Anatol Fransit **Mbi gurin e bardhë** një nga historianët e pyet madam Navazie: **“Cila është dita më fatkeqe në historinë e Francës?”** Nuk u përgjigj! As nuk e dinte se cila është ajo ditë?! Atëherë ai i tha: **“Ishte ky viti 732, në të cilën ndodhi Beteja në Puatje, viti kur kultura arabe u zbraps para barbarizmit francez.”<sup>149</sup>**

F. Rahman, filozof i njohur mysliman nga Pakistani, hedh poshtë mendimin se filozofia islame nuk ekziston si e tillë, duke pohuar se **“lënda prej të cilës u ndërtua ky sistem filozofik nuk ka qenë as greke as e nxjerrë nga idetë greke; përka përmbytja e vet ai është plotësisht helenist. Mirëpo, struktura konkrete, vetë sistemi, pa dyshim ka vulën islame ....”<sup>150</sup>**

Përkundër pranisë së huazimeve reciproke, të natyrshme sipas mendimit tonë, hulumtimi dhe studimi shumëdi-

■

<sup>147</sup> Sipas: Salih H. Alić, *op. cit.*, fq. 128, shën. 64.

<sup>148</sup> Dituria, fl. 6, 1885, f. 89, sipas: Sami Frashëri, *Vepra 8*, Prishtinë, 1984, fq. 23.

<sup>149</sup> Rože Garodi, *Islam, kultura i socijalizam*, Sarajevë, 1981, fq. 11.

<sup>150</sup> Fazlur Rahman, *Duh islama*, Beograd, 1983, fq. 171.

siplinor i tërësisë intelektuale islame provon se ajo është **“thellë e rrënjosur në Kur’an dhe hadith.”**<sup>151</sup>

Në pamundësi që të zgjerohemi, shkurtimisht do të cekim se historianët e shkencës pajtohen se të gjitha shkencat e përvetësuara në botën islame më tej janë zhvilluar e përkryer dhe se myslimanët në këtë mënyrë kanë luajtur rol qenësor në zhvillimin e shkencës dhe kulturës së njerëzisë. Delis Avliri në lidhje me shkencat të cilat myslimanët i kanë përvetësuar nga grekët e vjetër, thotë: **“Atë që arabët (myslimanët) e përvetësuan prej grekëve nuk është përcjellë te popujt e tjerë më tej në formë të pandryshueshme. Duhet thënë se shkenca greke në mjedisin arab (mysliman) ka pasur vend dhe rol të veçantë. Arabët bënë intervenime të rëndësishme në astronomi, matematikë dhe shkencat tjera që i përvetësuan nga grekët dhe indusët, duke iu dhënë klasifikim e metodologji të re, ashtu që këto dy shkenca kanë përparuar ndjeshëm. Mund të thuhet se arabët e kanë themeluar dhe zhvilluar algjebërën, trigonometrinë dhe gjeometrinë sferike...”**<sup>152</sup>

Mendimi i atyre se kultura, shkenca dhe filozofia islame është një përkthim i pastër i neoplatonistëve (ishrakijun) dhe peripatetikëve (meshajjun) dhe se në këtë nuk ka origjinalitet, përgënjeshtrohet nga hulumtimi dhe studimi i vetë veprave të Ibn Sinës, i cili ndonëse konsiderohet peripatetiku më i madh mysliman, nuk vepron me terminologjinë dhe konceptimet peripatetike, kurse shumë teza



<sup>151</sup> Sayyid Husejn Nasr, *The History of Islamic Philosophy*, op. cit., fq. 1165.

<sup>152</sup> Sipas: Morteza Motahhari, *Osvrt na filozofski tok u islamu*, [http://www.ibn-sina.net/txt/tekstovi.asp?tekst\\_id=23](http://www.ibn-sina.net/txt/tekstovi.asp?tekst_id=23). Krahaso: Rože Garodi, *Islam, kultura i socijalizam*, Sarajevë, 1981, fq. 11-64.

dhe konceptime islame te ky dhe dijetarët e tjerë nuk ha-  
sen te Platoni dhe Aristoteli.<sup>153</sup>

Me këtë mendim ne nuk mohojmë ndikimet e pash-  
mangshme të kulturave ndërmjet tyre, që janë të domos-  
doshme dhe të mirëseardhura.<sup>154</sup> Për këtë arsye këtë zhvi-  
llim do ta ndajmë në katër etapa specifike:

1. Çështjet që pak a shumë kanë ruajtur formën të cilën  
e kanë pasur në përkthimet e para dhe nuk kanë pësuar  
ndikime, plotësime dhe riformësime të mëvonshme.

2. Çështjet të cilat janë plotësuar në filozofinë islame, në  
kuptim të shqyrtimit dhe përpunimit të saktë nga filozofët  
islamë, e jo në kuptim që t'u ndryshohet forma zanafillëse  
dhe të vijë deri te ndryshimi i kuptimit.

3. Çështjet të cilat në tërësi kanë pësuar ndryshim.

4. Çështjet të cilat nuk kanë ekzistuar në periudhën para-  
islamike, janë krijim i shkollës intelektuale islame dhe janë  
trajtuar ekskluzivisht në qarqet intelektuale myslimane.<sup>155</sup>

D. B. Mekdonald, qysh në vitin 1904 ka pohuar se “histo-  
rianët e Europës mesjetare domosdo duhet të jenë arabistë,  
ose do të duhet të bashkëpunojnë me arabistë. Unë nuk  
ngurroj të shpreh konfirmimin tim të fuqishëm se përpjekjet

■  
<sup>153</sup> Shih: Morteza Motahhari, *Osvrt na filozofski tok u islamu*, [http://www.ibn-sina.net/txt/tekstovi.asp?tekst\\_id=23](http://www.ibn-sina.net/txt/tekstovi.asp?tekst_id=23).

<sup>154</sup> Janë të shumta ajetet kur'anore dhe hadithet e Pejgamberit a.s. lidhur me këtë temë.

<sup>155</sup> Shih gjerësisht elaborimin e: Morteza Motahhari, *Osvrt na filozofski tok u islamu*, [http://www.ibn-sina.net/txt/tekstovi.asp?tekst\\_id=23](http://www.ibn-sina.net/txt/tekstovi.asp?tekst_id=23). A. F. El-Ehwani, op. cit., fq. 38-58.



e ardhshme të këtyre historianëve do të jenë të riinterpretu-  
në qytetërimin e Europës në dritë të asaj islame.”<sup>156</sup>

Mekdonald pohimin e vet e mbështet edhe në shkencë-  
tarin e madh L. Ranke se “për studimin e historisë mesje-  
tare të Evropës nevojitet të njohë dy gjuhë, latinishten  
dhe arabishten.”<sup>157</sup>

Mund të përfundohet se kultura dhe qytetërimi islam  
hapën shtigje të reja dhe deri atëherë të panjohura për eu-  
ropianët, orientuan pikëpamjet europiane drejt kulturave  
deri atëherë për ta të parëndësishme, bënë që evropianët  
të fillojnë ta dashurojnë kulturën dhe qytetërimin islam, e  
cila krahas vlerave të veta ofroi edhe vlerat e harruara gre-  
ke etj.<sup>158</sup>

## V. Kultura dhe qytetërimi islam e jo arab, as arabo-islam

Çështja e emërimit të kulturës dhe qytetërimin islam te  
shumë shkencëtarë, kulturologë dhe filozofë, si ata klasikë  
ashtu edhe te ata bashkëkohorë të shekullit XIX dhe XX,  
është e diskutueshme dhe e kontestueshme. Kësaj mos-  
marrëveshjeje i ndihmoi edhe paraqitja e nacionalizimit  
arab dhe e vetëdijësimit të arabëve mbi qenien kombëtare  
dhe identitetin e tyre në shekullin XIX dhe XX. Por du-

■  
<sup>156</sup> D. D. Macdonald, *The Problems of Muhammedanism*, 1904, fq. 534, sipas: Salih H. Alic, *op. cit.*, fq. 128, shën. 64.

<sup>157</sup> J. J. Waardenburg, *L'Islam dans le miroir de l'Occident*, Paris, La Haye, 1963, fq. 195, sipas: Salih H. Alic, *op. cit.*, fq. 128.

<sup>158</sup> Më hollësisht lexo: Ibrahim Madkur, *Uticaj na polju filozofije*, në: *Arapsko-islamski uticaj na evropsku renesansu*, Sarajevë, 1987, fq. 101-143.



het theksuar se qëndrimi i autorëve klasikë është tjetërfare nga ai i disa shkencëtarëve bashkëkohorë.

Filozofët e parë e kanë njohur vetveten, por edhe nga bashkëkohanikët e tyre janë njohur si ‘filozofë të islamit’, ‘filozofë islamë’ dhe ‘urtakë islamë’. Këtë e hasim te autorët e mëdhenj të asaj kohe, si te Shehrestani, Kiftiu, Bejhekiu etj.

Gjatë historisë në sipërfaqe kemi shumë emërtime, por disa prej tyre i kanë qëndruar kohës, janë profilizuar dhe janë të pranishme deri në ditët tona:

### **1. Kultura dhe qytetërimi arab**

Ata të cilët mendojnë se kultura dhe qytetërimi duhet të quhet **‘arab’**, mbështeten në faktin se shumica e madhe e veprave në kulturën dhe qytetërimin islam janë përkthyer apo janë shkruar në gjuhën arabe. I një mendimi të ngjashëm është edhe orientalisti Carlo A. Nalino, i cili me rastin e hapjes së Universitetit të Egjiptit, kah gjysma e shekullit XX kontestoi emërtimet si “filozofë të islamit”, “filozofë islamë” dhe “urtakë islamë”, duke pohuar se **“... kur është fjala për periudhat e mëvonshme të shekullit të parë hixhrij, këtë term e kemi marrë në kuptimin teknik, profesional, me të kemi përcaktuar shumë popuj e kombe në shtetet islame, në të cilat, në pjesën më të madhe, librat e tyre shkencorë janë shkruar në gjuhën arabe, kështu që në kuadër të këtij termi hyjnë: arabët, persianët, indusët, sirianët, egjiptianët, spanjollët e të tjerë, për të cilët është e përbashkët shkruarja me gjuhën e shkencës, në arabishte, dhe në të cilët vërehet ndikimi i shteteve islame. ...”**. K. Nalino mendon se emërtimi ‘islam’, ‘mysliman’ **“i përjashton kristianët, hebraikët, sabejtë dhe**

**përfaqësuesit e feve të tjera, të cilët kanë meritë të vazhdueshme në dituritë dhe doracakët arabë”.**<sup>159</sup>

Një mendim të tillë, respektivisht jo fort të diferencuar në periudhën e tij paramyslimane, e kishte edhe Rozhe Garodi, kur kulturën islame herë e cilësonte si **islame** e herë si **arabe**.<sup>160</sup>

Umer Ferruh i kushton rëndësi emërtimit të filozofisë e kulturës dhe i trajton opsionet ‘arabe’, ‘islame’ *për e kundër* dhe megjithatë përcaktohet për arabe, pa ndonjë arsye të qartë për përcaktimin e tij. Mbase edhe tek ai ka mbizotëruar aspekti nacional.<sup>161</sup>

## **2. Kultura dhe qytetërimi arabo-islam**

Shkencëtarët të cilët mendojnë se kultura dhe qytetërimi duhet të quhen **arabo-islam**, mendimin e tyre e mbështesin në faktin se kjo filozofi është islame, por e shprehur dhe e shkruar në gjuhën arabe dhe për këtë arsye përcaktimin e tyre **kultura dhe qytetërimi arabo-islam** e kanë

■

<sup>159</sup> Sipas: A. F. El-Ehwani, *op. cit.*, fq. 18-19. Është interesant edhe mendimi i orientalistit të frytshëm kroat Daniel Bučan, që shquhet me disa vepra dhe përkthime islamologjike, i cili përdor shprehjen arabljan dhe arab. Me shprehjen arabljan nënkupton entitetin, arabët, të cilët kanë jetuar në fazën paraislamike dhe në fazën e hershme të Islamit, kurse entiteti arab është më i vonshëm dhe përcakton të gjithë banorët e halifatit, pa marrë parasysh prejardhjen etnike, ata të cilët e kanë pranuar Islamin dhe në vend të gjuhës së të parëve të tyre kanë përvetësuar gjuhën arabe. Sipas: Daniel Bučan, *Poimanje arabizma*, Zagreb, 1980, fq. 167.

<sup>160</sup> Roze Garodi, *Islam, kultura i socijalizam*, Sarajevë, 1981, fq. 53.

<sup>161</sup> Shih: Umer Ferruh, *Tarih’ul-fikr’il-arabijji ila ejjami Ibni Haldun*, Bejrut, botimi IV, 1983, fq. 26-27.

parë si kompromis.<sup>162</sup> Shpeshherë dijetarët arabë nuk janë udhëhequr vetëm nga arsyt shkencore, por më tepër janë udhëhequr nga nacionalizmi arab, i cili gjatë shekullit XIX dhe XX, duke kopjuar format europiane, ka dashur të vendoste njëfarë baraspeshe ndërmjet Islamit dhe shekullarizmit europaerëndimor. Ky përcaktim disi u ka ardhur për mbarë edhe shumë europianëve, të cilët natyrën absorbuese dhe integruese islame e kanë shikuar nën hijen e komponenteve arabe dhe islame, e jo pastër islame.<sup>163</sup>

### 3. Kultura dhe qytetërimi islam

Pika takuese e të gjitha krijimeve në kulturën dhe qytetërimin e krijuar të myslimanët është Islami. Islami shpjegoi problemet e botës, të së drejtës, raporteve shoqërore, rolin e Zotit në ekzistencë dhe të njeriut në shoqëri, sipas koncepteve dhe vizioneve të veta. Kultura dhe qytetërimi islam u krijua në botën myslimane e në mesin e myslimanëve dhe tërë kjo kulturë dhe qytetërim parimet, frymëzimin dhe çështjet e tjera i ka orientuar dhe kufizuar brenda burimeve të shpalljes islame.<sup>164</sup> Vetë jeta e filozofëve dhe vepra e tyre në tërësi tregojnë se ata nuk kanë vepruar për arabizma e të tjera, por për Islamin.

Është me interes të theksohet mendimi, përkatësisht reagimi i ashpër i dijetarës egjiptiane Aisha Abdurrahman (e njohur me nofkën Bint'ush-shat) ndaj Rozhe Garodit (para pranimit të Islamit, më 1969), që e cekëm më lart, e

■

<sup>162</sup> Salih H. Alić, *op. cit.*, fq. 122.

<sup>163</sup> Daniel Bučan trajton gjerë e gjatë shprehjen arabizëm, ai klasik dhe modern, themelet e konsekuencat e tyre dhe personalisht parapëlqen sintagmën kultura arabo-islame. Gjerësisht: Daniel Bučan, *Poimanje arabizma*, Zagreb, 1980.

<sup>164</sup> Sayyid Husejn Nasr, *The History of Islamic Philosophy*, *op. cit.*, fq. 1165.



cila e kundërshtoi atë, duke pohuar se kultura islame “është islame dhe se historia nuk e njih ndryshe. Vetë arabët nuk filluan ta sendërtojnë rolin e tyre në histori para shfaqjes dhe ardhjes së islamit. Flamuri i tij ishte ai i cili i mbuloi të gjithë popujt e shtetit islam ...”.<sup>165</sup> Edhe Mustafa Abdurrazik, filozof modern mysliman, rreth emërimit të filozofisë islame, pra edhe kulturës e qytetërimit islam thotë se “filozofinë për të cilën është fjala e quajmë pikërisht ashtu si e kanë quajtur përfaqësuesit e saj: *filozofi islame*, në kuptimin se është krijuar në hapësirat ku është përhapur Islami, në hijen e shtetit të tij, duke mos e marrë parasysh, gjatë tërë kësaj, fenë dhe gjuhën e përfaqësuesve të saj”<sup>166</sup>, apo si e shpreh këtë filozofi boshnjak N. Smailagić “me përcaktimin ‘felsefe’ kuptohet filozofia islame e krijuar nën ndikimin grek dhe duke e kundërshtuar atë.”<sup>167</sup> Po ashtu, është e qartë se Islami është jo vetëm religjion por edhe nocion kulturor, në të vërtetë

■

<sup>165</sup> Roze Garodi, *Islam, kultura i socijalizam*, Sarajevë, 1981, fq. 53.

<sup>166</sup> Mustafa Abdurrazik, *Temhid li't-tarihi'l-felsefet'il-islamijjeh*, sipas: Ahmed F. El-Ehwani, op. cit., fq. 18. Filozofi i madh mysliman, Ibrahim Madkur, përkrah opsionin që filozofia të myslimanët të quhet islame. Shih: *Fi'l-fikr'il-islamij*, botimi I, Egjipt, 1984. I këtij mendimi është edhe shejhu i El-Ez`herit, Abdulhalim Mahmud, *Et-Tefkir'ul-felsefij fi'l-islam*, botimi II, Kairo, 1989, fq. 8-10; Abdurrahman El-Bedevij, *Eflatun fi'l-islam*, botimi III, Bejrut, 1982/1402 h., fq. V-VI. Rreth opsioneve si të quhet kultura dhe qytetërimi i krijuar ndër myslimanët shih: Hana El-Fahuri - Halil El-Xherr, *Tarih'ul-felsefet'il-arabijjeti*, pjesa I, botimi III, Bejrut, 1993, fq. 125-139.

<sup>167</sup> Nerkez Smailagić, *Leksikon islama*, Sarajevë, 1990, fq. 191.



tërë kultura, e cila u krijua në nënqiellin dhe hapësirën e qytetërimeve të vjetra, para së gjithash të helenizmit, zo-roastrizmit dhe të tjerave dhe se komponentet kulturore të kësaj janë të shumta.

Edhe orientalisti i njohur dhe për lexuesin shqiptar, Henry Corbin, mendon se emërtimi 'filozofia arabe' është **"përcaktim linguistik"** i cili **"nuk është i përshtatshëm e as adekuat"**<sup>168</sup>, dhe mendon se emërtimi **filozofia islame** është i vetmi i drejtë.

Teza se kultura dhe qytetërimi të myslimanët duhet të quhet **arabe** kundërshtohet në *pikëpamjen gjuhësore*, sepse shumë vepra janë shkruar edhe në gjuhë të tjera, sikurse në persishte e turqishte, e sidomos shekujve të fundit, kur për Islamin nga pikëpamje të ndryshme shkruhet në gjuhë të shumta, e në miniaturë edhe në gjuhën shqipe. Lidhur me këtë profesori i Universitetit të Teheranit, Muini, konsideron se nëse kulturën dhe qytetërimin islam do ta quanim **'arabe'** atëherë do t'i përjashtonim iranianët, pakistanezët, afganët dhe hindusët.<sup>169</sup>

I këtij mendimi është edhe filozofi i njohur islam, Ibrahim Madkur, i cili mendon se 'kjo filozofi po të quhej arabe do të ishte vepër e një kombi dhe një populli... Islami nuk është vetëm besim; ai është edhe kulturë. ... Filozofia islame përfshin të gjitha ato studime filozofike që janë shkruar në fushë të Islamit qofshin nga pena e myslimanit, kristianit dhe hebraikut.'<sup>170</sup>

Teza se kultura dhe qytetërimi duhet të quhet **'arab'** nuk qëndron as në *pikëpamjen nacionale*, sepse përfaqësuesit kryesorë, me përjashtime të vogla, janë persianë, turq,

■

<sup>168</sup> Henry Corbin, *Historia e filozofisë islame*, I-II, Shkup, 1997, fq. 5 dhe fq. 5-9.

<sup>169</sup> Sipas: A. F. El-Ehwani, *op. cit.*, fq. 20-21.

<sup>170</sup> Sipas: A. F. El-Ehwani, *op. cit.*, fq. 23.

berberë, pakistanezë e të tjerë, e shekujve të fundit edhe popujt tjerë.<sup>171</sup>

Disa autorë kanë dilema rreth emërimit 'islam' apo 'arab' dhe këtë mëdyshje të tyre e arsyetojnë me çështjen që, nëse "islamin e kuptojmë ekskluzivisht si fe, atëherë edhe ky emërtim do të ishte mjaft i diskutueshëm, sepse filozofia, për të cilën këtu mendohet, është zhvilluar shpesh jo vetëm paralel por në shumë raste edhe në konflikt të rreptë me mësimin ortodoks të islamit, dhe si e tillë ka qenë nën kritikën e rreptë të teologëve islamë dhe mbrojtësve të teologjisë islame."<sup>172</sup> Mirëpo këto dilema janë të paqëndrueshme, sepse sikur pohon edhe Samiu në disa raste, Islami është besim dhe veprim, mendim dhe veprim, trup dhe shpirt, rrugë e jetës në këtë botë dhe në botën tjetër, Islami është përpjekje për rregullimin e botës me ndihmën e edukimit dhe ligjit, të dorëzimit në rrjedhat e ligjësive të Krijuesit. Me fjalë të tjera, Islami nuk është vetëm fe në kuptimin e ngushtë, por ai është edhe nocion kulturor, kultura e tërë.

Mendimtari indus, Tara Shand, thotë: "Emërtimi 'filozofia arabe' ka herë është jo i plotë, para së gjithash për shkak se njerëzit që janë marrë me këtë filozofi nuk kanë qenë të gjithë arabë .... Sa u përket kristianëve dhe hebraikëve, të cilët kanë qenë nën ndikimin e islamit – ata du-

■

<sup>171</sup> Salih H. Alić, *Arapsko-islamska filozofija, definicija i značaj u istoriji*, në: *Prilozi za Orijentalnu filologiju*, (Simpozium mbi kulturën arabo-islame prej 18-19. 05. 1973 në Sarajevë), Sarajevë, 1976, fq. 121. Madje, orientalisti F. Hiti, literaturën e shkruar në arabishte e quan letërsia islame ose literatura islame për dallim prej literaturës arabe etj. Filip Hiti, *Povijest arapa*, botimi II fototip, Sarajevë, 1988, fq. 25 dhe 35.

<sup>172</sup> Salih H. Alić, *op. cit.*, fq. 111-112.

het klasifikuar në korpusin e filozofisë islame.”<sup>173</sup> Shembull për këtë merret filozofi hebraik, Henri Bergson (1859-1941) i cili përndryshe klasifikohet në periudhën bashkëkohore brenda historisë së filozofisë kristiane në Evropë.

Me shtrirjen e Islamit jashtë Arabisë, në Siri, Mesopotami, Persi, Egjipt dhe Afrikën veriore, procesi i zhvillimit të kulturës dhe qytetërimit islam që zhvilluar edhe në truallin helenist, edhe me mjetet heleniste, edhe në format heleniste, me ndikim oriental, atë persian, por me shenjë e vet dalluese, **tewhidin** (monoteizmin), dhe nga e tërë kjo **Islami** lindi si tërësi e mbyllur, e veçantë, specifike, që dallon nga helenizmi parakuranor dhe nga kulturat e qytetërimet tjera, por i gatshëm për bashkëpunim. Islami si nocion i gjerë kulturor, e jo vetëm i ngushtë religjioz, si motivues i filozofëve që të punojnë për dobinë e tij, jep të drejtë që kultura dhe qytetërimi të quhet islam.<sup>174</sup> Filozofi A. F. El-Ehwani mendon se shprehja ‘filozofi islame’ i absorbon të gjitha kuptimet e lartshënuara, e nëse kësaj filozofie ia shtojmë edhe filozofët kristianë e hebraikë, atëherë do të detyroheshim ta quajmë “filozofia në Islam”, sikur këtë e bëri edhe T. J. De Boer.<sup>175</sup>

Samiu arsyen për emërtimin ‘islam’ për kulturën dhe qytetërimin të myslimanët nuk e sheh “në faktin se gjendet vetëm te popujt islamë, por pikërisht për shkak se është fryt i Fesë islame, (dhe se qytetërimi, NI) nuk mund

<sup>173</sup> A. F. El-Ehwani, *op. cit.*, fq. 22.

<sup>174</sup> Kultura dhe qytetërimi islam ka ekuivalentin e saj në kulturën dhe qytetërimin mesjetar kristian në Evropë. Sipas: Salih H. Alić, *op. cit.*, fq. 112, shën. 3 dhe 4.

<sup>175</sup> T. J. De Boer, *Tarih’ul-felsefeti fi’l-islam*, apo anglisht: *The History of Philosophy in Islam*, Translated by Edward R. Jones, B. D. © Islamic Philosophy Online, INC.(s.a.), sipas: A. F. El-Ehwani, *op. cit.*, fq. 21-22.



të quhet me emër tjetër përveçse kështu.”<sup>176</sup> Samiu me modestinë më të madhe prej besimtarit nuk orvatet që meritat t’i gjejë tjetërkund, por me këmbëngulje saktëson se “Qytetërimi islam është fryt dhe prodhim pikërisht i fesë islame, sepse ky qytetërim është paraqitur bashkë me paraqitjen e Fesë islame; ngado që ka arritur Feja islame, ka arritur edhe ai qytetërim; cilido popull të ketë pranuar fenë islame, në gjirin e tij do të jetë futur edhe ai qytetërim. Ai qytetërim është rezultat dhe prodhim i Fesë islame, sepse shumë ajete urdhëruese të Kur’anit dhe shumë hadithe të Pejgamberit a.s. janë mbështetje dhe argument i tij. Ai qytetërim është prodhim i Fesë islame, sepse shembujt e parë të atij qytetërimi popullit islam i janë treguar personalisht nga ana e Pejgamberit a.s. dhe ashabëve të tij të respektuar; ...”<sup>177</sup>

Mund të përfundohet se emërtimi **“kultura dhe qytetërimi islam”** është më i ploti, më i drejti, më universal. Çdo emërtim tjetër, në një formë apo në një tjetër, do të çonte në interesa të ngushta nacionale, provinciale apo ideologjike. Edhe ata kulturologë, filozofë, shkencëtarë që krijuan në emër të Islamit, edhe ata që krijuan kundër Islamit, pikë qendrore patën Islamin dhe Kur’anin. Kur’ani ishte ai që nxitë, që kërkoi, që inicioi të krijohet kjo ndërtesë e madhe e quajtur **I s l a m**.

## VI. Në vend të përmbylljes

*(Perspektiva e studimeve të jetës, veprave dhe mendimit të Sami Frashërit)*

■

<sup>176</sup> Sami Frashëri, *Vepra 10*, op. cit., fq. 35-36.

<sup>177</sup> Sami Frashëri, *Vepra 10*, op. cit., fq. 37.



Ky vështrim i shkurtër mbi disa pikëpamje islamologjike të Sami Frashërit, i përcjellë edhe me përsiatjet e autorëve kompetentë dhe me refleksionet tona, ashtu si i kemi parë ne, shpresojmë të bëhet një nga nismat e mbara për studimin e jetës dhe veprës së eruditit dhe dijetarit me famë, Sami Frashëri, që ka trajtuar tema kulturore-shkencore të ndryshme, me një thellësi, akribi, largpamësi dhe shkencëri të rrallë për kohën e tij dhe në tërë multidimensionalitetin dhe kompleksivitetin e vet.<sup>178</sup>

Hulumtuesit e Samiut nuk duhet të kursejnë as përpjekjet as kohën, sepse Samiu e meriton këtë angazhim të tyre, sepse Samiut ia kemi borxh këtë angazhim, sepse kështu ndërtojmë të ardhmen tonë, sepse **“prapambetja kulturore-qytetëruese ... zë fill në vlerësimin jokritik të historisë së vet, sepse disa protagonistë të kësaj historie, bartës të mendimit shkencor, mbase edhe pavetëdijsëm janë bërë pengesë ndaj traditës vetjake, duke punuar në dëm të historisë së tyre.”**<sup>179</sup>

Do ta përfundojmë këtë punim me konstatimin e autorit të madh mysliman, Muhammed Asad alias Leopold Weis, i cili me një rast tha: **“Na pëlqen apo jo, deri te ndryshimet do të vijë.”**<sup>180</sup> Ndryshimet tashmë kanë filluar. Organizatori i këtij tubimi me këtë konferencë shkencore praktikisht hapi rrugën për ndryshime ndaj jetës dhe veprës së Samiut, por edhe të shumë autorëve të tjerë, të cilët për shkak të pseudoideologjive dhe kuaziideologjive mbetën një kohë të gjatë në harresë.

■

<sup>178</sup> Për burimet e veprës së Samiut shih: Hasan Kaleshi, *Vepra - I*, Shkup, 1996, fq. 139-172.

<sup>179</sup> Lexo: Muhammed Umhazun, *Koncept izučavanja islamske historije*, Sarajevë, 2000, fq. 7-8.

<sup>180</sup> Sipas: Murad Wilfried Hofmann, *Islam u trećem Mileniju*, Sarajevë, 2004/1425 h., fq. 175.

## **Aspects of Sami Frasheri's contribution to Islamology - Periodization, originality, and the denomination of the Islamic Culture and civilization -**

We would not be wrong if we qualify Sami Frasheri as a scholar, philologist, lexicographer, literary man, Islamologist, historian, political scientist, on the base of his written work, and the scientific, intellectual, and political activity. Sami is a symbol of a Turkish-Albanian cultural symbiosis on the bed of the Islamic civilization. It is not sustainable to consider **Medenijeti islamijeti** and **Himmet'ul-himam fi neshr'il-islam** as the only Islamistic works by Sami. The Islamic spirit and inspiration are present in many other writings of Sami, as well as in a number of his papers published in journals and newspapers. The attentive reading of the items in the master-work by this author, the historical and geographical encyclopedia **Kamus al-A'lam**, gives us full evidence about Sami as an Islamologist. The same element is evident in other books, like *The Sky, The Man, The Man once again, The Earth, Women*, not excluding the definitions in his various dictionaries. The silence about this aspect of Sami Frasheri's thinking is a reflection of the general anti-religious and in particular anti-Islamic climate.

There is a number of interesting ideas expressed by Sami on three groups of questions: 1) Was there any world culture and civilization before the Greek culture and civilization? 2) Were the Muslims mere descriptivists, interpreters, and transmitters of the Greek culture and civilization to the Muslim peoples, and later on to Europe? 3) How would be denominated the whole inheritance created and still in creation around the world among

Muslims: Islamic, Arab, or Arab-Islamic culture and civilization?

Sami Frasheri didn't agree with the European stand that culture and civilization begin with the Greeks. He stated that civilizations appeared around the world from the earliest times. On the base of historical, cultural, philosophical, sociological, linguistic, anthropological, and other proofs he demonstrates that after the fall of the Greek civilization until the European Renaissance there was not a vacuum period, without any civilization. Such an opinion is the result of the denial of the history of the other Asian peoples. The European civilization directly inherited the Islamic civilization; it was not a continuation of the Greek civilization. After the spread of the Hellenistic culture among the Arab peoples, many other learned men appeared, and furthered the knowledge in many fields.

Concerning the denomination, Sami was in favor of the term Islamic culture and civilization, because these developments started together with the establishment of Islam.





*Prof. Dr. Gazmend Shpuza\**  
(*Shqipëri*)

**SAMI FRASHËRI**  
**MIDIS SHQIPTARIZMIT DHE TURKIZMIT**

---

Shemsedin Sami Frashëri, sipas historiografisë turke, ishte një prej pionierëve të nacionalizmit turk, një nga themeluesit e, madje, dhe një nga udhëheqësit e "nacionalizmit kulturor turk". Ndërsa, sipas historiografisë shqiptare ai ishte një nga drejtuesit kryesor të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në rrafsh kulturor, ideor dhe politik qysh në fillimet e çerekut të fundit të shekullit XIX.

Kur përdorim termat nacionalizëm shqiptar dhe nacionalizëm turk nuk kemi pse të trembemi dhe t'u veshim ngarkesa negative që priren drejt barazimit të tyre me termin shovinizëm. Fjala është për lëvizje që i shërbenin fuqimisht në kohën e vet emancipimit dhe evropianizimit të Ballkanit.

Për të zgjidhur kundërshtinë e lindur nga këto vlerësime për mendimin tonë në dukje kontradiktore, studiuesit turq kanë nisur diskutimin mbi "identitetin e vërtetë" të Samiut në rrafsh kombëtar. Madje, si rrugë për ta kapërcyer atë po paraqitet teza për ekzistencën e një identiteti të dyfishtë të tij. Arsyeja e lindjes së kësaj kundërshtie ndonjëri e sheh në mitologjizimin e figurës së tij nga his-

■

\* "Instituti i historisë" - Tiranë.

toriografia nacionaliste turke dhe nga historiografia socialiste shqiptare.

Për të shpjeguar këtë kontradiktë, duhet të merren parasysh disa momente të jetës dhe të veprimtarisë së Samiut. Në këtë rast duhet të sillen në vëmendjen e studiuesve, në mënyrë të veçantë, shkallët e ndryshme të zhvillimit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe të lëvizjes panturkiste, kur Samiu u angazhua dhe u integrua në to dhe, madje u vu në krye të tyre. Për këtë duhet pasur parasysh, në radhë të parë, që në kohën kur Samiu angazhohet intensivisht në veprimtarinë publicistike dhe letrare, kombi shqiptar ishte formuar dhe kristalizuar dhe kishte hyrë në rrugën e konsolidimit. Nuk duhen harruar po ashtu në trajtimin e problemit edhe kushtet ndërkombëtare në të cilat u zhvilluan të dyja këto lëvizje dhe sidomos lufta për çlirimin kombëtar të shqiptarëve.

Humanistët shqiptarë, duke filluar me Skënderbeun, qenë të vetëdijshëm për prejardhjen e lashtë iliro-epirote të popullit të vet. Pasardhësit e tyre qysh në shekullin XVIII kapërcyen pasojat e kriterit mesjetar të identifikimit të kombësisë me fenë, të praktikuar dhe lë përforcuar nga perandoritë dhe kishat ballkanike dhe të institucionalizuar më pas nga Perandoria Osmane me sistemin e mileteve. Të parët tanë, duke u ngritur mbi besimet fetare, paraqiten të njësuar me etnonimin e përbashkët shqiptar.

Ndërsa turqit, me gjithë vetëdijen e hershme etnike të të parëve të tyre të shpallur që në shekullin VII, vijonin ta identifikonin veten deri në çerekun e parë të shek. XX sipas kriterëve fetare dhe dinastike: islamë apo osmanë. Deri vonë, siç pranojnë dhe autorë të sotëm turq, nuk mund të mohohet që turkizmi që shkrirë e kishte humbur brenda islamizmit. Për të dalë nga kjo guaskë atij iu deshën afro gjashtëqind vjet. Përkundrejt politikës së osmanizmit, intelektualë të rrallë si Ahmet Vefik, Ali Basiretçi e ndonjë

tjetër, në vitet '60-'70 të shek. XIX, nisin të vetëdijësohen për prejardhjen e tyre të veçantë etnike. Sipas Ali Suaviut, osmanët i përkisnin etnisë turke sikurse uzbekët, oguzët dhe turkmenët dhe gjuha e tyre nuk ishte osmanishtja.

Pikërisht në këtë kohë, kur turkizmi kishte nisur periudhën "e lehonërisë" së stërzgjatur, Shemsetin Samiu fillon të kontribuojë për konsolidimin e kësaj rryme në mendimin politik-shoqëror të Perandorisë Osmane.

Porse, ndërsa lëvizja nacionaliste e turkizmit po bënte hapat e parë, Lëvizja Kombëtare Shqiptare nën udhëheqjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit kishte filluar luftën për vënien në jetë të programit të vet. Nga ana politike, ideologjike dhe diplomatike këto kërkesa u argumentuan para opinionit publik evropian me veprën e Pashko Vasës "E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët". Është po ky autor, i njohur si Vaso Pasha, i cili me vjershën "Mori Shqypni" shpall manifestin letrar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Ndërsa turkizmit letrar do t'i duhen dhe 20 vjet të tjera për të shpalosur me poezitë e Mehmet Eminut kredon e tij poetike kombëtare. Kurse turkizmit politik do t'i nevojiten gjithashtu 25 vjet për të nisur rrugën e vet me veprën e Jusuf Akçurës. Sipas tij, një politikë kombëtare turke e mbështetur në etninë, ishte rruga e vetme që duhej të ndiqnin turqit brenda Perandorisë. Me këto pikëpamje ai iu kundërvu panislamizmit të shpallur dhe të ndjekur nga Abdylhamidi i Dytë. Porse kristalizimi i këtyre pikëpamjeve në një platformë të plotë dhe të qartë ideore dhe politike si dhe lufta për ta vënë në jetë atë do të realizohet afro gjysëm shekulli më vonë nën udhëheqjen e Mustafa Qemal Atatürkut.

Pra, Sami Frashëri, në ato vite, ishte angazhuar, tërësisht në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe, madje, që vënë në udhëheqje të saj si anëtar i Komitetit të Stambollit dhe



Kryetar i Shoqërisë së Shkronjave. Në kohën kur udhëheqja revolucionare e Lidhjes së Prizrenit krijon qeverinë e vet të përkohshme, Samiu shpreh besimin se ajo ishte afër realizimit të programit strategjik të Rilindjes dhe shpreson, siç i shkruante ai De Radës, më 1881, se shqiptarët, në varësi të rrethanave, mund të shpallnin dhe pavarësinë.

Siç shihet, identiteti kombëtar i Sami Frashërit ishte formuar e kristalizuar plotësisht dhe që shprehur qartë qysh në fund të viteve '70 të shek. XIX. Ai nuk linte shteg për asnjë ekuivok përse i takonte formimit dhe angazhimit të tij në rrafsh kombëtar shqiptar, me gjithë angazhimin e tij i.ë spikatur në gazetarinë dhe letërsinë turke të kohës.

Ndërsa shqiptarizmi, siç dihet, kishte bërë në të gjitha rrafshet hapat madhorë përpara, turkizmi vijonte përpjekjet për t'u afirmuar në fushën kulturore. Fushë e rëndësishme për përveçimin e turqve nga ana etnike, jashtë kritereve fetare dhe dinastike, osmane dhe islamike, përveç botimeve historike, u bë, sidomos, gjuhësia.

Fjalori i Samiut me vetë titullin "Kamus-i Turki", të përdorur për herë të parë në gjuhësinë turke, dhe, sidomos, me argumentet e parashtruara në hyrjen e tij për turqishten mund të quhet manifesti i turkizmit shkencor dhe kulturor.

Pra, në fund të shek. XIX turkizmi manifestohet në shkencë me veprën leksikografike të Shemsedin Samiut dhe në poezi me vargjet e Mehmed Eminut. Ndërsa shqiptarizmi ideologjikisht dhe politikisht do të manifestohet, 20 vjet pas Lidhjes së Prizrenit, në një shkallë më të lartë me veprën e Samiut "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhetë?" në mbështetje të Lidhjes Shqiptare të Pejës.

Në një shkallë të tillë të ulët të shkëputjes së inteligjencës turke nga ideologjia zyrtare perandorake qoftë dinastike osmane qoftë fetare islamike e, madje, panislamike, Samiu i angazhuar gjerësisht në lëvizjen kulturore e mendore të kohës në shkallë perandorake nuk mbajti një qën-



drim të ftohtë thjesht prej shkencëtari turkolog. Ai, nënsh tetas osman, kishte krijuar bindjen se zhvillimi i lëvizjes kombëtare midis popujve joturq të Perandorisë dhe i lëvizjes nacionaliste në vetë gjirin e popullit turk do të zgjeronte frontin antiperandorak osman dhe do të lehtësonte dhe zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare. Prandaj në veprat e Shemsedin Samiut ne ndeshim jo rrallë shprehje, të cilat janë mbivlerësuar nga autorët turq si shfaqje e besnikërisë së tij ndaj turkizmit. Nga ana tjetër, ato, të marra si qëndrime të rastësishme apo koniunkturore, janë injoruar nga autorët shqiptarë. Këta, me sa duket, iu shmangën përmendjes së këtyre fakteve nga frika se mos njollosej figura atdhetare e apostullit të shqiptarizmit, si turkoman.

Në të vërtetë, Samiu në shumë raste e ka identifikuar veten me turqit, i quan ata në vetë të parë "bashkatdhetarët tanë, të parët tanë". Në një kohë kur intelektualët osmanë që deklaroheshin turq numëroheshin me gishta. Shemsedin Samiu shkruante: "ne nuk jemi as arabë dhe as persë; ne jemi turq të mirëfilltë". Mos të harrojmë që turq në ato vite vijonin të konsideroheshin në mesin e intelektualëve osmanë katundarët e Anadollit dhe të kujtojmë sërishmi që emri turk për ta ende mbartte një ngarkesë përçmuese tepër të rëndë, sa barazohej me kafshën.

Në një kohë kur sulltan Abdylhamidi kërkonte që gjuha zyrtare e Perandorisë të ishte arabishtja, Sami Frashëri shprehej me kurajo, pa farë kompleksi dhe me krenari, se "gjuha jonë kombëtare, gjuha jonë amtare" është gjuha turke, për të cilën ai punoi si pak kush në atë kohë në Turqi.

Përballë fakteve të tilla, kur Samiu vetëdeklarohej jo rrallë herë turk. nuk mund të mbyllësh sytë dhe të heshtësh, siç ka ndodhur, përgjithësisht, deri më tani në mesin e studiuesve shqiptarë.

Interesat kombëtare të popullit shqiptar megjithëse ishin në kundërshtim të hapur me politikën osmane dhe is-

lamiste të sulltanatit dhe të kalifatit, jo vetëm nuk përplasheshin me interesat e mirëfillta kombëtare të turqve, por përkundrazi ata ecnin krah për krah me njëra-tjetrën. Zhvillimi dhe përparimi i Lëvizjes Kombëtare të Shqiptarëve ashtu sikurse dhe i lëvizjeve të popujve të tjerë joturq të perandorisë, afronte dhe përshpejtonte revolucionin kombëtar turk. Nga ana tjetër, emancipimi kombëtar i turqve i kontribuonte çlirimit nacional të shqiptarëve dhe të popujve të tjerë joturq të perandorisë. Në këtë ndërthurje të ngushtë midis këtyre përbërësve aktivë të lëvizjeve përparimtare brenda kësaj perandorie, duhet parë dhe shpjeguar qëndrimi jo vetëm pozitiv por dhe veprues, aktiv i Samiut në të mirë të turkizmit. Në rrugën e bashkëpunimit me lëvizjet përparimtare të popullit turk do të angazhohen më pas dhe veprimtarë të tjerë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, si Dr. Ibrahim Temo, Ismail Qemali, Nexhip Draga e Bajram Curri, Bajo e Çerçiz Topulli, Hasan Prishtina, Tajar Tetova e të tjerë.

Samii Frashëri shqetësohej jo vetëm për fatin e popullit të vct, por edhe për të ardhmen e popullit turk, sepse politika e Fuqive të Mëdha për ruajtjen e statuko-së në Ballkan e kishte dënuar popullin shqiptar që të vijonte të bashkëjetonte nën një çati perandorake me të. Nga ana tjetër. Kriza Lindore e viteve '70 të shek. XIX kishte provuar që të dy popujt tanë i priste një fat i përbashkët tragjik, një gjenocid i pamëshirshëm etnik e fetar dhe rreziku i zhdukjes së tyre si komb. Samiu punoi me intensitet që, siç shprehej ai, kur të shembej godina e kalbur e Perandorisë Osmane mos të merrte me vete dhe popullin shqiptar dhe popujt joturq në përbërje të Perandorisë Osmane. Ajo rrezikonte, siç treguan ngjarjet në fund dhe pas Luftës së Parë Botërore, të zinte nën të edhe vetë popullin turk. Këtë pat shprehur qartë dhe Mustafa Qemali.

Në këto rrethana Samiu u angazhua drejtpërsëdrejti e madje u dallua, pa hequr dorë nga identiteti i tij kombëtar, në lëvizjen për shpалosjen dhe zhvillimin e turkizmit.

Prandaj studiues turq dhe të huaj pranojnë pa mëdyshje dhe me të drejtë që Shemsedin Samiu ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e nacionalizmit turk dhe në historinë e panturkizmit. Porse këtë rol ai e luajti pa hequr dorë nga identiteti i tij kombëtar dhe për më tepër në funksion të çështjes kombëtare shqiptare.

Mund të thuhet se ai dëshmohej më turk se shumica e intelektualëve osmanë të kohës, më turk se turqit. Me këtë qëndrim ai nuk rrëshqiti nga majat e shqiptarizmit në pozitat e panturkizmit. Këto qëndrime nuk i bien ndesh njëri-tjetrit, ato përplotësojnë njëri-tjetrin. Nuk kemi të bëjmë një një dyzim të personalitetit politik të Samiut aq sa të bëhet fjalë për një identitet të dyfishtë të tij në rrafsh kombëtar.

Marrë në tërësinë e vet Shemsedin Sami Frashëri mbetet një atdhetar i madh shqiptar me një përfytyrim të qartë për zgjidhjen e çështjes kombëtare, jo vetëm të popullit të vet. Bashkëjetesa shekullore e popullit shqiptar me popullin turk, interesat e përbashkëta në rrafsh kombëtar, fati tragjik që ravijëzonte në horizont për të dy palët fundi i Perandorisë Osmane diktuan angazhimin e tij aktiv në lëvizjen e turkizmit. Përcaktues në marrjen dhe mbajtjen e këtij qëndrimi qe orientimi demokratik i tij në të gjithë krijimtarinë e vet.

Samiu i vetëdijshtëm për misionin e tij si shkencëtar e sidomos si veprimtar i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare punoi me të gjitha forcat të ndihmonte inteligjencie turke të kohës të vetëquajtur osmane të shkëputej nga konceptet perandorake. Pra, është atdhetarizmi shqiptar dhe humanizmi i Samiut që e shtynë atë të deklarohej pa ngurrim turk në mesin mbizotërues të intelektualëve që



vijonin të konsideroheshin osmanë, për t'i dhënë një shtytje jo të paktë turkizmit. Në këtë kuptim mund të pranohet që ai i përket sa shqiptarizmit po aq dhe turkizmit.

Nisur nga pozita të tilla të përparuara, i zhveshur nga nacionalizmi i ngushtë, duke bërë qartazi dallimin midis ideologjisë shtetërore të Jëllez Qoshkut dhe të Portës së Lartë dhe lëvizjes së re nacionaliste turke. pavarësisht nga kufizimet e saj, Shemsedin Samiu vijon të angazhohet në radhët e para të të dy këtyre fronteve. Në kuadër të këtij qëndrimi, në fund të shekullit XIX, ai boton, njëkohësisht, manifestin e turkizmit kulturor, Fjalorin e gjuhës turke (Kamus-i Turki) dhe manifestin ideologjik të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të kohës, veprën "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet?". Kjo nuk është një rastësi por rrjedhim i koncepteve të qarta të Samiut për zgjidhjen e çështjes nacionale në Turqinë evropiane.

Qëndrimi "separatist" i autorit të veprës "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet?", i papranueshëm prej shumicës së historianëve turq, nga njëra anë, dhe neglizhimi i militimit të Samiut në lëvizjen nacionale turke prej autorëve shqiptarë, nga ana tjetër, nuk kanë lejuar të përfytyrohen në të gjitha përmasat idetë përparimtare, demokratike dhe moderne të Samiut për çështjen nacionale në përgjithësi, jo vetëm në rrafsh shqiptar por shumë më gjerë.

Samiu është një figurë e tillë madhore mitike gjithsesi reale, e cila nuk kishte nevojë të mitologjizohej për t'i shërbyer çështjes kombëtare në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane. Për ta kuptuar këtë dukuri shumërrafshesh në të gjithë ndërthurjen e shfaqjeve të veta, mjafton që ai të vendoset në kuadër të zhvillimeve kulturore dhe sidomos politike të kohës në shkallë kombëtare shqiptare dhe në shkallë perandorake. Futja e studimeve kushtuar Samiut në kallëpet e skemave antropologjike nuk ndihmon për sqarimin e pikëpyetjeve të ligjshme që na dalin



rreth tij. Përkundrazi, me mëtimin për një kundrim kinse modern të kësaj figure, shpjegimi i fenomenit politik dhe kulturor të quajtur Sami Frashëri futet, thënë me një fjalë të huazuar nga turqishtja, në qorrsohak.

### **Sami Frasheri between Albanianism and Turkism**

According to Turkish historiography, Shemsedin Sami Frasheri was one of the pioneers of the Turkish nationalism, one of the founders and even leaders of the “Turkish cultural nationalism”. At the same time, the Albanian historiography considers Sami from the political, ideological, and cultural point of view as one of the principal leaders of the Albanian National Movement in the last quarter of the 19<sup>th</sup> century. It is evident that we are here faced with a contradiction, and the Turkish scholars started a discussion on the “true national identity” of Sami Frasheri. In order to clarify this contradiction a number of moments in the life and the activity of Sami should be taken in account. First of all the successive stages in the development of the Albanian Movement and in the Turkish Movement when Sami engaged in them are to be considered. Precisely at the period of the prolonged post-natal period in the Pan-Turkist movement Sami began his contribution to its consolidation in the socio-political thinking of the Ottoman Empire. The difference was that at the time of the first steps of Turkish nationalist movement, the Albanian national movement lead by Albanian League of Prizren already was struggling for the implementation of its program. Sami not only was engaged in the Albanian Movement, but also was in its leadership, as a member of the Istanbul Committee, and the president of the Society for the publishing of Albanian writing. All

this means that his identity already was crystallized and clearly expressed beginning from the 1870s.

At the end of the 19<sup>th</sup> century Turkism is manifested in science through the Turkish Dictionary by Sami ("Kamus-i Turki"), particularly in the Preface to this book, which could be considered a manifesto of the cultural and scientific Turkism. On the other hand, 20 years after the Prizren League, Sami published his manifesto of the Albanian Renaissance, the book *Albania – What it was, what it is and what will become of it*. It is true that in many occasions Sami identified himself with Turks, called them in first person 'our ancestors, our compatriots'. It is impossible to close eyes to such facts, as it was until now in use among the Albanian scholars. National interests of the Albanians were in deep contradiction with the Islamist policy of the Sultan and Khalifat, but there were no clashes between the national interests of the Turks and the national interests of the Albanians. Sami was concerned with the fate of his people, as well as with the future of the Turkish people. Without abandoning his national identity, Sami directly was involved in the Turkist movement. It was not a kind of the duplication of his political personality leading to a double national identity.

In general, Shemsedin Sami Frasheri remains a great Albanian patriot, with a clear vision of the solution for both Albanians and Turks.

*Prof. Dr. Françesko Altimari\**  
(Itali)

**TAKIMI I VATRAVE TË DIASPORËS,  
PIKËNISJA E RILINDJES SHQIPTARE**

---

Në këtë kontribut do të ndalem në impenjimin e forcave intelektuale arbëreshe, të bashkuara nga përvoja kulturore e kryer në Kalabri më parë në Kolegjin Korsini dhe më pas në atë të Shën Adrianit, që në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit XIX, dhe në Sicili pranë Seminarit greko-arbëresh që prej gjysmës së shekullit XVIII, për krijimin e asaj lëvizjeje të gjerë letrare që mori emrin "Rilindja" dhe që pati në gjirin e arbëreshëve personalitetin pa dyshim më të spikatur, Jeronim de Radën.

Por ky impenjim nuk shfaqet, siç është pohuar nga ndonjë studiues, në frymën e ideologjisë romantike, mbizotëruese në atë kohë, ai lind në kushtet e reja kulturore, mjaft të favorshme, të përcaktuara një shekull më parë, për sa i takon Kalabrisë, me themelimin në Shën Benëdhit të Kolegjit Korsini (1732), në të cilin u formua një radhë intelektualësh, klerikësh dhe laikësh, të vëmendshëm dhe të ndjeshëm në mënyrë të veçantë për rizbulimin e "rrënjëve" të tyre kombëtare (kujtoj këtu, ndër të tjerë: Frangjisk Avati, nga Maqi; Paskal Bafi, Ëngjëll Mashi dhe Frangjisk

■

\* "Universiteti i Palermos", Palermo.



Bulari, nga Shën Sofia; Jul Variboba, nga Mbuzati; Mikel dhe Dhumink Bellushi, nga Frasnita).

Por vetëm rreth fundit të shekullit XVIII, atëherë kur filloi të bëhet e ndjeshme lëvizja e re reformatore dhe iluministe e ndërmarrë nga rrethet intelektuale napoletane, me formim demokrat dhe jakobin, ideja kombëtare fillon të gjejë hapësirë dhe shprehje tek autorët arbëreshë të kësaj periudhe.

Disa vjet më vonë, një tjetër shkrimtar i shquar arbëresh, Ëngjëll Mashi, nxënës i Kolegjit Korsini, në një "pamflet" fatlum, bën një paraqitje të studimeve mbi kombin shqiptar, "një Komb, - siç shkruan ai, - sa i famshëm, aq edhe pak i njohur, një Komb që për shekuj e shekuj nuk ka ndryshuar as karakterin, as edhe zakonet e tij ... i cili jo vetëm zë një territor të paskajshëm, në të cilin është autokton, duke filluar nga Shkodra deri në Artë, por edhe ka të shpërndara nëpër More, Sicili dhe Itali koloni të pafundme." Ndër motivet që paraqet për rivendikimin e të drejtave të njerëzve të tij dhe të një jete kombëtare autonome, të lirë dhe dinjitoze, hedh pikërisht ndër të parët, Mashi, tezën e autoktonisë së shqiptarëve:

"Që gjuha e sotme shqipe të jetë pikërisht ajo që flisnin maqedonasit, ilirët dhe epirotët, kemi plotësisht të drejtë ta besojmë, pavarësisht se ndoshta për shkak të kohës ka pësuar edhe ndryshime, ashtu si edhe greqishtja. Nga Gjiri i Artës deri në Shkodër flitet shqip: ky uniformitet, që duket në vende kaq të largëta mes tyre, përjashton çdo hamendje të ndërrimit të gjuhës..." dhe sërish:

"Nëse kështu maqedonasit, ilirët dhe epirotët flisnin të njëjtën gjuhë, por të ndryshme nga greqishtja; nëse të ngjashëm mes tyre, ndryshonin nga grekët; mundet ende të dyshoni që shqiptarët e sotëm të jenë autoktonë të vendit ku jetojnë dhe që të jenë pasardhësit e atyre kombeve kreshnike dhe të shkëlqyera?"



Edhe për meritë të një fati të jashtëzakonshëm, vepra e Mashit ndeshi në rrethet e intelektualëve italianë dhe të huaj- mes të tjerave, ajo u përkthye edhe në frëngjisht dhe u përfshi e plotë në veprën enciklopedike të gjeografit danez Konrad Maltebrun, e cila pati një përhapje të ndjeshme në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të kaluar- që “çështja shqiptare” do të fillonte të vihej seriozisht nën vëmendjen e opinionit publik evropian.

Edhe në mjedisin arbëresh po rritej në këtë periudhë, me punën e intelektualëve, shumica e të cilëve klerikë të formuar në Kolegjin e Shën Adrianit, vetëdija për të thelluar lidhjet e gjuhës dhe të kulturës me mëmëdheun.

Procesi i rritjes së ndërgjegjes kombëtare, mes shqiptarëve të Kalabrisë, pati një impuls të ri dhe vendimtar kur Kolegji i Shën Adrianit kaloi nën drejtimin e Ispeshkvit-president, Dhumink Bellushi,

d.m.th. në periudhën që shkon nga 1806 deri në 1833. Me Bellushin u krye një shndërrim rrënjësor në drejtimin arsimor të këtij instituti: studimet shkencore dhe klasike mbizotëruan ndaj atyre teologjike, u hapën katedra të reja dhe lëndë të reja, u zgjodh një trup arsimtarësh të kualifikuar, u pasurua fondi i madh i librave të bibliotekës me vepra të reja të natyrës historike, politike dhe letrare.

Të gjitha këto iniciativa të ndërmarra nga Mons. Bellushi çuan në një kthesë të vërtetë rinovuese në formimin kulturor dhe didaktik të nxënësve të rinj dhe patën një ndikim vendimtar në zgjerimin e horizonteve të tyre kulturore, duke i shtyrë drejt një interesi më të madh ndaj traditës shqiptare. Vetë De Rada, në Autobiologjinë, na përshkruan gjerësisht klimën e re kulturore që karakterizonte jetën e Kolegjit italo-arbëresh nën drejtimin e Dhumink Bellushit, kur, pavarësisht nga (Rimëkëmbja konservatore) ose “Restaurazione”, mund të qarkullonin lirisht idetë e reja romantike dhe patriotike, bashkë me veprat

më të rëndësishme të kulturës evropiane të kohës. Në bibliotekën e këtij instituti, në fakt, mundet, ende sot, të gjejmë dëshmi vërtet shumë interesante të këtij impenjimi të Bellushit për idetë e reja të kulturës romantike dhe shenjat e para të zgjimit të kulturës kombëtare shqiptare. Ndër këto, një prej kopjeve të rralla të përkthimit shqip të Dhjatës së Re të Grigor Gjirokastrit, të botuar në ishullin e Korfuzit në 1827.

Prania e këtij vëllimi përbën një provë të padiskutueshme të ekzistencës së formave, edhe pse natyrisht ende episodike, të bashkëpunimit dhe të një qarkullimi veprash dhe idesh mes shqiptarëve të Kalabrisë dhe atyre të mëmëdheut, para se të niste të shfaqej lëvizja e vërtetë dhe e mirëfilltë e “Rilindjes”, frymëzues dhe protagonist i padiskutueshëm i së cilës ishte Jeronim de Rada, poeti i madh nga Maqi, që mbetet figura më e shquar dhe prestigjioze e letërsisë romantike arbëreshe.

De Rada i përket asaj radhe të intelektualëve të rinj arbëreshë që u formua në kontakt të drejtpërdrejtë me kulturën e re romantike evropiane, në Shkollën e Shën Adrianit, nën drejtimin e Mons. Dhumink Bellushit. Veç De Radës, që studioi në këtë Kolegj nga 1822 deri në 1833, kujtojmë ndër të tjerët: Ëngjëll Basile, nga Pllatëni, student i këtij Kolegji, nga 1829 deri 1841; Raffaele Lopez, nga Shën Mitri, që e rigjejmë mes nxënësve të këtij instituti në periudhën që shkon nga 1819 deri në 1831; Luigj Petrassi, nga Qana, që ndenji vetëm dy vjet, nga 1827 deri në 1829 dhe Vinçenc Dorsa, nga Frasnita, student i këtij Kolegji nga 1832 deri në 1839.

Kështu, ishte vendimtar kontributi i dhënë nga De Rada dhe nga intelektualët e tjerë italo-shqiptarë të kohës (Santori dhe Dorsa, në radhë të parë), me impenjimin e tyre civil dhe me veprat e tyre letrare, për krijimin e një lëvizjeje të fortë të opinionit në mbështetje të të drejtave poli-

tike dhe kulturore të kombit shqiptar. Kjo lëvizje, falë rolit stimulues të kryer nga kjo pararojë intelektualësh, mori një impuls të mëtejshëm në vitet '40 të shekullit të kaluar, kur regjistrojmë marrëdhëniet e para të ngushta mes shqiptarëve të Italisë dhe atyre të Rumanisë, d.m.th. mes komuniteteve shqiptare të diasporës, atëherë më të zhvilluara kulturalisht dhe më të impenjuara.

Në tetor të 1845-s, arbëreshi Tommaso Paçe botoi në gazetën "*Athina*" të Athinës, një përmbledhje në greqishten e re të një studimi të De Radës, të paraqitur që në 1840 në revistën napoletane "*Il Lucifero*", me titullin "*Hyjnitë pellazgjike*" (*Divinazioni pelasghe*) të ripunuar dhe të ribotuar në 1844 me titullin, pjesërisht të ndryshuar, "*Identiteti i shqiptarëve me pellazgët*" (*Identitetà degli albanesi con i pelaghi*). Ky artikull i Paçes u përkthye në rumanisht, në vitin e mëpasshëm, në revistën "*Cuvieru Român*" të Bukureshtit nga J. Elide Radulesku.

Në këtë mënyrë, teza e De Radës, por që ishte paraprirë në shekullin e kaluar nga arbëreshi i Sicilisë Nikollë Keta, mbi një origjinë të mundshme pellazgjike të shqiptarëve që u gjet më pas jo e saktë shkencërisht, por që pati, gjithsesi, një peshë të rëndësishme në historinë e kulturës shqiptare, duke qenë se frymëzoi një pjesë të madhe të intelektualëve të "Rilindjes" - u prit menjëherë me interes të madh dhe mbështetje nga intelektualët e komunitetit të gjerë shqiptar të Rumanisë.

Dhe në "Letër Enciklike për të gjithë të pasurit e të mësuarit ortodoksë shqiptarë", të 1846-ës, që përfaqëson manifestin ideologjik të lëvizjes rilindase shqiptare, Naum Veqilharxhi, figurë e rëndësishme e kolonisë shqiptare të Rumanisë, fton bashkëpatriotët e tij "*për të analizuar me vëmendje një studim filologjik, të shkruar dhe botuar nga gazetatat greke, duke qenë se flitet për një vepër që meriton një konsideratë të madhe, për më tepër, sepse iu referohet shqiptarëve*". Që kemi të



bëjmë me sintezën e veprës deradiane, të përkthyer në greqishten e re nga Pace, është provuar, ndër të tjera, nga citimet e drejtpërdrejta që bën vetë Veqilharxhi në letrën dërguar të nipit, Jani Cali, edhe kjo e 1846-ës.

Në këtë mënyrë, edhe pse në mënyrë indirekte, vepra e De Radës kontribuoi në mënyrë efikase për sensibilizimin e inteligjencies shqiptare të Rumanisë dhe para të gjithëve, Naum Veqilharxhit, që sot konsiderohet ideologu i parë i “Rilindjes”, mbi nevojshmërinë e thellimit të problematikës kulturore të lidhur me rekuperimin e identitetit kombëtar. Dhe anasjelltas, vëmendja kushtuar shqiptarëve të Bukureshtit në lëvizjen kulturore që po zhvillohej në kolonitë arbëreshe, e bindi De Radën për të vazhduar veprimtarinë e tij letrare dhe poetike në gjuhën shqipe, të cilën e kishte filluar që disa vjet më parë me botimin e “*Milosao*”-s (1836)- vepra e parë artistike moderne e letërsisë shqiptare- dhe të “*Serafina Topid*”-s (1839).

De Rada i shkruan, në lidhje me këtë, në një letër të hapur “të riut shumë të ngritur, Vinçenc Dorsa », botuar në revistën letrare “*Il Calabrese*”, në 1847:

Kur në vitin e kaluar Tommaso Pace ishte në Athinë, botoi në gazetën “*La Minerva*” disa mendime të tij mbi kombin pellasg, për lëvizjen intelektuale të kolonive të Sicilisë dhe për bukurinë dhe fatet e gjuhës shqipe. Kohët e fundit, ai mori një pako librash shqiptarë, nga Bukureshti në Vllahi dhe një letër të një zotëriu shqiptar, Qiriako Danieli, ku thuhet: “Lajmi se në Itali zhvillohet gjuha jonë na ka bërë të na shpërthejë zemra nga gëzimi, këtu në Shqipëri”. I kërkonte kështu, kopje të të gjitha botimeve tek ne, që t’i dërgoheshin në Brailov. Bëjani të ditur këtë Santorit, në mënyrë që t’i japë një dorë Dramës së tij, dhe ta nxjerrë në dritë...”.

Pasi e rivendosi të njëjtën pjesë tek *Autobiologjia*, i shtoi këto konsiderata:



“Të tilla suksese dhe kjo letër i kthyen përfundimisht mendimet e mia në bindjen që t’ia kushtoja krijimet e mia poetike jetës dhe gjuhës së kombit tim sa fisnik, aq edhe të mjerë ndër të gjithë”.

Në përfundim, takimi i këtyre dy shtigjeve të lëvizjes së “Rilindjes” nuk ishte diçka e rastësishme dhe episodike, por rezultati konvergues i impenjimit të përbashkët të intelektualëve të këtyre qendrave veçanërisht të gjalla, që krijuan - siç është thënë dhe më parë- raporte të bashkëpunimit gjithmonë e më të ngushta dhe më të vlefshme, që stimuluan një qarkullim të mirëkuptuar të veprave dhe ideve dhe pasuruan përvojat përkatëse kulturore. Dhe ishte pikërisht nga takimi i këtyre dy realiteteve domethënëse kulturore të kombit shqiptar, atij të Bukureshtit dhe të arbëreshëve- që i dha hov lëvizjes së “Rilindjes” së vërtetë, që përfshiu në gjysmën e dytë të shekullit të gjitha grupet e intelektualëve shqiptarë, si të diasporës, ashtu edhe të mëmëdheut dhe që pati si protagonistë, krahas arbëreshëve, intelektualë si: vëllezërit Sami, Abdyl dhe Naim Frashëri, Jani Vreto, Pashko Vasa, Kostandin Kristoforidhi, Hasan Tahsini dhe shumë të tjerë, që në pjesën më të madhe i referohen, si për formimin kulturor dhe për veprimtarinë publicistike dhe letrare, kolonisë shqiptare të Stambollit.

### **Meeting of Albanian Diaspora centers as the originating point of the Albanian Renaissance**

The paper speaks about the engagement of the Arberesh intellectual forces united by their cultural experience in Calabria first at the Corsini College, and later at Saint Adrian College during the last decades of the 19th century, as well as in Sicily at Arberesh Seminary beginning

from the second half of the 18<sup>th</sup> century. In this long way the broad literary movement called Renaissance was born, which as the most distinguished representative among the Italo-Albanians had Jeronim De Rada.

A decisive contribution was given by De Rada and the other Italo-Albanian intellectuals, including first of all A. Santori and V. Dorsa, through their civil engagement and the literary works in establishing a strong opinion in support of the political and cultural rights of the Albanian nation. A new impetus was given to this movement in 1840s, when the first close relations between Albanians in Italy and their brothers in Rumania were established. The conclusion is that the meeting of these two currents of Albanian Renaissance was not something accidental; on the contrary, it was the converging result of the common engagement of the intellectuals from these live centers, creating more and closer relations and co-operation, stimulating a welcomed circulation of the works and ideas, which enriched the respective cultural experiences. Precisely the meeting of these significant cultural realities, in Italy and in Rumania, was the incentive for the true Albanian Renaissance developing during the second half of the 19<sup>th</sup> century including all the groupings of the Albanian intellectuals, in Diaspora and in the homeland, with other protagonists like Frasheri brothers – Abdyl, Naim and Sami, Jani Vreto, Pashko Vasa, Konstantin Kristoforidhi, Hasan Tahsini, and many others, a large part of them very active in Albanian colony of Istanbul

**Prof. Dr. Mustafa S. Kaçalın\***

(Turqi)

### **FJALËT E URTA**

---

Shemseddin Samiu [1850-1904] është një shkencëtar i shumanshëm osman. Shumica atë e njohin përmes veprës së tij *Kamus al-A'lam* [=Oqeani i emrave të përveçëm]. Emrin Attila (453) si një term për herë të parë e hasim te kjo vepër e tij. Një kohë, fjalori i tij turqisht-turqisht *Kamus-i Türki* [=Oqeani i turqishtes] ishte një burim referimi shumë i përdorur. Për shkak të këtij përdorimi të madh e të gjatë në kujtesën e shumëkujt është shënuar si fjalori i parë turqisht-turqisht. Para këtij fjalori ka qenë vepra e Shejhulislam Mehmed Esat Efendiut [1685-1753] *Lehce-tü'l-Lugat* [=Gjuha e fjalëve] me 3722 kryelëndë dhe versioni i shkurtuar i saj i bërë nga Mehmed Rifati [1851-1907] *Mir'atü'l-Lugat* [=Pasqyra e fjalëve] si dhe vepra e Ahmed Vefik Pashës [1818-1890] *Lehce-i Osmani* [=Dialekti osman]. Edhe vepra *Kamus-i Türki* ka karakteristikat e veta të veçanta. Në këtë vepër dallohen zanoret o - ö dhe u - ü. Emrin 'turk' e ka përdorur në titullin e veprës. Përderisa për ata që merren me studime në gjuhën arabe kur të përmendet fjala *Kamus* nënkuptohet vepra e Firuzabadit [1329-1413] *al-Ukjanusu'l-Basit fi Terxhemeti'l-Kamusi'l-Mubit*, së këndejmi për ata që merren me studime në

■

\* "Universiteti i Marmarasë", Stamboll.



gjuhën turke kur të përmendet fjala *Kamus* nënkuptohet vepra *Kamus-i Türki* e Sh. Samit.

Autori shumëdimensional është interesuar edhe për këshillat dhe proverbat. Shembull për këtë është vepra e tij *Emsal* [=Fjalë të urta]. Vepra për herë të parë është botuar pjesë-pjesë në gazetën *Sabab*<sup>181</sup> të cilën ai e ka botuar në vitet 1876-1877, në pjesën “şundan bundan”. Përbërjen e kësaj vepre e mësojmë nga lapsi i vetë autorit: “Vepra *Emsal* mund të ndahet në tri pjesë. Një pjesë e tyre janë përkthime të fjalëve dhe mendimeve të dijetarëve e letrarëve lindorë e perëndimorë, ku në një pjesë prej tyre edhe janë përmendur emrat e autorëve të tyre, në pjesë tjetër ndërkaq janë përshtatur me karakterin tonë kombëtar; në pjesën e tretë zënë vend idetë e mia origjinale, të cilat e përbëjnë gati gjysmën e përmbledhjes”.

Titulli që bart kjo vepër është: Ş[emseddin] SAMI [1850-1904]: *Emsal*: Istanbul 1297 [=1879], f. 511, Mihran Kitaphanesi. (Mihran) Matbaası Babiali Caddesi numro 28. İfade-i meramin tarihi: 1296 Şaban 8 [=28 qershor 1879]. Vepra përbëhet prej 4 vëllimeve. Vëllimi I: f. 1-128, Vëllimi II: f. 129-256, Vëllimi III: f. 257-384 dhe Vëllimi IV: f. 385-511. Përmban 2919 lëndë.

Kjo vepër është përkthyer në gjuhën shqipe në vitin 1975 nga Zyber Hasan BAKIU, së fundi është shtypur si libri i dhjetë i përmbledhjes së Shemseddin Samiut të botuar nga Shtëpia Botuese Logos-A në kryeqytetin e Maqedonisë, në Shkup në vitin 2004.<sup>182</sup>

■

<sup>181</sup> Nr. 1 i saj ka dalë më 12 Safer 1293 e enjte [=9 mars 1876]. Pas nr. 256 që ka dalë më 17 Dhul-hixhxe 1293 e mërkurë [3 janar 1877] Sh. Samiu largohet nga gazeta.

<sup>182</sup> Sami FRASHËRI: *Fjalë të Urta: me parathënien e Gazmend Mukës*, f. 212.



Vepra *Emsal* e autorit shumëdimensional, që është një përmbledhje e fjalive të bukura të zgjedhura nga libra të ndryshëm, kur të analizohet nga aspekti i opinionit publik do të shihet se në të gjenden 279 fjalë popullore (proverba). Këto proverba që në libër janë të shpërndara gjithandej, do t'i gjeni të dhëna më poshtë sipas radhitjes alfabetike.\*

Qeni i uritur i ha dhentë e veta.

Më mirë është të flesh i uritur sesa të frysh barkun me borxhe.

Më mirë është të flesh i uritur sesa të zgjohesh me borxhe.

Uria të çon të bësh gjithçka.

Mos u frikëso nga hidhërimi i të drejtit, por nga qetësia e tiranit.

Sa më shumë që t'i priten degët drurit aq më tepër rritet.

Ai që e mbyll gojën e hap qesen.

Më mirë është të vdesësh në mesin e shokëve sesa të jetosh pa shokë.

Paraja fitohet me para.

I mençuri nuk e thotë atë që e di; budallai nuk e di atë që e thotë.

I mençuri e di atë që e bën, nuk përzihet në atë që s'e di.

I mençuri i del në krye punës që e ka nisur.

Ai që do të mashtrojë, mashtrohet vetë.

Në botë s'ka barrë më të rëndë se borxhi.

Në botë as lumturia s'e ka skajin, as fatkeqësia fundin.

Pasurinë e atij që nuk jep për hir të Zotit, e merr djalli.

Ari është gur prove i njeriut.

■

\*\* Në tekst këto proverba janë radhitur sipas alfabetit turk, çka është e pamundur që kjo radhitje të ruhet edhe në përkthim në gjuhën shqipe. (Përkthyesi)

Ari nuk i ka hije as kopracit e as shkapërdarit; arma as frikacakut e as budallait.

Nuk ke bletë e shet mjaltë; si të sigurohemi se nuk je vjedhacak?<sup>183</sup>

Dëshira lind pushtetin.

Njeriu që e di se do të varet, nuk i frikohet litarit (tre-këmbëshi).

Në shtëpinë e atij që është varur nuk flitet për litarin.

Të dashuruarin gjithkush e zë për të marrë.

Dashuria është kripa e jetës.

Përmbysja e zjarrit nuk ia dëmton flakën.

Zjarri, atë që s'e djeg dot, e nxin.

Fuqia e zjarrit del në pah ditëve të dimrit, vlera e dëborës ditëve të verës.

Atë që vegjelia s'e kupton dot, e shenjtëron.

Vegjelia është e pasionuar pas gjërave të jashtëzakonshme.

Gjuetari dhe peshkatari kurrë s'bëhen pasanikë.

E rralla është e vlefshme.

Gjëja e fituar me pak mundim duket e ëmbël.

Me pak ushqim, kokë të qetë.

Më mirë është ta marrësh të paktën sesa ta lypësh të shumtën.

Mos i fol vreshtarit për dhentë, as bariut për rrushin.

Lumturia nuk është qetësi.

Ai që blen pa parë, mashtrohet.

Mos u bëj mjaltë, se të hanë mizat.

Gabimet e të tjerëve janë shkak për përmirësimin e tonave.

Mos e ço dorën në xhepin e tjetrit, as syrin në letrën e tjetrit.

Ai që nuk di, devijon.

Tjetër është ajo çka mendon kalorësi, e tjetër ajo çka mendon kali.

■

<sup>183</sup> Proverb spanjoll.

Ai që mbështetet pas një druri të madh gjithnjë është nën hije.

Një çinar (rrap) nuk pritet me një sëpatë.

Ai që dashuron me një të parë, harron me një të paparë.

Një punë e mirë është më e mirë se një mijë fjalë të bukura.

Nuk zgjat shumë dashuria e atij që dashurohet në shikimin e parë.

Të marrësh borxh do të thotë ta shesësh veten.

Qypi i zbrazët bën zë shumë.

Për lukthin e sëmurë edhe gjëja më e ëmbël është e hidhur.

Zogu bezdiset së kënduari, gruaja nuk bezdiset së dashuruari.

Në lumenjtë e mëdhenj ka peshq të mëdhenj.

Fitimi i madh ka edhe humbjen e madhe.

Madhështia fitohet me drejtësi, lumturia me sjellje të mirë.

Gjuetia nuk bëhet në xhade.

Ai që largohet nga xhadeja e humb rrugën.

Gruaja e paditur është më e mirë se burri i paditur.

Trimëria më e madhe është durimi dhe toleranca.

Burrit trim ia zgjat dorën fati.

Kur lodhet trupi, çlodhet mendja.

Fytyra është piktura e zemrës.

Buka e misrit që e ha bujku është më e ëmbël se bakllavaja e Ajvazit.

Syri i bariut është më i mirë se dhëmbët e njëqind qenve.

Ai që mendon shumë, pak punë bën.

Ai që mendon shumë, rrallëherë mashtrohet.

Ai që beson shumë, mashtrohet.

Ai që nis shumë punë, asnjërën s'e kryen dot.

Ajo që është shumë, nuk zgjat shumë.

Gëzimi i madh tregon lumturinë e vogël.

Mos nis punë me njerinë që flet shumë.

Kush flet shumë, rren shumë.

Mos prit shumë punë prej njeriut që flet shumë.  
Kush flet shumë, fiton armiq shumë.  
Lavdërimi i tepërt është një lloj nënçmimi.  
Nuk i besohet shumë premtimit të atij që premtton shumë.

Nuk shkojnë dot bashkë ngrënia e tepërt dhe gjumi i rahatshëm.

Ata që vdesin nga të ngrënët e tepërt janë më shumë sesa ata që vdesin nga uria.

Gjëja që fitohet me mundime të mëdha, edhe vlerën e ka më të madhe.

Nuk bje në kurth zogu që nuk lëshohet pas kokrrave.  
Këshillimi e shton bashkimin.

Ai që nuk merr këshilla, nuk merr as ndihmë.

Ai që vjen pa ftesë, shkon pa leje.

Luksi është krimb i kapitalit, fama krimb i lirisë.

Shtamba e shpuar s'mbushet dot.

Ta këshillosh të marrin, ia shton marrëzinë.

S'bën para kalorësi në det, e as lundërtari në të thatë.

Të qash për dertin e pazgjidhshëm, është marrëzi.<sup>184</sup>

Gjuha gjithnjë shkon aty ku dhemb dhëmbi.

Gjuha e memecit është më e mirë se e rrenavecit.

Fjala e drejtë është e fortë, fjala e keqe është e butë.

Ndihmësi i të drejtit është drejtësia, kurse i rrenavecit e gjithë bota.

Askush s'e do njerinë që flet drejt.

Miku është pasqyra e përsosurisë, armiku pasqyra e së metës.

Mik është ai që të shpëton nga gjendja e vështirë.

Mos ki frikë nga shuplaka e mikut, por nga buzëqeshja e armikut.

Kjo botë është arrë e botës tjetër (ahiretit).<sup>185</sup>

■  
<sup>184</sup> Davudi.



Mos prit mirë prej njeriut që është bezdisur nga jeta e tij.  
 Ki frikë mikut që takohet me armikun tënd.  
 Mendohu, konsultohu, nis punën.  
 Të flasësh pa menduar, është sikur të hedhësh shigjetën  
 pa shenjuar.  
 Nuk këmbehet veza e shtëpisë me pulën e çarshisë.  
 Më mirë është të mos e humbasësh atë që e ke, sesa ta  
 fitosh atë që s'e ke.  
 Armikun më të madh e ke atë që merret me shoshitjen  
 e punës që ke bërë.<sup>186</sup>  
 Profesioni më i keq është joprofesioni.  
 Kirurgu më i mirë është ai që ka marrë vetë shumë plagë.  
 Dhjamin që s'do ta shkrish, mos ia afro zjarrit.  
 Të thuash shtëpi, do të thotë të thuash grua.  
 Plaçkitja e shtëpisë quhet vjedhje, plaçkitja e një vendi  
 quhet çlirim.  
 Buka e thekrit e shtëpisë është më e mirë se buka e gru-  
 njtë e çarshisë.  
 Askush s'ia jep hakun të varfrit e mendjen të dobëtit.  
 I varfri jep për të marrë më tepër.  
 Njeriu i keq thyhet lehtë, e ngjitet rëndë.  
 S'ka dallim ai që porosit të keqen nga ai që e bën atë.<sup>187</sup>  
 Mendimet përmirësohen me kohën, kurse lëvizjet me  
 përvojën.  
 Njeriu që ka ide të mëdha, ai ka dhe zemër të butë.  
 Fëmija që lind vonë, herët mbetet jetim.  
 Rinia është një dehje e vazhdueshme.  
 Syri është një dritare e shpirtit.  
 Ai që i hap sytë s'mbetet dot i uritur.  
 Ai që fryhet nga krenaria, sigurisht një ditë pëlçet.

■  
<sup>185</sup> Hadith. *Ed-dunja mazra'atu'l-ahirah* [botuesi].  
<sup>186</sup> Proverb spanjoll.  
<sup>187</sup> Hadith [botuesi].

Ajo që është e vështirë, është më e dëshirueshme.  
 Fytyra e qeshur është kripa e bukurisë.  
 Dita është e shkurtër, puna e gjatë.  
 Mos i besoj atij që s'beson.  
 Ai që vesh tesha të bukura nuk është rrobaqepës.  
 Arsyeja pse e drejta jepet vështirë, është se kërkohet me të drejtë.  
 Gëzimi i pamërituar, zgjat shkurt.  
 Krijuesi shikon njetin (qëllimin), krijesat shikojnë punën.  
 Ai që e do Krijuesin i do dhe krijesat.  
 Fundi i pasurisë së lindur nga smira vjen nga shkapërderdhja.  
 Dorështrënguari dhe shkapërderdhësi janë të barabartë në mosshfrytëzimin e pasurisë.  
 Vonimi i së mirës është sherr.<sup>188</sup>  
 Dhurata u ka hije të huajve, shërbimi të dashurve.  
 Mos e thuaj krejt atë që e di, mos mendo për krejt atë që e sheh.  
 Në çdo mendim ka gabim, në çdo lëvizje ka lëndim.  
 Për secilin sy ka nga një të bukur.  
 Fundi i çdo pune është më i mirë se fillimi i saj.  
 Ai që i beson çdo gjëje që dëgjon, është rrenacak.<sup>189</sup>  
 Sikur çdo gjë që shkëlqen të ishte flori, s'do t'i mbetej vlerë floririt.  
 Çdo gjë është armike e së kundërtës.  
 Çdo gjë ka kohën e vet.  
 Ai që dëgjon gjithkënd, është kokëdele.  
 Atë që do gjithkënd, e do gjithkush.<sup>190</sup>

■  
<sup>188</sup> Hadith [botuesi].

<sup>189</sup> Hadith [botuesi].

<sup>190</sup> *E duan atë që do, i dashuri duhet // E flakin nga zemra atë që flaket nga syri (HAKIKIU: Irşad-*

Butësia njeriun e bën të dashur për të gjithë.  
 Nga India sheqeri, nga Amerika duhani.  
 Nga këngëtari i moshuar nuk lypet këngë e re.  
 Lumturia e pleqërisë është nipi.  
 Pleqëria nuk njihet jetë.  
 Dija është e gjatë, jeta e shkurtër.  
 Kujdesi bën punë më shumë se dija.  
 Privilegji është ndihmëtar i padrejtësisë.  
 Vesin që e fiton njeriu në djep, e braktis në tabut.  
 Njeriu është zotëri i asaj që ka dhe rob i asaj që s'e ka.  
 Njeriu në rini duhet të mendojë për pleqërinë, kur është  
 i shëndoshë për sëmundjen.  
 Njeriu nuk e do dashuruesin e tij, por lavdëruesin.  
 Njeriu gjen atë që e bën.  
 Njeriu kur bezdiset me tokën e ngre kokën kah qielli.  
 Njeriu s'ka armik më të madh se njeriun.  
 Ajo që e tregon vlerën e njeriut është zelli i tij.  
 Baza e njeriut është nderi.  
 Fotografia e brendshme e njeriut është puna e tij.  
 Përsosuria e njeriut kuptohet pas vdekjes së tij.  
 Njerëzit ndryshojnë, njerëzia nuk ndryshon.  
 Më i ligu i njerëzve është ai që i përkulet të ligut.  
 Më i miri i njerëzve është ai që sillet mirë me njerëzit.<sup>191</sup>  
 Dallimi midis njerëzve është në kokat e tyre, e jo te  
 këmbët.  
 Rregullsia e mund shumësinë.  
 Vështirësitë vijnë nga pasioni, mirëqenia vjen nga kë-  
 naqja me atë që ke.  
 Drita e tregon sendin, kurse pasuria njeriun.  
 Në punë nuk lypet teprimi, por vazhdueshmëria.

■  
 name: Manisa Il Halk Ktp. 1296. sy. 53<sup>b</sup>. yr.)  
 [botuesi].

<sup>191</sup> Hadith. (Botuesi).

Ai që i fsheh gabimet e tij i shton ato dhe më, kurse ai që i tregon i shpërndan.

Arra që ka lëvozhgë të hollë, thelbin e ka të madh.

Te femra fitimtare është zemra, te mashkulli mendja.

Drejtësia e zemrës fiton miq, kurse drejtësia e mendjes armiq.

I përsosuri kërkon nderin, i pasuri urtësinë.

Kënaqja me atë që ke është kështjellë kundër robërisë.

Në të vendosur duhet menduar, në të vepruar s' duhet ngurruar.

Në të vendosur duhet qenë frikacak, në të zbatuar duhet qenë trim.

Atij që ruan sorra, i dalin sytë.

Zije ushqimin para se të uritesh.

Miza nuk ulet në dhjamin e pashkrirë.

Ka fituar ai që e ha atë që e ka fituar.

Ai që s'është qel, nuk turpërohet ta heqë fesin prej koke.

Mos kërko ndihmë në punën që mund ta bësh vetë.<sup>192</sup>

Njeriu që nuk është në gjendje të mbarojë punët e veta, nuk mund të mbarojë punët e kurrkujt.

Nuk ta pret faqen brisku i mprehtë, por brisku që s'e pret dot as qimen.

Devotshmëria e tepërt është dyfytërsi.

Të thyesh është më mirë se të lakohesh.

Nëna e frikacakut as nuk qanë as nuk qeshet.

Frikacaku të fut frikën.

Nuk i kërkohet ndihmë tigrin për t'u shpëtuar qenve.

Gruaja e qorrit nuk duhet të stoliset.

Vetmia është më e mirë se të rrih me një shok të keq.

Qeni i tërbuar së pari e kafshon zotërinë e tij.

Qenit që gjuan ujë exheli i vjen nga dhëmbët e ujkut.

Ujku atje ku ka gjetur një qengj, atje e kërkon sërish.

■  
<sup>192</sup> Proverb spanjoll.



Ai që dëshiron ta hajë zogun, së pari e puçlit atë.

Kur sosit pusi, nuk i dihet vlera ujit.

Ai që s'u jep rëndësi punëve të vogla, s'i shkojnë për dore as punët e mëdha.

Nëse nuk ndalet gruri nga koteci, as koteci nuk mbetet pa pula.

Nëse s'di të lundrosh, mos i hip barkës.

Gjëja e panevojshme është e shtrenjtë edhe sikur të jetë lirë.<sup>193</sup>

Më mirë është të vdesësh fitimtar sesa të jetosh i mposhtur.

Ai që s'është i gjykuar është gjykatës; ai që s'është i nënshtruar është epror.

Pasi të shitet malli dalin shumë myshterinj.

Lavdërimi më i pranueshëm është ai që del nga goja e armikut.

E keqja shumë rrallë vjen vetë.

Diskutimi lind nga të menduarit.

Zëri i muezinit është në përpjesëtim me lartësinë e minares.

Gjënë që ia jep përbuzësit, e ke hedhur në det.

Mos u bëj as borxhmarrës i pasanikut, as borxhdhënës i fukarasë.

Lumi humbet në detë, vlera në interes.

E meta është tepricë e përkryerjes.

Njeriu i pjekur ka shpirt të shqetësuar e fytyrë të qeshur.

Gomarin ortak e ha ujku.

Pas agjërimit vjen bajrami.

Kush s'merr këshilla, s'kërkon as ndihmë.

Nuk rrihet përpara kaut, pas mushkës e në asnjë anë të të pandershmit.

Nuk i jepet këshillë atij që ka nevojë për para.

■  
<sup>193</sup> Një deve, një akçe. [b.]

Në pazar shiten edhe lule edhe therra.  
Kush rri ulur i qetë, nuk çohet në këmbë.  
Nuk duhet qëndruar përballë erës, kryeneçit dhe të marrit.  
Lumturinë kërkojë, fatkeqësinë prite.  
Durimi dhe shpresa nuk bashkohen me pendimin.  
Nuk zbrazet qesja me dhënien e lëmoshës.  
Është marrëzi ta këshillosh shurdhanin.  
Nuk bën ta shash të shurdhtin, e t'i vësh gurë qorrit.  
Njeriu që mundohet ta fshehë dehjen duket edhe më i dehur.

Pasuria nuk t'i shton mendtë.

Pasuria dhe modestia janë armiq të njëra-tjetrës.

Duaj që të duhesh.

Ai që dëshiron të duhet, duhet të dojë.

Kau lidhet për brirësh, kurse njeriu për fjalësh.

Në sofër nuk shtrohet libri, e as në masë ushqimi.

Shiu që bie në mot të ftohtë, nuk nxjerr lule të bukura.<sup>194</sup>

Mos prit fruta nga druri i shelgut, e as hije nga druri i hurmës.<sup>195</sup>

Mos shiko kush tha, por çka tha.

Fjala nuk kuptohet sikurse ari, për nga zëri.

Fjala dhe puna janë armiq të njëra-tjetrës.

Fjala është e lirë, puna e shtrenjtë.

Njeriu që e mban fjalën, shumë pak fjalë jep.

Delen që ndahet nga tufa e ha ujku.

Nuk bëhet mirë me rrugë të keqe.

Dyshimi është kriteri i së vërtetës.

Nuk ka njeri pa ambicie.

Përvoja nuk mashtrohet.

■  
<sup>194</sup> Përvoja [b.]

<sup>195</sup> Në shëlg a mbinë molla // Pa u çarë, zhveshur  
e goditur me gurë // A piqet njeriu // Pa u  
sharë, rrahur e goditur me gurë. [b.]

Drejt rrezikut duhet shkuar ngadalë, drejt kujdesit duhet shkuar shpejt.

Për të qenë i pastër duhet lëvizur.

Më shumë duhet armiku i ndershëm sesa miku i pandershëm.

Falënderimi i bëhet një të mire të vogël, kurse mosmirënjohja i bëhet një të mire të madhe.

Kush jep menjëherë, jep dy herë.

Me gomarin topall e me qesenë boshe nuk shkohet në Bagdad.

Shpresa është ëndrra që njeriu e sheh derisa është zgjuar.

Njeriu që jeton me shpresë, vdes urie.

Në ujin e fjetur mos e fut as edhe gishtin.

Në fjalët e gjata ka kuptim të shkurtër.

Vakëfin e jep All-llahu, e merr prapë shejtani.

Tradhtari nuk ka shokë besnikë.

Nuk duhet vajtuar një lirë e dhuruar, por dyzet paratë e humbura.

Rrenacaku kapet më lehtë se topalli.

Për këmbën e njeriut që është mësuar të ecë zbathur, çizmja është burg.

Zbatimi i gabuar është më i mirë se pavendosmëria.

Vendimi i gabuar është më i mirë se pavendosmëria.

Njerëzit që i ka mbytur ushqimi janë më të shumtë sesa ata që i ka shëruar Ibni Sina.<sup>196</sup>

Mos e ziej mishin që nuk do të mund ta hash.

Me të gërmihur tokën del ujë.

Njeriu që djersitet duke ngrënë, dridhet duke punuar.

Kush i del përpjetës, sigurisht që do ta shohë edhe tatëpjetën.

■  
<sup>196</sup> Proverb spanjoll. [Ibni Sina, një filozof dhe mjek musliman].

Kush për bashkudhëtar e ka shpresën, për shok e ka varfërinë.

Vështirësia e rrugës është në hapin e parë.<sup>197</sup>

Nuk i bie në dhëmbë gjë dhelpres që fle në strofullën e saj.

Njeriu që bart rëndë, hapin e ka të shkurtër.<sup>198</sup>

Nuk provohet forca kundër të dobët.

Pasaniku është kujdestar i mallit të tij.

Pasaniku është lakmitar.

Mos i premtu gjë pasanikut, të varfrit jepja gjënë e premtuar

Arusha që e këput zinxhirin, së pari e rrokullis të zotin e saj.

Edhe njeriu që bën padrejtësi bile është kundër padrejtësisë.

Zullumi lind nga frika.

## Proverbs

Shemseddin Sami [1850-1904] is a multidimensional Ottoman scientist. Most people know him from his *Kamus al-A'lam* [The Ocean of the proper names]. For many years his Turkish dictionary *Kamus-i Türki* [The Ocean of Turkish] was the most used source of reference. This prolific author was also interested in proverbs and maxims. In the newspaper *Sabah* during the years 1876-1877 under the title “şundan bundan” were published a number of sayings. Finally, Sami made a selection of them and in 1879 published the book *Emsal* [Proverbs]. It includes folk proverbs, translated maxims from written sources,

■

<sup>197</sup> Gjermanisht: *Aller Anfang ist schwer*.

<sup>198</sup> Shpejtësia e njeriut që bart barën është e mangët. Kadı Burhaneddin: *Divan*: 17<sup>b</sup> yr. Gazel 74/2<sup>a</sup>. [b.]



selected from Western and Eastern authors, men of science and literature, and almost half of them compiled by the same author, in general containing 2919 entries.

The book was translated into Albanian in 1975 by Zyber Hasan Bakiu, and re-published in 2004 in Skopje by Logos-A Publishing House. From various pages of the book here below are selected only folk proverbs altogether 279 entries, listed in alphabetical order.

## FJALA PËRMBYLLËSE

---

Të nderuar miq e kolegë. Më lejoni që edhe një herë këtu para Jush në këtë përfundim të kësaj konference, të shpreh kënaqësinë time të veçantë që pikërisht ne jemi nikoqirë të këtij tubimi të organizuar për një kolos aq të madh siç është Sami Frashëri. Kemi qenë shumë të nderuar që Ju të gjithë iu përgjigjët ftesës sonë.

Nuk dua ta zgjas më shumë, sepse mundet edhe të jeni lodhur, por megjithatë do të më falni edhe për një çast që ta mbyllim këtë konferencë.

Mysafirë të dashur, jam tejet i nderuar të konstatoj se urtia e Samiut: "Njerëzit e shkencës janë vëllezër edhe sikur t'u përkasin dy kombeve të ndryshme", gjeti vendin e saj më të mirë pikërisht në këto dy ditët e kësaj konference.

Andaj, më lejoni që për këtë dhe për gjithçka tjetër t'Ju falënderohem së pari ligjëruesve tanë që me kënaqësi pranuan të jenë me ne, pastaj edhe Juve mysafirë të nderuar, si dhe ata pa ndihmën e të cilëve kjo konferencë ndoshta edhe nuk do të bëhej kështu: në radhë të parë ASHARM, kryetarin e saj, akad. Cvetan Grozdanovin dhe akademikët e tjerë që, përveç se na ndihmuan që këtë konferencë ta mbajmë në mënyrë dinjitoze në lokalet e ASHARM, njëherit na nderuan edhe me faktin që me kënaqësi pranuan të ishin edhe si nikoqirë të këtij tubimi. Pastaj, më lejoni që këtu të falënderoj përzemërsisht edhe Agjencinë Turke për Bashkëpunim Ndërkombëtar (TIKA), e cila në funksion të sponsorit gjeneral të këtij tubimi, dëshmoi se kur është fjala për kulturën dhe shkencën, nuk ka kufij etnikë, linguistikë, gjeografikë apo politikë.

Më lejoni që po ashtu t'i falënderoj edhe ata që mbase sot janë lodhur më së shumti: përkthyesit tanë të shkëlqyer, falë punës së të cilëve, jemi marrë vesh më lehtë mes vete.

Dhe krejt në fund:

Ne si organizatorë nuk e dimë se çka do të thonë të tjerët për këtë punë që e bëmë. Megjithatë e dimë vetëm se ne jemi si disa fëmijë që në breg të detit mbledhin guaska dhe, me gjithë përpjekjet e shumta, nga ky det arrijnë të shtijnë në dorë vetëm disa që kanë dalë më në breg. E tillë mendojmë se është edhe puna jonë. Vjelja e guaskave të Samiut kujtoj se tash sa ka filluar.

Ju faleminderit dhe mirupafshim edhe në takime të ardhshme.

*Shkup, 20.11.2004*

*Mr. Adnan Ismaili  
Drejtor i SH.B. Logos-A*

## PËRMBAJTJA

- ◆ Parathënie / 7
- ◆ Pjesa e parë / 13
  - Bibliografi e veprës së Sami bej Frashërit / 13
- ◆ Veprat e Shemsedin Sami Frashërit / 15
- ◆ Sami Frashëri: Vepra në 20 vëllime / 43
- ◆ Bibliografi e shkrimeve për Shemsedin Sami Frashërin / 55
  - ◆ Pjesa e dytë / 91
  - ◆ Hapja e Konferencës Shkencore "Sami Frashëri 100 vjet pas" dhe promovimi i vëllimit Sami Frashëri 1-20, 19-20 nëntor 2004 / 91
- ◆ Fjala e organizatorit / 93
  - ◆ Prof. Dr. Remzi Nesimi Veprat gjuhësore të Sami Frashërit / 97
    - ◆ Fahri Kaja Shemsetin Sami beu / 101
    - ◆ Dr. Milazim Krasniqi Mundësitë e pashfrytëzuara të njohjes së vetes sonë / 109



- ◆ Fjala e ministrit të Arsimit  
dhe Shkencës,  
dr. Aziz Pollozhani / 115
  - ◆ Pjesa e tretë / 119
  - ◆ Kumtesat e Konferencës  
Shkencore "Sami Frashëri  
100 vjet pas" 19-20 nëntor  
2004 / 119
    - ◆ Akad. Ali Aliu  
Primesa letrare në veprën  
e Sami Frashërit / 121
    - ◆ Prof.dr.Ismail Ahmedi  
Vështrim krahasues mes dramës  
"Sejdi Jahja" të Sami Frashërit  
dhe "Princesha e Andaluzisë"  
të Ahmed Sheuki-ut / 127
    - ◆ Prof.Dr. Dr.Azmi Bilgin  
Veprat dhe idetë e Shemseddin  
Samiut  
mbi letërsinë / 137
    - ◆ Akad. Gane Todorovski  
Idetë universale në veprën e  
vëllezërve  
Sami dhe Naim Frashëri / 159
    - ◆ Matteo Mandalà  
Strukturat e rrëfimit në  
dramën "Besa"  
të Sami Frashërit / 167
    - ◆ Dr.Sali Bashota

Për enciklopedinë, romanin dhe  
dramën

e Sami Frashërit / 190

◆ Dr. Zeki Gyrel

Pozita dhe rëndësia e Sami  
Frashërit

në letërsinë turke / 198

◆ Prof.dr.Xhevat Lloshi

Ndihmesa e Sami Frashërit  
në fushën e gjuhësisë / 229

◆ Akad.Jorgo Bulo

Sami Frashëri dhe kodifikimi i  
shqipes / 240

◆ Akad.Luan Starova

Bërthamat enciklopedike te  
Sami Frashëri e Faik Konica -  
Kamus al-A'lam e Albania / 246

◆ Prof. Dr. Ömer Faruk Akün  
Shemseddin Samiu dhe Kamus-i  
Turki / 256

◆ Yumi Ishimareu

Shemseddin Sami Frashëri përçues  
i ideve etnike në shoqërinë  
osmane nga "Sabah" te "Hafta" /  
290

◆ Akad. Jashar Rexhepagiq

- Veçoritë thelbësore dhe  
rëndësia e veprës  
së Sami Frashërit / 302
- ◆ Prof. Dr. Mehdi Polisi  
Sami Frashëri - njeriu që  
shkeli në shumë  
fusha të diturisë / 316
  - ◆ Nexhat s. Ibrahimimi  
Aspekte të kontributit të Sami  
Frashërit  
në islamologji / 326
  - ◆ Prof.dr.Gazmend Shpuza  
Sami Frashëri midis  
shqiptarizmit dhe turkizmit /  
359
  - ◆ Prof.dr.Françesko Altimari  
Takimi i vatrave të diasporës,  
pikënisja e rilindjes shqiptare  
/ 369
  - ◆ Prof.Dr. Mustafa S. Kaçalin  
Fjalët e urta / 377
  - ◆ Fjala përmbyllëse / 392

V

E

P

Copyright©LogosA, 2006

Shënimi i katalogut CIP të këtij libri ndodhet  
në Bibliotekën Kombëtare Universitare  
ISBN 9989-58-215-7

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.  
Kjo parapëlqehet për qëllime promovuese të librit apo edhe për përkrahjen e  
kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet rirpodhimi, transmetimi apo  
kopjimi i këtij libri pa lejen paraprake të Logos-A.

A

O



# V E P R A O O

BIBLIOGRAFIA & KUMTESAT